

Validimi i Shqipërisë

Raport mbi të dhënat fillestare të mbledhura dhe konsultimet me grupet e interesit

Shkurtime

DSH	Dogana Shqiptare
AKBN	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKPT	Agjencia Kombëtare për Planifikimin e Territorit
ALBEITI	EITI Shqipëri
EFN	Ekuivalent i Fuçisë Naftë
Fnd	Fuçi në ditë
TAK	Tatimi për të Ardhurat Korporative
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
MPGN	Mbështetja Programore Globale për Nxjerrëset
EITI	Nisma për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse
BE	Bashkimi European
FIAA	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SFQ	Statistikat Financiare Qeveritare
GWh	gigavat orë
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
INSTAT	Instituti i Statistikave
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Kontrollit të Lartë
SNA	Standardet Ndërkombëtare për Auditimin
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
FTSHD	Fond i Trustit Shumë-Donatorësh (MDTF)
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
MEI	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MSG	Grupi Ndërshtetëror i Punës
OJQ	Organizatë Joqeveritare
KKN	Kompani Kombëtare e Naftës
IQBN	Instituti i Qeverisjes së Burimeve Natyrore
MNP	Marrëveshje për Ndarjen e Prodhimit
Kks	Këmbë kubike standarde
NPSH	Ndërmarrje në Pronë të Shtetit
TeR	Termet e Referencës
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
USD	Dollari Amerikan
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Tabela e Përmbajtjes

Shkurtime	2
Përmbledhje Ekzekutive	5
Hyrje	15
Pjesa I – Mbikqyrja e MSG	19
1. Mbikqyrja e procesit EITI	20
Angazhimi i qeverisë në procesin EITI (#1.1)	20
Angazhimi i industrisë në procesin EITI (#1.2)	24
Angazhimi i shoqërisë civile në procesin EITI (#1.3)	26
Plani i punës (#1.5)	45
Pjesa II – Publikimet e EITI	52
2. Akordimi i kontratave dhe licensave	52
Kuai Ligjor (#2.1)	52
Akordimi i licensave (#2.2)	55
Regjistrat e licensave (#2.3)	63
Publikimi i kontratave (#2.4)	67
Publikimi i pronësisë reale (#2.5)	69
Pjesëmarrja e shtetit (#2.6)	71
3. Monitorimi dhe prodhimi	80
Vështrim mbi sektorin e nxjerrjes, përfshi veprimtaritë e eksplorimit (#3.1)	80
Të dhëna për prodhimin (#3.2)	81
Të dhëna për eksportin (#3.3)	84
4. Grumbullimi i të ardhurave	88
Materialiteti (#4.1)	88
Të ardhura në natyrë (#4.2)	94
Transaksione ndihmëse dhe infrastrukture (#4.3)	98
Të ardhura transporti (#4.4)	99
Transaksione midis NPSH-ve dhe qeverisë (#4.5)	100
Pagesa direkte lokale (#4.6)	102
Niveli i disagregimit (#4.7)	104
Përshtatshmëria në kohë e të dhënave (#4.8)	105
Cilësia e të dhënave (#4.9)	107
5. Menaxhimi dhe shpërndarja e të ardhurave	123
Shpërndarja e të ardhurave (#5.1)	123
Transferta lokale (#5.2)	125
Informacion shtesë mbi menaxhimin dhe shpenzimet e të ardhurave (#5.3)	128
6. Shpenzimet sociale dhe ekonomike	132
Shpenzime sociale (#6.1)	132
Shpenzime gjysmë fiskale të NPSH-ve (#6.2)	135
Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi (#6.3)	136

Pjesa III – Rezultatet dhe Ndikimi	141
7. Rezultatet dhe Ndikimi.....	141
Debati publik (#7.1).....	141
Aksesueshmëria e të Dhënave (#7.2).....	145
Mësime të nxjerra dhe ndjekja e rekomandimeve (#7.3)	147
Rezultatet dhe ndikimi i zbatimit (#7.4)	150
8. Analiza e ndikimit	157
Shtojca	Error! Bookmark not defined.
Shtojca A - Lista e anëtarëve të MSG dhe kontaktet.....	160
Shtojca B – Ndjekja e takimit me MSG	162
Shtojca C – Kostoja e Raporteve EITI.....	163
Shtojca D - Lista e grupeve të interesit të konsultuar	164
Shtojca E - Lista e dokumenteve të referencës	167
Bibliografi.....	167

Indeks i figurave dhe tabelave

Figura 1– Karta e vlerësimit fillestar.....	13
Tabela 1 – Tabelë e përmbledhjes së vlerësimit fillestar - Mbikqyrja nga MSG.....	48
Tabela 2- Tabela e përmbledhjes së vlerësimit fillestar: Akordimi i kontratave dhe licensave	77
Tabela 3- Tabela e përmbledhjes së vlerësimit fillestar: Monitorimi dhe prodhimi	86
Tabela 4- Tabela e përmbledhjes së vlerësimit fillestar: Grumbullimi i të ardhurave.....	118
Tabela 5 - Tabela e përmbledhjes së vlerësimit fillestar: Menaxhimi dhe shpërndarja e të ardhurave ...	130
Tabela 6- Tabela e përmbledhjes së vlerësimit fillestar: Shpenzimet sociale dhe ekonomike	139
Tabela 7 - Tabela e përmbledhjes së vlerësimit fillestar: Rezultatet dhe ndikimi	154

Përmbledhje Ekzekutive

Qeveria e Shqipërisë u angazhua të vinte në zbatim EITI-n më 27 dhjetor 2008, duke miratuar Urdhrin Nr. 156 për ngritjen e një Grupi Pune Ndër-Institucional, i cili do të përgatiste aplikimin për kandidaturën e Shqipërisë për në EITI. Vendi u pranua si kandidat për në EITI në maj 2009 në takimin e Bordit të EITI në Uashington DC në Shtetet e Bashkuara. Një MSG i përhershëm u emërua më 21 korrik 2011, pas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 71. Në shtator 2013, qeveria përcaktoi Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) si institucioni përgjegjës për të mbikqyrur industritë nxjerrëse në Shqipëri. MSG kryesohet nga Zëvendës Ministri i Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe përbëhet nga përfaqësues nga qeveria, industria dhe shoqëria civile.

Më 25 tetor 2016, Bordi ra dakord se Validimi i Shqipërisë sipas Standardeve EITI 2016 do të fillonte më 1 prill 2017. Ky raport përfaqëson gjetjet dhe vlerësimin fillestar të të dhënave të grumbulluara dhe konsultimeve me aktorët nga ana e Sekretariatit Ndërkombëtar. Sekretariati Ndërkombëtar ka ndjekur Procedurat e Validimit¹ dhe ka aplikuar Udhëzimet për Validimin² gjatë vlerësimit të përparimit të Shqipërisë në lidhje me Standardin EITI. Edhe pse vlerësimi nuk është shqyrtuar nga MSG apo nga Validuesi i pavarur, vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se një numër kërkesash të Standardit EITI nuk janë trajtuar plotësisht. Katër nga kërkesat janë vlerësuar si të paplotësuara, me përparim të pamjaftueshëm ose pa përparim. Rekomandimet dhe veprimet korrigjuese të sugjeruara që janë identifikuar nëpërmjet këtij procesi lidhen në veçanti me angazhimin e shoqërisë civile dhe mbikqyrjen nga MSG, sigurimin e cilësisë së të dhënave dhe se sa tërësore është raportimi si nga qeveria ashtu edhe nga industria, si dhe ndërmarrjet në pronësi shtetërore, përfshi shpenzimet gjysmë-fiskale, marrëdhëniet financiare me qeverinë dhe nivelin e pronësisë shtetërore.

Përfundime të përgjithshme

Shqipëria është i vetmi vend në Ballkan që vë në zbatim EITI-n, në përputhje me përpjekjet e saj për t'iu bashkuar Bashkimit Europian (BE). Në dritën e historisë së saj të një mjegulle lidhur me menaxhimin e burimeve të saj natyrore, vendi është përpjekur ta përdorë EITI-n për të siguruar llogaridhënie ndaj komuniteteve tek të cilat zhvillohen projekte nafte, gazi dhe minerare. Një numër projektesh në horizont, përfshi Gazsjellësin Transadriatik (TAP) për gazin natyror dhe perspektivat pozitive për eksplorimin e naftës nga Shell, ka shtuar nxitjen komerciale për përmirësimin e mëtejshëm të transparencës.

Shqipëria filloi ta zbatonte EITI-n në vitin 2009 për të fokusuar përpjekjet e qeverisë për të siguruar menaxhim transparent dhe të përgjegjshëm të burimeve natyrore. Zbatimi i EITI-t plotësonte reformat më

¹ <https://beta.eiti.org/document/validation-procedures>

² <https://beta.eiti.org/document/validation-guide>

të gjera ekonomike, financiare dhe institucionale, në veçanti një Ligj të ri për Minierat dhe Hidrokarburet. Një tjetër pikë e fortë e zbatimit të EITI-t nga Shqipëria kanë qenë përpjekjet e saj për ta përdorur procesin për të trajtuar shqetësime vendore, si nëpërmjet përpjekjeve aktive të shpërndarjes së informacionit ashtu edhe duke zgjeruar gamën raportimit EITI në sektorin e hidroenergjisë. Qeveria është duke shqyrtuar mundësinë për ta shtrirë raportimin sipas EITI edhe në sektorët pyjorë dhe të peshkimit – industri me rëndësi strategjike me kontribut domethënës në ekonominë e vendit.

Qeveria e Shqipërisë e ka mbështetur zbatimin e EITI, duke sanksionuar kërkesat për raportim në legjislacionin e sektorit si dhe duke ndjekur zbatimin për të siguruar transparencë të plotë për të ardhurat, edhe pse disa ente të qeverisë nuk kanë qenë plotësisht bashkëpunuese. Përfaqësues nga agjenci të tilla si Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI), Ministria e Financës (MF), Ministria e Drejtësisë (MD), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Drejtoia e Doganave kanë kontribuar për punën e MSG, kanë ofruar të dhëna për raportet EITI si dhe kanë mbështetur përfshirjen e raportimeve sipas EITI në sistemet e qeverisë. Përfaqësues nga industritë e naftës, gazit dhe minerare janë mbështetëse ndaj EITI-t dhe e gjejnë të dobishëm për marrëdhëniet e tyre publike, çka ndihmon për të përmirësuar të kuptuarit nga publiku. Pjesa e shoqërisë civile ishte aktive në fillim të procesit EITI por është bërë gjithnjë e më pak aktive me kalimin e kohës; vazhdojnë të mbështesin raportimin sipas EITI dhe të kërkojnë më shumë transparencë, por nuk shfrytëzojnë të dhënat nga EITI në praktikë. Sfidat e brendshme të shoqërisë civile pengojnë në mënyrë efektive pjesëmarrjen e sektorit më të gjerë në procesin EITI dhe kufizojnë efektshmërinë e EITI-t.

Procesi i zbatimit ka pasur mbështetjen të fortë nga Banka Botërore, e cila ka ofruar financim të konsiderueshëm prej vitit 2013. Qeveria kontribuon duke ofruar zyrat për Sekretariatit AlbEITI pranë MEI, duke punësuar nëntë vetë, dhe duke mbuluar disa prej veprimtarive të specifikuara në planin e punës së MSG. Zbatimi i Standardit EITI është nxitur në radhë të parë nga Sekretariati AlbEITI në bashkëpunim të ngushtë me MEI, duke pasur një angazhim aspak frymëzues nga shoqëria civile dhe industria. Ndërkohë që ka pasur raste kur përfaqësues individualë të kompanive apo aktivistë të shoqërisë civile që kanë luajtur role proaktive në raportim, përhapje dhe shpërndarje, ka pak të dhëna që tregojnë se këto dy grup po punojnë në mënyrë të efektshme. Në mungesë të mbikqyrjes ndërinstitucionale të zbatimit, Sekretariati AlbEITI është shndërruar në një ent gjysmë të pavarur qeveritar. Ndërkohë që kjo përjasje është provuar si e efektshme në fuqizimin e AlbEITI për të zgjeruar shtrirjen e zbatimit tek hidroenergjia dhe, në të ardhmen, pagesa mjedisore, peshkim dhe pyjëtar, duket sikur ka ardhur në dëm të mbikqyrjes domethënëse të procesit EITI nga aktorët. Tani do të ishte me vend të rishikohej struktura institucionale e zbatimit të EITI në Shqipëri për të përmirësuar mbikqyrjen nga MSG.

Disa aspekte të Standardit EITI janë veçanërisht me vend për disa prej sfidave kyçe të Shqipërisë që kanë qenë burime kundërshtish publike në të kaluarën. Kërkesat e Standardit EITI që lidhen me sqarimin e menaxhimit të burimeve jashtë buxhetit, marrëdhëniet financiare midis ndërmarrjeve në pronësi shtetërore dhe qeverisë, të dhënat për prodhimin, shpenzimet sociale, transfertat lokale dhe praktikat e auditimit, të gjitha prekin çështje që aktorët i konsiderojnë sensitive. Standardi EITI ofron një mundësi unike për t'i trajtuar këto çështje.

Pavarësisht nga sfidat në mbikqyrjen nga MSG dhe boshllëqe të caktuara në raportim, zbatimi i EITI ka

çuar në ndikime të prekshme nëpërmjet reformave të qeverisë dhe një ndërgjegjësimi më të madh nga komunitetet në lidhje me të drejtat e tyre. Për shembull, pas rekomandimeve të Raportit EITI 2011, Shqipëria ka ngritur një regjistër licensash të aksesueshëm publikisht për të gjitha licensat minerare, të naftës dhe gazit. Pas rekomandimeve të lidhura me transfertat lokale inaktive të të ardhurave minerare në Raportet EITI 2013 dhe 2014, qeveria po ashtu ka reformuar Ligjin mbi Tatimet, në fuqi prej janarit 2015, duke zbritur transfertat nga 25% në 5% të rentës tek NJQV-të, ndonëse pa kushte për të lejuar ekzekutimin e transfertave.

Rekomandime

Ndërkohë që raporti i mëposhtëm përfshin rekomandime për përmirësime specifike që MSG mund të dojë të marrë në konsideratë për zbatim, më poshtë gjendet një listë rekomandimesh strategjike që mund ta ndihmonin Shqipërinë të shfrytëzonte edhe më shumë EITI-n si instrument për të mbështetur reformat.

1. MSG duhet të sigurojë pjesëmarrje më konseguente të përfaqësuesve të qeverisë në veprimtaritë e shpërndarjes.
2. Për të forcuar zbatimin, pjesa e industrisë nxitet që të sigurohet që anëtarësia në MSG të jetë përfaqësuese e strukturës së sektorëve të minierave, hidroenergjisë, naftës dhe gazit dhe që rregullsia dhe niveli i pjesëmarrjes së industrisë në MSG të jetë në përputhje me nevojën e MSG për të marrë vendime të informuara dhe për të ndjekur pikat e caktuara për veprim. MSG duhet të sigurojë raportim tërësor nga të gjitha kompanitë materiale.
3. Në përputhje me kërkesën 1.3.a, pjesa e shoqërisë civile duhet të demonstrojë se janë të angazhuar plotësisht, aktivisht dhe efektivisht në procesin EITI. Specifikisht, shoqëria civile duhet të sigurojë që të jenë në gjendje të kontribuojnë plotësisht dhe të ofrojnë input për procesin EITI dhe që kanë kapacitetin e përshtatshëm për të marrë pjesë në EITI. Në përputhje me kërkesën 8.3.c., pjesa e shoqërisë civile duhet të zhvillojë dhe publikojë një plan veprimi për të trajtuar mungesat në angazhimin e kompanive dokumentuar në vlerësimin fillestar dhe raportin e validuesit brenda tre muajsh nga vendimi i Bordit, dmth <Vendim Bordi + 3 muaj>. Sektori mund të dojë të ndërmarrë një shqyrtim të pavarur të angazhimit të shoqërisë civile në EITI në Shqipëri, duke zgjeruar angazhimin me OSHC me interesa të mundshme në zbatimin e EITI. Ndërmarrja e një vlerësimi për nevojat për kapacitete dhe formulimi i veprimeve për të trajtuar kufizimet në kapacitete të shoqërisë civile janë thelbësore, veçanërisht për të zhbllokuar financime nga partnerë zhvillimi dhe palë të tjera përkatëse. Sektori i shoqërisë civile nxitet që të zhvillojë dhe të bjerë dakord në lidhje me udhëzime që përcaktojnë efektshëm procesin me anë të të cilit do të zgjidheshin dhe do t'u kërkohej llogari përfaqësuesve në MSG.
4. Në përputhje me kërkesën 1.4.a.ii, MSG duhet të sigurohet që procedurat e tij për të emëruar dhe ndryshuar përfaqësuesit e grupit ndër-institucional të jenë publike dhe të konfirmojnë të drejtën e secilit grup aktorësh për të emëruar përfaqësuesit e vet. Për të forcuar zbatimin, qeveria nxitet të sigurojë që entet shtetërore përkatëse, të tilla si kompania kombëtare e naftës Albpetrol, duke pasur parasysh boshllëqet në raportimin për pjesëmarrjen shtetërore (*shih Kërkesa 2.6*), të përfaqësohen në MSG dhe se niveli i pjesëmarrjes së tyre të jetë në përputhje me nevojën e

MSG për të marrë vendime të informuara dhe të ndjekë veprimet për të cilat është rënë dakord. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.ii dhe 1.4.b.iii, MSG duhet të ndërmarrë veprimtari të efektshme informimi me grupe të shoqërisë civile dhe kompani, përfshi me anë të komunikimeve si media, faqja e internetit dhe letrat, duke informuar grupet e interesit për angazhimin e qeverisë për të zbatuar EITI-n dhe rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile. Anëtarët e MSG duhet të shërbejnë si ndërlidhës me grupet e tyre të interesit. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.vi, MSG duhet të sigurojë një proces përfshirës vendim-marrjeje gjatë të gjithë procesit të zbatimit, sidomos në lidhje me industrinë dhe shoqërinë civile. Sektorët e qeverisë dhe të kompanive nxiten që të sigurojnë që prania e përfaqësuesve të tyre në takimet e MSG të jetë konseguente dhe e një niveli mjaftueshëm të lartë për të marrë vendime dhe për t'i ndjekur ato. Rekomandohet gjithashtu që MSG të shqyrtojë procedurat e vlerësimit për anëtarët e vet me të cilat duhet të bien dakord të gjitha grupet e interesit.

5. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të bjerë dakord për një plan pune që lidhet me përparësitë kombëtare dhe që të jetë produkt i konsultimeve të gjera me grupet e interesit. Lidhje më të qarta me diskutime e përparësi kombëtare do të nxisnin pjesëmarrje më aktive nga të gjitha grupet e interesit dhe do të nxihmonin për të mobilizuar burime shtesë. MSG duhet të trajtojë qëndrueshmërinë financiare të zbatimit të EITI nga pikëpamja afatmesme.
6. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të eksplorojë potencialin e shfrytëzimit të raportimit EITI për të vënë në pah mospëputhje në kuadrin ligjor, mjedisor dhe fiskal si dhe përgjegjësitë rregullatore në sektorët e minierave, naftës dhe gazit në Shqipëri. MSG mund të dojë ta lidhë raportimin EITI me asistencën e planifikuar teknike në sektorët e minierave, naftës dhe gazit për të siguruar që zbatimi i EITI të shërbejë si diagnozë për të mbështetur reforma në proces apo të planifikuara.
7. Në përputhje me kërkesën 2.2.a, MSG duhet të sigurojë bërjen publike vjetore të licensave në miniera, naftë dhe gaz që u dhanë (gjatë vitit/-eve) në shqyrtim, duke theksuar kërkesat teknike dhe financiare si dhe devijimet jo të vockla nga kuadri ligjor dhe rregullator përkatës që qeveris dhënien dhe transferimin e licensave.
8. Në përputhje me kërkesën 2.3.b, Shqipëria duhet të sigurojë që datat e aplikimit, akordimit dhe skadimit, të mirat e përfshira si dhe koordinatat për licensat në naftë, gaz dhe miniera që zotërohen nga kompanitë materiale të jenë në dispozicion të publikut. Qeveria nxitet ta vendosë këtë informacion në dispozicion për licensat që zotërojnë të gjitha kompanitë, pavarësisht nga fusha e tyre.
9. Në përputhje me kërkesën 2.4.b, Shqipërisë i kërkohet të dokumentojë në Raporte EITI të ardhshme politikën e qeverisë lidhur me publikimin e kontratave dhe licensave që qeveris eksplorimin për naftë, gaz dhe minerale. Kjo duhet të përfshijë dispozitat ligjore përkatëse, çfarëdo reformash të planifikuara apo në proces si dhe një shqyrtim të kontratave të publikuara tashmë.
10. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të shqyrtojë raportimin për pronësinë reale në Raportin EITI të ardhshëm me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për transparencën për pronësinë

reale dhe përkufizimet e pragjet për pronësinë reale. AlbEITI mund të dojë të kryejë informim më të gjerë tek kompanitë lidhur me objektivat e transparencës për pronësinë reale, si dhe të zhvillojë biseda me agjencitë qeveritare lidhur me mënyrën për t'i bërë këto publikime të detyrueshme.

11. Në përputhje me kërkesën 2.6.a, MSG duhet të ofrojë një shpjegim të rregullave dhe praktikave ekzistuese që lidhen me të ardhurat, ri-investimet dhe financimet nga palët e treta të NPSH-ve. Edhe qeveria duhet të sigurojë publikimin vjetor të çfarëdo ndryshimesh në pronësinë shtetërore të NPSH-ve apo nëndegëve të tyre, si dhe të japë llogari tërësore për çfarëdo huash apo garanci huash të dhëna nga shteti apo NPSH-të për kompani minerare, naftë dhe gazi, në përputhje me kërkesën 2.6.b.
12. Për të vazhduar forcimin e zbatimit, MSG mund të dojë të ndjekë rekomandimet e përsëritura nga Raporte EITI të mëparshme lidhur me sigurimin e saktësisë së përlllogaritjeve zyrtare për rezervat.
13. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurojë që Raportet EITI të ardhshme do të ofrojnë vëllime e vlera prodhimi të disagreguara për të gjitha mineralet kyçe prodhura në vitin/-et në shqyrtim. MSG po ashtu mund të dojë të punojë me entet përkatëse qeveritare për të siguruar që informacioni lidhur me çmiment vendase të të gjitha mineraleve të publikohet si pjesë e publikimeve rutinore të qeverisë.
14. Në përputhje me kërkesën 3.3, MSG duhet të sigurojë që Raportet EITI të ardhshme do të ofrojnë vëllime dhe vlera të disagreguara eksporti për të gjitha mineralet kyçe të eksportuara në vitin/-et në shqyrtim. MSG nxitet të ndajë qartë çfarëdo gazi natyror tranzit në të ardhmen nga zhvillimi i Gazsjellësit TAP prej eksporteve të tjera të Shqipërisë.
15. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të shohë mundësinë për të rishikuar pragun e materialitetit për përzgjedhjen e kompanive minerare për të gjetur balancën midis tërësisë së publikimit dhe cilësisë së raportimit. MSG mund të dojë të marrë parasysh një përjasje kampionimi, e cila do t'i lejonte hetimin e këtyre pagesave pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi. MSG po ashtu nxitet të sigurojë që Administratori i Pavarur të ofrojë opinionin e vet lidhur me tërësinë e Raportit EITI.
16. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurojë që Raportet EITI të ardhshme të disagregojnë qartë të ardhurat shtetërore në natyrë nga nafta e Albpetrol, siç ka bërë në Raportet EITI të mëparshme. MSG duhet të shqyrtojë mundësinë për t'u bashkuar [përpyqjes së shënjestruar](#) të EITI-t lidhur me tregtinë e mallrave për të ofruar një kuadër që do të siguronte se shitjet nga shteti të të ardhurave të veta në natyrë të jenë në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.
17. Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të sigurohet që Raportet EITI të ardhshme të trajtojnë qartë Kërkesën 4.3 dhe të përputhen me vlerësimin e MSG për mosaplikueshmërinë. MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën do të ishte i nevojshëm një rishikim i termave ekzistuese në kontrata minerare, gazi e naftë për të siguruar një vlerësim përfshirës të aplikueshmërisë së Kërkesës 4.3.

18. Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të shohë mundësinë për t'u siguruar që Raportet EITI të ardhshme të deklarojnë shprehimisht se qeveria dhe NPSH-të nuk përftojnë ndonjë të ardhur nga transporti i mineraleve, naftës bruto apo gazit natyror në vitin/-et në shqyrtim.
19. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet fort që të sigurojë që Raportet EITI të ardhshme të përfshijnë dividendët e Albpetrolit për qeverinë në fushën e rakordimit, në përputhje me kërkesën 4.5.
20. Në përputhje me kërkesën 4.6, MSG duhet të ndërmarrë studimin e pagesave të drejtpërdrejta vendore nga kompanitë nxjerrëse për NJQV-të, duke vendosur një bazë tërësore për diskutimet e MSG për materialitetin lidhur me pagesat drejtpërdrejt për NJQV-të. MSG mund të dojë të marrë në konsideratë një përjasje kampionimi, e cila do t'i lejonte pagesa të tilla të hetoheshin pa krijuar barrë të paarsyeshme raportimi.
21. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën mund të bëjë përparim në zbatimin raportimin EITI në nivel projekti për detyrime e tatime specifike për sektorin përpara afatit për të gjitha Raportet EITI që mbulojnë periudha fiskale që përfundojnë më ose pas 31 dhjetorit 2018, rënë dakord nga Bordi i EITI në takimin e tij të 36të në Bogota.
22. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të lidhet me agjenci kyçe për grumbullimin e të ardhurave dhe rregullatorë të sektorit për të shqyrtuar mjetet e përfshirjes së informacionit që kërkohet sipas EITI-t në sisteme rutine qeveritare për të siguruar raportim EITI më në kohë.
23. Në përputhje me Kërkesën 4.9.a, EITI kërkon një vlerësim nëse pagesat dhe të ardhurat i nënshtrohen auditimit të besueshëm, të pavarur, që aplikon standarde ndërkombëtare auditimi. Në përputhje me 4.9.b.iii dhe Termat e Referencës standarde për Administratorin e Pavarur rënë dakord nga Bordi i EITI-t, MSG dhe Administratori i Pavarur duhet:
 - a. të shqyrtojë procedurat e auditimit dhe sigurimit në kompanitë dhe organet qeveritare që marrin pjesën në procesin e raportimit EITI, dhe bazuar mbi këtë kontroll, të bien dakord se çfarë informacioni kërkohet që kompanitë dhe entet qeveritare pjesëmarrëse t'i paraqesin Administratorit të Pavarur me qëllim që të sigurojnë besueshmërinë e të dhënave në përputhje me Kërkesën 4.9. Administratori i Pavarur duhet të ushtrojë gjykim dhe të aplikojë standardet e duhura profesionale ndërkombëtare gjatë zhvillimit të procedurës që do të ofronte një bazë të mjaftueshme për një Raport EITI gjithëpërfshirës dhe të besueshëm. Administratori i Pavarur duhet të shfrytëzojë gjykimin e vet profesional për të përcaktuar masën në të cilën mund të mbështetet në kuadret ekzistuese të kontrollit dhe auditimit të kompanive dhe qeverive. Raporti fillestar i Administratorit të Pavarur duhet të dokumentojë opsionet e shqyrtuara dhe racionalen për siguri që do të ofrohen.
 - b. të sigurojnë që Administratori i Pavarur do të ofrojë një vlerësim të tërësisë dhe besueshmërisë së të dhënave (financiare) të paraqitura, përfshi një përmbledhje informuese të punës së kryer nga Administratori i Pavarur dhe kufizimet e vlerësimit të ofruar.
 - c. të sigurojnë që Administratori i Pavarur ofron një vlerësim mbi faktin nëse të gjitha

kompanitë dhe entet qeveritare brenda kuadrit të procesit të raportimit sipas EITI e kanë paraqitur informacionin e kërkuar. Çfarëdo boshllëqesh apo dobësish në raportim pranë Administratorit të Pavarur duhen publikuar në Raportin EITI, përfshi përmendjen e çfarëdo entesh që kanë dështuar t'iu përmbahen procedurave të dakorduara, si deh një vlerësim nëse kjo do të kishte një ndikim material mbi tërësinë dhe besueshmërinë e raportit.

24. Në përputhje me kërkesën 5.1.a, MSG duhet të sigurohet që të shpjegohet alokimi i të ardhurave nga industria nxjerrëse që nuk regjistrohen në buxhetin e shtetit, duke përfshirë linqe për raportet financiare përkatëse sipas rastit. MSG mund të dojë të eksplorojë masën në të cilën mund të shfrytëzonte klasifikimet specifike për industrinë nxjerrëse sipas klasifikimeve SFQ nga tabelat përmbledhëse EITI si mjet për të disagreguar përbërësit për industrinë nxjerrëse të taksave të zakonshme në sistemet ekzistuese të Ministrisë së Financave.
25. Në përputhje me kërkesën 5.2.a, MSG duhet të vlerësojë materialitetin e transfertave tek NJQV përpara grumbullimit të të dhënave dhe të sigurojë që të publikohet formula specifike për llogaritjen e transfertave tek qeveritë vendore specifike, për të mbështetur një vlerësim të mospërputhjeve midis transfertave të buxhetuara dhe atyre të ekzekutuara. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të interesit publik mbi këtë çështje, MSG mund të dojë të shohë mundësinë që t'i përfshijë NJQV-të në procesin e raportimit për transfertat tek to me qëllim që të sigurohet përputhshmëri për këto transaksione.
26. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të shqyrtojë përfshirjen e informacionit shtesë në proceset e buxhetimit dhe auditimit për llogaritë qeveritare në Raportet EITI në të ardhmen.
27. Në përputhje me kërkesën 6.1.a, MSG duhet të bjerë dakord për një dallim të qartë midis shpenzimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare sociale, përpara grumbullimit të të dhënave dhe të sigurohet që shpenzimet e detyrueshme materiale sociale të publikohen tërësisht në Raportet EITI në të ardhmen. Aty ku përfituesit e shpenzimeve të detyrueshme sociale janë një palë e tretë, dmth jo një agjenci qeveritare, MSG duhet të sigurohet të publikohet emri dhe funksioni i përfituesit. MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën do të ishte i nevojshëm publikimi i kontratave faktike minerare, të naftës dhe gazit (ose rishikimi i termave kyçe) për të siguruar një vlerësim tërësor të ekzistencës së shpenzimeve sociale të detyrueshme. MSG mund të dojë të shqyrtojë edhe fizibilitetin e përputhjes së shpenzimeve sociale të detyrueshme.
28. Në përputhje me kërkesën 6.2, MSG duhet të shqyrtojë ekzistencën dhe materialitetin e çfarëdo shpenzimesh gjysmë-fiskale ndërmarrë nga NPSH nxjerrëse dhe nënkontraktorët e tyre, duke siguruar që të gjitha shpenzimet materiale gjysmë-fiskale të publikohen në Raportet EITI në të ardhmen.
29. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet që të sigurohet se Raportet EITI në të ardhmen do të përfshijnë vlerën e kontributit të industrive nxjerrëse në PBB në terma absolute si dhe të ofrojnë shifra specifike për informacionin makro-ekonomik të zbuluar sipas Kërkesës 6.3. MSG nxitet që të studiojë masën në të cilën mund të ofrojë informacion të përditësuar makro-ekonomik lidhur me kontributin e industrive nxjerrëse më në kohë me anë të faqes së internetit të AlBEITI (ose








ndonjë faqeje tjetër qeveritare përkatëse).

30. Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të shohë mundësinë për të forcuar angazhimin e grupeve të interesit në komunikimet, përpjekjet për informim dhe shpërndarje, për të siguruar përhapje më të gjerë të informacionit dhe debat publik lidhur me çështje që lidhen me EITI. Qeverisja e burimeve natyrore dhe anti-korrupsioni janë tema të nxehta në Shqipëri dhe MSG mund të dojë të shqyrtojë përshtatjen e diskutimeve EITI me kërkesat e prekshme nga grupet e interesit.
31. Në përputhje me kërkesën 7.3, MSG duhet të ndëmarrë hapa për të vepruar pas mësive të nxjerra, për të identifikuar, hetuar dhe trajtuar shkaqet për çfarëdo mospërputhjesh, si dhe për të shqyrtuar rekomandimet që lindin nga raportimet EITI. MSG, në konsultim sidomos me aktorët qeveritarë, mund të dojë të shqyrtojë institucionalizimin e mekanizmave të veta për ndjekjen e rekomandimeve nga Raportet dhe Validimin EITI si mjet për të siguruar vëmendje më rigoroze ndaj zbatimit.
32. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të shihet mundësinë për të diskutuar rolin që mund të lunate EITI në arritjen e përparësive kombëtare për reforma të industrive nxjerrëse si pjesë e shqyrtimit të vet vjetor të planit të punës. MSG mund të dojë edhe të ndërmarrë një vlerësim të ndikimit me qëllim identifikimin e mundësive për të rritur ndikimin e zbatimit.

Figura 1– Karta e vlerësimit fillestar

Kërkesat EITI		NIVELI I PËRPARIMIT				
		Asnjë Përparim	Parafakturochë	Domethënës	Kënaqshëm	Përtej
Kategoritë	Kërkesat					
Mbikqyrja nga MSG	Angazhimi i qeverisë (#1.1)					
	Angazhimi i industrisë (#1.2)					
	Angazhimi i shoqërisë civile (#1.3)					
	Qeverisja e MSG (#1.4)					
	Plani i punës (#1.5)					
Licensat dhe kontratat	Kuadri ligjor (#2.1)					
	Akordimi i licensave (#2.2)					
	Regjistri i licensave (#2.3)					
	Politika për publikimin e kontratave (#2.4)					
	Pronësia reale (#2.5)					
	Pjesëmarrja e shtetit (#2.6)					
Monitorimi i prodhimit	Të dhëna për eksplorimin (#3.1)					
	Të dhëna për prodhimin (#3.2)					
	Të dhëna për eksportet (#3.3)					
Mbledhja e të ardhurave	Tërësia (#4.1)					
	Të ardhura në natyrë (#4.2)					
	Marrëveshje për shërbime ndihmë (#4.3)					
	Të ardhura nga transporti (#4.4)					
	Transaksione të NPSH (#4.5)					
	Pagesa të drejtpërdrejta tek NJQV (#4.6)					
	Disagregimi (#4.7)					
	Të dhëna në kohë (#4.8)					
	Cilësia e të dhënave (#4.9)					
Alokimi i të ardhurave	Shpërndarja e të ardhurave (#5.1)					
	Transferta tek NJQV (#5.2)					
	Menaxhim të ardhurash dhe shpenzime (#5.3)					
Kontribut social-ekonomik	Mandatory social expenditures (#6.1.)					
	SOE quasi-fiscal expenditures (#6.2)					
	Economic contribution (#6.3)					
Rezultate dhe ndikim	Debat publik (#7.1)					
	Të dhëna të aksesueshme (#7.2)					
	Ndjekja e rekomandimeve (#7.3)					
	Rezultatet dhe ndikimi i zbatimit (#7.4)					

Legjenda për kartën e vlerësimit

	S'ka përparim. Vendi nuk ka bërë përparim në trajtimin e kërkesës. Objektiva e përgjithshme e kërkesës nuk është përmbushur aspak.
	Përparim i pamjaftueshëm. Vendi ka bërë përparim të pamjaftueshëm në përmbushjen e kërkesës. Elementë domethënës të kërkesës mbeten të paplotësuar dhe objektiva e përgjithshme e kërkesës është larg përmbushjes.
	Përparim domethënës. Vendi ka bërë përparim në përmbushjen e kërkesës. Elementë domethënës të kërkesës janë duke u zbatuar dhe objektivi i përgjithshëm i kërkesës është duke u përmbushur.
	Përparim i kënaqshëm. Vendi përputhet me kërkesën EITI.
	Përtej. Vendi ka arritur përtej kërkesës.
	Kjo kërkesë vetëm nxitet dhe rekomandohet dhe nuk duhet marrë parasysh në vlerësimin e përputhshmërisë.
	MSG ka demonstruar se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme në vend.

Hyrje

Përmbledhje e shkurtër e fazës së nënshkrimit

Shqipëria u pranua si vend kandidat për EITI në maj 2009 dhe u vlerësua se përmbushte rregullat EITI në maj 2013.

Kryeministri Sali Berisha nxori Urdhrin no. 156, datë 27 dhjetor 2008 që ngrinte një Grup Pune Ndër-Institucional që do të përbëhej nga përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore dhe përfaqësues të ftuar nga kreu i Grupit të Punës nga “*organizatat jofitimprurëse, Banka e Shqipërisë, Enti Rregullator i Energjisë, grupet e interesit, Sindikatat e Tregtisë dhe Industrisë*” (Hart Nurse Ltd, 2011). Shqipëria aplikoi për statusin e vendit kandidat për EITI në mars 2009 duke paraqitur një letër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë më 30 mars 2009. Grupi i Punës miratoi planin e punës të vendit, zhvilluar me asistencën e Bankës Botërore, në takimin e vet të parë më 17 mars 2009. Pas rekomandimeve nga Validimi i Shqipërisë sipas Rregullave të EITI, Kryeministri Sali Berisha nxori Dekretin nr. 71, 21 korrik 2011, i cili ngrinte Grupin e punës MSG (MSG) (Hart Nurse Ltd, 2011). Sipas Dekretit, MSG kryesohet nga Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe përbëhet nga përfaqësues të qeverisë, kompanive që punojnë në industritë nxjerrëse dhe nga shoqëria civile. Në shtator 2013, qeveria e re ristrukturoi kabinetin dhe krijoi Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) si institucioni i qeverisë me përgjegjësinë për të mbikqyrur industritë nxjerrëse në Shqipëri.

Objektivat për zbatimin dhe përparimin e përgjithshëm në zbatimin e planit të punës

MSG e Shqipërisë ka rënë dakord për një plan pune për zbatimin EITI gjatë periudhës 2016-2019, botuar në faqen e Alb-EITI. Ndërkohë që plani i punës u miratua më 17 shkurt 2016, MSG dhe sekretariati më pas vazhduan ndryshime në planin e punës, duke mbajtur shënim veprimtaritë e përmbushura.

Plani i punës rendit katër përparësitë e mëposhtme kombëtare që lidhen me qeverisjen e burimeve natyrore dhe ofron një shpjegim të hollësishëm të mënyrës se si do të zbatohen objektivat në lidhje me procesin EITI: qeverisja e burimeve natyrore; të dhëna të hapura; mbështetje për shoqërinë civile dhe lufta kundër korrupsionit. Veprimtaritë e planit të punës janë kategorizuar qartë sipas objektivave që trajtohen.

Historia e Raportimit EITI

Shqipëria ka prodhuar shtatë Raporte EITI, të cilat mbulojnë vitet fiskale 2009-2015. Administratori i Pavarur Deloitte Audit Albania u kontraktuar tri here, duke prodhuar një total prej pesë Raportesh EITI që mbulonin vitet 2011-2017. Administratori i Pavarur i mëparshëm (Fair Links) u kontraktua për të përfunduar raportet EITI për vitet 2009 dhe 2010.

Përmbledhje e angazhimit nga qeveria, shoqëria civile dhe industria

Grupi Ndërinstitucional i Punës në Shqipëri u ngrit me anë të Urdhrit të Kryeministrit #156, datë 27 dhjetor 2008 dhe përbëhej nga përfaqësues nga institucione të ndryshme shtetërore dhe përfaqësues – ftuar nga

kreu i Grupit të Punës – nga “*organizata jofitimprurëse, Banka e Shqipërisë, Enti Rregullator i Energjisë, grupet e interesit, Sindikata e Tregtisë dhe Industrisë*” (Hart Nurse Ltd, 2011). Pas rekomandimeve nga Validimi i Shqipërisë sipas Rregullave EITI, Kryeministri Sali Berisha nxori Dekretin nr. 71, më 21 korrik 2011, për të ngritur MSG.

Shtatë anëtarët e qeverisë përfshijnë Zëvendës Ministrin e Energjisë dhe Industrisë Ilir Bejtja, kryetar i MSG, Dritan Spahiu nga MEI, Sajmir Laçe nga MF, Elda Spasse nga MD, Borjana Shaka nga DPT, Nikoll Kaza nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Azbi Arapi nga AKBN. Përfaqësimi i industrisë në MSG përfshin Adriatik Golemi nga Bankers Petroleum Ltd, Saimir Boka nga Albchrome, Perparim Alikaj nga FIAA (Kreu i Komitetit për Industrinë dhe Minierat), Dritan Dervishaj nga ANTEA Cement dhe Turker Sengonul nga Shell Upstream Albania. Shoqëria civile në MSG përfaqësohet nga Sami Neza i Qendrës për Transparencë dhe Informim të Lirë, Ilir Aliaj i Qendrës për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, Anila Hajnaj e Qendrës Shqiptare për Zhvillim Institucional dhe Baki Bajraktari nga Sindikata e Minatorëve të Bulqizës.

Veçori kryesore të industrisë nxjerrëse

Me rezerva në krom, qymyrguri, baker, hekur, nikel, naftë dhe gaz, industritë nxjerrëse të Shqipërisë përbënin 5.6% të PBB-së në vitin 2015, përfshi 3% nga minierat, nafta dhe gazi dhe 2.6% nga sektori i energjisë (EITI Shqipëri, 2016). Shqipëria ishte prodhuesi i tretë në botë për kromin gjatë periudhës komuniste deri në vitin 1990 dhe ende përbën 2.5% të prodhimit global. Shqipëria po ashtu mban rezervat më të mëdha në Europë për mineralin me afro 10m ton (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2017). Fusha naftëmbajtëse e Patos-Marinzës, zbuluar në vitin 1928, mbetet fusha më e madhe naftëmbajtëse në Europë në tokë me rreth 200m fuçi rezervash të provuara dhe të mundshme (2P) të naftës bruto (një përzierje e naftës së lehtë dhe të rëndë bruto, API 8-11) (Bankers Petroleum, 2017). Shqipëria mban rezervën e 63të më të madhe naftëmbajtëse në botë për naftën bruto (FMN, 2016). Teksa vlera e eksporteve të mineraleve ka rënë në përputhje me recesionin në partnered kyç të tregtisë në zonën e Euros si Italia dhe Greqia, pjesa e eksporteve minerare, të naftës dhe gazit në totalin e eksporteve ra nga 39% në vitin 2013 në 24% në vitin 2015 (EITI Shqipëri, 2016) (US Geological Survey, 2016).

Ndërsa i gjithë kërkimi dhe prodhimi mineral ishte i kontrolluar fort nga shteti gjatë periudhës komuniste, Ligji për Minierat i vitit 1994 i hapi dyert investimeve private në industritë nxjerrëse (Shoqata Shqiptare e Energjisë, 2012). Mbizotërimi i shtetit në sektorin mineral la pas komplekse të mëdha industriale të integruara përgjatë zinxhirit të vlerave në krom, baker, hekur-nikel dhe bitum, edhe pse kalimi në ekonominë e tregut në mes të viteve 1990 shkaktoi thujse kolaps në aktivitetin mineral (Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve, 2012). Nga mesi i viteve 2000, me zbatimin e reformave në sektorin mineral dhe rritjen e fortë të çmimeve në mallrat minerale, sektori shqiptar i minierave tërhoqi investime domethënëse, sidomos në krom (US Geological Survey, 2016) (Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve, 2012). Depozitat kryesore të kromit në vend gjenden në very-lindje, qendër dhe juglindje (Shoqata Shqiptare e Energjisë, 2012).

Fushat e para naftëmbajtëse të Shqipërisë u zbuluan në Drashovicë në vitin 1918 dhe në Kuçovë dhe Patos-Marinzë në vitin 1928 (World Petroleum Council, 2003). Depozita të konsiderueshme gazi u

identifikuan në perëndim të vendit që prej viteve 1963-1966 (AKBN, 2012). Albpetroli në pronë të shtetit kontrollonte të gjithë rrjedhën në zinxhirin e vlerës së naftës dhe gazit deri në hapjen e sektorit ndaj investimeve private në vitin 1990, kur filloi kontraktimin e kompanive private me anë të “marrëveshjeve për ndarjen e naftës” (PSA – të ngjashme me marrëveshjet për ndarjen e prodhimit) (EITI Shqiperi, 2016). Qeveria zhvilloi raunde licensimi për kompani private naftë në vitin 1990 (offshore), 1992 (onshore) dhe 1995 (të kombinuara), duke akorduar në total nëntë PSA (AKBN, 2012). Zbulimet e para madhore offshore të naftës u shpallën nga Agip në bllokun Adriatiku-4 dhe OXY, Shell dhe Petromanas në fushën e Shpiragut në 2001 and 2014 (AKBN, 2012). Ndërkohë që tranzicioni i Shqipërisë në mes të viteve 1990të përjetoi një rënie drastike në prodhimin e naftës, nga 1.4m ton në vit në vitin 1974 në 1.1m ton në vitin 1990 dhe pikën më të ulët prej 0.315m ton në vitin 2000 (World Petroleum Council, 2003) (AKBN, 2012), prodhimi i naftës më shumë se u dyfishua prej vitit 2003 si rezultat i investimeve private, për të arritur në 1.279m ton në viti 2015 (EITI Shqiperi, 2016). Një kompani private, Bankers Petroleum, nënshkroi një PSA për fushën naftëmbajtëse Patos-Marinzë në vitin 2003 dhe rriti prodhimin në 21,000 fuçi në ditë (Bankers Petroleum, 2017). Megjithatë, Shqipëria vazhdon të mbetet një prodhuese naftë me kosto të lartë, çka nënkupton se ndryshimet në çmimet ndërkombëtare të naftës kanë një ndikim më të madh në prodhimin e naftës të Shqipërisë se sa në prodhues të tjerë me kosto më të ulët (FMN, 2016).

Ndërkohë që qeveria ka planifikuar prej një kohe të gjatë privatizimin e kompanisë kombëtare të naftës, Albpetrol, dhe nëndegës së saj të përpunimit, ARMO, përparimi ka qenë i paqëndrueshëm. Në tetor 2012, qeveria zhvilloi një tender për shumicën e aksioneve në Albpetrolin në pronësi shtetërore për privatizim. Edhe pse oferta e Vetro prej 850m EUR ishte më shumë se gjysma e ofertuesit tjetër në radhë, dështimi i saj për të kryer pagesën e parë deri në afatin e shkurtit 2013 çoi në anulimin e privatizimit (Reuters, 2013). Transaksioni nuk u krye kurrë dhe Kryeministri Edi Rama e shtyu formalisht privatizimin e Albpetrolit në dhjetor 2015 për shkak të çmimeve të ulëta të naftës (Tirana Times, 2015) (EBRD, 2016).

Shqipëria u bë vend kandidat për në Bashkimin Europian në qershor 2014, duke krijuar nxitjen për të harmonizuar ligjet e saj, përfshi në koncesionet minerare dhe tenderat e naftës dhe gazit (US Geological Survey, 2016). Vendi po ashtu është duke fituar rëndësi si vend për tranzitimin e energjisë prej shkurtit 2012, kur ish-Kryeministri Sali Berisha shpalli se Shqipëria do të ishte vendi i parë që do të mbështeste Gazsjellësin TransAdriatik (TAP). TAP është një seksion i Korridorit Jugor të Gazit prej 3,500 km, i cili lidh fushat gazmbajtëse të Azerbaixhanit me rrjetin europian të gazit me anë të Greqisë, Shqipërisë dhe jugut të Italisë (Re:Common, 2016). Megjithë kundërshtimin publik të projektit nga disa komunitete në Greqi dhe Itali, analistët presin që gazsjellësi të përfundojë në vitin 2019 (FMN, 2016).

Shqipëria është edhe një prodhues kyç i hidroenergjisë, burimi kryesor i energjisë së vendit. Ndërkohë që kapaciteti i instaluar vlerësohet të jetë 10,000 GWh, prodhimi në fakt ka rënë nga kulmi i 7,674 GWh në vitin 2010 dhe Shqipëria ka mbetur e varur nga importet e energjisë elektrike për të përmbushur kërkesën vendase (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2017). Qeveria përllëgarit se deri tani është zhvilluar vetëm rreth 35% e potencialit të vendit për prodhimin e energjisë elektrike (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, 2017).

Shpjegim i procesit të Validimit

Në tetor 2016, Bordi ra dakord për kalendarin e Validimit të 30 vendeve që zbatojnë EITI-n, përfshi Shqipërinë. Bordi Ndërkombëtar i EITI ra dakord në takimin e 35të të Bordit në Astana, Kazakistan se Validimi i Shqipërisë do të fillonte më 1 prill 2017 (Bordj, 2016).

Validimi është një veçori thelbësore e procesit të zbatimit të EITI. Ai synon t'u ofrojë të gjitha grupeve të interesit një vlerësim të paanshëm të faktit nëse zbatimi EITI në një vend është në përputhje me dispozitat e Standardit EITI. Ai po ashtu trajton ndikimin e EITI, zbatimin e aktiviteteve të nxitura nga Standardi EITI, mësimet e nxjerra në zbatimin e EITI, si dhe çfarëdo shqetësimesh që grupet e interesit kanë shprehur dhe rekomandime për zbatimin në të ardhmen e EITI-t.

Procesi i Validimit paraqitet në kapitullin 4 të Standardit EITI³ dhe ka katër faza:

1. Përgatitja për Validim nga Grupi i punës (MSG)
2. Grumbullimi fillestar i të dhënave dhe konsultimi me grupet e interesit ndërmarrë nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-t.
3. Sigurimi i pavarur i cilësisë nga një Validues i pavarur që i raporton drejtpërdrejt Bordit të EITI.
4. Shqyrtimi nga Bordi.

[Udhëzimet e Validimit](#) ofrojnë udhëzime të hollësishme për vlerësimin e Kërkesave të EITI-t, si dhe [Procedura Validimi](#) më të hollësishme, përfshi një procedurë të standardizuar për grumbullimin e të dhënave dhe konsultimet me grupet e interesit nga Sekretariati Ndërkombëtar i EITI-t dhe terma reference të standardizuara për Validuesin.

Udhëzimet për Validimin përfshijnë një dispozitë se: “Aty ku MSG dëshiron që Validimi t'i kushtojë vëmendje të posaçme vlerësimit të objektivave apo aktiviteteve të caktuara në përputhje me planin e punës të MSG, këto duhen përvijuar me kërkesën e MSG.” MSG e AlbEITI nuk kërkoi që ndonjë çështje të merrte konsideratë të posaçme.

Në përputhje me procedurat e Validimit, puna e Sekretariatit Ndërkombëtar për mbledhjen fillestare të të dhënave dhe konsultimet me grupet e interesit u krye në tri faza:

1. Shqyrtimi në Tavolinë

³ Shih edhe <https://eiti.org/validation>.

Përpara vizitës në vend, Sekretariati kreu një shqyrtim të hollësishëm në tavolinë për dokumentacionin në dispozicion lidhur me përputhshmërinë e vendit me Standardin EITI, përfshirë si më poshtë por jo vetëm:

- Plani i punës EITI dhe të tjera dokumente planifikimi të tilla si buxhete dhe plane komunikimi;
- Termat e Referencës së grupit të punës MSG, si dhe procesverbalet e takimeve të grupit të punës MSG;
- Raportet EITI, si dhe informacion shtesë të tillë si raporte përmbledhëse dhe studime fillestare;
- Materiale komunikimi;
- Raporte progresi vjetore; dhe
- Ndonjë informacion tjetër që lidhur me Validimin që ishte në dispozicion online ose u ofrua nga Sekretariati AlbEITI.

Në përputhje me procedurat e Validimit, Sekretariati nuk ka marrë parasysh veprime të ndërmarra pas fillimit të Validimit.

2. Vizita në vend

Vizita në vend u zhvillua më 5-10 qershor 2017. Të gjitha takimet u zhvilluan në Tiranë, Shqipëri. Sekretariati u takua me grupin e punës MSG dhe anëtarët e tij, Administratorin e pavarur dhe të tjerë grupe interesi kyç, përfshi grupe interesi që janë të përfaqësuara por nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në grupin e punës MSG. Përpos takimeve me MSG si grup, Sekretariati u takua edhe me elementët përbërës të tij (qeveria, kompanitë dhe shoqëria civile) ose individualisht ose në grupe, me protokollet e duhura për t'u siguruar që aktorët do të ishin në gjendje të shprehnin lirisht pikëpamjet e tyre dhe që kërkesat për konfidencialitet do të respektoheshin. Lista e aktorëve të konsultuar është e renditur në Shtojcën D.

3. Raportimi për përparimin lidhur kundrejt kërkesave

Ky raport paraqet vlerësimin fillestar të Sekretariatit Ndërkombëtar për përparimin e bërë kundrejt kërkesave, në përputhje me Udhëzimet për Validimin. Ai nuk përfshin një vlerësim tërësor të përputhshmërisë.

Ekipi i Sekretariatit Ndërkombëtar përbëhej nga: Oliana Valigura, Alex Gordy, Pablo Valverde dhe Sam Bartlett.

Pjesa I – Mbikqyrja nga MSG

1. Mbikqyrja e Procesit EITI

1.1 Vështrim i Përgjithshëm

Ky seksion lidhet me angazhimin e grupeve të interesit dhe mjedisin për zbatimin e EITI në vend, qeverisjen dhe funksionimin e grupit të punës (MSG), si dhe planin e punës EITI.

1.2 Vlerësim

Angazhimi i qeverisë në procesin EITI (#1.1)

Dokumentim i përparimit

Deklarim publik: Më 27 dhjetor 2008, Kryeministri Sali Berisha nxori Urdhrin Nr. 156 për ngritjen e Grupit Ndër-Institucional të Punës për të përgatitur aplikimin e Shqipërisë për kandidaturën EITI (Keshilli i Ministrave, 2008). Dekreti përfshinte një ftesë për kompanitë dhe shoqëritë civile për të marrë pjesë në procesin EITI. Më 16 dhjetor 2009, Sali Berisha i shkroi një letër Kryetarit të EITI Peter Eigen në lidhje me vendimin e Shqipërisë për të zbatuar EITI-n (Sali Berisha, 2009). Angazhimi u theksua nga Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë Neritan Alibali në Konferencën Globale të EITI-t në Doha, Katar më 16-17 shkurt 2009 (EITI, 2009). Bordi i EITI e pranoi Shqipërinë si vend kandidat për EITI gjatë takimit të tij të 9të në Uashington DC, Shtetet e Bashkuara, në maj 2009 (EITI, 2009). Angazhimi i fortë i qeverisë u përsërit në Konferencën Globale të EITI-t në Lima me anë të deklaratave publike, intervistave dhe aktiviteteve (Ministry of Energy and Industry, 2016), (Ministria e Energjise dhe Industrise, 2016). Në Konferencën Globale të EITI-t në Lima në shkurt 2016, Damian Gjinkuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë riafirmoi se Qeveria e Shqipërisë e mbështet procesin EITI dhe përpjekjet për të bërë publike pronarët realë të kompanive nxjerrëse (Alb-EITI, 2017).

Shqipëria ka marrë pjesë në Partneritetin për Qeverisjen e Hapur (OGP) prej vitit 2011. Plani Kombëtar i Veprimit i OGP përfshinte angazhimin (numër 3.3) për të vazhduar zbatimin e EITI-t dhe për të përfituar statusin e vendit në Përputhje me EITI-n me Rregullat EITI 2009 (OGP Shqiperi, 2012), edhe pse Plane Veprimi Kombëtare të OGP nuk i referoheshin zbatimit nga Shqipëria të EITI.

Drejtimi: Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë Enno Bozdo, u emërua në dhjetor 2008 për të drejtuar Grupin Ndër-Institucional të Punës nga ana e qeverisë dhe Ministria ka angazhuar personel të nivelit të lartë për të koordinuar dhe mbështetur zbatimin e EITI (Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjise, 2009). Sekretariati kombëtar shqiptar i EITI u ngrit me Vendim të Këshillit të Ministrave më 7 korrik 2010 (Keshilli i Ministrave, 2010). Pas rekomandimeve nga Validimi i Shqipërisë sipas Rregullave EITI, Kryeministri Sali Berisha nxori Dekretin nr. 71, më 21 korrik 2011, për të ngritur Grupin e Punës (MSG) dhe duke përcaktuar role dhe përgjegjësitë e tij (Kryeministri, 2011). Sipas Dekretit, MSG

drejtohet nga Zëvendës Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe përbëhet nga përfaqësues nga qeveria, kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse dhe nga shoqëria civile. Në shtator 2013, qeveria e re u ristrukturua dhe u krijua Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI) si institucioni përgjegjës me përgjegjësinë për të mbikqyrur industrinë nxjerrëse në Shqipëri. MEI luan një rol kyç dhe proaktiv në promovimin e aktiviteteve EITI, përfshi duke ofruar mjedise për sekretariatit kombëtar, duke ofruar shërbime telekomunikacioni dhe utilitete, si dhe duke ofruar një personel prej nëntë vetësh për AlbEITI. Ministri i Energjisë dhe Industrisë Damian Gjoknuri promovon EITI-n duke marrë pjesë në konferenca shtypi, forume dhe aktivitete të tjera publike.⁴ Në shtator 2013, Zëvendës Ministri i Energjisë dhe Industrisë Ilir Bejtja u emërua Kreu i ri i MSG (Alb-EITI, 2013). Ai ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive në zbatimin e EITI dhe ka kryesuar të gjitha takimet e MSG prej vitit 2013.

Angazhim aktiv: Angazhimi i qeverisë në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI ka qenë në mënyrë konsekuente i fortë gjatë gjithë zbatimit nga Shqipëria të EITI-t. Shtatë anëtarët qeveritarë të MSG përfshijnë Zëvendës Ministrin e Energjisë dhe Industrisë Ilir Bejtja, Kreu i MSG, si dhe përfaqësues nga Ministria e Financave (MF), Ministria e Drejtësisë (MD), Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe MEI. Përfaqësuesit e qeverisë kanë qenë të angazhuar në mënyrë aktive në aktivitete kyçe të MSG të tilla si hartimi dhe komentimi i planeve të punës dhe raporteve për veprimtarinë vjetore të EITI, format e raportimit EITI dhe Raportet EITI. Një analizë e shënimeve nga takimeve të MSG konfirmon se një numër prej këtyre aktiviteteve kanë qenë iniciuar nga përfaqësuesit e qeverisë në MSG.⁵ Përfaqësuesit e qeverisë në MSG, sidomos përfaqësuesit nga MEI, AKBN, SHGJSH dhe DPT, zakonisht marrin pjesë në të gjitha takimet e MSG. Përfaqësuesi i MF nuk mori pjesë në ndonjë takim prej tremujorit të dytë të vitit 2016 për shkak të ndryshimeve të brendshme të personelit brenda Ministrisë, edhe pse një përfaqësues i ri nga MF u emërua në MSG në maj 2017, pas fillimit të Validimit.

Përfaqësuesit e qeverisë kanë marrë pjesë rregullisht në aktivitete e konferenca kombëtare e ndërkombëtare kapacitet-ndërtuese,⁶ duke rritur ndërgjegjësimin për zbatimin e EITI dhe duke përhapur gjetjet nga Raportet EITI për vitet 2013-2014 dhe 2015 në komunikimet e tyre me median dhe publikun e gjerë.⁷ Përfaqësues nga qeveritë vendore, MEI dhe personeli i sekretariatit kanë qenë të angazhuar në aktivitete shpërndarjeje të EITI në rajone ku zhvillohen veprimtari minerare nxjerrëse; pjesëmarrja e përfaqësuesve të qeverisë qendrore në këto aktivitete duket se është më pak konsekuente se sa ajo e Sekretariatit AlbEITI dhe qeverive vendore, por më konsekuente se sa e grupeve nga industria dhe shoqëria civile (shih *Kërkesa 7.1*). Qeveria e Shqipërisë, përfshi MEI dhe Sekretariatit AlbEITI, po ashtu ka lehtësuar vizita studimore dhe aktivitete për të mësuar nga homologët nga Kosova, përfshi në tetor 2013 (Republika e Kosovës, 2013).

⁴ <http://www.albeiti.org/press-conference-eiti-report-2013-and-2014/>

⁵ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/>

⁶ <http://www.albeiti.org/training-sessions-good-governance-of-natural-resources/>

⁷ Një listë e intervistave lidhur me EITI me zyrtarë të qeverisë gjendet këtu [link to internal/google drive]

Pjesëmarrja e qeverisë në raportimin EITI ka qenë disi e luhatshme, edhe pse shumica e enteve qeveritare janë përpjekur t'i përgjigjen kërkesave për të dhëna, ndonëse me njëfarë vonese nga ana e institucioneve të caktuara kyçe. Kështu, ndërkohë që MF, GPT dhe Doganat kanë pasur prirjen për të raportuar në kohë, organe të tjera si AKBN dhe Albpetrol, dy ente qeveritare jobuxhetore, janë prirur të ofrojnë vetëm një pjesë të informacionit që iu është kërkuar. Raporti EITI 2015 thekson që AKBN ofroi vetëm informacion të kufizuar, duke refuzuar për shembull të paraqiste kopje të pasqyrave financiare pranë Administratorit të Pavarur dhe MSG (shih *Kërkesa 4.9*), (Shqipëria EITI, 2016). Megjithëkëtë, MEI duket se ka ndjekur çështjet në mënyrë aktive për t'i nxitur të gjitha entet qeveritare material që të raportonin, përfshi nëpërmjet shkresash për entet qeveritare nga Zëvendës Ministri i Energjisë dhe Industrisë Bejtja.

Qeveria po ashtu është përpjekur të krijojë një mjedis të favorshëm për raportimin EITI të kompanive, duke përfshirë kërkesa për të marrë pjesë në raportimet EITI në amendamentet për Ligjin për Minierat në 2009 dhe Ligjin për Hidrokarburet në 2015. Qeveria ka shprehur mbështetje për një projekt Ligj për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse të përafuar me Direktivën e BE për Transparencë dhe duke sanksionuar kërkesa kyçe EITI në legjislacionin kombëtar dhe raportimin rutinor të qeverisë. Edhe MF ka mbështetur një projekt Ligj për Raportimin Kontabël dhe Financiar, i cili do të integronte raportimin e certifikuar EITI në kërkesat statutoare të kompanive për raportim pranë qeverisë.

Ndërkohë që zgjedhjet e përgjithshme të qershorit 2013 sollën një ngadalësim të përkohshëm në aktivitetet e lidhura me EITI, me vonesa në emërimin e anëtarëve të rinj qeveritarë në MSG dhe më pak takime të MSG, ritmi i zbatimit u rikuperua gjatë vitit 2015. Në shtator 2013, qeveria e re caktoi MEI-n për të mbikqyrur sektorët e minierave, hidroenergjisë, naftës dhe gazit në Shqipëri dhe prej asaj kohe, Ministria drejtuar në zbatimin e EITI, duke ofruar një pjesë të financimit për EITI-n nga buxheti i saj vjetor.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Deklarata mbështetjeje: Një përfaqësues i shoqërisë civile u shpreh se angazhimi fillimisht i fortë i qeverisë ndaj EITI-t ishte zbehur me kalimin e viteve dhe vërejtje se qeveria nuk dukej të kishte riafirmuar angazhimin e saj publik ndaj zbatimit EITI gjatë dy viteve të fundit. Megjithëkëtë, një numër anëtarësh OSHC të MSG theksuan se Kreu i MSG kishte qenë gjithmonë mbështetës ndaj EITI-t dhe kishte marrë përgjegjësi personale për t'u siguruar që zbatimi do të qëndronte në shina pas një fillimi të ngadaltë në raportimin EITI përpara Validimit të parë të Shqipërisë sipas Rregullave EITI. Anëtarët nga qeveria dhe industria nuk shprehën ndonjë pikëpamje të veçantë lidhur me deklaratimet publike të qeverisë në mbështetje të EITI-t.

Drejtimi i nivelit të lartë: Të gjithë aktorët e konsultuar, përfshi anëtarët e MSG, u shprehën se Zëvendës Ministri i Energjisë dhe Industrisë Bejtja ofronte drejtim të efektshëm dhe të nivelit mjaftueshëm të lartë për zbatimin e EITI. Megjithatë, një numër përfaqësuesish nga të tria grupet dhe personeli i sekretariatit shprehën shqetësim lidhur me qëndrueshmërinë e kësaj mbështetjeje pas zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, duke marrë parasysh faktin që perspektiva e zbatimit EITI ishte e lidhur ngushtë me devotshmërinë personale të drejtimit të nivelit të lartë ndaj zbatimit të EITI. AP dhe personeli i sekretariatit vërejtën rolin kyç të Kreut të MSG për kapërcimin e pengesave në raportimin EITI, si nga pikëpamja e ndjekjes me kompanitë dhe organet qeveritare që nuk raportonin ashtu edhe me ndjekjen e

rekomandimeve të EITI.

Angazhimi: Një përfaqësues kompanie mendonte se angazhimi i qeverisë ishte rritur me kalimin e viteve dhe se koordinimi midis enteve qeveritare që më parë nuk kishin lidhje ishte përmirësuar dukshëm si rezultat i bashkëpunimit të tyre për EITI-n. Një numër anëtarësh të MSG nga qeveria dhe shoqëria civile vërentën se pjesëmarrja e qeverisë në takimet e MSG ishte e ndryshueshme, ku institucione si MEI dhe DPT merrnin pjesë në mënyrë më konseguente se sa të tjera si AKBN. Këta përfaqësues po ashtu vërentën se MSG zakonisht nuk merrte inpute për dokumente kyçe të EITI-t, të tilla si plani vjetor i punës dhe projekt Raportet EITI nga agjencitë qeveritare si AKBN.

Një anëtar i MSG nga industria vërejt se anëtarët e MSG nga qeveria kishin tendencën të përfaqësonin interesat dhe kompetencat e tyre të ngushta, duke u prirur që të ofronin komente vetëm lidhur me fushat e ekspertizës. U vërejt se ndërkohë që anëtarë qeveritarë në MSG diskutonin çështje që lidheshin me industrinë, zakonisht dukej se bënë rezistencë ndaj idesë së miratimit të ndonjë reforme, duke qenë se ishin të lidhur me postet e tyre dhe politikën përkatëse. Një numër përfaqësuesish nga qeveria theksuan sfidat në lidhje me sigurimin e pjesëmarrjes në raportimin EITI nga ente të caktuara qeveritare si AKBN dhe Albpetrol, duke u shprehur se këto institucione nuk e merrnin gjithmonë seriozisht EITI-n. Personeli i sekretariatit dhe AP vërejtën se bashkëpunimi i Albpetrolit me raportimin EITI kishte pasur rënie në lidhje me Raportet EITI 2013-2014 dhe 2015, për shkak të kritikave të Albpetrol për disa aspekte të Raportit EITI 2013-2014 lidhur me çmimet e shitjeve të naftës bruto nga Albpetroli.

Personeli i sekretariatit theksoi se MEI kishte ofruar financim të pjesshëm për EITI-n, duke mbuluar rreth një të tretën e nevojave financiare vjetore të AlbEITI-t (përpos dy të tretave nga Banka Botërore). Ky financim mbulonte pagat e personelit të sekretariatit, prokurimet administrative, transportin, hapësirën e zyrave dhe mjedise të tjera.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë. Pavarësisht vonesave lidhur me tranzicionin politik të vitit 2013, ka deklarime të rregullta publike mbështetjeje nga qeveria; një individ i nivelit të lartë është emëruar për të drejtuar zbatimin e EITI dhe zyrtarë të lartë të qeverisë janë të përfaqësuar në MSG. Të dhënat, përfshi shënime nga takimet e MSG tregojnë se qeveria është e angazhuar në mënyrë aktive dhe të efektshme në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e EITI. Anëtarët e grupeve të interesit vërejnë se edhe pse angazhimi nga disa ente të caktuara qeveritare ka qenë i dobët hera-herës, përfaqësimi i tanishëm në MSG tregon se qeveria po e merr procesin seriozisht dhe aktorët e qeverisë kanë qenë të angazhuar në mënyrë të efektshme në të gjitha aspektet e zbatimit. Megjithatë, pjesëmarrja e përfaqësuesve të qeverisë në aktivitete shpërndarjeje dhe endërgjegjësimi duket se ka qenë relativisht jokonseguent, ndonëse në të njëjtin nivel me angazhimin e grupeve të tjera të përfaqësuara në MSG (shih *Kërkesa 7.1*). Njësitë e qeverisë vendore janë taë angazhuara në mënyrë aktive për të promovuar EITI-n dhe për të gjeneruar debat publik. MEI ofron mjediset për sekretariatit AlbEITI, punëson personelin e sekretariatit dhe kontribuon afërsisht një të tretën e fondeve për zbatimin EITI.

MSG duhet po ashtu të sigurojë pjesëmarrje më konseguente të përfaqësuesve të qeverisë në aktivitete

shpërndarjeje.

Angazhimi i industrisë në procesin EITI (#1.2)

Dokumentimi i përparimit

Angazhimi aktiv: Raportimi EITI i Shqipërisë mbulon sektorët e minierave, naftës dhe gazit si dhe hidroenergjinë. Industria e naftës dhe gazit përfshin aktorët e mëposhtëm kryesorë: Albpetrolin në pronësi të shtetit, Shell, Bankers Petroleum, Transatlantic Albania, TransoilGroup Dega në Shqipëri, Sherwood International Petroleum dhe Phoenix Petroleum. Bankers Petroleum, i cili administron fushën naftëmbajtëse më të madhe onshore të Europës në Patos-Marinzë siguron afërsisht 89% të të gjithë prodhimit të naftës të Shqipërisë. Sektori i minierave, i cili përbëhet në radhë të parë nga kromi, gëlqerorët dhe material të tjera ndërtimore, përfshin kryesisht kompani të vogla dhe të mesme dhe kontribuon një total prej 0.8% të buxhetit kombëtar. Prodhuesit më të mëdhenj të hidroenergjisë përfshijnë shtetëroret Korporata e Energjisë e Shqipërisë (KESH), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) përkrah investitorëve privatë (Shqiperia EITI, 2016).

Kompanitë nxjerrëse me financim të huaj kanë mbështetur zbatimin EITI prej fazave të hershme, përfshi me anë njoftimesh për shtyp nga Shoqata e Investitorëve të Huaj të Shqipërisë⁸ (FIAA) (FIAA, 2012) (Nenkomiteti i FIAA për Minierat, Naften & Gazin në EITI, 2011).⁹ Në tetor 2016, AlbEITI dhe FIAA nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi (MM) për të bashkërenduar angazhimin e aktorëve nga industria në EITI nëpërmjet FIAA. Megjithatë, FIAA nuk përfaqëson kompanitë nxjerrëse në pronësi vendase, të cilat përbëjnë shumicën dërrmuese të kompanive që përfshihen në objektin e raportimit EITI. Një numër prej 527 kompanish kishin një total prej 626 licensash minerare në vitin 2015. Gjithashtu, ndërkohë që hidroenergjinë përfshihet në fushën e raportimit EITI, për sektorin nuk ka përfaqësim në MSG.

Roli i industrisë në zbatimin e EITI është i përkufizuar në TER të MSG, përfshi përgjegjësinë e sektorit për të ndihmuar me sigurimin e pjesëmarrjes së plotë të të gjitha kompanive nxjerrëse materiale, për të publikuar saktë të gjitha pagesat dhe të dhënat përkatëse pranë qeverisë dhe aktorëve të tjerë në kohë si dhe për të komunikuar me aktorë të tjerë të industrisë lidhur me zhvillimet për EITI-n (Alb-EITI, 2017). Pjesëmarrja e anëtarëve nga industria të MSG në takimet e MSG duket se ka qenë konsekuente, ku regjistrat e takimeve tregojnë se shumica e anëtarëve të industrisë kanë marrë pjesë në shumicën e takimeve të MSG. Megjithatë, nuk ka të dhëna se përfaqësuesit e industrisë morën pjesë në aktivitete ndërgjegjësim-informimi apo përdorën zbatimin e EITI për të trajtuar specifikisht interesat e kompanive nxjerrëse.

⁸ <http://fiaalbania.al/>. The FIAA acts as Albania's membership-based association of foreign-invested companies operating in all sectors of the economy. Shoqata numëronte 96 anëtarë deri në 1 prill 2017, përfshi 12 kompani të regjistruara si aktive në sektorin e energjisë dhe 13 në miniera, naftë dhe gaz.

⁹ <http://fiaalbania.al/members-list/>

Gjithashtu, ndërkohë që shumica e kompanive më të mëdha kanë marrë pjesë në mënyrë konseguente në raportimin sipas EITI, pjesëmarrja e kompanive më të vogla minerare ka qenë më sfidues pavarësisht rritjes së qëndrueshme në numrin e kompanive raportuese nga 41 në vitin 2009 në 133 në vitin 2015 (*shih Kërkesa 4.1*). Numri i kompanive që marrin pjesë në raportimin EITI është rritur gradualisht nga 41 në vitin 2009 në 69 në vitin 2010, 75 në vitin 2012, 103 në vitin 2013, 118 në vitin 2014 dhe 133 në vitin 2015. Megjithatë, ndërkohë që kompanitë janë priru të paraqesin formularët e raportimit EITI, zakonisht nuk kanë përmbushur procedurat për sigurimin e cilësisë për raportimin EITI, për të cilat është rënë dakord nga MSG (*shih Kërkesa 4.9*).

Mjedisi nxitës: Qeveria duket të ketë ofruar një mjedis nxitës ligjor për raportimin EITI të kompanive, përfshi dispozitat që e bëjnë raportimin EITI të detyrueshëm sipas Ligjin 10304 mbi sektorin minerar dhe Ligjin 7746 (ndryshuar) mbi sektorin e hidrokarbureve (Parlament, 2010), (Parlament, 2015). Nuk ekzistojnë dispozita ligjore që e bëjnë raportimin EITI të detyrueshëm për sektorin e hidroenergjisë (Shqipëria EITI, 2016). Neni 51 i Ligjit 10304 mbi sektorin minerar specifikisht ndalon çdo dispozitë konfidencialiteti të lidhur me pagesën e taksave lokale dhe kombëtare në sektorin e minierave dhe konfirmon detyrimin e kompanive për të publikuar pagesa të tilla pranë EITI (Parlament, 2010).

Për të anashkaluar dispozitat për konfidencialitetin në ligjin e tatimeve për kompani të tjera, të cilat e ndalojnë qeverinë kombëtare të publikojë informacion për taksapaguesit tek palët e treta, DPT ka punuar me MSG për të hartuar heqje dorë nga konfidencialiteti që iu janë dërguar kompanive materiale mbi baza vjetore. Megjithatë, Raporti EITI 2015 vërejt se “më pak se 50” kompani kishin dorëzuar kërkesa për heqje dorë (EITI Shqipëri, 2016). Për ta kapërcyer këtë hendek, Sekretariati AlbEITI, si ent qeveritar nën MEI-n, nënshkroi Memorandume Mirëkuptimi me secilin ent raportues qeveritar për të lejuar agjencitë e qeverisë të raportojnë informacion sipas EITI pranë Sekretariatit AlbEITI, duke kopjuar AP. Kështu, ndërkohë që raportimi fillestar i qeverisë i dorëzohet Sekretariatit AlbEITI, është AP që ndjek procesin e përputhjeve të të dhënave si dhe ndonjë mbledhje të mëtejshme të dhënash (*shih Kërkesa 4.9*). Kjo e ka lejuar efektivisht qeverinë të publikojë informacionin e kërkuar të disagreguar sipas taksapaguesit, në pritje të miratimit të projekt Ligjit për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse, të cilat do të shmangnin të gjitha dispozitat për konfidencialitetin tatimor për qëllime të raportimit sipas EITI.

Pikëpamjet e aktorëve

Mes anëtarëve të MSG dhe përfaqësuesve të industrisë që u konsultuan kishte konsensus se anëtarët e industrisë në MSG përfaqësonin kompani me investime të huaja që ishin anëtarë të FIAA, dhe jo kompani në pronësi vendase. Po ashtu kishte konensus se nuk kishte përfaqësim të sektorit të hidroenergjisë në MSG.

Një ish-anëtar qeveritar i MSG përgëzoi kontributet aktive dhe të zëshme të përfaqësuesve të industrisë në diskutimet dhe aktivitetet EITI, të cilat shiheshin se përfaqësonin shqetësimet e kompanive. Një përfaqësues i shoqërisë civile mendonte se anëtarët e industrisë në MSG ishin aktivë dhe demonstroi kompetencë profesionale. Një numër anëtarësh të MSG nga grupe të ndryshme konfirmuan se anëtarët e MSG nga FIAA ishin përfaqësuar në mënyrë konseguente në MSG që nga fillimi dhe nuk kishin munguar në asnjë takim të MSG. megjithatë, një numër përfaqësuesish qeveritarë dhe të shoqërisë civile shprehën shqetësim se disa kompani përfaqësoheshin vetëm në nivel të ulëta ose nga departamentet e

Marrëdhëniet Publike, çka nënkuptonte se nuk kishin mandat për të ndjekur më pas vendimet e MSG ose të merrnin vendime në emër të kompanive të tyre, e jo më të kompanive në tërësi.

AP mendonte se kompanitë ishin të përkushtuara ndaj raportimit sipas EITI, por se prireshin ta shihnin pjesëmarrjen e tyre si formë përmbushjeje dhe nuk dukej se e njihnin vlerën që kishte zbatimi për të identifikuar dhe kapërcyer sfidat në qeverisjen e sektorit. AP vërejti se kishte një numër fushash ku raportimi sipas EITI mund të ishte veçanërisht i dobishëm për kompanitë, përfshi në sqarimin e pjesëve të mjegullta në regjimin fiskal, hapjen e procesit të licensimit dhe ofrimin e një diagnoze për besueshmërinë e raportimit nga kompanitë.

Në lidhje me mungesën e raportimit tërësor nga ana e kompanive, asnjë prej përfaqësuesve të industrisë që u konsultuan nuk mentonte se ishte përgjegjësia e tyre për të ndjekur çështjen me kompanitë që nuk raportonin. Të gjithë përfaqësuesit e konsultuar, përfshi anëtarë të industrisë në MSG, mendonin se ishte përgjegjësia e qeverisë në përputhje me dispozitat në legjislacionin për minierat dhe hidrokarburet. Asnjë prej aktorëve të konsultuar, përfshi AP, nuk mund të shpjegojnë se pse anëtarët e industrisë në MSG binin dakord me të njëjtat procedura për sigurimin e cilësisë për raportimin sipas EITI çdo vit ndërkohë që asnjë prej kompanive nuk përmbushte asnjëherë procedurat e dakordësuara.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë. Kompanitë më të mëdha minerare, të naftës dhe gazit janë të angazhuara aktivisht dhe efektivisht në procesin EITI, edhe si ofrues informacioni, edhe në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI. FIAA e përdor EITI-n për të mbështetur një mjedis nxitës për kompani dhe investiture, dhe kontribuon në promovimin e debatit publik. Megjithatë, mungesa e përfaqësimit sipas EITI të kompanive në pronësi vendase është shqetësim. Gjithashtu, mungesa e inputit të industrisë për vendime kyçe EITI të tilla si mekanizmat për të siguruar besueshmërinë e informacionit EITI duhet trajtuar. Ekzistojnë dispozita të qarta ligjore që kërkojnë raportim sipas EITI-t për të gjitha kompanitë minerare, të naftës dhe gazit në Shqipëri, të cilat mundësojnë 110 taksapaguesit më të mëdhenj nxjerrës të raportojnë në vitin 2016, edhe pse raportimi tërësor nga të gjitha kompanitë materiale mbetet sfidë (shih Kërkesa 4.9).

Për të forcuar zbatimin, sektori i industrisë nxitet që të sigurohet se anëtarësia e vet në MSG të përfaqësojë strukturën e sektorëve minerarë, të hidroenergjisë, naftës dhe gazit dhe se rregullsia dhe niveli i pjesëmarrjes së industrisë në MSG është në përputhje me nevojën e MSG për të marrë vendime të informuara dhe të ndjekë pikat që kërkojnë veprim. MSG duhet të sigurojë raportim tërësor nga të gjitha kompanitë materiale.

Angazhimi i shoqërisë civile në procesin EITI (#1.3)

Dokumentimi i përparimit

Një shoqëri civile energjike lindi në Shqipëri gjatë tranzicionit post-komunist në vitet 1990të, duke luajtur një rol të rëndësishëm sidomos në lidhje me rritjen e ndërgjegjësimit dhe avokatisë lidhur me lirinë e

shprehjes, të drejtat e njeriut, korrupsionin dhe praktikën demokratike (CIVICUS, 2010). Ndërkohë që nuk duket të ketë pengesa ligjore për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në zbatimin e EITI, ka pak të dhëna se kjo hapësirë përdoret në praktikë nga OJQ-të.

Shprehja: Nuk ka të dhëna që të sugjerojnë se ekzistojnë kufizime ligjore apo rregullatore që organizatat e shoqërisë civile të shprehin lirisht pikëpamjet e tyre lidhur me procesin EITI. Neni 22 i Kushtetutës së Shqipërisë të viti 1998 garanton lirinë e shprehjes për të gjithë qytetarët ndërsa Pjesa II e Kushtetutës garanton të drejtat themelore të njeriut dhe lirinë e shtypit (Parlamenti i Shqipërisë, 1998). Sipas një raporti nga Indeksi i Transformimit të Bertelsmann Stiftung (BTI) për 2016, media luan një rol aktiv në ekspozimin e rasteve të korrupsionit, edhe pse gjithashtu thekson se gazetarët hera-herës përdoren nga bizneset dhe politikanët për të përmirësuar mbulimin mediatik të tyre me anë të përmbajtjes së paguar (Bertelsmann Stiftung, 2016). Freedom House e vlerëson Shqipërinë pjesërisht të lirë dhe nuk vëren pengesa ndaj lirisë së shprehjes, qoftë në kuptimin statutor qoftë në praktikë, në lidhje me çështje të naftës, gazit a minierave (Freedom House, 2017). Qendra Burimore Anti-Korrupsion ka vlerësuar se shoqëria civile është e aftë të angazhohet haptas në debat publik dhe kritika për qeverinë (Qendra Burimore Anti-Korrupsion, 2011). Raporti për të Drejtat e Njeriut 2016 i Departamentit të Shtetit të SHBA theksonte incidentet e dhunës dhe kanosjes kundër anëtarëve të medias dhe shprehej se gazetarët praktikojnë një nivel vetëcensure për të shmangur ngacmimet dhe presionin nga botuesit dhe redaktorët (Departamenti i Shtetit të SHBA, 2016). Parlamenti Europian po ashtu ka ngritur shqetësime lidhur me vetëcensurën nga media shqiptare The European Parliament has also raised concerns over self-censorship by the Albanian media (Balkan Insight, 2016). Megjithatë, nuk ka të dhëna për pengesa ndaj lirisë së shtypit apo vetëcensurë midis OSHC-ve në lidhje me minierat, naftën dhe gazin apo çështje të tjera lidhur me EITI-n, dhe se ka një numër shembujsh ku shoqëria civile kritikon mbikqyrjen nga qeveria të sektorëve, përfshi protesta dhe greva (Sindikata e Industrisë, 2007) (Reuters, 2011).

Shënime nga takimet e MSG tregojnë se OSHC janë në gjendje të flasin lirisht lidhur me procesin EITI pa kufizime apo shtrëngime, përfshi duke kritikuar si qeverinë ashtu edhe industrinë. Anëtarët e OSHC në MSG kanë shprehur pikëpamje të forta mbi çështje që lidhen me pagesat sociale, publikimin e pronarëve realë, transfertat për qeveritë vendore, çështje mjedisore dhe qeverisjen e SMG në një numër takimesh të MSG gjatë të gjithë periudhës 2013-2017 (AlbEITI, 2016), (AlbEITI, 2016). Sekretariati Ndërkombëtar bëri kërkesa të përsëritura pranë OSHC-ve për prova për deklarime publike nga OSHC-të mbi çështje të lidhura me qeverisjen e burimeve natyrore apo të tjera çështje të lidhura me EITI-n por nuk iu paraqit ndonjë dokumentim i tillë. Kështu, ndërkohë që ka prova të shumta online lidhur me aftësinë e OSHC-ve për të folur lirisht dhe në mënyrë kritike mbi çështje të qeverisjes së industrisë nxjerrëse, ka vetëm prova të kufizuara ku OSHC diskutojnë çështje lidhur me EITI-n publikisht apo përdorin informacion nga EITI përtej shënimeve nga takimet e MSG.

Funksionimi: Nuk ka të dhëna për ndonjë pengesë ligjore, rregullatore apo administrative që ndikon aftësinë e përfaqësuesve të shoqërisë civile për të marrë pjesë në procesin EITI. Regjistrimi i OJQ-ve është një proces relativisht i thjeshtë, rregulluar nga Ligji i vitit 2001 mbi Organizatat Jofitimprurëse, Ligji i vitit 2001 për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse dhe Kodi Civil i Shqipërisë (ICNL) (Parlamenti i Shqipërisë, 2001). Organizatat jofitimprurëse dhe OJQ-të mund të regjistrohen nga çdo person, përfshi organe juridike dhe qytetarë të huaj, duke depozituar një aplikim për regjistrim pranë Gjykatës së Rrethit

të Tiranës. Duke qenë se Gjykatat e Rrethit në qytete të tjera nuk marrin të tilla aplikime, një numër OSHC ndërkombëtare dhe partnerësh zhvillimi kanë përmendur nevojën për të udhëtuar në Tiranë si pengesë administrative e mundshme për ata me bazë jashtë kryeqytetit (BE, 2013) (TACSO Shqiperi, 2016). Dokumentet e kërkuara për të regjistruar një OJQ përcaktohen në Nenin 22 të Ligjit për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse dhe përfshijnë aplikimin për regjistrim (përfshi llojin, objektivat, fushën e veprimtarisë, hollësi për themeluesin dhe drejtuesit, strukturën, organin qeverisës, adresën e organizatës dhe hollësi për përfaqësuesin ligjor), dokumentet e themelimit të OJQ dhe rregulloren (Keshilli i Ministrave, 2001). Për degët e OJQ-ve të huaja, dokumentet e kërkuara (në shqip) përfshijnë aplikimin për regjistrim, dokumentet e themelimit, statutin dhe prova për vendimin e OJQ për të hapur një degë Shqiptare (FMN, 2016) (Keshilli i Ministrave, 2001). Mbyllja e një OJQ-je po ashtu kërkon që përfaqësuesit të udhëtojnë në Gjykatën e Rrethit të Tiranës për të marrë një vendim formal (ICNL). Si organizata jofitimprurëse, OJQ-të përjashtohen nga taksat për dhurimet, detyrimet e anëtarësisë si dhe tatimi mbi fitimin, por përsëri kanë përgjegjësi të paguajnë taksa të konsumit të përgjithshëm, të tilla si Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH).¹⁰ Nuk ka të dhëna për ndonjë grup që të jetë përpjekur të regjistrojë një OJQ apo organizatë tjetër jofitimprurëse që fokusohet tek çështjet, qeverisja ose transparenca e industrisë nxjerrëse dhe t'i jetë mohuar apo të jetë përballur me sfida për regjistrimin. Të gjitha OSHC që janë angazhuar në EITI, qoftë si anëtare të MSG apo si OSHC që marrin pjesë në emërimin e anëtarëve të MSG, duket se janë regjistruar pa vonesa administrative.

Ekzistojnë të dhëna se, ndërkohë që nuk ka pengesa ligjore apo administrative që OJQ të sigurojnë fonde si nga burime të brendshme ashtu edhe të jashtme, shoqëria civile përballlet me sfida burimore dhe për kapacitete, të cilat ndikojnë qëndrueshmërinë financiare dhe administrative (Qendra Burimore Anti-Korrupsion, 2011). Sipas një anketimi të vitit 2010 zhvilluar nga CIVICUS për Indeksën e Shoqërisë Civile (CSI) në Shqipëri,¹¹ vetëm 16.1% e organizatave konsideroheshin me personel të mjaftueshëm, ndërkohë që shumë OSHC punonin mbi baza vullnetare për shkak të mbështetjes mbizotëruese të OJQ-ve për financime tek donatorët e huaj (57%) dhe qeveria (17.8%) (CIVICUS, 2010). Sipas Rrjetit Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, ngritja lokale e fondeve¹² konsiderohet sfiduese për shkak të mungesës së traditës dhe nxitjeve për kontributeve të sektorit privat (Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile). Një numër anëtarësh të MSG nga OSHC-të kanë ngritur publikisht shqetësime lidhur me kufizimet në aksesin ndaj fondeve të Bankës Botërore ose Qeverisë për aktivitete të lidhura me EITI (AlbEITI, 2016). Sipas marrëveshjes për grante të Bankës Botërore me Qeverinë e Shqipërisë të datës 21 dhjetor 2015, anëtarët e MSG nuk kualifikohen për të aplikuar për aktivitete të EITI financuar me grante për të shmangur ndonjë konflikt interesi (Banka Botërore, 2015). Natyra e pengesave të tjera të hasura nga shoqëria civile për ngritjen e fondeve për aktivitete të lidhura me EITI-n nga donatorë të tjerë është e paqartë. Megjithatë, një raport i vitit 2015 për Indeksën e Qëndrueshmërisë nga USAID theksonte përmirësime në vitet e fundit në mjedisin ligjor dhe qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë civile

¹⁰ <http://www.bridgewest.eu/article/register-non-profit-organization-albania>

¹¹ <http://www.civicus.org/>

¹² Donatorët kryesorë të huaj të shoqërisë civile janë Komisioni Europian, USAID, UNDP, OSBE, Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO), GIZ dhe Banka Botërore. OJQ ndërkombëtare si Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe Konrad Adenauer Stiftung (KAS) ofrojnë burime më të kufizuara financimi. I vetmi ent vendas që ofron financim, nga qeveria, është Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

shqiptare, të lidhura me ngritjen e një Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (shih më poshtë) dhe financimin nga qeveria për OJQ-të (USAID, 2015).

Shoqatat: Nuk ka të dhëna që të sugjerojnë se ekzistojnë kufizime apo shtrëngime për OJQ-të në lidhje me aftësinë e tyre për shoqërizime, komunikime dhe bashkëpunime me të tjera OJQ kombëtare apo ndërkombëtare. Kushtetuta dhe kuadri ligjor i Shqipërisë sigurojnë liritë e grumbullimit dhe shoqatave, dhe duket se qeveria përgjithësisht i respekton këto të drejta në praktikë (Departamenti i Shtetit i SHBA, 2016). Sipas Gjykatës së Rrethit të Tiranës, deri në fund të vitit 2014 ekzistonin 6,855 OSHC të regjistruara, edhe pse autoritetet tatimore regjistronin vetëm 2,427 OSH që paguanin rregullisht taksat (p.sh. TVSH) dhe për pasojë konsideroheshin operacionale (USAID, 2015). Sipas Anketimit 2010 CSI-CIVICUS, shoqëria civile është relativisht e mirëstrukturuar, me struktura të brendshme funksionale, ndërveprime aktive, kapacitete për rrjetëzim dhe infrastrukturë të mirë (CIVICUS , 2010). Ndërkohë që anketimi është nga viti 2010, përshkrimi prej tij i situatës duket ende me vend. Nga ana tjetër, anketimi vëren se qytetarët priren të jenë skeptikë për shoqërinë civile dhe e perceptojnë atë si burim përfitimesh financiare, shpesh të nxitur nga donatorët dhe mundësitë për financim (CIVICUS , 2010). Shoqëria civile në Shqipëri është e shumëllojshme dhe përfshin organizata të ndryshme që variojnë nga OJQ që i kushtohen grave, pakicave, anti-korrupsionit, sindikatat profesionale (p.sh. minatorët), institucione arsimore, think tank, grupe mjedisore, organizata që ofrojnë shërbime sociale, organizata rinore, grupe fetare dhe media (CIVICUS , 2010). Megjithatë, raporti CSI-CIVICUS vë në pah perceptimin publik për shoqërinë civile dhe organizatat e medias si me anësi partiake, me rreth një të katërtën e OJQ-ve si anëtarë të organizatave politike (CIVICUS , 2010).

Aktualisht janë katër OSHC që përfaqësohen në MSG: Qendra Shqiptare për Zhvillim Institucional, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë dhe Sindikata e Minatorëve të Bulqizës. Përfaqësuesja e pestë OSHC Madlina Puka nga Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim në Vlorë, dha dorëheqjen në mars 2016 pasi u emërua në një post në qeverisjen vendore dhe nuk është zëvendësuar që atëherë (*shih Kërkesa 1.4.*). Katër OJQ-të e përfaqësuar drejtpërdrejt në MSG kanë regjistruar një shoqatë jofitimprurëse, të quajtur Rrjeti Shqiptar – Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse në janar 2016; ka statutin dhe kodin e vet të sjelljes (AlbNet-EITI, 2016). Nuk ka nëndegë vendase të rrjetit global Publish What You Pay (PWYP) (Publiko Atë që Pagan) në Shqipëri. Ka të dhëna për kontakte të shpeshta, informale midis disa anëtarëve të OSHC në MSG dhe PWYP ndërkombëtar dhe anëtarë nga OSHC në MSG kanë marrë pjesë në workshop-e rajonale organizuar nga PWYP dhe NRG (PWYP, 2016) (PWYP, 2015) (NRGI, 2015).

Statutet e AlbNet-EITI ofrojnë objektivat dhe përgjegjësitë kryesore por nuk tregojnë përmasat e anëtarësisë së OJQ-së. Objektivat kryesore përfshijnë ofrimin e mbështetjes së plotë për procesin e EITI në Shqipëri, fushatat për transparencë dhe llogaridhënie të qeverisë dhe kompanive nëpërmjet transparencës së të ardhurave dhe kontratave, duke rritur ndërgjegjësimin publik mbi përfitimet nga përdorimi i burimeve natyrore, duke ndikuar vendim-marrjen e qeverive vendore në lidhje me zhvillimin komunitar në rajonet nxjerrëse, cilësinë e arsimit, kulturës dhe të drejtave të njeriut, duke zgjeruar anëtarësinë dhe duke kryer studime të ndryshme të lidhura me EITI (AlbNet-EITI, 2016). Përveç këtyre, statutet e OJQ-së përcaktojnë përgjegjësitë e anëtarëve të koalicionit përfshi pjesëmarrjen aktive në zbatimin e EITI në Shqipëri, organizimin e workshop-eve, konferencave, simpoziumeve dhe të tjera

formave të diskutimit lidhur me EITI-n, promovimin e hapësirës mediatike për politikat publike në industrinë nxjerrëse, organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere me qeverisjen vendore dhe shoqërinë civile, anëtarësim të tjera organizatave ndërkombëtare që punojnë mbi çështje të ngjashme, ofrimin e asistencës teknike për qeveritë qendrore dhe vendore si dhe kompanitë lidhur me zbatimin e EITI-t dhe përgatitjen e botimeve lidhur me EITI-n (AlbNet-EITI, 2016). Nuk ka të dhëna dokumentare për të tilla aktivitete prej formimit të OJQ-së në janar 2016.

Përveç katër OJQ-ve të pranishme në MSG, edhe OSHC të tjera kanë shprehur interes në EITI, siç evidentohet nëpërmjet workshop-it kapacitet-ndërtues të PWYP (Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, 2015). Megjithatë, nuk ka të dhëna për ndonjë përpjekje për shpërndarje nga anëtarët e OSHC në MSG për të identifikuar OJQ Shqiptare të fokusuar tek çështje të industrisë nxjerrëse, të qeverisjes apo transparencës. Në prill 2015, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve zhvilloi një workshop për OSHC për rreth 30 OSHC nga Tirana, Bulqiza, Pogradeci Patosi dhe Vlora me mbështetjen e PWYP dhe MEI për të zgjeruar angazhimin e OSHC dhe për të ndërtuar kapacitete për të rritur EITI-n (Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, 2015). Nuk ka të dhëna për angazhim më pas të lidhur me EITI me këto 30 OSHC pas workshop-it, përfshi nga anëtarët e OSHC në MSG. Megjithatë, ka një numër OSHC-sh me interes potencial në çështje të lidhura me EITI-n, përfshi pjesëmarrës të OSHC në përpjekjet e Shqipërisë për OGP¹³ (Transparency International Shqipëri, Open Data Shqipëri, Lëvizja Mjaft!, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Citizens Advocacy Office dhe Rrjeti për Shoqërinë e Hapur në Shqipëri) (Qendra Burimore Anti-Korrupsion, 2011).

Sipas kodit të sjelljes së OSHC, anëtarët e OSHC në MSG duhen të konsultohen dhe t'i raportojnë rregullisht zonave të tyre të komuniteteve vendore, rrjeteve dhe OJQ-ve të tjera. Kodi kërkon që anëtarët e MSG të ofrojnë informacion të mjaftueshëm pranë rrjeteve për të lejuar mundësi për inpute domethënëse në diskutimet e MSG dhe për të zhvilluar takime përgatitore për të bashkërenduar dhe dakordësuar një pozicion dhe rekomandime të përbashkëta të shoqërisë civile lidhur me temat në axhendën e takimit të MSG (Kodi i Sjelljes i OSHC-ve, 2015).

Angazhimi: Shoqëria civile është e angazhuar në ndërtimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e EITI-t nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet e MSG, megjithatë ka pak fakte dokumentare për angazhimin e tyre në shpërndarje dhe përhapje. Shënimet e takimeve të MSG tregojnë angazhim aktiv në diskutimet e MSG gjatë viteve dhe është e qartë që ka kapacitet mes shoqërisë civile në tërësi për t'u angazhuar në çështje që lidhen me qeverisjen e burimeve natyrore. Ka të dhëna që një numër anëtarësh të MSG nga OSHC kanë shprehur pikëpamjet e tyre mbi pagesat sociale, publikimin e pronësisë reale, transfertën për NJQV të rentës prej 5%, çështje mjedisore dhe qeverisjen e MSG në takimet e MSG gjatë periudhës 2013-2017 (AlbEITI, 2016), (AlbEITI, 2016). Megjithatë, nuk ka të dhëna se anëtarë të MSG nga OSHC të ishin aktivë jashtë takimeve të MSG dhe që t'i kenë përdorur të dhënat e EITI-t për avokati, kërkim ose përhapje për

¹³ <https://www.opengovpartnership.org/countries/albania>

të gjeneruar debat publik. Gjithashtu, që nga rinovimi i anëtarësisë së OSHC në MSG në prill 2015, ka të dhëna se bashkërendimi midis anëtarëve të MSG ka rënë dhe se nuk ka të dhëna dokumentare për konsultime midis anëtarëve të MSG nga OSHC jashtë takimeve të MSG përveç të dhënave anekdotike për biseda telefonike informale dhe ad hoc.

Objektivi i tretë kombëtar i planit të punës EITI 2016 njih rëndësinë e mbështetjes së përfaqësimit të qytetarëve shqiptarë nga shoqëria civile në diskutimet me qeverinë (Plani i Punës Alb-EITI, 2016). Një prej objektivave kyçe të AlbEITI-t është të promovojë krijimin e një mjedisi që nxit pavarësinë, eficiencën dhe qëndrueshmërinë e shoqërisë civile (Plani i Punës Alb-EITI, 2016). Një prej aktiviteteve të planit të punës lidhet me identifikimin e aktorëve dhe ndërtimin e konsensusit për shoqërinë civile lidhur me zbatimin e EITI, edhe pse plani i punës nuk përfshin aktivitete të tjera që lidhen me ndërtim kapacitetesh të OSHC-ve. Ndonëse plani i punës EITI përfshin aktivitete që synojnë ndërtim kapacitetesh për shoqërinë civile, nuk ka të dhëna se këto aktivitete janë kryer apo se shoqëria civile është përpjekur aktivisht të trajtojë ndonjë sfidë lidhur me kapacitetet.

Aksesi në vendim-marrjen publike: Ka pasur një numër reformash ligjore kohët e fundit për të forcuar inputin e shoqërisë civile në vendim-marrje. Ligji 119/2014 mbi të Drejtën për Informim miratuar në vitin 2014 garanton të drejtën për akses në informacion publik dhe ofron kuadrin ligjor që rregullon aksesin në informacionin publik (Parlamenti i Shqipërisë, 2014). Në vitin 2014, Parlamenti miratoi Ligjin 247/2014 mbi Njoftimin dhe Konsultimin Publik për të rregulluar detyrimin për të konsultuar projektligje, strategji dhe të tjera politika me qytetarët (Balkan Insight, 2014) (Ministria e Mjedisit, 2015). Sipas Nenit 9 të Ligjit 247/2014, të gjithë qytetarët dhe rezidentët e huaj kanë të drejtën të kërkojnë informacion mbi konsultimin publik, përfshi aksesin për të hartuar projekt-legjislacion, propozuar nisjen e rihartimit të legjislacionit nga autoritetet publike dhe paraqitur komente dhe rekomandime për projektligje. Një platformë online u themelua nga Ministria e Novacionit dhe Administratës Publike për të lehtësuar këto mekanizma (Keshilli i Europes, 2016). Neni 21 i Ligjit 247/2014 rregullon kanalet për njoftimin dhe marrjen e komenteve si dhe përcakton afate specifike për përpunimin e kërkesave, me mekanizma të qarta apelimi (brenda 30 ditësh nga miratimi) që përfshijnë kreun e organit publik përgjegjës për rregullimin specifik ose Komisionerin për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave (Keshilli i Europes, 2016).

Raporti për Indeksin e Qëndrueshmërisë 2015 i USAID theksonte miratimin nga qeveria të një politike kombëtare në vitin 2015 për të ofruar një mjedis nxitës për shoqërinë civile, i cili mbulonte fusha prioritare që përfshijnë financimin publik, bashkëpunimin qeveri-OSHC, kuadrin legjislativ për regjistrimin dhe funksionimin e OSHC-ve, zhvillimin e vullnetarizmit dhe raportimin financiar e trajtimin tatimor të OSHC-ve (USAID, 2015). Ligji i qeverisë 119/2015, miratuar në vitin 2015, institucionalizonte bashkëpunimin dhe dialogun midis shoqërisë civile dhe qeverisë duke krijuar një Këshill Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) (USAID, 2015). Megjithatë, fakti që KKSHC kryesohet nga Ministri për Mirëqenien Sociale dhe Rininë ka shkaktuar njëfarë skepticizmi lidhur me pavarësinë e KKSHC mes disa OSHC-ve (USAID, 2015).

Megjithatë, ka pak të dhëna se shoqëria civile e ka përdorur procesin EITI për të promovuar debat publik. Sekretariati Alb-EITI punësoi EuroSupport për konsulencë për një shqyrtim të legjislacionit kombëtar

lidhur me EITI-n dhe hartimin e një Ligji për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse. Nuk ka të dhëna dokumentare se anëtarët e OSHC në MSG kanë ofruar inpute apo kanë komentuar projektligjin, apo ndonjë analizë të shoqërisë civile për projektligjin apo avokatinë e lidhur me Alb-EITI në periudhën 2015-2017.

Po ashtu, ka pak të dhëna se anëtarët e OSHC në MSG kanë qenë aktivë jashtë takimeve të MSG apo të kenë përdorur të dhënat nga EITI për avokati, kërkim dhe përhapje që të kenë çuar në debat publik. Nuk ka njoftime për shtyp, deklarata apo publikime nga anëtarët e OSHC në MSG që të shprehin ndonjë pikëpamje lidhur me çështje të lidhura me EITI-n apo të një natyre më të gjerë për qeverisjen e burimeve natyrore. Shënimet e takimeve të MSG nga 6 maj 2016 tregojnë se një përfaqësues i shoqërisë civile kishte sugjeruar përgatitjen e një Raporti EITI për të hetuar çështje të pambuluara plotësisht nga Raportet EITI të Shqipërisë, të tilla si transfertat e rentës tek rajonet nxjerrëse si dhe shpenzimet sociale dhe mjedisore (AlbEITI, 2016). Ndërkohë që u prit mirë nga anëtarë të tjerë të MSG si dhe nga Kreu i MSG, i cili ofroi mbështetje për sigurimin e fondeve për të tilla përpjekje, nuk ka të dhëna që OSHC-të të kenë ndjekur më pas diskutimin për ta përgatitur një raport të tillë (AlbEITI, 2016). Pavarësisht kërkesave të përsëritura për prova deklarimesh publike mbi çështje të lidhura me qeverisjen e burimeve natyrore apo çështje të tjera të lidhura me EITI-n, Sekretariati Ndërkombëtar nuk mori ndonjë provë nga përfaqësuesit e OSHC-ve që u konsultuan.

Pikëpamjet e aktorëve

Shprehja: Të gjithë anëtarët e OSHC në MSG që u konsultuan konfirmuan se kishin mundësi të flisnin lirisht në publik dhe se nuk kishin pengesa në lirinë e tyre të fjalës për sa i përket ndonjë çështjeje të lidhur me EITI. Një anëtar i industrisë në MSG konfirmoi se OSHC-të ishin shumë kritike lidhur me MSG, çka shihej si e dobishme në kuptimin që një vështrim i tillë kritik ndihmonte për të përmirësuar cilësinë e zbatimit. Përfaqësues të shoqërisë civile jashtë MSG vërejtën se nuk kishte çështje që ndikonin lirinë e fjalës në Shqipëri. Ndërkohë që një numër OSHC-sh mendonin se gazetarët hera-herës praktikonin një formë vetëcensure, kjo i mvishej faktit që media ishte e politizuar dhe se gazetaret iu përkisnin biznesmenëve a politikanëve, çka nënkuptonte se gazetarët nuk prireshin të shprehnin pikëpamje kritike për çështje që lidheshin me pronarët e tyre. Këta përfaqësues po ashtu vërejtën se gazetarët shpesh ia përshtasnin përmbajtjen përparësive të reklamuesve të tyre, edhe pse pranonin se kjo ndodhte ndonjëherë edhe në vende europiane. Asnjë prej gazetarëve të konsultuar nuk mendonin se kishte ndonjë çështje e cila nuk mund të raportohet në publik për ndonjë arsye. Një përfaqësues qeveritar tha se shoqëria civile nuk përballëj me kufizime për të shprehur lirisht pikëpamjet e tyre mbi qeverisjen e industrive nxjerrëse dhe theksoi se anëtarët e OSHC në MSG shpesh ishin të zëshëm dhe shumë kritikë si ndaj qeverisë ashtu edhe ndaj kompanive në takimet e MSG. Partnerët zhvillimorë mendonin se nuk kishte kufizime në aftësinë e shoqërisë civile për të shprehur lirisht pikëpamjet e tyre kritike dhe se ekzistonte një mjedis nxitës ndaj lirisë së shprehjes në Shqipëri.

Funksionimi: Përfaqësues të shoqërisë civile jashtë MSG mendonin se nuk kishte pengesa ligjore apo praktike për funksionimin e OJQ-ve, por se kërkesa që themeluesit e një OJQ-je të vizitonin Gjykatën e Rrethit të Tiranës ishte sfiduese (për sa i përket kohës dhe kostove të udhëtimit) për disa aktivistë të vendosur jashtë kryeqytetit. U vërejt se hapja e një OJQ-je nuk ishte sfiduese dhe se kushtonte afërsisht 100 USD, edhe pse një tjetër përfaqësues OSHC vërejt se tarifatat ligjore dhe noteriale mund të shtonin

edhe 200-300 USD përpos kostos për ngritjen e një OJQ-je. Një anëtar i MSG nga OSHC shpjegoi se ishte e mundur që të shmangeshin thuajse të gjitha kostot ligjore duke përgatitur statutet dhe dokumenta të tjera, me kusht që themeluesit e OJQ-ve të kishin ekspertizë ligjore. Pas diskutimit të numrit total dhe shumëllojshmërisë së OSHC-ve që faktikisht operojnë në Shqipëri, përfaqësues të OSHC jashtë MSG theksuan mungesën e qartësisë lidhur me numrin faktik të OJQ-ve që faktikisht ishin operacionale. Ata theksuan se ndërkohë që të dhënat nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile tregonin se kishte 7,000 OJQ të regjistruara pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve tregonin vetëm 3,000 OJQ që paguanin taksa (p.sh. TVSH). Gjithashtu, një zyrtar qeveritar shpjegoi se OJQ-të mund të regjistroheshin vullnetarisht në bazën e të dhënave të OJQ-ve e mbajtur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, vetëm rreth 1,000 OSHC e kishin bërë këtë deri tani. Një numër OSHC-sh jashtë MSG shpjeguan se numri i lartë i OJQ-ve të regjistruara në Gjykatën e Rrethit Tiranë vinte ndoshta për shkak të kostos së lartë për të mbyllur një OJQ, e cila iu kërkonte themeluesve të udhëtonin në Tiranë dhe të merrnin një vendim gjykate për mbylljen e OJQ-së, dhe se shumica e themeluesve thjesht e linin OJQ-në e tyre në qetësi në vend që ta mbyllnin atë zyrtarisht. Të tjera OSHC të konsultuara nuk e shihnin kohën dhe koston për mbylljen e një OJQ-je se ishte fort shkurajuese për mbylljen e një organizate.

Të gjithë anëtarët e OSHC në MSG shprehën keqardhjen për ato që ata i shihnin si pengesa të larta për akses në financim. Një anëtar i OSHC në MSG vërejti se fond-ngritja e pasuksesshme nga OSHC-të ishte pengesa kryesore për ndërmarrjen nga shoqëria civile e aktiviteteve për shpërndarje dhe përhapje lidhur me EITI-n jashtë Tiranës. Kur iu kërkua të përshkruanin përpjekjet për ngritje fondesh deri më sot, disa anëtarë të OSHC në MSG pranuan se nuk ishin takuar me ndonjë nga donatorët e pranishëm në Shqipëri lidhur me projekte të lidhura me EITI-n specifikisht, dhe as kishin zhvilluar projekte konkrete për të aplikuar për financim. Megjithatë, një numër anëtarësh të OSHC në MSG mendonin se mungesa e financimit të OSHC-ve për aktivitete të lidhura me EITI-n vinte për shkak të një fushate shpifjeje zhvilluar nga Sekretariati AlbEITI për të koplikuar përpjekjet për ngritje fondesh nga OSHC-të lidhur me EITI-n dhe për të diskredituar anëtarët e OSHC në MSG pranë partnerëve të zhvillimit. Një anëtar i OSHC në MSG vërejti se ndërkohë që kishte ngritur fonde me sukses për aktivitete të lidhura me EITI-n në periudhën 2011-2012, ai ishte ndjerë i demotivuar që të tjera OSHC i kishin përdorur këto fonde pa ngritur fonde të tjera shtesë vetë. Një numër anëtarësh të OSHC në MSG vërejtën se kishin projekte në vazhdim financiar nga donator të huaj, përfshi për transparencë në sektorin e shëndetit publik. Personeli i Sekretariatit shpjegoi se ishin përpjekur t'i prezantonin anëtarët e OSHC në MSG me donatorë të mundshëm në komunitetin e partnerëve për zhvillim, por mendonin se OSHC-të nuk kishin ndjekur kontaktet në mënyrë proaktive pas prezantimit fillestar. Partnerë të ndryshëm zhvillimi konfirmuan se kishin financime në dispozicion për OSHC-të, sidomos mbi çështje të transparencës dhe qeverisjes, dhe mendonin se kishte mundësi të mjaftueshme për ngritje fondesh për OSHC-të në Shqipëri. Disa donator vërejtën se nuk ishin takuar kurrë me OSHC-të e përfaqësuar në MSG dhe nuk kishin marrë ndonjëherë ndonjë aplikim për aktivitete të lidhura me EITI-n. Një partner zhvillimi theksoi se pak OJQ kishin marrë financim nga donatorët për punën e tyre lidhur me EITI-n në vitet 2011-2012 por se këto OJQ nuk dukeshin se kishin qenë aktive në aktivitete të lidhura me EITI-n që nga ajo kohë. Ndërkohë që një numër përfaqësuesish të industrisë mendonin se OSHC-të gjithmonë dukeshin të interesuara dhe propozonin ide për projekte të reja, dukej se OSHC-të ishin të interesuara për të kërkuar financim për projektet e veta dhe kjo mund të konsiderohej një konflikt interesi për OJQ-të që kërkonin të përfitonin nga pozicionet e tyre në MSG.

Shoqërimi: Anëtarët e shoqërisë civile në MSG thanë se kishin një listë prej pothuajse 100 OJQsh të interesuara për EITI-n por se këto OSHC nuk ishin kontaktuar prej vitit 2015. Vërtet, anëtarët shpjeguan se anëtarët e OSHC të AlbNet-EITI ende nuk ishin njoftuar se organizata ishte regjistruar në janar 2016. Përfaqësues të shoqërisë civile jashtë MSG nuk i njihnin përfaqësuesit e tyre në MSG dhe vërejtën se anëtarët e OSHC në MSG nuk kishin pasur ndonjëherë kontakt me ta përpara pjesëmarrjes së tyre në konsultimet me aktorët për Validimin e Shqipërisë. Një OSHC vërejtë se kontakti i tyre fillestar me anëtarët e OSHC në MSG lidhur me EITI-n, ku OSHC ishin përpjekur të vendosnin një marrëdhënie pune lidhur me çështje të EITI, kishte qenë i pasuksesshëm sepse një anëtar OSHC në MSG kishte qenë veçanërisht jomiqësor dhe dukej se agresivisht mbronte vendin e vet si anëtar OSHC në MSG në vend që të ishte i hapur për angazhimin me të tjera OSHC me interesa në EITI. Personeli i Sekretariatit shpjegoi se ishin përpjekur të vendosnin kontakte midis OSHC-ve të tjera dhe akademikëve të interesuar tek EITI, por se kjo nuk kishte qenë e suksesshme sepse anëtarët e OSHC në MSG sipas raportimeve nuk kishin treguar interes për hapje ndaj OSHC-ve të tjera. Personeli i Sekretariatit shprehu keqardhje për akuzën e OSHC-ve sikur sekretariati ndërhynte në pavarësinë e shoqërisë civile me anë të përpjekjesh të tilla dhe shpjegoi se sekretariati, për pasojë, ishte tërhequr menjëherë nga të tilla përpjekje. Përfaqësuesit e industrisë që u konsultuan nuk shprehën ndonjë pikëpamje të veçantë lidhur me shoqërimin e shoqërisë civile, qoftë në përgjithësi apo në lidhje me EITI-n.

Angazhimi: Përfaqësues të OSHC në MSG vërejtën se OJQ-të që nuk përfaqësohen në MSG dukeshin se kishin vetëm ndërgjegjësime përgjithësisht të ulët lidhur me EITI-n dhe mendonin se pika qendrore e çështjeve EITI ishte Sekretariati AlbEITI, jo anëtarët e OSHC në MSG. Ndërkohë që disa nga këto OSHC shprehën interes për më shumë angazhim me EITI-n, vinin në dyshim vlerën e mobilizimit tek njerëzit në bazë në lidhje me EITI-n dhe mendonin se qeveria duhet të ishte ajo që të vepronte dhe organizonte sektorin e OSHC-ve lidhur me EITI-n. Një përfaqësues OSHC vërejtë se ndonëse ai ishte i mirë-informuar mbi EITI-n, nuk ishte në dijeni të mundësisë për t'u përfaqësuar në MSG. Të gjithë OSHC-të jashtë MSG konfirmuan se anëtarët e OSHC në MSG nuk iu kishin shtrirë dorën atyre apo komunitetit të gjerë të OSHC. Personeli i Sekretariatit komentoi se anëtarët e OSHC në MSG nuk dukeshin se kishin praktikën e mirë të konsultimit me sektorin e vet më gjerë mbi çështje të lidhura me EITI-n dhe se anëtarët e OSHC në MSG në radhë të parë e shihnin angazhimin e tyre në EITI si pjesëmarrje në takimet e SMG, jo në aspekte të tjera të zbatimit të EITI-t. Personeli i Sekretariatit vërejtë se ndërsa anëtarja e pestë e OSHC në MSG (Madlina Puka nga Vlora) kishte qenë proaktive deri në kohën e dorëheqjes në vitin 2016, mungesa e zëvendësuesit kishte lënë një boshllëk.

Një përfaqësues qeveritar mendonte se shoqëria civile në MSG nuk kishte qenë aktive. Një anëtar i OSHC në MSG theksoi kundërshtimet që kishte ngritur mbi MSG në vitin 2015 se pikëpamjet e OSHC-ve nuk merreshin parasysh në diskutimet në MSG dhe se kjo kishte kufizuar hapësirën e OSHC-ve për të vepruar. Megjithatë, zyrtari qeveritar mendonte se arsyeja për këto pretendime ishte se anëtarët e OSHC në MSG nuk kishin marrë financim nga Banka Botërore nën grantin MDTF në mbështetje të zbatimit EITI pavarësisht se këto OSHC kishin kërkuar financim për pjesëmarrjen e tyre në MSG. Zyrtari theksoi se politika e qartë e Bankës Botërore që përjashtonte anëtarët e MSG nga aplikimi për projekte të financuara nga MDTF por vërejtë se plani i punës EITI ofronte mundësi për OSHC-të përfshi workshop-e, aktivitete për ngritje kapacitetesh dhe shpenzime udhëtimi për OSHC-të.

Një konsulent që zhvilloi një strategji komunikimi për EITI-n për 2016-2017 për OSHC-të ka vërejtur e kapacitetet për avokati dhe lobim të OSHC-ve Shqiptare nuk kishin ndryshuar dukshëm në vitin 2015, pavarësisht angazhimit të tyre në një numër nismash avokatie. Ndërkohë që përgëzonte rolin thelbësor të OSHC-ve në MSG, për përfaqësimin e komuniteteve dhe theksimin e çështjeve sfiduese, konsulenti theksoi nevojën për një analizë të mirëfilltë dhe plan pune për të përmirësuar angazhimin e OSHC-ve në EITI përtej pjesëmarrjes së tyre në takimet e MSG, për të përfshirë OJQ që nuk janë të përfaqësuara drejtpërdrejt në MSG (Alb-EITI, 2016).

Aksesi në vendim-marrjen publike: Pavarësisht konsultimeve të gjera me OSHC mbi përdorimin prej tyre të informacionit EITI në fushata avokatie, anëtarët e OSHC në MSG vërejtën se i kishin përdorur vetëm rrallë të dhënat nga Raportet EITI në punën e tyre të zakonshme. Megjithatë kërkesat e përsëritura për fakte të çfarëdo përdorimi të të dhënave EITI, OSHC-të e konsultuara nuk i ofruan ndonjë dokument Sekretariatit Ndërkombëtar. Një përfaqësues OSHC në MSG mendonte se raportimi EITI nuk ishte mjaftueshëm në kohë për të mbështetur avokatinë e OSHC, duke vërejtur se të dhënat për 2015 ishin me pak interes në vitin 2017 (*shih Kërkesa 4.8*). Megjithatë, ka të dhëna se shoqëria civile ka akses në vendim-marrjet publike në çështje të tjera. Një anëtar i OSHC në MSG vërejti se shoqëria civile kishte marrë pjesë me sukses në fushata avokatie për miratimin e Ligjit për të Drejtën për Informim në vitin 2014. Megjithatë, anëtarët e OSHC në MSG vërejtën se nuk kishin bërë komente të posaçme për projektligjin mbi Transparencën në Industrinë Nxjerrëse dhe nuk kishin planifikuar ndonjë fushatë avokatie përkatëse. Personeli i Sekretariatit ishte kritik lidhur me përmbushjen nga OSHC të rolit të tyre në zbatimin EITI, duke menduar se OSHC-të nuk kishin një vizion të qartë se si donin ta përdornin EITI-n, nuk prireshin të ndanin informacion lidhur me planet e tyre e as nuk dukeshin se i përdornin të dhënat EITI në ndonjë mënyrë. Personeli mendonte se OSHC-të ishin kryesisht joaktivë për sa i përket shpërndarjes dhe përhapjes lidhur me EITI-n dhe se kompanitë dukeshin më aktive se sa shoqëria civile në këtë drejtim.

Vlerësim fillstar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Nuk ka të dhëna për ndonjë pengesë ligjore, rregullatore apo praktike për aftësinë e shoqërisë civile për t'u angazhuar në EITI apo aftësinë e tyre për të funksionuar, komunikuar dhe bashkëpunuar me komunitetin e gjerë. Shënimet nga takimet e MSG dhe konsultimet me aktorët nuk tregojnë kufizime mbi të drejtat apo aftësinë e shoqërisë civile për të qenë e angazhuar aktivisht në EITI. Megjithatë, ka pak të dhëna që tregojnë se OSHC-të e kanë përdorur këtë hapësirë për të qenë të angazhuara plotësisht, aktivisht dhe efektivisht në zbatimin EITI përveç shprehjes së pikëpamjeve kritike në takimet e MSG. ndërkohë që kufizimet në financim dhe mungesa e angazhimit të efektshëm të OSHC-ve nuk e lë shoqërinë civile të ndikojë plotësisht dhe efektshëm ndërtimin dhe zbatimin e EITI-t, ka pak të dhëna që tregojnë se oraganizatat e shoqërisë civile kanë ndërmarrë hapa për të mobilizuar financime.

Në përputhje me kërkesën 1.3.a, sektori i shoqërisë civile duhet të demonstrojë se janë plotësisht, aktivisht dhe efektivisht të angazhuar në procesin EITI. Specifikisht, shoqëria civile duhet të sigurojë që janë në gjendje të kontribuojnë plotësisht dhe ofrojnë input për procesin EITI dhe se kanë kapacitet e duhura për të marrë pjesë në EITI. Në përputhje me kërkesën 8.3.c.i, sektori i shoqërisë civile duhet të zhvillojë dhe publikojë ndonjë plan për të trajtuar mungesat në angazhimin e shoqërisë civile dokumentuar në vlerësimin fillestar dhe raportin e validuesit brenda tre muajsh nga vendimi i Bordit,

dmth <Vendim Bordi + 3 muaj >. Sektori mund të dojë të ndërmarrë një shqyrtim të pavarur të angazhimit të shoqërisë civile në EITI në Shqipëri, duke zgjeruar angazhimin me OSHC me interesa të mundshme në zbatimin EITI. Ndërmarrja e një vlerësimi për nevojat për kapacitete dhe formulimi i veprimeve për të trajtuar kufizimet në kapacitete të shoqërisë civile janë thelbësore, The constituency may wish to undertake an independent review of civil society engagement in the EITI in Albania, broadening the engagement with CSOs with potential interests in EITI implementation. Undertaking a capacity needs assessment and formulating actions to address civil society capacity constraints are crucial, sidomos për të zhbllokuar financime nga partnerë zhvillimi dhe palë të tjera përkatëse. Sektori i shoqërisë civile nxitet të zhvillojë dhe bjerë dakord mbi udhëzimet që përcaktojnë efektivisht procesin me anë të të cilit anëtarët në MSG do të përzgjidhen dhe do t'u kërkohet llogari.

Qeverisja dhe funksionimi i MSG (#1.4)

Dokumentimi i përparimit

Përbërja dhe anëtarësia e MSG: MSG me 17 anëtarë u themelua me Dekret të Kryeministrit 71/2011 më 31 korrik 2011. As Dekreti 71/2011 as ToR të vetë MSG nuk parashikojnë zëvendësues të anëtarëve të MSG. Shtatë anëtarët qeveritarë përfshijnë Zëvendës Ministrin e Energjisë dhe Industrisë Ilir Bejtja, Kreu i MSG, dhe përfaqësues nga MF, MD, DPT, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, AKBN dhe IMEI. Pesë anëtarët e industrisë në MSG përfshijnë Albchrome, ANTEA Cement, Bankers Petroleum Ltd, FIAA dhe Shell Upstream Albania. Shoqëria civile k apesë vende në MSG, edhe pse dorëheqja e një anëtareje të MSG nga OSHC në vitin 2016 nuk kishte çuar në zëvendësimin e saj deri në fillim të Validimit të Shqipërisë më 1 prill 2017. Katër anëtarët e tjerë të OSHC në MSG në përfshijnë përfaqësues nga tri OJQ me qendër në Tiranë¹⁴ dhe një sindikatë vendore punëtorësh, Sindikata e Minatorëve të Bulqizës.

Përbërja e MSG përcaktohet në Nenin 7 të Termave të Referencës (TeR) së MSG të janarit 2017 (Alb-EITI, 2017). TeR përcaktojnë kufizime mandati për anëtarësinë dhe vërejnë se emërimi i anëtarëve nga qeveria varet nga posti i tyre në qeveri dhe nuk është emëror (Neni 11). Anëtarët e MSG nga dy grupet e tjera lejohen të shërbejnë për një periudhë prej tre vjetësh, ku zëvendësimi i tyre ndërmerret vetëm gradualisht për të siguruar ruajtjen e memories institucionale të grupit në MSG. TeR po ashtu lejojnë anëtarët e MSG që të rrimërohen nga grupi i tyre nëse performanca e tyre është konsideruar “e kënaqshme” (Alb-EITI, 2017).

Përfaqësimi i shoqërisë civile: Shoqëria civile në MSG përfaqësohet nga Sami Neza i Qendrës për Transparencë dhe Informacion të Lirë, Ilir Aliaj i Qendrës për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, Anila Hajnaj nga Qendra Shqiptare për Zhvillim Institucional dhe Baki Bajraktari nga Sindikata e Minatorëve të Bulqizës. TOR të MSG specifikojnë se përfaqësues nga shoqëria civile do të përzgjidhen nga “Rrjeti Kombëtar i Shoqërisë Civile për EITI” por nuk përfshin dispozita për përzgjedhjen e anëtarëve të MSG. Urdhri 71/2011 kërkon vetëm që Rrjeti të paraqesë emrat e përfaqësuesve të vet në

¹⁴ Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve dhe Qendra Shqiptare për Zhvillim Institucional.

MSG pranë Sekretariatit EITI. Ndërkohë që TeR sugjerojnë se shoqëria civile është e lirë të zgjedhë anëtarët e saj sipas kriterëve të veta, nuk ka rregulla e procedura strikte për përzgjedhjen e kandidatëve. Procesi i emërimit për shoqërinë civile zhvilluar në prill 2015 u mbështet nga PWYP dhe Sekretariati AlbEITI. PWYP zhvilloi një workshop tre-ditor më 19-21 prill 2015 për rreth 30 OSHC nga Tirana dhe rajonet ku zhvillohen aktivitete nxjerrëse (Bulqizë, Pogradec, Patos dhe Vlorë), të cilat përfshinin pjesëmarrës të shumëllojshëm nga organizata që përqendrohen tek rinia, media, qeverisja demokratike, mjedisi dhe sindikatat e naftës. Përpara workshop-it, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve zhvilloi outreach në Tiranë dhe rajone për të identifikuar aktorë përkatës të shoqërisë civile. Anëtarët në largim nga OSHC në MSG ranë dakord se dy përfaqësuesve që nuk kishin marrë pjesë në takimet e MSG gjatë dy viteve të mëparshme iu kërkohet që të lëshonin vendet e tyre. Anëtarët e workshop-it ranë dakord që tri anëtarët e e tjerë të OSHC në MSG të qëndronin në pozicionet e tyre për të ruajtur memorien institucionale dhe për të ndërtuar kapacitetet e anëtarëve të rinj. Pjesëmarrësit emëruan pesë kandidatë për dy vendet dhe zgjodhën Baki Bajraktarin nga Sindikata e Minatorëve e Minierës së Kromit Bulqizë dhe Madlina Puka nga një rrjet mjedisor që operon në Patos dhe Vlorë. Ndërkohë që Madlina Puka dhe Rexhep Resuli (nga sindikata e naftëtarëve) dolën barazim me vota në tri raundet e votimit, Resuli ia lëshoi vendin në MSG Pukës (Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve, 2015).

Përfaqësimi i Industrisë: Përfaqësimi i industrisë në MSG përfshin Adriatik Golemi nga Bankers Petroleum Ltd, Saimir Boka nga Albchrome, Perparim Alikaj nga FIAA (Kreu i Komitetit për Industrinë dhe Minierat), Dritan Dervishaj nga ANTEA Cement dhe Turker Sengonul nga Shell Upstream Albania. Nuk ka të dhëna për një proces emërimi për të përzgjedhur përfaqësimin e industrisë në MSG. Përpara nënshkrimit të një MoU në tetor 2016 midis AlbEITI dhe FIAA për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin e sektorit, nuk kishte kriterë për përzgjedhjen e anëtarëve të industrisë në MSG. Në maj 2011, qeveria u dërgoi një ftesë për të marrë pjesë në MSG katër kompanive më të mëdha nxjerrëse (Albpetrol Sha, Bankers Petroleum, Beralba Company dhe ACR Company).¹⁵ Letra po ashtu i ftonte këto kompani të kërkonin masa të tjera për të përfshirë numrin më të madh të mundshëm të pjesëmarrësve në takimet e MSG. Nuk ka të dhëna që të sqarojnë zhvillimin e përfaqësimit të industrisë prej emërimit të tyre fillestar deri në ditën e sotme. Ndërkohë që TeR të MSG konfirmojnë se grupi i industrisë është i lirë të përzgjedhë anëtarët e vet në MSG sipas kriterëve të veta, nuk ekzistojnë rregulla e procedura strikte për përzgjedhjen dhe zgjedhjen e kandidatëve (Alb-EITI, 2017). Megjithatë, ekzistojnë shqetësime se përfaqësimi i industrisë në MSG pasqyron vetëm kompani me investim të huaj në sektorët e minierave, naftës dhe gazit, pa përfaqësim të shumicës së kompanive minerare që janë në pronësi vendore apo ndonjë kompani hidroenergjitike (*shih Kërkesa 1.2*).

Përfaqësimi i qeverisë: Pesë përfaqësuesit e qeverisë në MSG janë Ilir Bejtja, Zëvendës Ministër i Energjisë dhe Industrisë, Dritan Spahiu nga MEI, Sajmir Laçeç nga MF, Elda Spasse nga MD, Borjana Shaka nga DPT, Nikoll Kaza nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe Azbi Arapi nga AKBN. Ndërkohë që numri i anëtarëve nga

¹⁵ Letër nga Neritan Alibali, Zëvendës Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, për kompanitë dhe shoqërinë civile për të marrë pjesë në MSG EITI, 26 prill 2011, http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/04/Zgjerimi_MSG_26-04-2011.pdf

qeveria në MSG u reduktua nga ai fillestar prej gjashtë në Dekretin 71/2011 (i cili përfshinte një përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë), nuk ka të dhëna për një dokument që e formalizon këtë ndryshim (Keshilli i Ministrave, 2011). TeR e reja të MSG dakordësuar në vitin 2017 (paragrafi VII/b) vetëm konfirmojnë që anëtarët qeveritarë në MSG emërohen nga krerët e institucioneve të tyre përfaqësuese brenda 15 ditësh nga kërkesa për përfaqësues të rinj paraqitur nga Sekretariati AlbEITI (Alb-EITI, 2017).

Termt e referencës: TeR të MSG AlbEITI janë të qarta dhe publike (Alb-EITI, 2017). Shënime nga takimi i SMG më 31 janar 2017 ofrojnë të dhëna se TeR u diskutuan gjerësisht, ku përfaqësuesit e shoqërisë civile shprehën shqetësim lidhur me dispozitat për vlerësimet vjetore të performancës për të gjithë anëtarët e MSG.¹⁶ TeR përfshijnë gjuhë specifike lidhur me përgjegjësinë e MSG për të shqyrtuar dhe përditësuar rregullisht planin e punës të AlbEITI work plan, emëruar AP, dakordësuar për fushën e zbatimit EITI dhe për të marrë pjesë në aktivitete outreach dhe shpërndarjeje. Nenet 4, 8 dhe 9 të TeR përshkruajnë mandatet, pushtetet dhe funksionet e MSG, përfshi përgjegjësi për të siguruar përkushtim politik të qëndrueshëm, mobilizim të burimeve të nevojshme, përcaktimin e drejtimit strategjik të zbatimit, vlerësimin dhe zhvendosjen e pengesave për zbatimin, përcaktimin e shtrirjes së zbatimit EITI dhe të siguruarit se EITI është i integruar në proceset reformuese kombëtare. TeR po ashtu konfirmojnë përgjegjësitë e MSG për të dakordësuar një plan pune me kosto të plotë, prodhimin e Raporteve EITI, rakordimin e pagesave vjetore, TeR për AP, mbikqyrjen e sekretariatit, si dhe për outreach dhe shpërndarje, edhe pse nuk përfshijnë dispozita specifike që MSG të miratojë emërimin e AP. Në praktikë, është Sekretariati i AlbEITI që punëson Administratorin e Pavarur dhe MSG e përkrah atë.

Gjatë zhvillimit të konsultimeve të Sekretariatit Ndërkombëtar, u bë e qartë që versioni i Raportit EITI 2015 në faqen e internetit AlbEITI (në qershor 2017) ishte i ndryshëm nga ai i miratuar nga MSG në shkurt 2017 dhe i ndryshëm nga versioni i i botuar në faqen e internetit të AlbEITI në fillim të Validimit të Shqipërisë më 1 prill 2017. Versioni i qershorit i raportit kishte dallime në mospërputhje dhe MSG nuk kishte dijeni për këtë. Personeli i Sekretariatit AlbEITI dhe AP shpjeguan se ndryshimet ishin për shkak të mbërritjes vonë të formave të raportimit nga disa kompani, të cilat kishin ndryshuar rezultatet e rakordimit dhe se AP e kishte ndryshuar Raportin EITI 2015 ndërkohë që bëhej faqosja për botim, por nuk ia kishte theksuar ndryshimet Sekretariatit AlbEITI.

Përfaqësimi: TeR të MSG paraqesin rolet, përgjegjësitë dhe të drejtat e MSG, përfshi nevojën që anëtarët e MSG të ndërmarrin outreach me sektorët e tyre më të gjerë (Neni 8.e). Neni 8.f po ashtu përfshin dispozita që anëtarët e MSG të komunikojnë dhe rrisin ndërgjegjësimin lidhur me EITI ndërkohë që Neni 8.g kërkon që MSG të mbikqyrë dhe vlerësojë zbatimin e planit të punës. Neni 9.1 përcakton se përfaqësuesit qeveritarë duhet të ofrojnë udhëheqje dhe mbështetje politike, të sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të enteve të qeverisjes kombëtare dhe vendore, të sigurojnë pjesëmarrjen plotë të kompanive nxjerrëse, të nxisin pjesëmarrjen e plotë të shoqërisë civile, të ofrojnë një bazë ligjore për zbatimin e EITI

¹⁶ <http://www.albeiti.org/year-2017/>

dhe të publikojnë të ardhurat qeveritare dhe të dhëna përkatëse në mënyrë të saktë dhe në kohë. Neni 9.2 përcakton se anëtarëve të industrisë në MSG iu kërkohet të ndihmojnë për të siguruar pjesëmarrjen e plotë të kompanive nxjerrëse, të bëjnë publike pagesat dhe të dhëna përkatëse dhe të komunikojnë lidhur me zhvillimet për EITI-n pranë aktorëve të industrisë. Neni 9.3 përcakton se përfaqësuesit e shoqërisë civile duhet të komunikojnë dhe konsultohen gjerësisht me një gamë të shumëllojshme aktorësh, të ndërtojnë kapacitete, të sigurojnë pjesëmarrjen e plotë të OSHC-ve përkatëse dhe të monitorojnë publikimet nga qeveria dhe kompanitë nxjerrëse (Alb-EITI, 2017). Megjithatë, nuk ka të dhëna dokumentare për përpjekjet e anëtarëve të MSG (nga asnjë prej tre grupeve të përfaqësuara) për të ndërmarrë outreach me grupet e tyre më të gjera apo për të përfutur në praktikë opinionin e tyre.

Qeverisja e brendshme dhe procedurat: Neni 13 i TeR të MSG shprehet se MSG duhet të takohet një herë në tremujor dhe më shpesh nëse ka nevojë (Alb-EITI, 2017). Në praktikë, MSG duket se është takuar gjashtë herë në vitin 2014, tetë herë në vitin 2015, katër herë në vitin 2016 dhe një herë në tremujorin e parë të vitit 2017, edhe pse takimet nuk janë zhvilluar në mënyrë konsekuente çdo tremujor.¹⁷ Axhendat dhe dokumentacioni përkatës duhet qarkulluar mes anëtarëve të MSG një javë përpara takimit. TeR të MSG nuk përcaktojnë shprehimisht që ndonjë anëtar i MSG të mund të paraqesë një çështje për diskutim nga MSG, edhe pse Neni 14 vëren se ankesat e cilitdo anëtari të MSG duhen trajtuar haptas gjatë takimeve të MSG (Alb-EITI, 2017).

Vendim-marrja: TeR përcaktojnë rregullat për vendim-marrjen e MSG, çka kërkohet të jetë me konsensus ose, në rast se nuk arrihet konsensusi, me votën e shumicës së thjeshtë. Neni 13 i TeR të MSG siguron që vendimet të merren me email ose mbi bazën e mungesës së kundërshtimeve në rastet kur vendime të tilla nuk shihen se kërkojnë një takim formal të MSG, me kusht që dokumentet përkatëse për diskutim të jenë qarkulluar mes anëtarëve të MSG përpara vendimit me anë të një qarkoreje (Alb-EITI, 2017). Nuk ka të dhëna që ndonjë vendim i MSG të jetë marrë ndonjëherë me vote gjatë periudhës 2013-2017, edhe pse ka të dhëna që shumë vendime kyçe të MSG të jenë marrë me anë të qarkores me email.

Mbajtja e regjistrave: Neni 15 i TeR të MSG i vesh Sekretariatit të MSG përgjegjësinë për të përgatitur dhe qarkulluar shënimet e takimit dhe përcakton një afat një-javor për komente për shënimet, të cilat miratohen kur nuk ka kundërshtime. Po ashtu kërkon që sekretariati të raportojë statusin e zbatimit të vendimeve të kaluara të MSG në takimet pasuese të MSG. MSG ka mbajtur shënime të të gjitha takimeve deri më sot, të cilat janë në dispozicion së bashku me peës takime të grupit teknik të punës në faqen e internetit të Alb-EITI.¹⁸ Vendimet kyçe të MSG janë të renditura në faqen e internetit të AlbEITI, të cilat duhen theksuar si praktikë e mirë për sa i përket vënies në pah të vendimeve të MSG.

Kapaciteti i MSG: Neni 6 i TeR paraqet parimet e përgjithshme të angazhimit midis qeverisë, industrisë dhe shoqërisë civile në MSG. Kjo përfshin fushat e konsultimit, ndërtimit të kapaciteteve dhe fuqizimit si

¹⁷ Për një listë të plotë të shënimeve të takimeve për periudhën 2014-2017, shihni: <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/>

¹⁸ Faqja e internetit e Alb-EITI, <http://www.albeiti.org>

mjete për të rritur njohuritë për praktikën më të mira globale dhe stimuluar ndarjen e dijeve nëpërmjet dialogut të vazhduar (Alb-EITI, 2017). Shënime të takimeve të MSG dokumentojnë se të tri grupet e përfaqësuara kanë qenë të angazhuara në diskutime teknike lidhur me formularët e raportimit si dhe kanë marrë pjesë në workshop-e për ndërtim kapacitetesh në vend dhe jashtë. Ka të dhëna për kufizime financimi për OSHC-të, ndonëse këto duket se janë si rezultat i përpjekjeve të paefektshme për ngritje fondesh se sa për shkak të ndonjë kufizimi statutor apo praktik për ngritje fondesh nga OSHC-të (*shih Kërkesa 1.3*).

Dietat: MSG nuk ndjek një praktikë dietash për anëtarët e MSG që të marrin pjesë në aktivitete të lidhura me EITI-n, përfshi takime të MSG. Neni nuk ka ndonjë politikë për alokim “dieta rentash dhe dieta” për aktivitete të lidhura me EITI-n dhe se përkushtimi i anëtarëve të MSG është mbi baza vetëm vullnetare (Alb-EITI, 2017).

Pjesëmarrja: Neni 11.4 i TeR të MSG kërkon një vlerësim vjetor performance në fillim të çdo viti për të gjithë anëtarët e MSG nga Kreu i MSG, me mbështetje teknike nga Sekretariati i Alb-EITI, duke trajtuar çështje të tilla si pjesëmarrja në takime, shënime për takimet, prezantime, platforma dhe materiale të tjera për të matur “kontributin real të çdo anëtarit të MSG.” Këto vlerësime kërkohet të përqendrohen në cilësinë e pjesëmarrjes së matur nëpërmjet zbatimit të planit vjetor të punës, me 30% kushtuar pjesëmarrjes në takime të MSG dhe aktivitete të tjera, 30% kushtuar nivelit të angazhimit në proceset konsultuese dhe në hartimin e dokumenteve kyçe të EITI-t dhe 40% kushtuar përkushtimit të anëtarit/-es ndaj aktiviteteve të komunikimit dhe përhapjes së informacionit të lidhur me EITI-n. TeR kërkojnë zëvendësimin e anëtarëve të MSG që arrijnë një vlerësim më pak se 60%, nëpërmjet procesesh të hartuara nga grupet që përfaqësojnë (Alb-EITI, 2017). Ka të dhëna nga shënime për takimet e MSG, përfshi më 31 janar 2017, lidhur me kundërshtime të forta nga shoqëria civile për këtë dispozitë të TeR.¹⁹ Në praktikë, pjesëmarrja në takime të MSG duket se ka qenë konsekuente për të tria grupet e përfaqësuara, ndonëse niveli i pjesëmarrjes ka variuar tek anëtarët e ndryshëm të çdo grupi që përfaqësojnë.

Sekretariati Kombëtar: Sekretariati kombëtar – AlbEITI – strehohet nga MEI dhe përbëhet nga nëntë anëtarë personeli. MEI punëson personelin e sekretariatit dhe financon pagat, prokurimet administrative, transportin, hapësirën e zyrës dhe të tjera mjedise. Kreu i sekretariatit është Dorina Cinari. Aktivitetet e planit të punës mbulohen nga financimi i Bankës Botërore. Sekretariati është enti i prokurimit për financimin dhe është përgjegjës për të vlerësuar aplikimet për tendera të lidhur me EITI-n. Ka të dhëna nga shënime për takimet e MSG për kritika ndaj kësaj strukture prokurimi, duke pasur parasysh shqetësimet për mungesën e rolit të MSG në përzgjedhjen e AP për Raportet EITI.

Neni 10 i TeR të MSG shprehet se Sekretariati i Alb-EITI është përfaqësues i shtetit, ndërsa Neni 11 vëren se sekretariati është përgjegjës për të ndjekur pjesëmarrjen në takime dhe përgatitur shënime për

¹⁹ <http://www.albeiti.org/year-2017/>

takimet, prezantime, platforma apo materiale të ndryshme të kërkuara për të vlerësuar kontributin e secilit anëtar të MSG për zbatimin e EITI-t (Alb-EITI, 2017).

Pikëpamjet e aktorëve

Përbërja e MSG: Një përfaqësues qeveritar mendonte se përbërja e MSG ishte e përshtatshme për mbikqyrjen efektive të zbatimit të EITI dhe se në MSG përfaqësoheshin institucionet dhe organizatat e duhura.

Për sa i përket përfaqësimit të shoqërisë civile në MSG, një numër përfaqësuesish të kompanive shprehën shqetësim se shumëllojshmëria e OSHC-ve në Shqipëri nuk pasqyrohej si e sa duhet në MSG dhe se opinionet e komuniteteve vendore nuk përfaqësoheshin në MSG, pavarësisht rëndësisë së tyre. Pavarësisht konsultimeve të gjera me OSHC-të si në ashtu edhe jashtë MSG, Sekretariatit Ndërkombëtar nuk iu dhanë prova dokumentare të ndonjë kontakti të rregullt midis anëtarëve të OSHC në MSG dhe OJQ-ve të tjera që nuk përfaqësoheshin drejtpërdrejt në MSG.

Për sa i përket përfaqësimit të industrisë, personeli i sekretariatit konfirmoi se nuk kishte pasur ndonjëherë ndonjë ndryshim në kompanitë që përfaqësoheshin në MSG, ndonëse disa kompani si Bankers Petroleum i kishin zëvendësuar përfaqësuesit e tyre me zyrtarë marrëdhëniesh publike në praktikë për shkak të kufizimeve në kohë të menaxherëve të nivelit të mesëm. Personeli po ashtu theksoi se Shell Albania ishte future në MSG në shkurt 2017, pas një takimi dypalësh midis një përfaqësuesi të Shell Albania dhe Sekretariatit Alb-EITI. Një numër përfaqësuesish të industrisë si në ashtu edhe jashtë MSG mendonin se përfaqësimi i tyre në MSG duhet të kishte qenë më i efektshëm. Personeli i Sekretariatit vërejti MoU i tetorit 2016 midis AlbEITI dhe FIAA e kishte bërë më të lehtë bashkëpunimin me sektorin e industrisë meqenëse institucionalizonte mekanizmat bashkërenduese të atij sektori.

Për sa i përket përfaqësimit të qeverisë, personeli i sekretariatit shpjegoi se përfaqësuesit qeveritarë ishin emëruar mbi bazën e posteve të tyre dhe për pasojë prireshin të ndërroheshin shpesh, me përfaqësues të MF, DPT dhe Doganave të ndërruar disa herë dhe me përfaqësuesin e MD të ndërruar shpesh. Personeli i sekretariatit po ashtu theksoi se shihej sikur ishte detyra e Sekretariatit Alb-EITI për të ndjekur ndryshimet në funksionet qeveritare me qëllim që të ndiqte pastaj entet qeveritare kur përfaqësuesi i tyre largohej nga funksionet me qëllim që të sigurohej një anëtar i ri për MSG.

Termet e referencës: Personeli i Sekretariatit vërejti se procedurat për emërimin e anëtarëve të MSG nuk ishin specifikuar kur MSG ishte themeluar fillimisht në vitin 2011, edhe pse TeR të reja të MSG në 2017 specifikonin procedurat për zgjedhjen dhe vlerësimin e anëtarëve të MSG me qëllim që procesi EITI të qeverisej më mirë. Personeli konfirmoi se MSG kishte diskutuar për projekt-TeR gjerësisht dhe kishte miratuar draftin përfundimtar me anë të një qarkoreje ku miratimi nënkuptohej nga munesa e kundërshtimeve, pas përfshirjes së komenteve fillestare të antëtarëve të MSG. Një numër anëtarësh nga OSHC në MSG vërejtën se MSG kishte zhvilluar diskutime të gjera mbi projekt-TeR, të cilat kishin zgjatuar 4-5 orë, dhe se shumica e shqetësimeve të OSHC kishin qenë trajtuar përveç vlerësimeve vjetore për performancën. Një anëtar nga industria në MSG mendonte se TeR të MSG përmbushnin kërkesat e EITI dhe ofronin një hapësirë të sigurt për diskutime lidhur me zbatimin e EITI-t.

Për sa i përket vlerësimeve vjetore të performancës, Kreu i MSG vërejti shqetësimet e tij lidhur me këtë përgjegjësi për të vlerësuar performancën e anëtarëve dhe mendonte se do kishte preferuar t'ia linte vlerësimet e performancës secilit nga tri grupet e aktorëve të përfaqësuar. Megjithatë, ai vërejti se procedurat e vlerësimit ishin paraqitur për shkak se anëtarët e MSG nuk shiheshin si mjaftueshëm aktivë dhe dukeshin të shpërqendruar gjatë takimeve të MSG. ai theksoi se anëtarët e MSG nuk ishin vlerësuar ende, duke theksuar se mungesa e përsëritur të anëtarit OSHC në MSG nga Bulqiza do kishte kërkuar zëvendësimin e tij por se Kreu i MSG kishte dëshiruar që grupi që përfaqësonte ta kishte zgjidhur këtë sfidë përpara se të vazhdonte me vlerësimet. Kreu i MSG bëri thirrje që anëtarët nga OSHC në MSG ta zgjidhnin këtë çështje brenda grupit që përfaqësojnë, për shembull duke zëvendësuar anëtarin me një OJQ nga Tirana për të lehtësuar pjesëmarrjen.

Përfaqësimi: Anëtarët e MSG pranonin gjerësisht se struktura e MSG nuk ishte më pasqyruese e shtrirjes së Standartit EITI dhe anëtarët e MSG pranonin nevojën për ta ristrukturuar MSG për të siguruar përfaqësimin e të gjithë aktorëve të duhur. Personeli i sekretariatit shpjegoi se Albpetrol nuk përfaqësohej në MSG sepse kërkesat për raportim sipas EITI lidhur me NPSH nuk ekzistonin sipas Rregullave EITI kur MSG kishte qenë themeluar në vitin 2011 dhe se qeveria planifikonte ta privatizonte Albpetrolin, siç në fakt ka ende në plan. Personeli i sekretariatit pohoi se po shqyrtonin mundësinë për ta zgjeruar SMG në shtatë përfaqësues për secilin nga aktorët.

Anëtarët e industrisë në MSG vërejtën se ata përfaqësonin tetë kompanitë nxjerrëse më të mëdha me investim të huaj në Shqipëri, por se nuk ishin në kontakt me qindar kompanitë vendase që operonin në sektorin e minierave apo me ndonjë kompani hidroenergjitike. Një numër përfaqësuesish të FIAA vërejtën se kishin në plan të ndërmerrnin aktivitete informuese pranë kompanive në pronësi vendore me qëllim që të merrnin pjesë si në FIAA, ashtu edhe në EITI dhe potencialisht në MSG.

Anëtarët e shoqërisë civile në MSG pranuan se përfaqësonin rreth shtatë OJQ nga Tirana dhe nuk ishin në kontakt me të tjera OSHC në Shqipëri. Në fakt, themeluesit e OJQ-së AlbNet-EITI vërejtën se ende nuk kishin njoftuar rreth njëqind OSHC-të që ata i konsideronin anëtarë potencialë të koalicionit të ri se OJQ-ja ishte themeluar në janar 2016 (*shih Kërkesa 1.3*). Anëtarë të ndryshëm të OSHC në MSG fajësuan njëri-tjetrën për mungesën e ndjekjes së çështjes me aktorët e tjerë të shoqërisë civile dhe dukej se nuk kishte koordinim midis aktiviteteve informuese të katër anëtarëve të OSHC në MSG.

Një numër anëtarësh të OSHC në MSG mendonin se përfaqësimi qeveritar ishte jokonseguent në MSG dhe se anëtarët që ishin aty prej kohësh nuk luanin role aktive në EITI. Anëtarët e MSG dhe personeli i sekretariatit vërejtën mungesën e pranisë së përfaqësuesve të MD për shembull, the bënë thirrje për përfshirjen e enteve me rëndësi, si për shembull Drejtoria e Doganave. Një numër agjencish kyçe si Këshilli i Lartë i Shtetit nuk ishin kontaktuar ndonjëherë më parë nga Alb-EITI, edhe pse aktorët nga të gjitha grupet e përfaqësuar shprehën pikëpamje të përziera lidhur me pavarësinë politike të kontrollorit (*shih Kërkesa 4.9*).

Qeverisja dhe procedurat e brendshme: Të gjithë anëtarët e MSG që u konsultuan – të mëparshëm dhe të tanishëm – konfirmuan se të gjitha vendimet e MSG ishin marrë me konsensus, pa asnjë rast votimi. Një numër anëtarësh qeveritarë në MSG dhe personel i sekretariatit mendonin se rolet dhe përgjegjësit e

MSG ishin të përshkruara mirë në TeR, por nuk ndiqeshin në praktikë, ku shumica e anëtarëve të MSG shiheshin si joaktivë.

Mbajtja e regjistrave: Shumica e aktorëve të konsultuar, përfshi ata jashtë MSG, lavdëruan punën e Sekretariatit Alb-EITI për dokumentimin e takimeve të MSG, duke i qarkulluar ato për miratim përpara publikimit online. Aktorët po ashtu përgëzuan profesionalizmin e sekretariatit në hartimin e dokumenteve kryesore, të tilla si plane pune, raporte vjetore progresi dhe TeR. Megjithatë, reagimet nga anëtarët e OSHC në MSG lidhur me mbajtjen e regjistrave nga sekretariati dhe logjistikën e takimeve ishin të përziera. Një anëtar përgëzoi sekretariatit për regjistrimin e shënimeve të takimeve, duke qarkulluar projekt-shënime pas një jave për miratim nga MSG, si dhe qarkullimin e dokumenteve të duhura përpara takimeve të MSG. Nga ana tjetër, dy anëtarë të tjerë kritikuan sekretariatit për mosqarkullimin e dokumenteve apo shënimeve të takimeve të MSG, si dhe ngritën dyshime për saktësinë e shënimeve nga takimet pavarësisht natyrës së tyre të detajuar.

Dietat: Të gjithë aktorët e konsultuar konfirmuan se MSG nuk praktikonte dieta. Të gjithë OSHC në MSG kritikuan mungesën e rimbursimit të kostove të udhëtimit për pjesëmarrjen në takimet e MSG, të cilat ishin çështje veçanërisht për përfaqësuesin e OSHC nga rajoni minerar i Bulqizës. Anëtarët e OSHC nga grupe të tjera të përfaqësuar menduan se duhet të ishte përgjegjësi e OSHC-ve për të ngritur fonde për pjesëmarrjen e tyre domethënëse në EITI, përfshi për pjesëmarrjen në takimet e MSG. Personeli i Sekretariatit dhe zyrtarët qeveritarë konfirmuan se kushtet e financimit me grant nga Banka Botërore për Alb-EITI, i cili mbulonte dy të tretat e kostove të zbatimit, nuk lejonin pagesën e dietave. Kreu i MSG shpjegoi se nuk kishte linjë buxheti që të mbulonte shpenzimet e përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Pjesëmarrja: Personeli i sekretariatit theksoi se ndërsa përfaqësuesit e MF dhe MD në MSG ishin ndryshuar shpesh, asnjë prej tyre nuk prirej të merrte pjesë në takimet e MSG. AP vërejti se vetëm rreth gjysma e anëtarëve të MSG ishin të pranishëm kur AP paraqiti projekt-Raportin EITI 2015. Një numër OSHC-sh vërejtën se ndërkohë që qeveria dhe kompanitë kryesisht merrnin pjesë në takime, ata zakonisht nuk ishin aktivë.

Sekretariati kombëtar: Një përfaqësues i industrisë vërejti se ekzistonin tensione të pazgjidhura midis shoqërisë civile dhe Sekretariatit AlbEITI, por mendonin se grupi i industrisë kishte marrëdhënie të mira me Sekretariatit AlbEITI, siç evidentohet nga MoU i 2016 me FIAA, i cili shihej si i realizuar me AbIEITI si një institucion shtetëror. Një zyrtar qeveritar dhe një partner zhvillimi përgëzuan sekretariatit për performancën e tij dhe aftësitë në menaxhimin e fondeve të veta. Një partner zhvillimi theksoi shqyrtimin paraprak të prokurimit nga Banka Botërore të të gjitha rekrutimeve dhe prokurimeve me kërkesën e Sekretariatit AlbEITI. Personeli i sekretariatit konfirmoi se buxheti i AlbEITI i nënshtrohej katër lloj kontrolleve, përfshi kontrollin para dhe pas-hoc nga Banka Botërore, kontrolli nga MEI dhe njësia anti-korrupsion e Kryeministrit. Sekretariati publikon të gjithë informacionin financiar në faqen e internetit të

Programit të Transparencës për AlbEITI.²⁰ Megjithatë, disa OSHC bënë thirrje që sekretariati kombëtar të ishte më transparent lidhur me alokimin dhe financimin e projekteve dhe mendonin se duhet të kishte mbikqyrje më të fortë nga anëtarët e MSG për të gjitha projektet AlbEITI.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. MSG është formuar dhe përfshin përfaqësues të vetëmëruar nga secili grup aktorësh pa sugjerime ndërhyrjeje apo shtrëngimi, edhe pse mungesa e përfaqësimit sa i përket shumëllojshmërisë së industrisë nxjerrëse në Shqipëri dhe shoqërisë civile në MSG është shqetësim. MSG ka miratuar TeR të qarta që trajtojnë pjesën më të madhe të Kërkesës 1.4 të Standartit EITI. Ndërkohë që TeR nuk kanë dispozita të tilla si emërimi i AP, angazhimi në Validim dhe ushtrimi i së drejtës për të paraqitur një çështje për diskutim, duket se këto dispozita kryesisht ndiqen në praktikë. Ndërkohë që TeR të MSG sugjerojnë se shoqëria civile dhe kompanitë janë të lira të zgjedhin anëtarët e tyre në mënyrë të pavarur sipas kritereve të tyre, nuk ka procedura të përcaktuara qartë për zgjedhjen e anëtarëve të MSG përveç Kodit të Sjelljes së shoqërisë civile, i cili nuk duket i zbatuar, dhe MoU midis Alb-EITI dhe FIAA, i cili nuk sqaron procedurat e përzgjedhjes. Ndërkohë që anëtarët e MSG duket se marrin pjesë rregullisht në takime të MSG dhe mbajnë regjistra të mjaftueshme, ka pak të dhëna për pjesëmarrje të MSG në aktivitete informimi dhe përhapjeje, të cilat kryesohen nga sekretariati. Ndërkohë që kapaciteti duket i fortë tek qeveria dhe industria, ka prova të kufizuara se anëtarët e shoqërisë civile në MSG kanë kapacitete të mjaftueshme, sidomos financiare, për të kryer detyrat e tyre. Në tërësi, duket se Sekretariati Alb-EITI udhëheq zbatimin EITI, me mbikqyrje të kufizuar nga MSG.

Në përputhje me kërkesën 1.4.a.ii, MSG duhet të sigurojë që procedurat e tij për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve në grupin shumë-aktorësh të jenë publike dhe të konfirmojnë të drejtën e çdo anëtari të aktorëve për emëruar përfaqësuesit e vet. Për të forcuar zbatimin, qeveria nxitet që të sigurohe se entet përkatëse shtetërore, të tilla si kompania kombëtare e naftës Albpetrol, duke pasur parasysh mungesat në raportim lidhur me pjesëmarrjen shtetërore (*shih Kërkesa 2.6*), të përfaqësohen në MSG dhe se niveli i këtij përfaqësimi të jetë në përputhje me nevojën e MSG për të marrë vendime të informuara dhe të ndjekë kryerjen e veprimeve të dakordësuara. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.ii dhe 1.4.b.iii, MSG duhet të ndërmarrë aktivitete të efektshme informimi me grupe të shoqërisë civile dhe kompani, përfshi nëpërmjet komunikimeve të tilla si media, faqja e internetit dhe letrat, duke informuar aktoriët për përkushtimin e qeverisë për të zbatuar EITI-n, dhe për rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile. Anëtarët e MSG duhet të shërbejnë si ndërlidhës me grupet e aktorëve që përfaqësojnë. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.vi, MSG duhet të sigurojë një proces gjithëpërfshirës vendim-marrjeje gjatë gjithë zbatimit, sidomos në lidhje me industrinë dhe shoqërinë civile. Grupet e aktorëve nga qeveria dhe kompanitë nxiten që të sigurojnë që pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre në takimet e MSG të jetë konsekuente dhe e një niveli mjaftueshëm të lartë për të lejuar MSG që të marrë vendime dhe të ndjekë kryerjen e tyre. Qeveria mund të marrë në konsideratë ftuarjen e Albpetrolit në MSG. Rekomandohet

²⁰ <http://www.albeiti.org/transparency-program/>

gjithashtu që MSG të rishikojë procedurat e vlerësimit për anëtarët e vet, të cilat të gjitha grupet e aktorëve do të binin dakord t'i ndiqnin..

Plani i punës (#1.5)

Dokumentimi i përparimit

Plan pune i aksesueshëm publikisht: MSG ka rënë dakord për një plan pune për zbatimin e EITI gjatë periudhës 2016-2019, publikuar në faqen e internetit të Alb-EITI.²¹ Ndërkohë që plani i punës u miratua me qarkore më 17 shkurt 2016,²² MSG dhe sekretariati vazhduan ndryshimet në planin e punës, duke mbajtur shënime aktivitetet e kryera. Për qëllimet e këtij vlerësimi, Sekretariati Ndërkombëtar ka marrë në shqyrtim versionin e planit të punës 2016-2019 në dispozicion në faqen e internetit të AlbEITI më 1 prill 2017.

Objektivat e zbatimit: Plani i punës radhit katër prioritetet e mëposhtme kombëtare të lidhura me qeverisjen e burimeve natyrore dhe ofron një shpjegim të hollësishëm (përmbledhur më poshtë) të mënyrës se si do të zbatohen objektivat në lidhje me procesin EITI:

1. Qeverisja e burimeve natyrore

Procesi duhet të përputhet me Standardin EITI duke prodhuar raporte EITI të cilësisë së lartë dhe në kohë. MSG duhet të përdorë raportimin EITI për të trajtuar mangësi ligjore dhe fiskale, për të kontribuar në zhvillimin e strategjive kombëtare dhe çuar në reforma sektoriale. Raportet EITI duhet të përqendrohen në nivelin nënkombëtar dhe çështje mjedisore, si dhe të prezantojnë sektorin hidroenergjitik, i cili është me rëndësi strategjike për qeverinë.

2. Të dhëna të hapura (Open data)

Raportimi EITI duhet të përputhet me politikën e qeverisë mbi të dhënat e hapura që mundëson akses në kohë, format të lexueshëm nga pajisjet dhe mundësinë për ripërdorim. Raportimi duhet të jetë eficient për nga kostot dhe të sigurojë publikime të automatizuara rutinë nëpërmjet sistemeve qeveritare.

3. Mbështetja për shoqërinë civile

Qeveria duhet të ruajë një mjedis nxitës për shoqërinë civile, i cili të stimulojë angazhim eficient, aktiv, të qëndrueshëm dhe të pavarur me procesin shqiptar për EITI.

²¹ www.albeiti.org

²² <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2016/>

4. Lufta kundër korrupsionit

Ky objektivi përfshin tre fusha: (1) reformimi i kuadrit ligjor kombëtar për menaxhim më të mirë të burimeve natyrore duke prezantuar amendamente ligjore dhe rregullatore ndaj kuadrit ekzistues që qeveris industrinë nxjerrëse; (2) ndërtimi i një baze ligjore dhe kapaciteteve të aktorëve për të mundësuar publikime të pronarëve realë; (3) rritjen e angazhimit të aktorëve dhe gjenerimin e debatit publik mbi qeverisjen e burimeve natyrore nëpërmjet përpjekjeve të shënjestruara të komunikimit.

Aktivitetet të matshme dhe me afate: Plani i punës përfshin aktivitete të matshme dhe me afate për të arritur objektivat e dakordësuara. Planet për aktivitetet janë të qarta dhe nënkuptojnë afate specifike (mbi bazë mujore).

Aktivitetet që synojnë të trajtojnë kufizime në kapacitete: Aktiviteti 11 përqendrohet tek ndërtimi i kapaciteteve, përfshi workshop-e për anëtarët e MSG lidhur me forcimin e rolit të tyre në industrinë nxjerrëse, Standardin EITI dhe publikimet e pronarëve realë. Planifikon edhe workshop-e të shënjestruara për aktorë të ndryshëm (anëtarë të MSG, sekretariatit kombëtar dhe veçmas për përfaqësuesit e qeverisë dhe kompanive) mbi tema që variojnë nga kushtet fiskale tek kuadri ligjor, përmbajtja vendore, mjedisi, taktimet, hartëzimi GIS dhe sistemet kadastrale, arbitrazhi dhe kontratat ndërkombëtare. Plani i punës po ashtu përfshin aktivitete për identifikimin dhe ndërtim konsensusi për shoqërinë civile të angazhuar në EITI (#3) si dhe për ndërtim kapacitetesh për anëtarët e MSG për të mbështetur zbatimin e planit për pronësinë reale në vitet 2017-2018 (#13).

Shtirja e raportimit EITI: Aktiviteti 4 përfshin aktivitete që synojnë të identifikojnë pengesat për sistemet e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave EITI. Po ashtu trajton edhe të dhënat e hapura dhe përfshin plane për të eksploruar mundësi për mundësitë për standartizim oportunitet. Aktiviteti 7 i referohet publikimit të Raporteve EITI që mbulojnë vitet 2015-2018 dhe përfshijnë miratimin nga MSG të TeR për AP, dakordësimin për shtrirjen e raportimit, prokurimin e AP dhe shpërndarjen e Raportit EITI tek publiku i gjerë. Megjithatë, plani i punës nuk shtjellon më tej lidhur me ndonjë përpjekje të MSG për të zgjeruar shtrirjen e raportimit EITI dhe është e paqartë nëse MSG ka përgjegjësi për të miratuar përzgjedhjen e AP apo për të komentuar për projekt-dokumente kyçe të tilla si raportimi fillestar apo Raporti EITI.

Pengesa ligjore apo rregullatore: Aktiviteti 4 mbulon planet e MSG për të ndërmarrë shqyrtime ligjore dhe rregullatore dhe hartimin e amendamenteve ligjore për miratim në vitin 2018. Aktiviteti 13 mbi planet e raportimit për pronësinë reale për shqyrtim ligjor dhe hartimin e amendamenteve për ligjet dhe rregulloret ekzistuese.

Ndjekja e rekomandimeve EITI: Ndërkohë që Aktiviteti 7 planifikon prokurimin e shërbimeve të konsulencës për të ndihmuar agjencitë qeveritare për zbatimin e rekomandimeve nga raportet EITI, plani i punës nuk përvijon plane që MSG të diskutojë rekomandimet nga Raportet EITI të mëparshme apo Validimi.

Kostot dhe financimi: Plani i punës identifikon burime financimi dhe nevoja specifike për asistencë teknike lidhur me aktivitete të caktuara. Ndërkohë që qeveria ka ofruar fonde të kufizuara për zbatimin e EITI, Banka Botërore ka ofruar rreth 80% të financimit, fillimisht nëpërmjet Fondit të Trustit Shumë-

Donatorësh EITI (MDTF) dhe nëpërmjet Mbështetjes Programatike Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS) MDTF prej vitit 2016, sipas planesh pune të ndryshme të Alb-EITI dhe informacionit nga Sekretariati Alb-EITI. Disa aktivitete nuk kërkojnë financim ose burimet e financimit nuk janë identifikuar.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Të gjithë anëtarët e MSG konfirmuan se Sekretariati AlbEITI zakonisht hartonte një version të parë të planit të punës dhe e qarkullonte për komente, të cilat zakonisht trajtoheshin në versionet përfundimtare të planeve të punës. Kreu i MSG tha se objektivat e planit të punës përkufizoheshin mbi bazën e shtrirjes së punës të sugjeruar në marrëveshjen e financimit të Bankës Botërore, duke theksuar se objektivat e qeverisë ishin sektorët e hidroenergjitikës, naftës dhe gazit, përkrah prioriteteve që përfshijnë bujqësinë, menaxhimin e ujrave dhe mjedisin.

Një përfaqësues i industrisë në MSG vërejti se FIAA gjithmonë i diskutonte planin e punës dhe çështje të tjera të lidhura me EITI-n mes vetes, jashtë takimeve të MSG, ndonëse komentet e tyre në MSG nuk merreshin gjithmonë parasysh apo përfshiheshin në planin e punës. Megjithatë, shumica e anëtarëve të MSG të konsultuar konfirmuar se e kishin miratuar si duhet planin e punës.

Megjithatë, anëtarët e shoqërisë civile shprehën pikëpamje të përziera lidhur me planin e punës. Disa anëtarë të OSHC në MSG sipas raportimeve kishin ofruar komente për planin e punës, ndërkohë që një tjetër tha se nuk kishte parë kurrë më parë një plan pune EITI. Një anëtar i OSHC në MSG tha se Sekretariati AlbEITI e kishte rishikuar planin e punës në mënyrë të njëanshme në fillim të 2017-ës pa u konsultuar me MSG, duke shtuar disa aktivitete që nuk përfshinin anëtarët e MSG.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Shqipëria ka një plan pune EITI të përditësuar për 2016-2019, i cili gjendet publikisht. Plani i punës përfshin objektiva të lidhura me prioritetet kombëtare, si dhe aktivitete dhe veprime që synojnë të sigurojnë përmbushjen e objektivave. Plani i punës përfshin një kalendar të gjerë për arritjen e objektivave, si dhe kostot e burimeve propozuara të financimit. Ndërkohë që Shqipëria ka shkuar përtej kërkesës minimale duke pasur parasysh përfshirjen e hidroenergjisë në fushën e zbatimit EITI, grupet e gjera të interesit nuk morën pjesë aktive në zhvillimin e planit të punës dhe as nuk morën pjesë në mbikqyrjen e zbatimit të aktiviteteve. Në praktikë, plani i punës është i menaxhuar dhe ndjekur mirë nga sekretariati kombëtar, edhe pse me pjesëmarrje të kufizuar nga anëtarët e MSG.

MSG nxitet që të dakordësojë një plan pune që lidhet me prioritetet kombëtare dhe që është produkt i konsultimeve të gjera me grupet e interesit. Lidhje më të qarta me diskutimet dhe prioritetet kombëtare do të nxisnin pjesëmarrje më aktive nga të gjitha grupet e interesit dhe do të ndihmonin për të mobilizuar burime shtesë. MSG duhet të trajtojë qëndrueshmërinë financiare të zbatimit EITI në pikëpamje afatmesme.

Tabela 1 – Tabelë përmbledhëse e vlerësimit fillestar: Mbikqyrja e MSG

Dispozitat EITI	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	Vlerësimi fillestar nga Sekretariati Ndërkombëtar i përparimit me dispozitat EITI (duhet plotësuar për dispozitat 'e kërkuara')
Mbikqyrja nga qeveria e procesit EITI (#1.1)	Qeveria është e përkushtuar ndaj EITI-t. Një individ i lartë është emëruar drejtues për zbatimin e EITI dhe zyrtarë qeveritarë të rëndësishëm përfaqësohen në MSG.	Përparim i kënaqshëm
Angazhimi i kompanive (#1.2)	Kompanitë e naftës, gazit dhe minierave janë të angazhuara aktivisht dhe efektivisht në procesin EITI, edhe si ofrues informacioni edhe në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI. Kompanitë hidroenergjitike marrin pjesë vullnetarisht.	Përparim i kënaqshëm
Angazhimi i shoqërisë civile (#1.3)	Ekziston mjedis nxitës për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në Shqipëri. Shoqëria civile është e përfshirë në zbatim. Megjithatë, kufizimet në kapacitete ndikojnë aftësinë e tyre për të qenë të angazhuar plotësisht dhe efektivisht në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit EITI.	Përparim domethënës

Qeverisja dhe funksionimi i MSG (#1.4)	MSG është formuar dh epërfshin përfaqësues të vetëmëruar nga çdo grup interesit, pa sugjerime ndërhyrjeje apo shtrëngimi. MSG takohet shpesh dhe pjesëmarrja dhe mbajtja e regjistrave duket e kënaqshme. Ndërkohë që kapacitetet janë të forta mes qeverisë dhe kompanive, ka të dhëna të kufizuara se anëtarët e shoqërisë civile në MSG kanë kapacitet të mjaftueshëm për të kryer detyrat e tyre..	Përparim domethënës
Plani i punës (#1.5)	Plani i punës AlbEITI 2016 është në vijë me dispozitat e Kërkesës 1.5. ka objektiva të qarta të lidhura me prioritetet kombëtare për sektorin nxjerrës, si dhe veprime e afate të hollësishme. Ekzekutimi i planit të punës të tanishëm duket në vijë.	Përparim i kënaqshëm

Rekomandimet e Sekretariatit:

1. MSG duhet të sigurojë pjesëmarrje më konseguente të përfaqësuesve të qeverisë në aktivitete shpërndarje informacioni.
2. Për të forcuar zbatimin, grupi i interesit i industrisë nxitet të sigurohet se anëtarësia e tij në MSG të jetë përfaqësuese e strukturës së sektorëve minerarë, hidroenergjitikë, të naftës dhe gazit dhe se rregullsia dhe niveli i pjesëmarrjes së industrisë në takimet e MSG të jetë në përpjestim me nevojën e MSG për të marrë vendime të informuara dhe për të ndjekur kryerjen e veprimeve të dakordësuara. MSG duhet të sigurojë raportim tërësor nga të gjitha kompanitë materiale.
3. Në përputhje me kërkesën 1.3.a, grupi i interesit i shoqërisë civile duhet të demonstrojë se janë plotësisht, aktivisht dhe efektivisht të angazhuar në procesin EITI. Specifikisht, shoqëria civile duhet të sigurojë se janë në gjendje të kontribuojnë plotësisht dhe të ofrojnë input për procesin EITI dhe se kanë kapacitet të mjaftueshëm për të marrë pjesë në EITI. Në përputhje me kërkesën 8.3.c.i, grupi i interesit i shoqërisë civile duhet të zhvillojë dhe publikojë një plan veprimi për të trajtuar mangësitë në angazhimin e kompanive në vlerësimin fillestar dhe raportin e validuesit brenda tre muajsh nga vendimi i Bordit, dmth nga <Vendimi i Bordit + 3 muaj>. Grupi i interesit mund të dojë të ndërmarrë një shqyrtim të pavarur të angazhimit të shoqërisë civile në EITI në Shqipëri, duke zgjeruar angazhimin e OSHC me interesa potenciale në zbatimin e EITI-t. Ndërmarrja e një vlerësimi për nevojat në kapacitete dhe formulimi i veprimeve për të trajtuar kufizimet e shoqërisë civile në kapacitete janë kyçe, edhe për të zhblokuar financime nga partnerë zhvillimi dhe të tjera palë. Grupi i interesit i shoqërisë civile nxitet të zhvillojë dhe të bjerë dakord për udhëzime që efektivisht përcaktojnë procesin me anë të të cilit do të përzgjidhen dhe do t'u kërkohet llogari përfaqësuesve në MSG.
4. Në përputhje me kërkesën 1.4.a.ii, MSG duhet të sigurojë që procedurat e veta për emërimin dhe ndryshimin e përfaqësuesve të grupeve të interesit të jenë publike dhe të konfirmojnë të drejtën e çdo anëtari të grupit të interesit për të emëruar përfaqësuesit e vet. Për të forcuar zbatimin, qeveria nxitet që të sigurohet se entet përkatëse shtetërore, të tilla si kompania kombëtare e naftës Albpetrol, duke pasur parasysh në raportimin mbi pjesëmarrjen shtetërore (*shih Kërkesa 2.6*), të përfaqësohen në MSG dhe se niveli i pjesëmarrjes së tyre të jetë në përputhje me nevojën e MSG për të marrë vendime të informuara dhe ndjekë veprime të dakordësuara. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.ii dhe 1.4.b.iii, MSG duhet të ndërmarrë aktivitete informimi efektive me grupe të shoqërisë civile dhe kompani, përfshi nëpërmjet komunikimit si media, faqja e internetit dhe letrat, duke informuar grupet e interesit për përkushtimin e qeverisë për ta zbatuar EITI-n, si dhe rolin qendror të kompanive dhe shoqërisë civile. Anëtarët e MSG duhet të shërbejnë si ndërlidhës me grupet e tyre të interesit. Në përputhje me kërkesën 1.4.b.vi, MSG duhet të sigurojë një proces vendim-marrjeje përfshirës nëpërmjet zbatimit, sidomos në lidhje me industrinë dhe shoqërinë civile. Grupet e qeverisë dhe kompanive nxiten të sigurojnë që pjesëmarrja e përfaqësuesve të tyre në takimet e MSG të jetë konseguente dhe e një niveli mjaftueshëm të

lartë sa për ta lejuar MSG të marrë vendime dhe të ndjekë përmbushjen e tyre. Qeveria mund të marrë në konsideratë ta ftojë Albpetrolin në MSG. Rekomandohet gjithashtu që MSG të rishikojë procedurat e vlerësimit për anëtarët e tij, të cilat do binin dakord t'i ndiqnin të gjitha grupet e interesit.

5. MSG nxitet të dakordësojë një plan pune që lidhet me prioritetet kombëtare dhe që është produkt i konsultimeve të gjera me grupet e interesit. Lidhje më të qarta me diskutimet dhe prioritetet kombëtare do të nxisin pjesëmarrje më aktive nga të gjitha grupet e interesit dhe do të ndihmonin për të mobilizuar burime shtesë. MSG duhet të trajtojë qëndrueshmërinë financiare të EITI-t nga pikëpamja afatmesme.

Pjesa II – Publikimet EITI

2. Akordimi i kontratave dhe licensave

2.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion ofron hollësi mbi zbatimin e kërkesave EITI lidhur me kuadrin ligjor për sektorin nxjerrës, aktivitetet e licensimit, kontratat, pronësinë reale dhe pjesëmarrjen shtetërore.

2.2 Vlerësim

Kuadri ligjor (#2.1)

Dokumentim i përparimit

Kuadri ligjor: Raporti EITI 2015 ofron një vështrim të përgjithshëm të kuadrit ligjor për sektorin e naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f.26), dhe për sektorin minerar (Raporti EITI 2015, f.49-52), përfshi përshkrime të shkurtra dhe linqe për faqe qeveritare përkatëse (MEI dhe AKBN) për përmbledhje të ligjeve e rregulloreve specifike për sektorin. Raporti po ashtu aludon për traktate investimi me “shumë vende” dhe ofron një link²³ për në listën e plotë të këtyre (Raporti EITI 2015, f.103).

Rolet e agjencive qeveritare: Raporti ofron një vështrim sipërfaqësor të agjencive²⁴ kryesore qeveritare të përfshira në industrinë nxjerrëse si dhe linqe për faqet e internetit që ekzistojnë, ku gjenden përshkrime të hollësishme të roleve dhe përgjegjësi të çdo agjencie (Raporti EITI 2015, f.15-18). Përshkruhet gjithashtu edhe anëtarësia e Shqipërisë në Komunitetin Rajonal të Energjisë të Bashkimit Europian prej vitit 2006 (Raporti EITI 2015, f.18). Raporti ofron një përshkrim sipërfaqësor të roleve të MEI-t, AKBN dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) në miratimin e licensave minerare si dhe të Agjencisë së Prokurimit Publik për mbikqyrjen e raundeve të aplikimit për licensa minerare (Raporti EITI 2015, f. 49-51).

Regjimi fiskal: Raporti ofron një vështrim të përgjithshëm të termave fiskale në sektorin e naftës dhe gazit, përfshi një diagram të të ardhurave nga nafta dhe gazi upstream, vlerën e të ardhurave kyçe nga nafta dhe gazi në vitin 2015 si dhe përshkrime të të gjitha rrjedhave kyçe të të ardhurave të naftës dhe gazit²⁵ (Raporti EITI 2015, f.32-35). Ndërkohë që vëren se termat specifike të PSA nafte dhe gazi nuk janë

²³ <http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/CountryBits/2#iialnnerMenu>

²⁴ Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Enti Rregullator i Energjisë, Agjencia për Koncesionet dhe PPP, Ministria e Mjedisit, entet në pronësi shtetërore në energji dhe burime.

²⁵ Renta, tatimi mbi fitimin, TVSH, pagesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale, pjesa e shtetit në prodhimin e naftës, bonuse trajnimi.

publike, raporti ofron një link në një faqe interneti të MEI²⁶ për termat dhe kushtet kryesore të PSA-ve (Raporti EITI 2015, f. 26). Raporti EITI 2015 përshkruan kuadrin fiskal në sektorin minerar, përfshi rregullore për përcaktimin e garancive financiare për plane investimi dhe plane rehabilitimi mjedisor (Raporti EITI 2015, f.49-51). Ofrohet edhe një vështrim i përgjithshëm për taksat dhe tatimet²⁷ e aplikueshme në sektorin minerar (Raporti EITI 2015, f. 53-54).

Niveli i decentralizimit fiskal: Raporti EITI 2015 përshkruan transfertat statutores tek njësitë e qeverisjes vendore (NJQV) në të cilat zhvillohet prodhim nxjerrës, fillimisht zbatuar në vitin 2008 në nivel prej 25% të rentës dhe amenduar në vitin 2014 në 5% të rentës (në fuqi prej 2015) (Raporti EITI 2015, f. 75-76). Përshkruhet procesi për mbledhjen dhe transferimin e këtyre pagesave pranë NJQV përshkruhet (Raporti EITI 2015, f.75). Raporti po ashtu thekson ineficencat në tranzicionin drejt sistemit të reformuar të transfertave në vitin 2015, viti i parë i zbatimit (Raporti EITI 2015, f. 76)).

Reformat: Raporti radhit reformat në sektorin minerar përfshi një zbritje me dy të tretat në rentën minerare në nëntor 2014 (Raporti EITI 2015, f. 53) dhe përshkruan shkurtimisht reformat në Ligjin për Naftën prezantuar nga MEI në dhjetor 2016 (Raporti EITI 2015, f. 26).

Raporti EITI 2013-14 përshkruan mjedisin ligjor për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2013-14, f.22), minerat dhe guroret (Raporti EITI 2013-14, f.40) dhe hidroenergjitikën (Raporti EITI 2013-14, f.54), me linqe aty ku ka vlerë, si dhe me regjimet fiskale të aplikueshme (Raporti EITI 2013-14, f.37, 49, 69-70). Shkalla e decentralizimit fiskal (Raporti EITI 2013-2014, f. 74) përshkruhet në përkrah roleve të agjencive përkatëse qeveritare dhe një numri reformash miratuar në vitin 2015 (Raporti EITI 2013-14, f.16-19).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Aktorët e konsultuar nuk shprehën ndonjë pikëpamje të veçantë lidhur me tërësinë dhe saktësinë e mbulimit nga ana e Raportit EITI 2015 për mjedisin ligjor dhe kuadrin fiskal për industrinë nxjerrëse. Një përfaqësues i industrisë në MSG mendonte se shpjegimi i mjedisit ligjor në Raportin EITI 2013-2014 ishte më tërësor se sa në Raportin EITI 2015, duke qenë se kishte pasqyruar disa nga shqetësimet e industrisë lidhur me disa paqartësi të caktuara ligjore.

Një numër përfaqësuesish nga qeveria, shoqëria civile dhe partnerë zhvillimi theksuan strukturën rregullore të fragmentarizuar që qeveris industrinë nxjerrëse, të ndara midis MEI-t, AKBN-së dhe Albpetrolit. Një numër përfaqësuesish nga shoqëria civile mendonin se fragmentarizimi i enteve shtetërore me përgjegjësi mbikqyrjen e sektorit ishte një përpjekje e ndërjegjshme në përpjekje për të fshehur informacion nga publiku. Disa përfaqësues nga qeveria dhe shoqëria civile shpjeguan se kishte një histori fërkimi midis AKBN dhe Albpetrolit, duke pasur parasysh natyrën e politizuar të menaxhimit të të dy organizatave. Një raport i janarit 2017 nga Eurosupport shpjegonte se rolet dhe përgjegjësitë e secilës

²⁶ <http://www.energija.gov.al/al/publikime/blloqet-e-lira-te-kerkimit>

²⁷ Including descriptions of all key mining revenue streams (royalties, tax on profits, VAT, payments for social and health insurance and personal income tax, personal income tax, tax on dividend).

ministri përshkruhet në faqen e internetit të ministrisë përkatëse dhe nxitën AlbEITI-n të shihte mundësinë për të ofruar një vështrim të përditësuar të mjedisit ligjor dhe regjimit fiskal për sektorët e minierave, naftës dhe gazit në faqen e internetit të AlbEITI (Eurosupport, 2017).

Disa përfaqësues të industrisë, qeverisë dhe partnerëve të zhvillimit shpjeguan se kishte paqartësi domethënëse në termat fiskale për minierat, naftën dhe gazin. Çështja e përlogaritjeve të rentës theksohej si sfidë nga këta përfaqësues, të cilët vërejtën se kompanitë vazhdonin të paguanin rentë edhe kur nuk kishin fitim. Gjithashtu, disa kompani kishin pasur vështirësi me çështjen e rikuperimit të kostove në PSA-të e naftës dhe gazit, ku një numër rastesh ishin referuar në arbitrazh ndërkombëtar. Këta përfaqësues theksuan mospërputhjet midis termave fiskale statutorë nga Ligji për Hidrokarburet, i cili përbëhej vetëm nga dy faqe, dhe termat fiskale për disa PSA naftë dhe gazi, të cilat ishin miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe përfshinin klauzola stabilizimi. Departamenti i Shtetit ka përdorur gjuhë të fortë lidhur me Albpetrolin si “një burim i qëndrueshëm raportesh për korrupsion, interpretim grabitqar të rregulloreve dhe inefficiencë në sektorin e hidrokarbureve” (Departamenti i Shtetit i SHBA, 2016).

Përfaqësues të ndryshëm të qeverisë dhe partnerëve të zhvillimit theksuan një numër reformash me rëndësi, si të planifikuara ashtu dhe në proces. Një zyrtar i lartë qeveritar shpjegoi se rishikimi në proces i Ligjit për Hidrokarburet synonte të sigurote përputhjen e tij me kushtet e PSA-ve ekzistuese në naftë dhe gaz. Një partner zhvillimi vuri në dukje se Ambasadat e SHBA dhe Mbretërisë së Bashkuar po përgatisnin asistencë teknike për të reformuar kuadrin rregullator për naftën dhe gazin. Byroja e Burimeve të Energjisë e Departamentit të Shtetit të SHBA po përgatiste nxjerrjen e Nismës për Qeverisjen dhe Kapacitetin Energjistik (EGCI)²⁸ për Shqipërinë në gjysmën e dytë të vitit 2017 për të rishikuar strukturën fiskale të industrisë së naftës dhe gazit, potencialisht duke kaluar nga një model i rikuperimit të kostove tek modeli taksë-dhe-rentë dhe për të formuar një task-forcë ndërqeveritare për naftën dhe gazin. EGCI i propozuar do të ofronte mbështetje për të përmirësuar kapacitetin tatimor dhe auditues të qeverisë në lidhje me sektorin e naftës dhe gazit dhe për të siguruar që të gjitha licensat për naftë dhe gaz akordoheshin nëpërmjet tenderash të hapur dhe jo negociatave të drejtpërdrejta, të cilat shiheshin si të mjegullta.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në trajtimin e kësaj kërkese. Raporti EITI 2015 përfshin një vështrim të përgjithshëm të ligjeve përkatëse, enteve qeveritare, termave fiskale në sektorin minerar, të naftës dhe gazit, nivelin e decentralizimit fiskal dhe komente të shkurtra mbi reformat aktuale.

Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të eksplorojë mundësinë e përdorimit të raportimit EITI për të theksuar mospërputhjet në kuadrin ligjor, kuadrin fiskal dhe përgjegjësitë rregulatore të Shqipërisë në

²⁸ <https://www.state.gov/documents/organization/264507.pdf>

sektorët e minierave, naftës dhe gazit. MSG mund të dojë ta lidhë raportimin EITI me asistencën e planifikuar teknike në sektorët e minierave, naftës dhe gazit për t'u siguruar që zbatimi EITI shërben si diagnozë për të mbështetur reformat në proces dhe të planifikuara.

Akordimi i licensave (#2.2)

Dokumentimi i përparimit

Në sektorin minerar, mbajtësve të licensave për kërkim dhe prodhim iu kërkohet të marrin leje minerare nga MEI çdo vit, në përputhje me Ligjin 10081 të 23 shkurtit 2009 (Raporti EITI 2015, f. 52). Në naftë dhe gaz, të gjithë mbajtësve të licensave iu kërkohet të realizojnë “marrëveshje për ndarje naftë” (PSA), të ngjashme me marrëveshjet për ndarje prodhimi, me qeverinë ose nëpërmjet AKBN ose nëpërmjet Albpetrolit (Raporti EITI 2015, f. 26).

Akordimet/transferimet: Në naftë dhe gaz, nga lista e PSA-ve (në Shtojcat 5 dhe 6) dhe nga lista e licensave për kërkim (në Shtojcën 7) duket se asnjë PSA për naftë dhe gaz nuk u akordua në vitin 2015, edhe pse Raporti EITI 2015 nuk pohon qartë nëse u akordua apo transferua ndonjë licensë naftë dhe gazi gjatë vitit 2015 (Raporti EITI 2015, f.139-140, 141). Ka të dhëna në media për një licensë kërkimi naftë dhe gazi (Blloku D) alokuar Shell dhe Petromanas në korrik 2015 (World Oil, 2015).

Raporti pohon se MEI shpalli tendera konkurrues për 77 zona minerare në vitin 2015 dhe akordoi 50 licensa minerare për krom (14), gëlqere dhe minerale të tjera ndërtimi (40), hekur-nikel dhe nikel-silikat (4) dhe zhavorr dhe rërë bituminoze (4) (Raporti EITI 2015, f. 52). Megjithatë, Shtojca 8 ofron një listë prej 62 licensash minerare akorduar nëpërmjet tenderimit konkurrues në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 142-144). Arsytet për mospërputhjen në raportimin e alokimit të licensave minerare në vitin 2015 nuk përshkruhen në raport. Raporti EITI 2015 nuk i referohet faktit nëse pati ndonjë transferim licensë minerare, naftë dhe gazi në vitin 2015. Raporti ofron një vështrim të përgjithshëm të regjistrave të aksesueshëm publikisht të MEI-t për licensat minerare, të naftës dhe gazit, si dhe një link²⁹ për tek një listë PDF e licensave në faqen e internetit të MEI-t (Raporti EITI 2015, f.101-102). Faqja e internetit e AlbEITI po ashtu ofron dy lista licensash, që mbulojnë minierat³⁰ dhe naftën e gazin,³¹ edhe pse lista e licensave minerare ishte përditësuar së fundi në 3 nëntor 2015. Bazuar në një krahasim të licensave minerare të renditura në faqet e internetit të AlbEITI³² dhe MEI³³, duket se 12 licensa minerare u akorduan në periudhën 3 nëntor – 31 dhjetor 2015.

Procesi i akordimit/transferimit: Për naftën dhe gazin, raporti i referohet procesit për akordimin e

²⁹ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

³⁰ <http://www.albeiti.org/mining-register/>

³¹ <http://www.albeiti.org/petroleum-licenses/>

³² <http://www.albeiti.org/mining-register/>

³³ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

licensave për naftë dhe gaz (dhe linqe për në faqet përkatëse të internetit), ku përfshihen MEI³⁴, AKBN³⁵ dhe Albpetrol³⁶ (Raporti EITI 2015, f.27). Të tri faqet e internetit ofrojnë përshkrime të përgjithshme të procesit statutor për akordimin e licensave. Raporti konfirmon nevojën për miratim ministror dhe ofron një link për në informacionin e MEI-t lidhur me licensat e kërkimit falas³⁷ (Raporti EITI 2015, f.27), kur ekzistojnë linqe për në vendime ministrore që akordojnë licensa eksplorimi. Ofrohet një vështrim i përgjithshëm i proceseve për konkludimin e PSA-ve në fushat e administruara respektivisht nga AKBN dhe Albpetrol, përfshi nevojën për miratim nga ministri (Raporti EITI 2015, f.27). Gjithashtu, raporti shprehet se, në raste kur ka dy a më shumë aplikantë për të njëjtin bllok naftë, AKBN ose Albpetrol duhet të paraqesin vlerësime paraprake pranë MEI-t për miratim përpara se të fillojnë negociatat (Raporti EITI 2015, f. 27).

Pas krijimit të AKBN si rregullator i sektorit në vitin 2006, Albpetrolit i kërkohet të konkludojë një marrëveshje me MEI-n për çdo licensë naftë dhe gazi për të cilën arrin një PSA me një kompani naftë apo gazi. Raporti EITI 2015 ofron një vështrim të përgjithshëm të procesit për arritjen e të tilla marrëveshjesh licensore midis Albpetrolit dhe MEI-t (Raporti EITI 2015, f. 28). Procesi për arritjen e një marrëveshjeje license qeveriset nga të njëjtat rregulla si PSA-të normale dhe kërkon miratim nga ministri (Raporti EITI 2015, f.28). Për sa i përket procedurave të transferimit të licensave për naftën dhe gaz, Tabela 4 tregon se miratimi i MEI-t ishte kërkuar për blerjen nga T Transatlantic Petroleum të operacioneve të Stream Oil and Gas Albania në shtator 2014 (Raporti EITI 2015, f. 29), por raporti nuk ofron më shumë hollësi lidhur me procesin statutor për transferimin e licensave të naftës dhe gazit apo të aksioneve në konsorciumet në PSA.

Në lidhje me procedurat statutorë për akordimin e licensave minerare, Raporti EITI 2015 përshkruan procesin për akordimin e licensave edhe me anë të tenderave konkurrense edhe për negociata ad hoc mbi baza "i shërbehet të parit," ku zonat konkurrense për të cilat bëhet tender përcaktohen në planin vjetor kombëtar të minierave (Raporti EITI 2015, f. 51-52). Raporti po ashtu sqaron që kërkohen leje vjetore minerare, paralel me licensa minerare afatgjata (Raporti EITI 2015, f. 52). Tabela 7 ofron një vështrim të përgjithshëm të termave (kohëzgjatjen dhe sipërfaqen) e dy lloje licensash minerare (kërkimi dhe prodhimi) (Raporti EITI 2015, f. 49). Përshkruhet edhe procesi për paraqitjen dhe miratimin e planeve vjetore të investimit dhe rehabilitimit mjedisor (Raporti EITI 2015, f.49-50).

Në lidhje me procedurat faktike të ndjekura për akordimin e licensave minerare të dhëna në praktikë në vitin 2015, raporti shprehet se "për qëllimet e këtij raporti nuk është bërë publik informacion shtesë në lidhje me procesin e vlerësimit të ofertave dhe aplikantët jofitues" (Raporti EITI 2015, f. 52). Shtojca 8 ofron informacion mbi termat e 62 licensave të akorduara në vitin 2015 por nuk përshkruan procesin për akordimin e tyre (Raporti EITI 2015, f.142-144). Duke qenë se raporti ofron datat e aplikimit për vetëm 33

³⁴ <http://www.energija.gov.al/al/publikime/blloqet-e-lira-te-kerkimit>

³⁵ <http://www.akbn.gov.al/rregullore-per-procedurat-e-miratimit-te-marreveshjeve/>

³⁶ <http://www.albpetrol.al/marreveshjet-hidrokarbure/baza-ligjore/>

³⁷ <http://www.energija.gov.al/al/publikime/blloqet-e-lira-te-kerkimit>

nga 62 licensat minerare akorduar në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f.142-144), lexuesi mundet që vetëm të bëjë vlerësime të përgjithshme për dritaren kohore për akordimin e licensave për afro gjysmën e licensave minerare akorduar në vitin 2015.

Kriteret teknike dhe financiare: Raporti EITI 2015 paraqet një vështrim të përgjithshëm sipërfaqësor të kriterëve statutorë teknike dhe financiare të përdorura në akordimin e licensave të naftës dhe gazit, “përfshi know-how, teknologji, personel, si dhe përvoja të mëparshme në sektor dhe në të njëjtën kohë të zotërojë burime financiare për të financuar një investim praktik eksplorimi dhe zhvillimi (...) si dhe aftësinë për të ndikuar pozitivisht komunitetet përreth” (Raporti EITI 2015, f. 27). Ndërkohë që vëren se termat specifike për PSA të naftës dhe gazit nuk janë publike, raporti ofron një link për në një faqe interneti³⁸ të MEI-t për termat dhe kushtet kryesore (Raporti EITI 2015, f. 26). Kjo faqe interneti MEI nuk ofron një listë përfshirëse dhe të hollësishme të kriterëve teknike dhe financiare të vlerësuara, edhe pse pohon se kërkesat përfshijnë ofrimin e pasqyrave financiare të tre viteve të audituara si pjesë e aplikimit.³⁹

Për licensat minerare, raporti përshkruan përmbatjen e njoftimeve për tendera, peshën e kriterëve të përgjithshme teknike dhe financiare, si dhe procesin e vlerësimit të aplikimeve (Raporti EITI 2015, f. 51-52). Megjithatë, raporti pohon se AP nuk pati sukses në sigurimin e një liste të kriterëve teknike dhe financiare të përdorura specifiku në akordimin e licensave minerare në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 102).

Raporti nuk ofron informacion lidhur me kriteret teknike dhe financiare të përdorura për të vlerësuar transferimet e licensave në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit.

Informacion për përfituesit e licensave: Identiteti i 62 përfituesve të licensave minerare në vitin 2015 jepet në Shtojcën 8 (Raporti EITI 2015, f. 142-144). Raporti nuk tregon nëse u akordua ndonjë licensë e re naftë dhe gazi gjatë vitit 2015 dhe nuk i referohet ndonjë transferimi license në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit, edhe nëse lista e PSA-ve dhe licensave për kërkim naftë dhe gazi në Raportin EITI 2015 nuk duket se tregon ndonjë akordim apo transferim license naftë dhe gazi (Raporti EITI 2015, f. 139-140,141).

Devijime jo-minimale: Raporti EITI 2015 deklaron se “autoritetet kontraktuese” nuk raportuan ndonjë devijim nga kuadri ligjor dhe rregullator përkatës që qeveris transferimet e licensave, por se AP nuk verifikoi nëse pati ndonjë devijim sepse nuk “u mundësua ta kryente këtë detyrë” (Raporti EITI 2015, f. 162). Ndërkohë që raporti thekson akordimet e licensave minerare gjatë vitit 2015, ai nuk ofron informacion mbi devijimet në procedurat statutorë për akordimin e licensave në praktikë për ndonjë prej 62 licensave minerare akorduar në vitin 2015. Raporti vëren se AP mori informacion mbi raundet e tenderave në vitin 2015 por jo për kriteret e tenderave që do përdreshin për të vlerësuar aplikimet apo emrat e tenderuesve aty ku pati më shumë se një aplikant që paraqiti propozim (Raporti EITI 2015, f. 102).

³⁸ <http://www.energija.gov.al/al/publikime/blloqet-e-lira-te-kerkimit>

³⁹ <http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Publikime2/Binder1-1.pdf>

Raporti nuk thekson ndonjë devijim nga procedurat statutores të akordimit në licensa në naftë dhe gaz akorduar përpara vitit 2013, duke pohuar vetëm se AP “kuptoi se thujse të gjitha marrëveshjet e naftës ishin akorduar nëpërmjet procedurash me negociata ad hoc deri në gusht 2013, (...) kërkua por nuk morëm nga MEI informacion mbi kriteret teknike dhe financiare të përdorura për akordimin e këtyre marrëveshjeve” (Raporti EITI 2015, f. 102).

Më herët, raporti pohonte se “thujse të gjitha” PSA-të e nënshkruara deri në fund të vitit 2015 ishin akorduar nëpërmjet negociatash ad hoc, ku termat kryesore teknike dhe financiare nuk ishin publikuar për akses publik (Raporti EITI 2015, f. 27).

Tërësia: Raporti ofron njëfarë informacioni lidhur me licencat e naftës dhe gazit akorduar në vitin 2016, edhe pse disa negociata për akordime dhe transferime licensash ishin në proces, por jo të përfunduara, në vitin 2015⁴⁰ (Raporti EITI 2015, f. 28-29). Megjithatë, raporti nuk i referohet ndonjë license naftë dhe gazi akorduar apo transferuar përpara apo pas vitit 2015.

Procesi i aplikimit: Raporti EITI 2015 pohon se MEI akordoi 50 licensa minerare në vitin 2015 me anë të tenderimit konkurrues (Raporti EITI 2015, f. 52) por që nuk mund të ofrohej informacion lidhur me procesin e vlerësimit të ofertave apo listë e tenderuesve të pasuksesshëm. Lista e zonave të akorduara dhe aplikantët fitues tregohen në Shtojcën 8 (Raporti EITI 2015, f. 142-144), edhe pse koj përfshin 62 licencat minerare fituese dhe jo 50 të përmendura më herët në raport (Raporti EITI 2015, p. 52). Përshkruhet procesi i përgjithshëm i tenderimit konkurrues, ku zonat e tenderimit përcaktohen në planin minerar vjetor (Raporti EITI 2015, f. 51-52). “Ofertat konkurruese akordohen për zona ku rezerva gjeologjike të njohura dhe të zbuluara paraqesin interes ekonomik të konsiderueshëm.” Raporti shpjegon që njoftimet për tender, TeR dhe kriteret për vlerësimin e ofertave publikohen në faqet e internetit të MEI-t⁴¹ dhe Agjencisë së Prokurimit Publik,⁴² dhe ofron linqe për në faqet e përgjithshme të internetit të agjencive. Raporti po ashtu përshkruan përmbajtjen e njoftimeve të tenderave, peshën e kriterëve të përgjithshme teknike dhe financiare, dhe procesin e vlerësimit të ofertave (Raporti EITI 2015, f.51-52). Megjithatë, seksioni 11.3.6 vëren se AP nuk mundi të merrte informacion mbi kriteret e tenderimit të përdorura për të vlerësuar ofertat në secilin raund për licencat minerare të akorduara në vitin 2015 dhe as emrat e ofertuesve të pasuksesshëm (Raporti EITI 2015, f. 102).

Koment mbi eficientë: Nuk ka informacion shtesë lidhur me procedura për akordim apo transferim të

⁴⁰ MEI filloi procedurat e akordimit për eksplorimin on-shore në blloqet 4, 5, C, Panaja Dumre, Jone-5 dhe Rodoni në 2015. Deri në fund të vitit 2015, MEI po negocionte me Petromanas Albania dhe Shell Upstream Albania për një PSA për eksplorimin e bllokut 4, edhe pse kjo nuk ishte finalizuar në kohën e hartimit të Raportit EITI 2015. Deri në fund të 2015, MEI po ashtu po negocionte me Navitas Petroleum Limited për bllokun e Dumresë. Më 15 mars 2016, MEI dhe AKBN nënshkruan një PSA me Albanides Energy për eksplorimin e bllokut numër 8, një PSA e miratuar më 26 prill 2016 me Vendim të Këshillit të Ministrave, me PSA-në të botuar në fletoren zyrtare 63/2016. Në vitin 2016, Petromanas Albania GmbH shiti operacionet e veta të naftës tek Shell Upstream Albania B.V. dhe aplikoi për likuidim. Në shtator 2014, Transatlantic Petroleum Ltd bleu Stream Oil & Gas in Albania, një transaksion i miratuar nga MEI. Në shkurt 2016, Transatlantic Petroleum shiti aksionet e veta tek GBC Oil. Në shkurt 2016, Petromanas Albania shiti operacionet dhe PSA e saj për eksplorimin e blloqeve 2 dhe 3 tek Shell Upstream Albania.

⁴¹ <http://www.energija.gov.al/>

⁴² <http://www.app.gov.al/>

licensës, por ka një referencë të përgjithshme për ineficencën dhe mungesën e transparencës në procesin e akordimit të licensave. Raporti thekson traktatet ndërkombëtare për investimet nënshkruar nga Shqipëria dhe i referohet një liste përfshirëse,⁴³ duke vërejtur se këto marrëveshje përfshijnë kërkesa për transparencë në procedurat e licensimit dhe prokurimit dhe se “mungesa e transparencës dhe proceset joefektive për akordimin e licensave mund ta ekspozonte vendin ndaj pretendimeve në arbitrazh ndërkombëtar” (Raporti EITI 2015, f. 103).

Raporti EITI 2013-14 EITI përshkruante dy sisteme për akordimin e licensave minerare, negociatat ad hoc dhe tenderimet konkurruese (Raporti EITI 2013-14, f.29), dhe rregulloret e reja nga maj 2015 (Raporti EITI 2013-14, f.41), përfshi kriteret teknike dhe financiare (Raporti EITI 2013-14, f.42) dhe informacion mbi përfituesit e licensave minerare në vitin 2015 (Raporti EITI 2013-14, f.261-262), ndonëse as kriteret e ofertimit për licensa minerare akorduar në vitet 2013-14 nuk ishin paraqitur. Përshkruheshin rregullat e reja të miratuara në fund të vitit 2015 për akordimin e licensave për naftë dhe gaz (Raporti EITI 2013-14, f.30), përfshi kriteret teknike dhe financiare. Raporti ofronte një link⁴⁴ për tek termat dhe kushtet për aplikimin për një PSA naftë dhe gazi, por vërente se kriteret teknike dhe financiare të përdorura gjatë negociatave ad hoc për të gjitha PSA-të e akorduara deri në vitin 2015 nuk ishin në dispozicion (Raporti EITI 2013-14, f.31). Raporti EITI 2013-14 po ashtu përfshinte një rekomandim për forcimin e sistemit të licensimit.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Aktorë nga grupet të ndryshme interesi shprehën pikëpamje thellësisht të ndryshme lidhur me transparencën e procedurave të akordimit të licensave në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit, edhe pse kishte konsensus mes grupeve të interesit të konsultuara se Shqipëria kishte një histori të mjegullt në akordimin e licensave dhe se kjo kishte qenë një çështje emocionale në të kaluarën. Një zyrtar i lartë qeveritar vërejt se krijimi i AKBN si rregullator gjysmë-i pavarur i sektorit kishte shënuar një përmirësim të theksuar në mbikqyrjen e akordimit të licensave, duke vërejtur se praktikrat e akordimit të licensave dhe PSA-ve të naftës dhe gazit që në të kaluarën bazoheshin tek “klientelizmi” nuk ishin më të mundura. Personeli i Sekretariatit shpjegoi se ALbEITI kishte ndërmarrë punë domethënëse për të sqaruar procedurat për akordimin e licensave për shkak të paqartësive në procesin e akordimit të licensave në të kaluarën. Megjithatë, një numër anëtarësh nga OSHC në MSG përgjithësisht argumentuan se kishte devijime thelbësore nga procedurat statutores të akordimit të licensave, ndonëse pa shembuj specifikë pavarësisht konsultimesh të gjera mbi këtë temë. Disa partnerë zhvillimi theksuan shqetësime lidhur me devijime nga kërkesa për konsultime publike përpara akordimit të koncesioneve hidroenergjitike, duke vërejtur shembuj specifikë ku konsultimet publike dukeshin të rreme, duke pasur parasysh përzgjedhjen e individëve specifikë për konsultimet. Megjithatë, nuk u dhanë shembuj specifikë devijimesh nga procedurat për akordimin e licensave në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit. Një anëtar i MSG nga qeveria ngriti pyetjen se pse çështja e devijimeve nga procedurat statutores të akordimit të licensave do të ishte me rëndësi për raportimin EITI dhe mendonte se vlerësime të tilla ishin përtej fushës së punës së

⁴³ <http://investmentpolicyhub.unctad.org/IIA/CountryBits/2#iialnnerMenu>

⁴⁴ <http://www.energija.gov.al/files/userfiles/Publikime2/Binder1-1.pdf>

EITI-t. zyrtari shpjegoi se nuk mund të kishte devijime nga procedurat e akordimit të licensave në miniera, naftë apo gaz, duke qenë se zyrtarët përgjegjës për akordime të tilla do ndiqeshin penalisht për çfarëdo devijimi.

Licensat minerare: AP shpjegoi se referenca për 50 licensat minerare të akorduara në tekstin e plotë të Raportit EITI 2015 ishte gabim dhe konfirmoi se numri i licensave minerare të akorduara në vitin 2015 ishte në fakt 62. Edhe AP, edhe përfaqësues nga MEI konfirmuan se nuk kishte pasur kontrata të akorduara nëpërmjet negociatash direkte *ad hoc* gjatë vitit 2015, përtej 62 licensave të akorduara me anë të tenderimit konkurrues. Përfaqësuesi i qeverisë shpjegoi se kishte pasur raste akordimi licensash minerare me anë të negociatave të drejtpërdrejta në të kaluarën, përfshi dy licensa prodhimi minerar në vitin 2001. Gjithashtu, përfaqësues të qeverisë dhe AP vërejtën se qeveria mund të vendoste të akordonte licensa minerare nëpërmjet negociatash direkte në raste me rëndësi “sociale apo ekonomike” kombëtare, për shembull kur kompania minerare angazhohej të investonte në përpunim downstream, por se të tilla licensa prodhimi do të akordoheshin për tre vjet dhe jo si zakonisht për 25 vjet. Zyrtari konfirmoi se nuk kishte pasur raste të tilla gjatë vitit 2015.

Për sa i përket kriterëve teknike dhe financiare për akordimin e licensave minerare, AP dhe një përfaqësues qeveritar shpjeguan se kriteret specifike ishin përfshirë në kriteret e ofertimit vetëm tek tenderuesit që aplikonin nëpërmjet portalit të dedikuar në agjencinë e prokurimeve publike,⁴⁵ por që këto nuk ishin të aksesueshme për publikun e gjerë (dhe ishin në dispozicion të pjesëmarrësve vetëm gjatë procesit të tenderimit) as të përmbledhura në faqen e internetit të MEI-t. Përfaqësuesit konfirmuan se kriteret specifike të tenderimit ndryshonin sipas tenderit specifik por AP vërejtë se nuk i ishte ofruar akses në kriteret specifike të tenderimit gjatë punës së tyre, pavarësisht disa kërkesash. Një zyrtar qeveritar vërejtë se ndërkohë që kriteret teknike zakonisht qëndronin të njëjtat për të gjithë tenderart, kriteret financiare ndryshonin në varësi të përmasave dhe karakteristikave gjeologjike të licensave që ofroheshin. AP vërejtë se kishte ndërmend të kontrollonte nëse këto ishin vërtet në dispozicion të tenderuesve gjatë raundeve të ardhshme të tenderave (ndërkohë që do ishin të hapura). Ndërkohë që AP vërejtë se e kishte theksuar këtë boshllëk pranë MSG, i ishte thënë vetëm që anëtarët e MSG “do ta shikonin.” Personeli i sekretariatit konfirmoi se i kishin kërkuar MEI-t të ofronte informacion lidhur me procesin faktik për akordimin e licensave minerare në vitin 2015 por MEI nuk kishte bashkëpunuar për këtë çështje. Një përfaqësues qeveritar shpjegoi se ekzistonte një dritare kohore strikte prej dy muajsh kur qeveria mund të përpunonte aplikimet për licensa minerare.

Një raport i janarit 2017 nga Eurosupport shpjegonte se kriteret teknike dhe financiare të përdorura për të vlerësuar akordimin e licensave minerare ishin kodifikuar në Vendimin 942, datë 17 nëntor 2010 (Eurosupport, 2017). Për licensat minerare të akorduara nëpërmjet tenderimit konkurrues, Ligji 145/2013 kërkonte që kriteret e tenderit të publikoheshin përkrah dokumenteve të tenderit në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Hollësitë për termat e ofertave dhe tenderuesit e pasuksesshëm janë në

⁴⁵ www.app.gov.al

dispozicion kur kërkohen për një vit pas mbarimit të tenderit, sipas kërkesave të pikës 7.4 të VKM 320 të 21 prillit 2011. Raporti po ashtu thekson se transferimi i licensave minerare menaxhohet në linjë me Vendimin 362 të 29 prillit 2011 dhe se çdo palë e interesuar mund të kërkojë informacion mbi procesin për të transferuar një licensë specifike në linjë me Ligjin për Lirinë e Informacionit 119/2014. Ndërkohë që raporti i Eurosupport shprehet se informacioni i mandatuar sipas Kërkesës 2.2 ishte në dispozicion në lëmin publik në Shqipëri, ai po ashtu rekomandon që informacioni lidhur me ofertat për licensa minerare të mbaheshin për më shumë se një vit dhe që i gjithë informacioni për raundet e tenderimit të ishte lehtësisht i aksesueshëm në faqen e internetit të MEI-t. Kjo do të kërkonte amendimin e pikës 7.2 të VKM 320 të 21 prillit 2011. Raporti po ashtu rekomandon që MEI të përgatisë një raport përmbledhës publik mbi procedurat e ndjekura për akordimin e çdo licensë të akorduar mbi bazën se kush aplikon i pari. Kjo do të kërkonte amendim të paragrafit 11 të Vendimit 942 të 17 nëntorit 2010 (Eurosupport, 2017).

Për sa i përket devijimeve jo të vogla nga procedurat statutores për 62 licensat minerare të akorduara në vitin 2015, AP shpjegoi se kishte kërkuar në mënyrë të përsëritur që të shqyrtonte raportet për vlerësimin e ofertave si për Raportin EITI 2013-14 ashtu edhe për Raportin EITI 2015, por se nuk i ishte dhënë akses në këto dokumente. AP vërejti se ishte mbështetur në opinionin e MEI-t se nuk kishte pasur devijime nga procedurat statutores për akordimin e licensave minerare në një vlerësim sipas Kërkesës 2.2. Ndërkohë që AP kishte ndërmarrë kërkim të pavarur bazuar në median publike dhe fletoren zyrtare të qeverisë për ndonjë lajm mbi licensat dhe koncesionet minerare, nuk ishte konsultuar me ndonjë prej 62 kompanive që kishin marrë ndonjë prej 62 licensave të akorduara në vitin 2015. Megjithatë, AP deklaroi se kishte "nxitur" kompanitë pjesëmarrëse të ndanin ndonjë shqetësim lidhur me procesin e licensimit dhe mbikqyrjes, nëpërmjet një pyetjeje të përgjithshme në formularët e raportimit, por nuk kishte marrë ndonjë koment nga kompanitë raportuese mbi këtë çështje. AP vërejti se disa kompani që kishin marrë licensa minerare në vitin 2015 ishin "materiale," dmth që iu kërkohej të merrnin pjesë në raportimin EITI, dhe se kishte në plan të pyeste specifikisht për ndonjë devijim nga procedurat ligjore të akordimit të licensave si pjesë e korrespondencës së tyre me kompanitë në përgatitje të Raportit EITI pasardhës, i cili mbulon 2016. Disa gazetarë theksuan se një numër i madh licensash minerare dukej të ishin akorduar me shpejtësi rekord në periudhën përpara zgjedhjeve të vitit 2013 dhe se e konsideronin këtë një pasqyrim të devijimeve nga rregullat statutores.

Licensat për naftë dhe gaz: Konsultime të gjera treguan se nuk kishte pasur transferime të licensave në naftë dhe gaz apo ndryshime në strukturën pronësore të konsorciumeve PSA në vitin 2015. Për sa i përket akordimit të licensave për naftë dhe gaz, një zyrtar qeveritar vërejti se një konsorcium i Shell dhe Petromanas kishin marrë një licensë eksplorimi për naftë dhe gaz onshore në korrik 2015 (Blloku D), për të cilën ka të dhëna në media (World Oil, 2015). Një tjetër përfaqësues qeveritar vërejti se nuk kishte pasur ndonjë akordim të ri apo transferim të ndonjë PSA në të cilën Albpetrol kishte marrë pjesë në vitin 2015.

Në lidhje me devijime jo të vogla nga procedurat e akordimit dhe transferimit të licensave në praktikë, shumica e përfaqësuesve të konsultuar shprehën konfuzion lidhur me dallimin midis transferimit të një licensë midis dy kompanive dhe blerjes së një kompanie (dhe asetëve të saj, përfshi licensat) nga një tjetër. Një numër përfaqësuesish nga shoqëria civile dhe të partnerëve të zhvillimit shprehën shqetësim

lidhur me pretendimet për akordime discrecionare të licensave dhe PSA-ve për naftë dhe gaz. Megjithatë, nuk u ngrit ndonjë pretendim specifik lidhur me licensën e vetme për naftë dhe gaz të akorduar në vitin 2015. Një anëtar nga OSHC në MSG mendonte se kishte pasur raste të rinegociatave për një PSA me AKBN pasi kishte qenë akorduar fillimisht, duke theksuar se të tilla ndryshime nuk mbuloheshin nga ligji, por nuk paraqiti shembuj specifikë të rasteve të tilla, edhe në periudha jashtë vitit që shqyrtohej (2015). Një numër partnerësh zhvillimi shprehën shqetësim për faktin që PSA-të për naftë dhe gaz asnjëherë nuk ishin akorduar nëpërmjet tenderimit konkurrues dhe se mbështetja tek negociatat e drejtpërdrejta linte hapësirë për diskrecion të tepërt. Ndërkohë që qeveria ishte përpjekur të zhvillonte një tender në vitin 2015, mungesa e interesit nga ofertues nënkuptonte se tenderi ishte i pasuksesshëm dhe se licensat në fund u akorduan me anë të negociatave të drejtpërdrejta sipas këtyre përfaqësuesve. Një përfaqësues zhvillimi shpjegoi se një nga fushat ku do të përqendrohej asistenca teknike që planifikonte Departamenti i Shtetit i SHBA do të ishte që licensat dhe PSA-të të mos akordoheshin më me anë të negociatave të drejtpërdrejta dhe se do të akordoheshin vetëm nëpërmjet tenderimit konkurrues.

Pas diskutimeve lidhur me periudhën e gjatë për përfundimin e negociatave për PSA-të (eventualisht konkluduar në 2016), AP vërejti se një përfaqësues i MSG nga MEI kishte shpjeguar se negociatat ishin zgjatur kur ofertuesit kishin humbur interes për shkak të rënies në çmimet ndërkombëtare të naftës. Pasi theksoi se nuk kishte marrë input nga ndonjë anëtar tjetër në MSG edhe pse e kishte ngritur këtë çështje, AP pohoi se nuk i kishte kontaktuar kompanitë e përfshira në këto negociata si pjesë e përgatitjes së Raportit EITI 2015 por se kishte në plan të kontaktonte përfaqësuesit e këtyre kompanive për të vlerësuar ndonjë devijim jo të vogël gjatë përgatitjes së Raportit EITI pasardhës, i cili mbulon vitin 2016.

Transferimi i licensave: AP dhe një përfaqësues i qeverisë shpjeguan se Ligjet për Minierat dhe Hidrokarburet nuk lejonin transferimin (apo shitjen) e licensave minerare, për naftë dhe gaz të akorduara me anë të tenderimit konkurrues, dmth licensat minerare akorduar pas vitit 2007. Për licensat minerare akorduar përpara vitit 2007, një zyrtar qeveritar shpjegoi se licensa mund të transferohej midis dy kompanive, në varësi të faktit nëse kompania plotësonte kriteret teknike dhe financiare fillestare për akordimin fillestar të licensës dhe vetëm me miratim formal nga MEI. Në rastet kur kompania përpiqej të shiste interesin e vet në një operacion minierar, naftë apo gaz, transaksioni prapë i nënshtrohej miratimit të MEI-t nëse partnerët apo aksionerët e rinj plotësonin kriteret teknike dhe financiare të akordimit fillestar të licensës. AP konfirmoi se të tilla kërkesa mbulonin vetëm shkrirjet dhe blerjet mes kompanie të incorporated në Shqipëri duke qenë se autoritetet shqiptare nuk kishin kapacitetet për të ndjekur transaksione të ekzekutuara tërësisht offshore (p.sh. transaksione midis dy korporatave offshore).

Vlerësim fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Ndërkohë që Raporti EITI 2015 ofron një listë të licensave minerare akorduar në vitin 2015, dhe nënkupton se nuk ishin akorduar licensa të reja për naftë dhe gaz gjatë vitit 2015, ai përshkruan vetëm procesin ligjor të akordimit të licensave, përfshi kriteret teknike dhe financiare, por jo ndonjë devijim në praktikë. Ka të dhëna për akordimin e një license naftë dhe gazi në korrik 2015. Procesi për transferimin e licensave përshkruhet për sektorin e naftës dhe gazit, por jo për minierat, dhe raporti nuk deklaron qartë nëse ndonjë licensë minerare, naftë dhe gazi ishin transferuar gjatë vitit në shqyrtim. Duke pasur parasysh faktin që licensat minerare ishin akorduar me anë të tenderimit, duhet të

ishte bërë publike lista e tenderuesve të pasuksesshëm dhe kriteret e ofertimit për çdo raund.

Në përputhje me kërkesën 2.2a, MSG duhet të sigurojë publikim vjetor se cilat licenca minerare, naftë dhe gazit ishin akorduar dhe transferuar në vitin(-et) në shqyrtim, duke theksuar kërkesat teknike dhe financiare si dhe ndonjë devijim jo të vogël nga kuadri përkatës ligjor dhe rregullator që qeveris akordimin dhe transferimin e licensave.

Regjistrat e licensave (#2.3)

Dokumentimi i përparimit

Licensa të kompanive materiale: Duke qenë se të gjitha kompanitë e naftës dhe gazit që operojnë në Shqipëri ishin përfshirë në Raportin EITI 2015, të gjitha licensat për naftë dhe gaz mbahen nga kompanitë materiale. Tabela 4 paraqet një listë të nëntë kompanive të naftës dhe gazit (përfshi shtetëroren Albpetrol) dhe një listë të fushave naftëmbajtëse përkatëse, përfshi datat e marrëveshjeve të licensave (Raporti EITI 2015, f. 29). Shtojca 8 ofron një listë të 62 licensave minerare akorduar nëpërmjet tenderimit konkurrues në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 142-144), por Raporti EITI 2015 nuk ofron një listë të të gjitha licensave që kanë kompanitë materiale, akorduar në periudhat përpara vitit 2015. Raporti paraqet një vështrim të përgjithshëm të regjistrave publikë të MEI-t për licensat minerare, të naftës dhe gazit, si dhe një link⁴⁶ për tek një listë PDG e licensave në faqen e internetit të MEI-t (Raporti EITI 2015, f. 101-102), ndonëse ka boshllëqe në paraqitjen e datave të aplikimit dhe koordinatat e licensave në kadastrë. Gjithashtu, raporti pohon se regjistri i licensave të naftës dhe gazit “nuk është përditësuar që të tregojë ndryshime/shitje aksionesh dhe transferime të operacioneve në sektor” (Raporti EITI 2015, f.102). Megjithatë, faqja e internetit AlbEITI ofron dy lista përfshirëse licensash, të cilat mbulojnë minierat⁴⁷ dhe naftën dhe gazin,⁴⁸ edhe pse lista e licensave minerare ishte përditësuar së fundi më 3 nëntor 2015. Raporti EITI 2015 nuk i referohet listës së licensave që gjenden në faqen e internetit të AlbEITI. Bazuar në një krahasim të licensave minerare të renditura në faqet e internetit të AlbEITI⁴⁹ dhe MEI⁵⁰, duket se 12 licensat minerare ishin akorduar në periudhën 3 nëntor – 31 dhjetor 2015.

Emrat e licensë-mbajtësve: Për naftën dhe gazin, Tabela 4 ofron një listë të nëntë kompanive të naftës dhe gazit (përfshi Albpetrol) dhe një listë të fushave të tyre naftëmbajtëse (Raporti EITI 2015, f. 29). Seksioni 11.3.5 konfirmon se kadastra e MEI-t ofron emrat e licensë-mbajtësve për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2015, f. 101-102). Informacioni mbi gjashtë PSA-të e nënshkruara me Albpetrolin në Shtojcën 5 (Raporti EITI 2015, f. 139), katër PSA-të e nënshkruara me AKBN në Shtojcën 6 (Raporti EITI 2015, f. 140) dhe 24 blloqet e eksplorimit në Shtojcën 7 (Raporti EITI 2015, f. 141) përfshin emrin e kompanisë kontraktuese. Në miniera, shqyrtimi i kadastrës për licensat minerare të MEI-t në Seksionin 11.3.5

⁴⁶ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

⁴⁷ <http://www.albeiti.org/mining-register/>

⁴⁸ <http://www.albeiti.org/petroleum-licenses/>

⁴⁹ <http://www.albeiti.org/mining-register/>

⁵⁰ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

konfirmon se emrat e licensë-mbajtësve janë përfshirë dhe ofron një link⁵¹ për tek një listë PDF e licensave në faqen e internetit të MEI-t (Raporti EITI 2015, f.101-102). Lista e 62 licensave minerare akorduar nëpërmjet tenderimit konkurues në vitin 2015 në Shtojcën 8 po ashtu përfshin emrat e licensë-mbajtësve (Raporti EITI 2015, f.142-144).

Koordinatat e licensave: Raporti EITI 2015 pohon se koordinatat për licensat minerare, naftën dhe gazin nuk janë në dispozicion publik me anë të kadastrës MEI (Raporti EITI 2015, f. 101-102,162-163). Megjithatë, koordinatat për të gjitha licensat minerare akorduar përpara 3 nëntorit 2015 gjenden në faqen e internetit AlbEITI,⁵² ndonëse për vetëm katër licensa naftë dhe gazi.⁵³ Kjo nënkupton se koordinata ekzistojnë për të gjitha licensat minerare përveç 12 licensave minerare që ishin akorduar pas nëntorit 2015, por jo për licensat për naftën dhe gazin.

Datat: Vështrimi i Raportit EITI 2015 mbi kadastrën e licensave të MEI-t pohon se janë dhënë datat e akordimit dhe kohëzgjatja e çdo licensë minerare, naftë dhe gazi, por që datat e aplikimit nuk janë dhënë (Raporti EITI 2015, f. 101-102). Informacioni mbi të gjitha PSC-të për naftën dhe gazin në Raportin EITI 2015 përfshin datat e marrëveshjes për licensën për secilën PSC për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2015, f. 29, 139-140). Raporti shpjegon se datat e aplikimit janë në dispozicion për të gjitha licensat për naftën dhe gazin të akorduara nga viti 2015 e më pas, por jo për ato të akorduara përpara vitit 2015 (Raporti EITI 2015, f. 162). Lista e 62 licensave minerare akorduar në vitin 2015 në Shtojcën 8 përfshin datën e akordimit dhe kohëzgjatjen, por datën e aplikimit për vetëm 33 prej tyre (Raporti EITI 2015, f. 142-144). Raporti konfirmon se MEI nuk publikon informacion mbi datat e aplikimit për licensat minerare (Raporti EITI 2015, f. 162).

Mallrat: Informacioni në Raportin EITI 2015 mbi kadastrën e licensave të MEI-t konfirmon se përfshin >>mallin(-rat) që mbulohen (Raporti EITI 2015, f. 101-102). Megjithatë, raporti po ashtu pohon se ndërkohë që MEI ofron informacion mbi mallin(-rat) e mbuluar nga licensat minerare, ai nuk specifikon listën e plotë të mineraleve që mbulohen nga çdo mall, as përqendrimin e tyre (Raporti EITI 2015, f. 163). Informacioni mbi licensat për naftën dhe gazin në raport tregon se PSC-të mbulojnë si naftën bruto ashtu edhe gazin natyror (Raporti EITI 2015, f. 29, 139-140). Raporti ofron numrin e licensave minerare në prodhim, të ndarë sipas secilit prej gjashtë grupeve të përgjithshme të mineraleve (Raporti EITI 2015, f. 41). Lista e 62 licensave minerare akorduar në vitin 2015 në Shtojcën 8 specifikon mallin e mbuluar për secilën (Raporti EITI 2015, f. 142-144).

Licensat që i kanë kompanitë jomateriale: Raporti EITI 2015 i referohet regjistrin të licensave minerare në faqen e internetit të MEI-t (Raporti EITI 2015, f. 101-102), ku gjendet informacion mbi të gjithat 626 licensat minerare aktive deri në vitin 2016. Kjo nënkupton se informacioni ofrohet për licensat minerare aktive në Shqipëri, pavarësisht nga materialiteti. Për naftën dhe gazin, duket se informacion për dhjetë

⁵¹ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

⁵² <http://www.albeiti.org/mining-register/>

⁵³ <http://www.albeiti.org/petroleum-licenses/>

PSA-të dhe 24 licencat e kërkimit përfaqëson të gjitha licencat dhe PSA-të aktive në vitin 2015.

Regjistri publik: Shqyrtimi i regjistrave të aksesueshme publikisht të MEI-t për licencat minerare, të naftës dhe gazit, i cili përfshin një link⁵⁴ për në listën PDF të licensave, thekson boshllëqet në ofrimin e datave të licensave dhe koordinatave në regjistër (Raporti EITI 2015, f. 101-102, 162-163). Gjithashtu, deklaroi se regjistri i licensave të naftës dhe gazit “nuk është përditësuar për të ndryshuar shitjet e aksioneve dhe transferimin e operacioneve në sektor” dhe se regjistri aktual i MEI-t është shënuar si i përditësuar së fundi në shkurt 2016 (Raporti EITI 2015, f. 102). Raporti EITI 2015 nuk shqyrton regjistrin e licensave minerare, të naftës dhe gazit në faqen e internetit të AlbEITI.

Raporti EITI 2013-14 ofron informacion mbi të gjitha PSA-të për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2013-14, f.31), të gjitha 626 licencat minerare aktive (Raporti EITI 2013-14, f.170-260) dhe të gjitha 177 koncesionet hidroenergjitike (Raporti 2013-14, f.263-271). Informacioni mbi licencat minerare përfshinte shumicën e informacionit të kërkuar sipas Kërkesës 2.3, përfshi koordinatat për licencat në shtojcë, mallin (mallrat) e mbuluara, përveç datave të aplikimit. Megjithatë, koordinatat për licencat mungonin për të gjitha PSA-të e naftës dhe gazit.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Raporti i Eurosupport i janarit 2017 thekson mungesën e ofrimit të koordinatave të licensave, datat e aplikimit, kohëzgjatjen e licensave apo mallrat e mbuluara në informacionin për licencat ofruar në faqen e internetit të MEI-t⁵⁵ (Eurosupport, 2017).

Minierat: Personeli i sekretariatit shpjegoi se informacioni mbi licencat minerare në faqen e internetit të AlbEITI e kishte burimin nga AKBN dhe shprehën pasiguri lidhur me arsyet për ndonjë mospërputhje midis informacionit në faqet e internetit të AlbEITI-t dhe të MEI-t. Personeli i sekretariatit theksoi se datat e aplikimit për shumicën e licensave minerare ishte në dispozicion në faqen e AlbEITI, por se këto të data nuk ishin në dispozicion për licencat më të vjetra duke pasur parasysh mungesat në sistemet e menaxhimit të të dhënave të qeverisë. Një përfaqësues i qeverisë vërejti se datat e aplikimit për të gjitha licencat minerare ishin në dispozicion nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit por ngriti pikëpyetje për vlerën e përfshirjes së tyre në Raportin EITI, duke menduar se datat e aplikimit ishin përtej fushës së raportimit të EITI.

Raporti i Eurosupport nga janari 2017 vërente se koordinatat e licensave janë në dispozicion për të gjitha licencat minerare nëpërmjet Regjistrimit Kombëtar të QKL për Licencat dhe Lejet⁵⁶ (Eurosupport, 2017). Megjithatë, kjo faqe interneti kërkon regjistrim dhe Sekretariati Ndërkombëtar nuk ishte në gjendje të krijonte një profil për të siguruar akses, pavarësisht përpjekjesh të përsëritura. Përfaqësues të ndryshëm të qeverisë shpjeguan se koordinatat për licencat ishin publikuar gjatë tenderave konkurrues, por se këto

⁵⁴ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

⁵⁵ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/minierat2/2016/RREGJ_LEJEVE_SHKURT_2016_Aktive.pdf

⁵⁶ <http://www.qkl.gov.al/Regjistrimes.aspx>

ishin hequr nga faqja e internetit e MEI-t pasi raundi i ofertimit kishte përfunduar. Një partner zhvillimi vërejti disa raste licensash minerare të mbivendosura dhe mendonte se ky problem vinte nga fakti që koordinatat për licensat minerare nuk ishin gjithmonë të qarta dhe në dispozicion të kujtdo.

Raporti Eurosupport i janarit 2017 rekomandon që MEI të japë informacion mbi mallrat të mbuluara nga licensat dhe që AKBN të përditësojë regjistrin e lejeve minerare çdo tre muaj, në të njëjtën kohë kur përgatit raportin tremujor mbi prodhimin dhe investimet minerare (Eurosupport, 2017).

Nafta dhe gazi: Personeli i sekretariatit shpjegoi se datat e aplikimit për licensat për naftën dhe gazin nuk ishin në dispozicion të publikut dhe se përpjekjet për t'i siguruar këto data nga MEI, AKBN dhe Albpetrol deri tani kishin qenë të pasuksesshme. Personeli theksoi shqetësime mbi cilësinë e të dhënave të mbajtura nga qeveria. Një zyrtar qeveritar pohoi se nuk duhet të ketë pengesa që AlbEITI t'i sigurojë datat e aplikimit për të gjitha licensat e naftës dhe gazit nga MEI por ngriti pikëpyetje për rëndësinë e këtyre datave, për shkak të konceptit të tij se kjo ishte përtej fushës së raportimit EITI. Një tjetër përfaqësues qeveritar pohoi se AKBN kishte vetëm datat për akordimin e PSA-ve dhe nuk kishte datat e aplikimit. Formularni i aplikimit⁵⁷ për licensat për kërkim dhe prodhim naftë dhe gazi në faqen e internetit të MEI-t përfshin datën e aplikimit.

Në lidhje me koordinatat për licensat për naftën dhe gazin, personeli i sekretariatit shpjegoi se faqja e internetit e AlbEITI-t ofronte koordinatat vetëm për katër PSA që në fakt prodhonin naftë dhe gaz por jo për të tjera. AlbEITI kishte kërkuar koordinatat e PSA-ve që mbante AKBN nga agjencia por nuk i kishte marrë ato. Një përfaqësues qeveritar konfirmoi se koordinatat për licensat për naftën dhe gazin që ishin ofruar për tenderim konkurues ishin botuar në faqen e internetit të MEI-t gjatë periudhës së ofertimit, por më pas ishin hequr prej aty.

Reforma: Personeli i sekretariatit dhe AP theksuan dy reforma të rëndësishme që lidheshin me menaxhimin e sistemeve të regjistrimit mineral, të naftës dhe gazit. I pari, përmendur në Raportin EITI 2015, lidhej me ngritjen nga AKBN nga të një sistemi GIS, ndërsa i dyti, i cili nuk përmendej në raport, lidhej me krijimin e një sistemi hartëzimi të integruar për përdorimn e tokës nga Autoriteti Shtetëror për informacionin Gjeohapësinor.⁵⁸

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përbushjes së kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 ofron një link për regjistrin publik për licensat minerare, të naftës dhe gazit, ndonëse ka boshllëqe në ofrimin publik të datave të aplikimit dhe koordinatave për disa licensa minerare, naftë dhe gazi.

⁵⁷ http://www.energija.gov.al/files/userfiles/2017/Aplication_form_EN.pdf

⁵⁸ <http://geoportal.asig.gov.al/en/Default.aspx?AspxAutoDetectCookieSupport=1>

Në përputhje me kërkesën 2.3.b, Shqipëria duhet të sigurohet që datat e aplikimit, akordimit dhe skadimit, mallin/mallrat e mbuluara dhe koordinatat për të gjitha licensat e naftës, gazit dhe ato minerare që kanë kompanitë materiale të jenë të aksesueshme publikisht, në linjë me rekomandimet e kaluara nga AlbEITI. Qeveria nxitet ta vëjë këtë informacion në dispozicion për licensat që kanë të gjitha kompanitë, pavarësisht nga materiality i tyre.

Publikimi i kontratave (#2.4)

Dokumentimi i përparimit

Politika qeveritare: Raporti EITI 2015 sqaron politikën e qeverisë mbi publikimet e kontratave të naftës dhe gazit nëpërmjet informacionit nga Z. Dritan Spahiu, Drejtor në MEI për Zhvillimin e Politikave në Sektorin e Naftës së ministria “nuk do të ishte në favor të aksesit publik në PSA-të me qëllim që të mos ndikonte termat e negociatave të ardhshme për PSA-të” (Raporti EITI 2015, f.26) dhe se kushtet e detajuara të PSA-ve të nënshkruara konsiderohen konfidenciale dhe aktualisht nuk bëhen publike. Raporti nuk sqaron politikën e qeverisë lidhur me publikimin e kontratave në sektorin minerar.

Praktika faktike: Raporti EITI 2015 pohon se asnjë kontratë PSA nuk është publikuar ende (Raporti EITI 2015, f. 26). Raporti pohon se qeveria kishte publikuar vendimin e Këshillit të Ministrave për akordimin e PSA për eksplorim onshore në bllokun 8 për Albanides Energy në fletoren zyrtare 63/2016 (Raporti EITI 2015, f.163), edhe pse teksti i plotë i PSA-së nuk ishte publikuar. Ka të dhëna se të paktën dhjetë PSA nafte dhe gazi janë publikuar në portalin e Kontratave Burimore të NRGJ.⁵⁹

Aksesueshmëria: Raporti nuk ofron udhëzime lidhur me aksesimin e ndonjë license minerare, nafte dhe gazi, duke pohuar se asnjë PSA nuk ishte publikuar ende.

Raporti EITI 2013-14 përshkruante dispozitat e konfidencialitetit të PSA-ve, licensave minerare dhe marrëveshjeve koncesionare, por po ashtu nuk sqaronte politikën e qeverisë mbi publikimin e kontratave (Raporti EITI 2013-14, f.22-23).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Politika: Ndërkohë që kishte konsensus mes grupeve të interesit të konsultuar se politika e qeverisë ishte të mos publikonte PSA-të për naftën dhe gazin duke pasur parasysh dispozitat për konfidencialitetin në kontrata, kishte pikëpamje të ndryshme lidhur me faktin nëse kontratat minerare duheshin publikuar. AP dhe një numër përfaqësuesish të qeverisë dhe industrisë konfirmuan se dispozitat për konfidencialitetin në PSA-të mbulonin të gjithë kontratën, dhe jo klauzola specifike, dhe se këto mund të shkeleshin vetëm me pëlqimin e të dyja palëve të kontratës. Megjithatë, personeli i sekretariatit theksoi dallimin midis mosqenies së qeverisë në gjendje për të publikuar kontratat për shkak të dispozitave të konfidencialitetit

⁵⁹ <http://resourcecontracts.org/search?q=albania>

dhe politikës së qeverisë për të mos publikuar kontratat. Personeli vërejti se qeveria kurrë nuk kishte pohuar se ishte kundër publikimit të kontratave dhe se avokatë të caktuar mendonin se qeveria mund të përdorte prerogativën e vet sovraane për të shkelur klauzolat e konfidencialitetit të një kontrate. Megjithatë, një zyrtar i lartë qeveritar theksoi një numër rastesh kur qeveria kishte humbur çështje të ngritura nga kompanitë në arbitrazh ndërkombëtar dhe shpjegoi se qeverisë i duhej të ecte me kujdes për çështje të tilla. Një anëtar i OSHC në MSG shpjegoi se shoqëria civile kishte kërkuar akses në tekstin e plotë të kontratave minerare, të naftës dhe gazit gjatë përgatitjes së Raportit EITI 2013-14 me qëllim që të vlerësonte ekzistencën e shpenzimeve të detyrueshme sociale. Kishte pikëpamje të ndryshme lidhur me nëse edhe kontratat minerare përmbanin klauzola konfidencialiteti. Ndërkohë që një përfaqësues i qeverisë shpjegoi se kontratat minerare në fakt i përfshinin klauzola të tilla, AP vërejti se nuk ishte në gjendje të konfirmonte nëse të tilla klauzola konfidencialiteti ekzistonin vërtet për shkak se asnjëherë nuk kishte pasur akses në një kontratë minerare.

Praktikat: AP shpjegoi se ishte në dijeni të disponueshmërisë publike të këtyre kontratave, por vërejti se nuk kishte marrë ndonjë shpjegim për praninë e tyre online nga MEI apo kompanitë e naftës që raportonin pavarësisht se ua kishte theksuar këtë çështje atyre gjatë përgatitjes së Raportit EITI 2015. AP vërejti synimin e vet për të pyetur NRCI nëse palët kontraktuese e kishin miratuar publikimin e këtyre kontratave, gjatë përgatitjes për Raportin EITI pasardhës. Kishte interes të madh nga të gjithë përfaqësuesit e shoqërisë civile, medias dhe qeverisë vendore të konsultuar për të siguruar akses në tekstin e plotë të PSA-ve si mjet për të monitoruar respektimin e detyrimeve kontraktuale nga ana e kompanive. Shembulli i cituar më shpesh ishte ai i PSA-së së vitit 2004 me Bankers Petroleum, i cili nuk ishte në dispozicion në në faqen e internetit të Kontratave Burimore (edhe pse dy amendamentet e saj ishin).

Raporti i Eurosupport nga janari 2017 pohon se lejet minerare publikohen përveç ndonjë të dhëne të lidhur me projektin. Kontratat minerare, miratuar nga Parlamenti në linjë me Nenin 16 të Ligjit 10304, botohen në Fletoren Zyrtare,⁶⁰ duke lënë jashtë ndonjë të dhënë konfidenciale projekti. Kushtet kryesore të koncesioneve minerare po ashtu supozohet të jenë në dispozicion nga Regjistri i Koncesioneve i Agjencisë së Koncesioneve, edhe pse raporti pohon se regjistri nuk është krijuar ende. Raporti vëren se nuk ka kërkesë në Ligjin 145/2013 për të publikuar tekstin e plotë të koncesioneve minerare, por se koncesionet kryesore minerare janë miratuar nga Parlamenti dhe për pasojë janë publikuar. (Eurosupport, 2017).

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 sqaron politikën e qeverisë mbi publikimet e kontratave në sektorin e naftës dhe gazit, por jo atë minerar. Raporti nuk komenton praktikën faktike të publikimit të kontratave pavarësisht se përfaqësues të grupeve të interesit ishin në dijeni të faktit se disa kontrata ishin

⁶⁰ <http://www.qbz.gov.al>

në lëmin publik.

Në përputhje me kërkesën 2.4.b, Shqipërisë i kërkohet të dokumentojë në Raportet EITI të ardhshme politikën e qeverisë lidhur me publikimin e kontratave dhe licensave që qeverisin eksplorimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Kjo duhet të përfshijë dispozitat përkatëse ligjore, çfarëdo reformash të planifikuara ose në proces si dhe një vështrim të përgjithshëm të kontratave tashmë të publikuara.

Publikimi i pronësisë reale (#2.5)

Dokumentimi i përparimit

Politika e qeverisë: Raporti EITI 2015 nuk sqaron politikën e qeverisë lidhur me publikimin e pronësisë reale në kompanitë nxjerrëse.

Praktika faktike: Raporti EITI 2015 pohon se Ministria (besojmë MEI) nuk mban një regjistër që radhit të gjithë pronarët realë dhe aksionet e tyre (Raporti EITI 2015, f. 78). Raporti i Eurosupport janar 2017 ofron një vështrim mbi ligjet përkatëse me pronësinë reale në Shqipëri dhe thekson konfuzion midis pronësisë ligjore dhe reale në aplikimin e ligjeve të caktuara që lidhen me licensat nxjerrëse (Eurosupport, 2017). Raporti EITI 2015 përshkruan përjasjen ndaj publikimeve të pronësisë reale përdorur për Raportin EITI 2015, me formularë raportimi që përfshijnë kërkesa për informacion lidhur me pronësinë reale nga kompanitë raportuese (Raporti EITI 2015, f. 78). Nga 134 kompani raportuese, vetëm 31 kanë ofruar informacion lidhur me PR (pronësinë reale) dhe raporti vëren se “përfaqësues të enteve raportuese komentuan se nuk ishin në gjendje apo të autorizuar për ta ofruar këtë informacion” (Raporti EITI 2015, f. 78). Raporti vjetor i progresit 2016 ofron shpjegim të mëtejshëm për mungesën e raportimit lidhur me pronësinë reale të kompanive, duke vërejtur se kompanitë “nuk ishin gati për këtë lloj raportimi” dhe se shumica e kompanive nuk ofruan informacionin e kërkuar duke pasur konceptin se i gjithë informacioni përkatës mbi pronësinë reale ishte tashmë në dispozicion nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe “një numër i madh kompanish” shpreheshin se nuk kishin informacion të hollësishëm lidhur me zinxhirin e plotë të pronësisë korporative. Ndërsa 17 kompanitë që në fakt raportuan informacion mbi pronësinë ofruan të njëjtët pronarë si ata të regjistruar në QKR (Alb-EITI, 2017).

Raporti i Eurosupport i janarit 2017 shqyrton dispozitat e Ligjit nr. 9917, miratuar më 19 maj 2008 për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe bën thirrje për shtrirjen e këtyre termave tek kompanitë që punojnë në industrinë nxjerrëse. Raporti ofron një listë ligjesh⁶¹ që kërkojnë rishikim dhe amendim të mundshëm në kontekstin e punës së AlbEITI lidhur me pronësinë reale (Eurosupport, 2017).

⁶¹ Ligji Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Mbi tregtarët dhe kompanitë tregtare;" Ligji nr. 9723/2007 "Mbi qendrën kombëtare të regjistrimit." Ligji Nr. 9917, datë 19.5.2008 "Mbi parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;" Ligji Nr. 9367, datë 7.4.2005 "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike;" Ligji Nr. 9049, datë 10.4.2003 "Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të zyrtarëve të zgjedhur dhe disa zyrtarëve publikë;" Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 10,279, datë 20.5.2010 "Mbi kundravajtjet administrative."

Raporti po ashtu vëren se pronësia reale e kompanive që zotërojnë licenca publikohet në aktin e miratimit për çdo licensë minerare, edhe pse pranon se pronarët realë shpesh identifikohen si kompani dhe jo si persona fizikë. Raporti thekson se “Regjistri Tregtar” (QKR), bazuar në dispozitat e Ligjeve 9901/2008 dhe 9723/2007, ofron të dhëna për themeluesit e secilës kompani ose tregtar individual, por se ky informacion përfshin kompani në vend të personave fizikë në disa raste (Eurosupport, 2017).

Për sa i përket reformave, Raporti EITI 2015 thekson se AlbEITI ndërmori “legal due diligence” për të dakordësuar një plan për publikimet e pronësisë reale deri në janar 2017, filloi hartimin e ndryshimeve rregullatori dhe “kërkoi nga entet raportuese për të siguruar komentet e tyre lidhur me gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar” (Raporti EITI 2015, f.78).

Plani tre-vjeçar i Shqipërisë për pronësinë reale⁶² (deri në vitin 2020) ofron një përshkrim të legjisllacionit shqiptar që lidhet me pronësinë reale për të ndihmuar me identifikimin e ligjeve dhe rregulloreve që mund të kërkojnë amendime dhe për të identifikuar hapat e mëtejshëm në harmonizimin e rregulloreve të brendshme me Direktivat e BE-së lidhur me publikimin e pronësisë reale. Plani parashikon ngritjen e një regjistri publik për pronësinë reale në vitin 2018, i cili potencialisht mund të integrohej me bazat ekzistuese të të dhënave për regjistrat korporativë. Ndërkohë që plani nuk identifikon shtëpinë institucionale për një regjistër publik të pronësisë reale, ai planifikon konsultime të gjera për të identifikuar shtëpinë institucionale më të përshtatshme (dhe përmend Ministrinë e Financës, Energjisë dhe Drejtësisë si shtëpi të mundshme). Kostot totale të zbatimit të planit tre-vjeçar janë përcaktuar 415,000 USD.

Pronarët ligjorë të kompanive materiale: Raporti pohon se Qendra Kombëtare e Regjistrimit⁶³ ofron informacion mbi aksionerët dhe aktivitetin e të gjitha kompanive që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri (Raporti EITI 2015, f. 78). Sekretariati Ndërkombëtar konfirmoi se pronarët ligjorë të të gjitha kompanive materiale janë në dispozicion në faqen e internetit të QKR.⁶⁴ Raporti EITI 2015 po ashtu përshkruan ndryshimet në pronësinë ligjore të Bankers Petroleum në vitin 2016 (Raporti EITI 2015, f.31).

Raporti EITI 2013-14 po ashtu përshkruan mungesën e MEI-t të një regjistri të pronarëve realë të kompanive nxjerrëse që nuk ishin renditur në burse, por vëren se informacioni mbi pronarët ligjorë të të gjitha korporatave në Shqipëri është në dispozicion nga QKR⁶⁵ (Raporti EITI 2013-14, f.72).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP shpjegoi se kishte ndërmarrë konsultime me anëtarët e qeverisë në MSG si dhe përfaqësues të MEI-t lidhur me politikën e qeverisë mbi publikimin e pronësisë reale, por vërejti pasigurinë e vet në lidhje me

⁶² <https://eiti.org/sites/default/files/documents/bo-roadmap-albania.pdf>

⁶³ <http://www.qkr.gov.al>

⁶⁴ <http://www.qkr.gov.al/search/search-in-trade-register/search-for-subject/>

⁶⁵ <http://www.qkr.gov.al/nrc/default1.aspx>

nëse anëtarët e MSG e kuptonin shtrirjen e plotë të punës së planifikuar në planin tre-vjeçar të Shqipërisë për pronësinë reale. Disa përfaqësues të grupeve të interesit që parapëlqyen të mos identifikoheshin theksuan përdorimin e aksionerëve të emëruar në disa raste, çka fshihte pronësinë reale fundore të kompanive të caktuara. AP vërejti se ishte një kërkesë ligjore që të gjitha kompanitë e regjistruara në Shqipëri të njoftonin QKR lidhur me ndonjë ndryshim në pronësinë ligjore brenda 15 ditësh nga fakti.

Një numër përfaqësuesish të shoqërisë civile, medias dhe qeverisë si dhe AP theksuan dispozitat ligjore që iu kërkojnë Personave të Ekspozuar Politikisht (PEP) të plotësojnë publikime vjetore të aseteve pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Aseteve dhe Konfliktin e Interesit (ILDKPKI), edhe pse kishte mosmarrëveshje lidhur me faktin nëse këto deklarime ishin të aksesueshme nga publiku. Një numër aktorësh vërejtën se kishin parë deklaratimet e pasurive të PEP të caktuar në gazeta dhe në seksionin e “Transparencës” në faqet e internetit të qeverisë (të gjitha faqeve të qeverisë iu kërkohet të përfshijnë një seksion “Transparency” në faqen e tyre). Personeli i sekretariatit konfirmoi se AlbEITI nuk ishte interesuar pranë ILDKPI lidhur me deklaratat e pasurisë së PEP deri më sot. Sekretariati Ndërkombëtar konfirmoi se deklaratat e pasurisë nuk ishin të aksesueshme në faqen e ILDKPI por se deklaratat e pasurisë të disa PEP të nivelit të lartë dukeshin të ishin në dispozicion në faqet e internetit të një numri organesh qeveritare.

Disa përfaqësues të qeverisë mendonin se shtëpia e natyrshme institucionale për një regjistër publik të pronësisë reale do të ishte ose MEI ose AlbEITI vetë, ndonëse asnjë prej grupeve të interesit të konsultuar, përveç personelit të sekretariatit, dukej të kishin parë mundësinë që informacioni për pronësinë reale të mund të përfshihej në portalin e QKR.

Vlerësimi fillestar

Vendeve zbatuese nuk iu kërkohet ende të trajtojnë pronësinë reale dhe përparimi në këtë kërkesë nuk ka ende ndonjë implikim për statusin EITI të vendit. Raporti EITI 2015 nuk sqaron politikën e qeverisë lidhur me publikimin e pronësisë reale në kompanitë nxjerrëse por emrat e pronarëve ligjorë të të gjitha kompanive materiale janë në dispozicion publik në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të marrë në konsideratë pilotimin e raportimit mbi pronësinë reale në Raportin EITI të ardhshëm me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi lidhur me transparencën për pronësinë reale dhe të pilotohen përkufizimet dhe pragjet për pronësinë reale. AlbEITI po ashtu mund të dojë të kryejë punë më të gjerë informuese me kompanitë lidhur me objektivat e transparencës për pronësinë reale, si dhe të kryejë diskutime me agjencitë qeveritare mbi mënyrën për t'i bërë këto publikime të detyrueshme.

Pjesëmarrja e shtetit (#2.6)

Dokumentimi i përparimit

Materialiteti: Raporti EITI 2015 pohon se shteti merr pjesë në eksplorimin, zhvillimin dhe prodhimin e naftës me anë të “pronësisë së drejtpërdrejtë” të tij në Albpétrol (Raporti EITI 2015, f.10, 27, 135).

Shtojca 4 deklaron se Albpetrol u nda në tre NPSH në vitin 1999: Albpetrol Sh.a., ARMO Sh.a. dhe Servcom (Raporti EITI 2015, f.135). Ndërkohë që është e qartë nga rezultatet e rakordimit që pjesëmarrja e shtetit në sektorin e naftës dhe gazit çon në të ardhura materiale (nëpërmjet dividendëve të Albpetrolit), raporti nuk sqaron nëse shteti mban pjesë në ARMO ose në Servcom (dhe nëse një pjesë e tillë kishte çuar në të ardhura materiale në vitin 2015). Raporti EITI 2015 po ashtu sqaron se asnjë NPSH nuk ishte identifikuar të kryente aktivitetet në sektorin minerar (Raporti EITI 2015, f. 163).

Marrëdhënia financiare me qeverinë: Raporti EITI 2015 nuk shpjegon shprehimisht rregullat dhe praktikatat lidhur me të ardhurat, ri-investimet apo financimet e palëve të treta, edhe pse duket se Albpetrol operon si kompani sh.a (Joint Stock Company) (Raporti EITI 2015, f. 135). Raporti ofron një vështrim të përgjithshëm të qeverisjes së Albpetrolit (Raporti EITI 2015, f. 135-138) dhe të planeve për privatizimin e tij (Raporti EITI 2015, f.138). Raporti përshkruan rolin e Albpetrolit si i licensuar kryesor në të gjitha fushat naftëmbajtëse të zbuluara deri në vitin 1993 dhe akordimin prej tij të të drejtave tek kompanitë private të naftës (Raporti EITI 2015, f.10). Përkruhen të ardhurat e shoqëruara me pjesëmarrjen shtetërore në sektorin e naftës dhe gazit, me shtetin që ka të drejtë dividendësh nga rezultatet financiare vjetore të Albpetrolit si dhe të gjitha taksat e aplikueshme ndaj të gjitha kompanive tregtare të naftës dhe gazit, të tilla si tatimi mbi fitimin, renta, TVSH, etj. Raporti specifikon se nuk ka transferime të tjera tek qeveria veç dividendëve dhe taksave dhe tatimeve normale (Raporti EITI 2015, f.34).

Përkruhet procesi i shitjeve të naftës bruto të Albpetrolit⁶⁶ (Raporti EITI 2015, f.136). Nga diagrama e lëvizjeve të të ardhurave nga nafta dhe gazi është e qartë që Albpetrol merr një pjesë të prodhimit të naftës dhe bonuse nga kompanitë që operojnë me PSA (Raporti EITI 2015, f. 79) dhe se Albpetrol i paguan dividendë MZHESTS; rentë për eksportet tek Administrata Shqiptare e Doganave; shtatë taksa dhe tarifa⁶⁷ pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave; dhe taksa vendore (të paspecifikuara) tek qeveritë vendore (Raporti EITI 2015, f.80). Shtojca 4 paraqet informacion nga pasqyrat financiare vjetore të audituara të Albpetrolit për vitet 2012, 2013 dhe 2014 (Raporti EITI 2015, f.138).

Pronësia qeveritare: Raporti nuk ofron një vështrim të përgjithshëm tërësor të pjesës shtetërore në kompanitë që operojnë në industrinë nxjerrëse (sidomos naftë dhe gaz). Ndërkohë që raporti nuk deklaron shprehimisht se qeveria zotëron 100% të Albpetrolit, ai i referohet në mënyrë të përsëritur Albpetrolit si në pronësi të shtetit (p.sh. Raporti EITI 2015, f. 134). Raporti deklaron se Albpetrol mban të drejta ekskluzive eksplorimi dhe prodhimi mbi të gjitha fushat ekzistuese naftëmbajtëse dhe disa blloqe kërkimi dhe se është palë kontraktuese për të gjitha PSA prodhuese (Raporti EITI 2015, f. 27). Raporti deklaron se Albpetrol kishte aksione në PSA-të me pesë kompani që prodhonin naftë dhe gaz, por edhe administronte puset e veta në Ballsh, Patos dhe Kuçovë deri më 31 dhjetor 2015 (Raporti EITI 2015, f. 27, 135). Lista e gjashtë PSA-ve të nënshkruara nga Albpetrol jepet në Shtojcën 5 (Raporti EITI 2015, f. 139). Raporti ofron një vështrim të përgjithshëm të ARMO sh.a. si kompani rafinerimi fillimisht në pronësi

⁶⁶ referuar rregullave për ankandet publike përcaktuar në urdhrin nr. 83 të 10 tetorit 2012.

⁶⁷ Renta për shitje të brendshme; tatim fitimi; TVSH; sigurime shoqërore dhe shëndetësore; tatimi për të ardhurat personale; gjobat tatimore; tatimi për dividend.

shtetërore të themeluar në vitin 1999 dhe privatizuar 85% në gusht 2008 (Raporti EITI 2015, f.21). Pas shitjeve pasuese, pohonte se Heaney Asset Corporation tani ka kontroll efektiv nëpërmjet pronësisë së tërthortë të 68% të aksioneve të ARMO-s. Është e paqartë se kush zotëron 32% të aksioneve, as nëse qeveria vazhdon të ruajë 15% e vet prej gushtit 2008.

Themelimi i Operatorit Shqiptar të Transmetimit të Gazit (Albgaz Sh.a.) në vitin 2016 përmendet shkurtimisht (Raporti EITI 2015, f.13), edhe pse nuk thuhet pjesa e saktë e qeverisë në këtë kompani.

Ndryshimet e pronësisë: Raporti vetëm aludon ndryshime në pronësinë e qeverisë në vitet përpara 2015, por jo gjatë periudhës nën shqyrtim. Raporti pohon se Këshilli i Ministrave transferoi tetë blloqe eksplorimi⁶⁸ nga Albpetrol tek MEI, edhe pse jepen dy data të ndryshme për vendimin e Këshillit të Ministrave (prill 2014 në tekstin e plotë dhe 22 prill 2015 në shënimin në fund të faqes⁶⁹) (Raporti EITI 2015, f.138).

Hua dhe garanci: Ndërkohë që raporti përshkruan borxhin e grumbulluar nga ARMO (Raporti EITI 2015, f. 21-22), ai nuk specifikon pronësinë shtetërore të ARMO-s në vitin 2015 dhe as ndonjë hua apo garanci huaje nga shteti, ose ndonjë NPSH, tek ARMO. Më gjerësisht, Raporti EITI 2015 nuk i referohet ndonjë huaje apo garancie huaje ofruar nga qeveria, apo ndonjë NPSH si p.sh. Albpetroli, tek ndonjë kompani që punon në sektorin minerar, të naftës dhe gazit, edhe pse ofron fakte të zgjeruara lidhur me hua dhe garanci për kompani që operojnë në sektorin hidroenergjitik (Raporti EITI 2015, f.62,63).

Raporti EITI The 2013-14 sqaron se qeveria mbajti pjesën 15% në ARMO Sh.a. (Raporti EITI 2013-14, f.17) dhe përshkruan të njëjtin përshkrim të rregullave mbizotëruese lidhur me marrëdhëniet financiare midis qeverisë dhe NPSH-ve si në Raportin EITI 2015 (Raporti EITI 2013-14, f.24-28). Megjithatë, raporti nuk i referohet ndonjë huaje nga qeveria apo NPSH nxjerrëse për ndonjë kompani naftë, gazi dhe minerare, edhe pse i referohej në fakt huave të qeverisë ndaj kompanive në sektorin hidroenergjitik (Raporti EITI 2013-14, f.59-60).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Pronësia: Raporti Eurosupport i janarit 2017 konfirmonte se nuk kishte NPSH që operonin në sektorin minerar në Shqipëri (Eurosupport, 2017). AP konfirmoi se Albpetroli ishte e vetmja kompani që operonte në sektorin nxjerrës në të cilin qeveria kishte pjesë mbi 51% në vitin 2015, duke pasur parasysh se si Servcom ashtu dhe kompania minerare në pronësi shtetërore Albkrom më përpara kishin falimentuar. AP konfirmoi se AKBN nuk mund të konsiderohej një NPSH, pavarësisht statusit të saj si ent qeveritar gjysmë i pavarur. Raporti Eurosupport i janarit 2017 deklaroi se nuk ka NPSH aktive në sektorin minerar, por vëren se “ka disa kompani, aksionet e të cilave zotërohen 100% nga shteti, të tilla si kompania Albaker Sh.a., e cila është kompani në procedure likuidimi dhe nuk ushtron ndonjë aktivitet tregtar në sektorin minerar.”

⁶⁸ Dumre, Panaja, 1, 4, 5, 6, 8 and C exploration blocks.

⁶⁹ CMD no. 335, dated 22 April 2015 “On some changes to the CMD no. 279 dated 12 April 2012.”

Raporti i Tranzicionit i BERZH mbi Shqipërinë vëren se qeveria është përpjekur të shesë pjesën e saj të aksioneve prej 15% në ARMO prej vitit 2010 (BERZH, 2012). Megjithatë, AP dhe një numër përfaqësuesish të qeverisë dhe shoqërisë civile konfirmuan se qeveria mbante 15% të aksioneve në ARMO. Mes anëtarëve të MSG të konsultuar kishte konsensus se çështja nëse ARMO duhej konsideruar NPSH për qëllimet e raportimit EITI nuk ishte shqyrtuar nga MSG në përgatitjet për ndonjë nga Raportet EITI. Një anëtar i OSHC në MSG gjykonte se ARMO duhej kategorizuar si NPSH: ndërkohë që qeveria ruante ligjërisht 15% të aksioneve, investitori që kishte pjesën tjetër prej 85% ishte larguar nga vendi dhe meqenëse nuk mundej që ARMO të falimentonte (meqenëse përpunimi konsiderohej sektor strategjik kombëtar) qeveria në fakt ishte në kontroll.

Një numër zyrtarësh të qeverisë dhe AP konfirmuan se kishte pasur një ndryshim në entin e qeverisë që kishte aksionet e Albpetrolit, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS) në MEI si pjesë e “Paketës së Tretë të Energjisë” në vitin 2016. Megjithatë, këta zyrtarë konfirmuan se MZHETTS vazhdonte të mbante aksionet në ARMO.

Nga pikëpamja e ndryshimeve në pjesëmarrjen shtetërore në vitin në shqyrtim (2015), AP deklaroi se nuk kishte pasur ndryshim në pronësi, duke sqaruar se ndryshimet në pronësi përfaqësonin transaksionet nga shteti në sektorin privat. Megjithatë, një përfaqësues i qeverisë konfirmoi se transferimi i tetë blloqeve për eksplorim nga Albpetroli tek MEI kishte ndodhur në vitin 2015 dhe se referenca për vitin 2014 në Raportin EITI 2015 ishte gabim. Zyrtari shpjegoi se qeveria kishte transferuar nëntë blloqe tek Albpetroli përpara privatizimit të planifikuar, por më pas i kishte transferuar tetë nga këto blloqe mbrapsht tek MEI kur privatizimi kishte dalë i pasuksesshëm (në vitin 2015). Qeveria kishte lënë një bllok eksplorimi në zotërim të Albpetrolit meqenëse ishte në faza të avancuara studimi dhe priste të përfundonte një PSA për bllokun e eksplorimit në vitin 2017.

Marrëdhëniet financiare: Përfaqësues nga shoqëria civile dhe media shprehën shqetësime të mëdha lidhur me menaxhimin financiar të Albpetrolit dhe marrëdhëniet financiare midis NPSHve nxjerrëse dhe shtetit, edhe pse pa ndonjë pretendim specifik apo shembuj përveç pretendimeve për emërime politike në Bordin e Drejtorëve të Albpetrolit. Një numër partnerësh zhvillimi vërejtën pretendime të përsëritura lidhur me shkeljet financiare në Albpetrol në shtyp dhe një pjesë të shoqërisë civile, por vërejtën se nuk kishin dëgjuar ndonjë pretendim specifik gjatë viteve të fundit. AP shpjegoi se rregullat që qeverisin të ardhurat e Albpetrolit, ri-investimet dhe financimet e palëve të treta ishin sanksionuar në Nenet e Shoqërisë të kompanisë, por jo të sanksionuara në ndonjë ligj. AP konfirmoi se Albpetroli i nënshtrohet Ligjit për Sipërmarrësit dhe Kompanitë Tregtare dhe nuk përfiton nga ndonjë kusht “i posaçëm,” të cilat AP i konfirmoi nëpërmjet pasqyrave financiare të Albpetrolit dhe konsultimet me një përfaqësues të MSG që është në Bordin e Drejtorëve të Albpetrolit dhe drejtuesit e Albpetrolit. Një numër anëtarësh nga OSHC në MSG vërejtën se shoqëria civile e kishte ngritur çështjen e menaxhimit financiar të Albpetrolit gjatë përgatitjeve të Raportit EITI 2013-14, të cilat i shihnin si herën e parë kur Raportet EITI të Shqipërisë mbulonin Albpetrolin por mendonin se Raporti EITI 2015 thjesht përsëriste informacionin që kishte qenë paraqitur tashmë në Raportin EITI 2013-2014.

Një anëtar nga OSHC në MSG shprehu shqetësim lidhur me faktin që Albpetrol mbante shumicën e të ardhurave dhe shpërndante dividendë shumë të ulët tek qeveria. Megjithatë, një përfaqësues i qeverisë

shpjegoi se dividendët përcaktoheshin nga Bordi i Drejtorëve i Albpetrolit dhe konfirmoheshin nga takimi i aksionerëve, i cili përbëhej kryesisht nga përfaqësues të MEI-t. Zyrtari konfirmoi se shënimet e takimeve të Bordit dhe aksionerëve nuk ishin dokumente publike. Dividendët e Albpetrolit kanë qenë më të ulët në vitet 2015 dhe 2016 për shkak të çmimeve të ulëta ndërkombëtare të naftës dhe Albpetrolit i duhej të mbante pjesën më të madhe të të ardhurave të veta për të financuar operacionet e veta, sipas këtij përfaqësuesi.

Huatë dhe garancitë: Kishte pikëpamje kundërshtuese mes të gjithë grupeve të interesit lidhur me nëse Albpetroli përfitoi nga një garanci për financimin nga një palë e tretë. Ndërkohë që një numër anëtarësh nga OSHC në MSG mendonin se e kishte një garanci të tillë, të gjithë grupet e tjera të interesit mendonin se nuk e kishte. AP shpjegoi se kishte shqyrtuar pasqyrat financiare të Albpetrolit dhe u konsultua me menaxherët e vet për të përcaktuar se Albpetroli nuk kishte asnjë hua apo garanci në vitin 2015. Megjithatë, një përfaqësues i qeverisë shpjegoi se Albpetroli kishte ofruar hua për të tjera kompani në të kaluarën, të tilla si ujësjellës si dhe AKBN. Zyrtari nuk ishte i sigurt nëse kishte të tilla hua aktive në vitin 2015.

Një anëtar nga OSHC në MSG deklaroi se MSG nuk kishte diskutuar kurrë çështjen e huave apo garancive qeveritare për ARMO-n në të kaluarën. Një zyrtar i lartë qeveritar shpjegoi se ARMO kishte një total prej 530 milionë USD borxhe (përfshi një borxh prej 270 milionë USD bankave) dhe aktualisht aksione me vlerë negative prej 90 milionë USD, dhe qeveria ishte e ekspozuar ndaj 15% të aksioneve negative. Megjithatë, zyrtari shpjegoi se meqenëse përpunimi i naftës ishte një sektor strategjik, qeveria nuk mund ta lejonte ARMO-n të paraqiste letra falimentimi dhe i duhej të merrte një vendim strategjik për të ardhmen e kompanisë. AP shpjegoi se nuk kishte akses në dokumentet për privatizimin e ARMO-s, marrëveshjen e ARMO-s me kreditorët apo strukturën e marrëveshjes për përdorimin e rafinerisë së Fierit nga TPD dhe për pasojë në Raportin EITI 2015 u përfshinë vetëm fakte të njohura publikisht.

Vlerësimi i FMN-së në janar 2016 për transparencën fiskale të Shqipërisë theksoi garancinë e gjerë sovraane ofruar sektorit të energjisë (mbi 80% e garancive sovraane në vitin 2015) dhe vërejti se departamenti për menxhimin e bordit në Ministrinë e Financave publikonte zbardhje të disagreguar të borxhit sovran, përfshi garanci, çdo tre muaj (FMN, 2016).

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 nuk ofron një listë përfshirëse të kompanive që operojnë në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit në të cilat qeveria ka aksione, edhe pse nuk ofron referenca për rregullat (por jo praktikat) lidhur me marrëdhëniet financiare mes NPSH-ve dhe qeverisë, ndonëse vetëm për të ardhurat e mbajtura dhe ri-investimet, por jo financimet nga palë të treta. Ekzistenca e huave ose garancive të huave nga shteti apo ndonjë NPSH për kompani që operonin në sektorët minerar, të naftës dhe gazit është e paqartë në Raportin EITI 2015, edhe pse ka informacion të zgjeruar lidhur me huatë e garancitë shtetërore për kompanitë hidroenergjitike.

Në përputhje me kërkesën 2.6.a, MSG duhet të ofrojë një shpjegim për rregullat dhe praktikat

mbizotëruese lidhur me të ardhurat e mbajtura, ri-investimet dhe financimet nga palë të treta të NPSH-ve. Qeveria po ashtu duhet të sigurojë publikim vjetor të çfarëdo ndryshimesh në pronësinë qeveritare në NPSH apo nëndegët e tyre, si dhe të ofrojë një listë përfshirëse të çfarëdo huash apo garanci huash të dhëna nga shteti apo NPSH-të për kompani minerare, naftë dhe gazi në përputhje me kërkesën 2.6.b.

Tabela 2- Tabelë e vlerësimit fillestar përmblendhës: Akordimi i kontratave dhe licensave

Dispozitat EITI	Përmblendhje e gjetjeve kryesore	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar për përparimin me dispozitat EITI
Kuadri ligjor (#2.1)	Raporti EITI 2015 përfshin një vështrim të përgjithshëm të ligjeve, enteve qeveritare, kushteve fiskale përkatëse në sektorin mineral, të naftës dhe gazit, shkallën e decentralizimit fiskal si dhe komente të shkurtra mbi reformat aktuale.	Përparim i kënaqshëm
Akordimi i licensave (#2.2)	Ndërkohë që Raporti EITI 2015 ofron një listë të licensave minerare akorduar në vitin 2015, dhe tregon se nuk ka pasur licensa të reja naftë dhe gazi të akorduara në vitin 2015, ai vetëm përshkruan procesin ligjor të akordimit të licensave, përfshi kriteret teknike dhe financiare, por jo ndonjë devijim në praktikë. Ka të dhëna për akordimin e një license naftë dhe gazi në korrik 2015. Procesi i transferimit të licensave përshkruhet për sektorin e naftës dhe gazit por jo për minierat, dhe raporti nuk pohon qartë nëse ndonjë licensë minerare, naftë dhe gazi u transferua gjatë vitit në shqyrtim. Duke pasur parasysh faktin se licensat minerare qenë akorduar me anë të tenderimit, duhet të ishte bërë publike lista e ofertuesve të pasuksesshëm dhe kriteret faktike të tenderit për secilin raund.	Përparim domethënës
Regjistrat e licensave (#2.3)	Raporti EITI 2015 ofron një link për regjistrin publik mineral, të naftës dhe gazit, edhe pse ka boshllëqe në ofrimin publik të dative të aplikimit dhe koordinatat për disa licensa minerare, naftë dhe gazi.	Përparim domethënës

Publikimi i kontratave (#2.4)	Raporti EITI 2015 sqaron politikën e qeverisë për publikimin e kontratave në sektorin e naftës dhe gazit por jo atë minerar. Raporti nuk komenton praktikën faktike për publikimin e kontratave pavarësisht se një numër grupesh interesi kyçe ishin në dijeni të një numër kontratash në domenin publik.	Përparim domethënës
Publikimi i pronësisë reale (#2.5)	Raporti EITI 2015 nuk sqaron politikën e qeverisë lidhur me publikimin e pronësinë reale në kompanitë nxjerrëse por pronarët ligjorë gjenden publikisht në faqen e internetit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.	
Pjesëmarrja shtetërore (#2.6)	Raporti EITI 2015 nuk ofron një listë përfshirëse të kompanive që operojnë në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit në të cilat qeveria ka aksione, edhe pse ofron referenca për rregullat (por jo praktikat) lidhur me marrëdhëniet financiare midis NPSH-ve dhe qeverisë, ndonëse vetëm në lidhje me të ardhurat e mbajtura dhe ri-investimet, jo financimet nga palë të treta. Ekzistenca e huave apo garancive të huave nga shteti ose ndonjë NPSH për kompani që operojnë në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit është e paqartë në Raportin EITI 2015, ndonëse ka informacion të zgjeruar mbi huatë dhe garancitë shtetërore për kompanitë hidroenergjitike.	Përparim domethënës

Rekomandimet e Sekretariatit:

1. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të eksplorojë potencialin për ta përdorur raportimin EITI për të theksuar mospërputhjet në mjedisin ligjor, kuadrin fiskal dhe përgjegjësitë rregullatore të Shqipërisë në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit. MSG mund të dojë ta lidhë raportimin EITI me asistencën teknike të planifikuar në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit për t'u siguruar që zbatimi i EITI të shërbejë si diagnozë për të mbështetur reformat në proces dhe ato të planifikuara.
2. Në përputhje me kërkesën 2.2.a, MSG duhet të sigurojë publikimin vjetor se cilat licenca minerare, naftë dhe gazi ishin akorduar dhe transferuar në vitin (vitet) në shqyrtim, duke theksuar kërkesat teknike dhe financiare si dhe ndonjë defijim jo të vogël nga kuadri përkatës ligjor dhe rregullator që qeveris akordimet dhe transferimet e licensave.
3. Në përputhje me kërkesën 2.3.b, Shqipëria duhet të sigurojë që datat e aplikimit, akordimit dhe skadimit, mallin/mallrat të mbuluara dhe koordinatat për të gjitha licensat e naftës, gazit dhe ato minerare që mbahen nga kompanitë materiale të jenë të aksesueshme publikisht, në përputhje me rekomandimet e Alb-EITI në të shkuarën. Qeveria nxitet ta vëjë këtë informacion në dispozicion për licensat që mbahen nga të gjitha kompanitë, pavarësisht nga materialiteti i tyre.
4. Në përputhje me kërkesën 2.4.b, Shqipërisë i kërkohet të dokumentojë në Raportet EITI në të ardhmen politikën e qeverisë për publikimin e kontratave dhe licensave që qeveris kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineralee. Kjo përfshin dispozitat përkatëse ligjore, çdo reformë të planifikuar apo në proces si dhe një vështrim të përgjithshëm të kontratave tashmë të pulibkuara.
5. MSG mund të dojë të marrë në konsideratë pilotimin e raportimit për pronësinë reale në Raportin EITI të ardhshëm me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi për transparencën lidhur me pronësinë reale si dhe të pilotojë përkufizimet dhe pragjet lidhur me pronësinë reale. AlbEITI mund të dojë po ashtu të kryejë fushata informimi ë të gjera me kompanitë lidhur me objektivat e transparencës lidhur me pronësinë reale, si dhe të zhvillojë biseda me agjencitë qeveritare lidhur me mënyrën për t'i bërë këto publikime të detyrueshme.
6. Në përputhje me kërkesën 2.6.a, MSG duhet të ofrojë një shpjegim të rregullave dhe praktikave mbizotëruese lidhur me të ardhurat, ri-investimet dhe financimet nga palë të treta për NPSH-të. Qeveria duhet po ashtu të sigurojë publikim vjetor të çfarëdo ndryshimesh në pronësinë e qeverisë të NPSH-ve apo nënkontraktorëve të tyre, si dhe të ofrojë informacion tërësor për ndonjë hua apo garanci huaje ofruar nga shteti apo NPSH-të për kompanitë minerare, të naftës dhe gazit në përputhje me kërkesën 2.6.b.

3. Monitorimi dhe prodhimi

3.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion ofron hollësi lidhur me zbatimin e kërkesave EITI që lidhen me kërkimin, prodhimin dhe eksportet.

3.2 Vlerësimi

Vështrim i përgjithshëm mbi sektorin nxjerrës, përfshi veprimtaritë e kërkimit (#3.1)

Dokumentimi i përparimit

Në sektorin e naftës dhe gazit, Raporti EITI 2015 ofron një vështrim të përgjithshëm të sektorit të naftës bruto, përfshi numrin e kompanive që operojnë,⁷⁰ vendndodhjen e prodhimit,⁷¹ pjesëmarrjen shtetërore si dhe një vështrim të përgjithshëm të prodhimit, eksporteve, të ardhurave dhe punësimit në sektorin e naftës gjatë vitit 2015 (Raporti EITI 2015, f.10-11, 20-21). Në Figurën 2 (Raporti EITI 2015, f. 23) ofrohet një hartë e depozitave të naftës dhe gazit. Raporti paraqet një histori të shkurtër të zhvillimit të rezervave të naftës dhe gazit si dhe një link⁷² për në faqen e internetit të Albpetrolit për rezervat dhe prodhimin (Raporti EITI 2015, f. 23). Raporti po ashtu ofron rezervat gjeologjike dhe të rikuperueshme të naftës bazuar në studime që datojnë nga 1985-1990, të disagreguara sipas fushës (Raporti EITI 2015, f. 24). Raporti ofron një vështrim të përgjithshëm të karakteristikave të secilës fushë naftëmbajtëse dhe një link të përgjithshëm⁷³ për në faqen e internetit të AKBN për më shumë informacion mbi formacionet gjeologjike dhe mundësitë e eksplorimit (Raporti EITI 2015, f. 25) si dhe një hartë me definicion të ulët të licensave të naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f. 28). Ofrohet edhe një vështrim i shkurtër i eksplorimit të naftës dhe gazit ndërmarrë nga Bankers Petroleum dhe Shell (Raporti EITI 2015, f. 30-31).

Në sektorin minerar, raporti ofron një vështrim të përgjithshëm të sektorit, përfshi numrin e licensave, vlerën e prodhimit minerar gjatë 2015, pjesën e dy grupeve më të mëdha të mineraleve të prodhuara, punësimin në sektorin minerar gjatë 2015 si dhe pjesën që zënë të ardhurat minerare nga të ardhurat dhe eksportet e përgjithshme të qeverisë (Raporti EITI 2015, pp.12, 40-42). Raporti po ashtu ofron një vështrim të përgjithshëm të aktivitetit minerar sipas tipit të mineralit⁷⁴ (Raporti EITI 2015, f.43-48). Ofrohet gjithashtu edhe një vështrim i përgjithshëm i sektorit hidroenergjitik (Raporti EITI 2015, f.12-13, 56-57).

⁷⁰ Pesë në prodhim, katër në eksplorim.

⁷¹ Shqipëria e jugut.

⁷² <http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/>

⁷³ <http://www.akbn.gov.al/>

⁷⁴ Krom, bakër, hekur-nikel dhe nikel-silic, gëlqeror dhe material ndërtimi, bitum, rërat e ziftit.

Kërkimi: Raporti EITI 2015 ofron shqyrtime të kompanive kyçe në sektorin e naftës dhe gazit (2 Raporti EITI 2015, f.30-31) dhe planet për zhvillimin e infrastrukturës së gazit (Raporti EITI 2015, f. 13,37-38). Shqyrtimi i aktivitetit minerar për tip minerali përfshin përshkrime të aktivitetëve kryesore kërkimore (Raporti EITI 2015, f.43-48).

Raporti EITI 2013-14 ofron një vështrim të përgjithshëm të industrive nxjerrëse (f. 11-15, 20-21) por vetëm aktivitetet eksploruese kryesore përpara viteve 2013-14 (f.20-21, 32).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Ndërkohë që grupet e interesit të konsultuara nuk shprehën ndonjë pikëpamje të veçantë në lidhje me vështrimin nga Raporti EITI 2015 të industrive nxjerrëse, përfaqësues të shoqërisë civile dhe industrisë shprehën pikëpamje shumë të ndryshme lidhur me besueshmërinë e përllogaritjeve të rezervave të mbledhura nga qeveria dhe të përfshira në Raportet EITI. Një numër anëtarësh nga OSHC në MSG ngritën shqetësime lidhur me cilësinë e përllogaritjeve zyrtare të rezervave, duke besuar se qeveria mbështetej në vetë-raportimin e rezervave prej kompanive, pa kryer kontrole shtesë. Megjithatë, një numër përfaqësuesish të kompanive si në ashtu dhe jashtë MSG shpjeguan se kompanive iu kërkohej të rideklaronin rezervat pranë qeverisë çdo dy vjet dhe se qeveria mund t'i krahasonte këto përllogaritje me ato shumë cilësore të mbledhura nga qeveria gjatë periudhës komuniste (deri në vitin 1990). Ndërkohë që këta përfaqësues të industrisë besonin se qeveria në fakt ndërmernte kontrole të raportimit të rezervave nga kompanitë, ata po ashtu vërejtën se kompanitë kishin një nxitje për të mos deklaruar rezerva të sakta duke pasur parasysh përshtypjen se kjo do bënte që qeveria dhe grupet e tjera të interesit të kërkonin më shumë para nga kompanitë. AP po ashtu theksoi mospërputhje midis vetë-raportimit nga kompanitë dhe të dhënave gjeologjike që qeveria mban prej viteve 1980të. Raporti i Eurosupport nga janari 2017 thekson informacionin e zgjeruar në faqen e internetit të MEI-t lidhur me sektorin minerar, përfshi informacion përfshirës mbi aktivitetet e kërkimit (Eurosupport, 2017).

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkese. Raporti EITI 2015 ofron një vështrim të përgjithshëm të sektorëve minerarë, të naftës dhe gazit, përfshi veprimtaritë kryesore eksploruese.

Për të vazhduar forcimin e zbatimit, MSG mund të dojë të ndjekë rekomandimet e përsëritura nga Raporte EITI të mëparshme që lidhen me sigurimin e saktësisë së përllogaritjeve zyrtare të rezervave.

Të dhënat për prodhimin (#3.2)

Dokumentimi i përparimit

Vëllimet dhe vlerat: Për sa i përket naftës dhe gazit, Raporti EITI 2015 ofron vëllimet dhe vlerat totale për prodhimin e naftës, edhe pse vlera e prodhimit të naftës për vitin 2015 ishte llogaritur duke përdorur çmimin mesatar të eksportit gjatë 2015 (Raporti EITI 2015, f. 11, 21). Tabela 4 paraqet prodhimin e naftës për vitin 2015 të disagreguar sipas secilës nga gjashtë kompanitë prodhuese (përfshi Albpetrolin) (Raporti EITI 2015, f.29). Raporti deklaroi se MEI, AKBN dhe Albpetroli nuk raportuan prodhimin e gazit gjatë vitit

2015 (Raporti EITI 2015, f.21). Paraqitet vendndodhja e përgjithshme e prodhimit të naftës, Shqipëria e jugut, (Raporti EITI 2015, f.10-11) si dhe emrat e fushave naftëmbajtëse individuale që prodhojnë (Raporti EITI 2015, f. 29).

Në sektorin minerar, Raporti EITI 2015 paraqet vlerën totale të prodhimit minerar gjatë vitit 2015, edhe pse kjo përfshin vlerën e shtuar nëpërmjet përpunimit (Raporti EITI 2015, f. 12). Paraqitet edhe pjesa e vlerës së prodhimit nga dy prej mineraleve më të rendësishme të prodhuara⁷⁵ (Raporti EITI 2015, f.12). Tabela 5 paraqet vëllimet dhe vlerat e prodhimit për pesë minerale⁷⁶ prodhuar gjatë vitit 2015, edhe pse vlera e prodhimit të kromit dhe ferrokromit ofrohet e agreguar për dy minerlet (Raporti EITI 2015, f. 41). Jepet edhe emri dhe vendndodhja e prodhimit të secilit tip minerali (Raporti EITI 2015, f.41), përgjatë hartave të depozitave të të gjithë mineraleve kyçe⁷⁷ (Raporti EITI 2015, f.43-48).

Informacion tjetër: Raporti shpjegon se kompanitë private të naftës dhe gazit përbënin 96% të prodhimit gjatë vitit 2015, kryesisht nga fushat naftëmbajtëse të Patos-Marinzës që menaxhohet nga Bankers Petroleum, e cila përbënte 89% të prodhimit të vitit 2015 (Raporti EITI 2015, f. 21) Tabela 2 paraqet prodhimin kumulativ deri në vitin 2015 për 12 fushat dhe një link⁷⁸ për në faqen e internetit të Albpetrolit për këto të dhëna (Raporti EITI 2015, f.23-24). Ofrohet një përshkrim i shkaqeve për përlllogaritjet e ndryshme të rezervave (Raporti EITI 2015, f. 24). Seksioni 11.3.2 rekomandon që AKBN të ofrojë një krahasim të prodhimit të raportuar nga kompanitë minerare dhe matjet e vetë AKBN-së gjatë gjithë vitit, përfshi përqendrimin e mineralit dhe vlerat bazuar në transaksionet e tregut vendas si dhe eksportet (Raporti EITI 2015, f. 100). Raporti thekson kufizimet në statistikat e prodhimit minerar të AKBN, meqenëse këto bazohen në vetë-raportimet e kompanisë pa verifikim të pavarur nga ana e AKBN (Raporti EITI 2015, f. 42, 81, 100). Raporti shpjegon se vetëm 67% e kompanive (400 nga 597 licensa) raportuan prodhim pranë AKBN, e cila nuk mund t'i ofronte AP-së informacion mbi përbërjen dhe cilësinë (përqendrimin) e prodhimit për periudhën 2011-2015. Raporti po ashtu deklaroi se nuk ishin ofruar vlerat e prodhimit të brendshëm dhe se vlerat e prodhimit ishin përlllogaritur duke përdorur ose shifrat e eksportit të çmimeve të ofruara nga AKBN për mineralet jo të eksportuara ose shifrat e eksporteve të raportuara për Administratën e Doganave Shqiptare (Raporti EITI 2015, f.42).

Raporti po ashtu paraqet një vështrim të përgjithshëm të prodhimit hidroenergjitik (f. 70).

Raporti EITI 2013-14 ofron vëllimet dhe vlerat e prodhimit për naftën bruto dhe gazin natyror (Raporti EITI 2013-14, f.33) si dhe të gjitha mineralet kryesore të prodhuara (Raporti EITI 2013-14, f. 14, 44, 48). Pjesa e prodhimit të rakorduar midis publikimeve nga kompanitë dhe nga AKBN u rrit nga 70% në vitin 2013 në 85% në vitin 2014 (Raporti EITI 2013-14, f.43).

⁷⁵ Krom dhe "gur gëlqeror e materiale të tjera ndërtimi".

⁷⁶ Krom, ferrokrom, baker, hekur-nikel & nikel-silic, dhe çimento.

⁷⁷ Krom, baker, nikel, gur gëlqeror dhe materiale ndërtimi.

⁷⁸ <http://www.albpetrol.al/rezervat-gjeologjike/>

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Një anëtar nga OSHC në MSG deklaroi se ndërkohë që i konsideronte të dhënat për eksportet nga industria nxjerrëse të besueshme, prapë kishte shqetësime serioze lidhur me besueshmërinë e të dhënave të prodhimit. Përfaqësuesi shprehu shqetësim për përdorimin e çmimeve të eksportit për të llogaritur vlerën e prodhimit. AP shpjegoi se nuk ishte e mundur të gjendeshin të dhëna të besueshme për çmimet e brendshme dhe se çmimet e eksportit zgjidheshin si zëvendësues meqenëse shumica e naftës dhe mineraleve të prodhuara në Shqipëri eksportohej dhe përpunoheshin jashtë. AP nuk mendonte se kishte pengesa serioze për publikimin e informacionit për çmimet e brendshme dhe theksoi se ndërkohë që AKBN kishte ofruar të dhëna për çmimet e brendshme për Raportin EITI 2013-2014, ky informacion nuk ishte paraqitur për Raportin EITI 2015.

Një përfaqësues i qeverisë vërejti se Departamenti i Doganave kishte disagreguar informacionin mbi eksportet e kromit dhe ferrokromit duke qenë se kishin dy kode të ndryshme doganore (HNSH), të cilat nënkuptonin se qeveria ndiqte edhe vëllimet e vlerat e prodhimit për të dy mineralet në mënyrë të veçantë. Zyrtari shpjegoi se përfshirja e një vlere të agreguar për të dy mineralet në Raportin EITI 2015 duhet të ketë qenë gabim.

AP shpjegoi se entet qeveritare nuk kishin paraqitur vëllimet dhe vlerat për prodhimin e gazit natyror për Raportin EITI 2015, por vërejtën se gazi natyror i prodhuar nuk ishte shitur. Në fakt, ose ishte ri-injektuar për të ruajtur prodhimin e naftës ose thjesht ishte djegur. Një përfaqësues qeveritar dhe personeli i sekretariatit shpjeguan se vëllimet e prodhimit të gazit natyror ishin minimale dhe jo praktike komercialisht, me rreth 12m-13m cu m në vit. Duke qenë se fushat e prodhimit të naftës ishin nën PSA me Albpetrolin, AP shpjegoi se Albpetroli ishte në pozita për të ofruar informacion tërësor mbi prodhimin total të gazit natyror në Shqipëri.

Vlerësimi i FMN për transparencën fiskale të Shqipërisë nga janari 2016 vërente se ndërkohë që buxheti botonte të ardhurat nga renta, në fakt nuk publikonte përlllogaritje vjetore dhe vlerat për prodhime naftë, qymyri apo të tjera minerale, edhe pse njëfarë informacioni i kufizuar u publikuar nga Instituti i Statistikave (FMN, 2016).

Për sa i përket ndjekjes nga MSG lidhur me rekomandime të kaluara EITI mbi cilësinë e statistikave zyrtare të prodhimit, AP vërente se AKBN nuk i kishte mjetet apo ekspertizën për të monitoruar outputet faktike dhe që AKBN kishte kontroll të dobët mbi administrimin e të dhënave dhe se prireshin të mbështeteshin në faqet excel. AP shpjegoi se forcimi i mbikqyrjes së vetë-raportimit të prodhimit nga kompanitë do të kërkonte investime domethënëse nga ana e AKBN, por vërejti se projekt Ligji mbi Transparencën në Administratën Publike, përgatitur nga AlbEITI, do të siguronte bashkëpunim më të madh midis enteve qeveritare dhe të licensuarve.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 ofron vëllimet dhe vlerat e të gjitha mineraleve të prodhuara, përfshi naftën, kromin, ferrokromin, bakrin, hekur-nikelin dhe nickel-silica, dhe gur gëlqeror, edhe pse vlera e agreguar e prodhimit jepet vetëm për kromin dhe ferrokromin. Ndërkohë që përdorimi

i çmimeve të eksportit për të llogaritur vlerat e prodhimit përbën një shqetësim, duke pasur parasysh mungesën e raportimit të çmimeve të brendshme nga ana e qeverisë (ndryshe nga vitet e mëparshme), është për t'u shënuar që MSG ka bërë përpjekje për të ofruar një përlogaritje të vlerave të prodhimit në Raportin EITI 2015. Ndërkohë që mungesa e informacionit për gazin natyror po ashtu përbën shqetësim, duket se prodhimi total i gazit natyror në Shqipëri është minimal dhe nuk shitet.

Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet që të sigurohet se Raportet EITI të ardhshme do të ofrojnë vëllime dhe vlera të disagreguara prodhimi për të gjitha mineralet kryesore të prodhuar në vitin (vitet) në shqyrtim. MSG mund të dojë edhe të punojë ente qeveritare përkatëse për t'u siguruar që informacioni për çmimet e brendshme të të gjitha mineraleve të publikohet si pjesë e publikimeve qeveritare rutinë.

Të dhënat e eksporteve (#3.3)

Dokumentimi i përparimit

Për naftën dhe gazin, ndërkohë që Raporti EITI 2015 ofron vëllimet dhe vlerat totale të prodhimit të naftës (Raporti EITI 2015, f. 11, 21), ai vetëm pohon se prodhimi i naftës “kryesisht eksportohet” jashtë vendit për përpunim dhe se nafta përbënte 55% të eksportit të industrisë nxjerrëse dhe 13% të të gjitha eksporteve në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 11, 22). Kështu, vëllimet ekzakte të naftës bruto të eksportuar nuk ofrohen në Raportin EITI 2015, edhe pse vlera e eksporteve të naftës ofrohet e disagreguar sipas vitit për 2011-2015, me burim Administratën e Doganave Shqiptare (Raporti EITI 2015, f.11).

Lidhur me miniera, Raporti EITI 2015, ofron vlerën e eksporteve minerare në terma absolute dhe relative ndaj eksporteve totale për 2015-ën, si dhe të disagreguara për secilin nga eksportet e tre mineraleve kryesore⁷⁹ (Raporti EITI 2015, f. 42). Megjithatë, raporti nuk ofron vëllimet e mineraleve të eksportuara.

Informacion tjetër: Raporti ofron një grafik të tri destinacioneve kryesore të eksporteve⁸⁰ (Raporti EITI 2015, f.22). Jepen tendencat kryesore në vlerat e eksporteve të naftës bruto për vitet 2011-2015 (Raporti EITI 2015, f. 22). Raporti po ashtu ofron një vështrim të eksporteve hidroenergjitike (Raporti EITI 2015, f.71).

Raporti EITI 2013-14 ofron vlerat e eksporteve për të gjitha eksportet e mineraleve (Raporti EITI 2013-14 EITI, f.13), por jo vëllimet.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Të gjitha grupet e interesit të konsultuara shprehën besim në besueshmërinë e të dhënave raportit zyrtar

⁷⁹ Gur gëlqeror, krom dhe ferrokrom.

⁸⁰ Malta, Spanja dhe më i madhi, Italia.

për eksportet, përfshi mallrat nga industria nxjerrëse. AP konfirmoi se vëllimi i naftës eksportuar në vitin 2015 ishte 991 mijë ton (afërsisht 7.234 milionë fuçi), krahasuar me prodhimin total të naftës prej 1.279 milionë ton (afërsisht 9.337 milionë fuçi). AP shpjegoi se deri në vitin 2015, rafineria e Ballshit prodhonte dizel (10 ppm) të shitur në tregun e brendshëm dhe naftë të virgjër eksportuar për përpunim të mëtejshëm, ndërsa rafineria e Fierit prodhonte kryesisht bitum dhe mbetje karbonike nga distilimi i naftës. AP deklaroi se nuk kishte marrë informacion mbi vëllimet e naftës së përpunuar në Shqipëri në vitin 2015 gjatë përgatitjes së Raportit EITI 2015, por vërejti se MEI kishte raportuar se dy rafineritë kishin përpunuar rreth 678 ton naftë bruto gjatë periudhës 2011-2014, shumë më pak se sa kapaciteti i instaluar.

Një përfaqësues i qeverisë shpjegoi se afro 80%-90% e eksporteve të naftës bruto trajtoheshin në Portin e Vlorës dhe pjesa tjetër nëpërmjet Portit të Durrësit, ndërkohë që eksportet e mineraleve kalonin përmes Portit të Durrësit si dhe kufijve tokësorë me Kosovën dhe Maqedoninë. Një numër përfaqësuesish të qeverisë vërejtën se edhe Doganat edhe INSTAT prodhoin statistika mujore mbi eksportet e naftës dhe mineraleve, përfshi vëllimet, vlerat dhe vendin e destinacionit (me anë të Raportit për Bilancin e Tregtisë⁸¹). Megjithatë, këto të dhëna ishin të disagreguara vetëm midis naftës bruto dhe “mineraleve të tjera,” pa ndarje midis mineralit specifik. Ndërkohë që përfaqësuesit e qeverisë vërejtën se nuk do kishte pengesa ligjore dhe praktike nëse Doganat do publikonin të dhënat e eksporteve sipas çdo minerali, duke vërejtur se e vetmja arsye që kjo nuk bëhej ishte se askush nuk e kishte kërkuar ndonjëherë, një tjetër përfaqësues qeveritar theksoi se nuk do ishte e mundur që INSTAT-i të publikonte të dhëna për eksportet të ndara sipas mineralit për ato raste ku më pak se tre kompani prodhoin një mineral të caktuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Statistikat Zyrtare.

Vlerësimet fillestare

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënëse në përmbushjen e kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 ofron vlerat e eksporteve për naftën bruto, por jo vëllimet specifike të eksportit të naftës, si dhe vlerën e tre eksporteve kryesore minerale, por jo vëllimet dhe vlerat e të gjitha mineraleve të eksportuara.

Në përputhje me kërkesën 3.3, MSG duhet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen të ofrojnë vëllime dhe vlera të disagreguara eksportesh për të gjitha mineralet kryesore të eksportuara në vitin (vitet) në shqyrtim. MSG nxitet të ndajë qartë çfarëdo gazi natyror që do të kalojë tranzit në të ardhmen nga zhvillimi i Gazsjellësit Trans-Adriatik nga eksportet e mirëfillta.

⁸¹ <http://www.dogana.gov.al/c/171/225/291/statistika>

Tabela 3- Tabelë përmbledhëse e vlerësimit fillestar: Monitorimi dhe prodhimi

Dispozitat EITI	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar për dispozitat EITI
Vështrim i përgjithshëm i sektorit nxjerrës, përfshi aktivitetin e kërkimit (#3.1)	Raporti EITI 2015 ofron një vështrim të përgjithshëm të sektorëve minerarë, të naftës dhe gazit, përfshi aktivitete domethënëse kërkimore. Në pikëpamjen e Sekretariatit Ndërkombëtar, Shqipëria ka bërë përpjekje të të shkuar përtej kërkesës duke përfshirë informacion të zgjeruar për sektorin hidroenergjitik.	Përparim i kënaqshëm
Të dhëna për prodhimin (#3.2)	Raporti EITI 2015 paraqet vëllimet dhe vlerat e prodhimit të të gjitha mineraleve kryesore të prodhuara, përfshi naftën, kromin, ferrokromin, bakrin, hekur-nikel dhe nikel-silikat, dhe gur gëlqeror, edhe pse vlera të disagreguara të prodhimit ofrohen vetëm për kromin dhe ferrokromin. Ndërkohë që përdorimi i çmimeve të eksportit për të llogaritur vlerat e prodhimit përbën shqetësim, duke pasur parasysh mungesën e raportimit të çmimeve të brendshme nga qeveria (ndryshe nga vitet e mëparshme), është për t'u shënuar që MSG ka bërë përpjekje për të përfshirë një përlogarritje të vlerave të prodhimit në Raportin EITI 2015. Ndërkohë që mungesa e informacionit për prodhimin e gazit natyror përbën gjithashtu shqetësim, duket se prodhimi total i gazit në Shqipëri është minimal dhe nuk shitet.	Përparim i kënaqshëm
Të dhëna për eksportet (#3.3)	Raporti EITI 2015 ofron vlerat e eksportit për naftën bruto, por jo vëllime specifike të eksportit të naftës, si dhe vlerën e tri eksporteve të mineraleve kryesore, por jo vëllime dhe vlera për të gjitha mineralet e eksportuara.	Përpardim domethënës

Rekomandimet e Sekretariatit:

1. Për të vazhduar forcimin e zbatimit, MSG mund të dojë të ndjekë rekomandimet e përsëritura nga Raportet EITI të mëparshme në lidhje me të siguruarit e përlogaritjeve zyrtare të rezervave.
2. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen të ofrojnë vëllime dhe vlera të disagreguara prodhimi për të gjitha mineralet kryesore prodhuar në vitin (vitet) në shqyrtim. MSG mund po ashtu të dojë të punojë me entet përkatëse të qeverisë që informacioni për çmimet e brendshme të të gjitha mineraleve publikohet si pjesë e publikimeve qeveritare rutinë.
3. Në përputhje me kërkesën 3.3, MSG duhet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen të ofrojnë vëllime dhe vlera eksporti të disagreguara për të gjitha mineralet kryesore në vitin (vitet) në shqyrtim. MSG nxitet të ndajë qartë çfarëdo gazi natyror që kalon tranzit në të ardhmen nga zhvillimi i Gazsjellësit Trans-Adriatik nga eksportet e tjera të Shqipërisë.

4. Mbledhja e të ardhurave

4.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion ofron hollësi për zbatimin e kërkesave EITI në lidhje me transparencën për të ardhurat, përfshi tërësinë, cilësinë dhe nivelin e hollësive që janë bërë publike. Po ashtu shqyrton përputhjen me Kërkesat EITI në lidhje me procedurat për prodhimin e Raporteve EITI.

4.2 Vlerësimi

Materialiteti (#4.1)

Dokumentimi i përparimit

Pragu i materialitetit për të ardhurat: Raporti EITI 2015 konfirmon se AP shqyrtoi pragjet fillestare për materialitetin të MSG, përfshirë në TeR të AP, por edhe thekson shqetësimet e AP-së lidhur me të dhënat e përdorura si bazë për përcaktimin e pragjeve të materialitetit (Raporti EITI 2015, f.85). Ndërkohë që raporti i referohet një pragu materialiteti sasior për përzgjedhjen e burimeve të të ardhurave materiale, (dmth si pjesë e të ardhurave totale të qeverisë), e bën këtë vetëm në terma të përgjithshme duke iu referuar “të ardhurave thelbësore në buxhetin e shtetit” (Raporti EITI 2015, f. 79). Raporti shpjegon paaftësinë e qeverisë për të disagreguar përbërësit taksave të zakonshme të industrive nxjerrëse (dmth jo specifike për industritë nxjerrëse), duke pasur parasysh paaftësinë e sistemit të Thesarit për të ofruar të ardhurat mujore të disagreguara sipas taksapaguesit apo industrisë (Raporti EITI 2015, f.100). Raporti vëren se pagesat e përzgjedhura për rakordim përfaqësojnë vetëm pagesat “domethënëse” në buxhetin e shtetit dhe tek entet jashtë buxhetit përfshi AKBN, Entin Rregullator të Energjisë (ERE), KESH dhe Albpetrol dhe nuk përfshijnë pagesat për të gjithë industrinë nxjerrëse (Raporti EITI 2015, f.14).

Raporti pohon se të gjitha taksat e përbashkëta kanë qenë përjashtuar nga fusha e rakordimit (Raporti EITI 2015, f.80). Ndërkohë që raporti vetëm konfirmon se MSG përfshinte të gjitha të ardhurat e renditura sipas Kërkesës 4.1.b në fushën e raportimit për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2015, f.79) por jo shprehimisht për minierat, lista e të ardhurave të përzgjedhura për rakordim përfshin të ardhura nga “taksa e përbashkët” të tilla si tatimi mbi fitimin, gjobat për tatimet dhe TVSH në fushën e rakordimit (Raporti EITI 2015, f.79-80). Ndërkohë që raporti pohon se tarifat e të licensuarve dhe hyrjes përjashtoheshin nga fusha e rakordimit bazuar mbi faktin se nuk “çojnë në pagesa thelbësore nga sektori” (Raporti EITI 2015, f. 80), ai nuk ofron një prag specifik sasior të materialitetit për përjashtimin e këtyre të ardhurave. Të gjitha kompanive materiale minerare, të naftës dhe gazit iu kërkohej edhe të raportonin çdo pagesë tjetër më shumë se 50 mijë USD tek qeveria qendrore dhe 5 mijë USD tek qeveritë vendore (Raporti EITI 2015, f.79-81).

Përshkrimi i të ardhurave materiale: Raporti ofron përshkrime për të gjitha të ardhurat materiale nga nafta dhe gazi⁸² (Raporti EITI 2015, f.33-35) dhe minierat⁸³ (Raporti EITI 2015, f.53-54).

Pragu i materialitetit për kompanitë: Për naftën dhe gazin, Raporti EITI 2015 konfirmon vendimin e MSG për të përfshirë të gjitha kompanitë e naftës dhe gazit që operojnë në Shqipëri në fushën e raportimit, saktësisht tetë kompani private naftë dhe gazi dhe Albpetrolin (Raporti EITI 2015, f. 80, 89). Për minierat, raporti pohon se MSG kishte zgjedhur kompani minerare materiale bazuar në pragjet e ndryshme vjetore të prodhimit,⁸⁴ dhe jo bazuar në pagesat për qeverinë (Raporti EITI 2015 f. 80). Raporti konfirmon se “gjatë vitit 2015 nuk u raportuan nga të licensuarit pagesa materiale të lidhura me marrëveshjet koncesionare minerare” (Raporti EITI 2015, f. 81). Raporti pohon se përzgjedhja e kompanive minerare materiale ofronte një mbulim rakordimi prej 89% të vlerës së përlogaritur të prodhimit për vitin 2015, ndonëse duke ngritur shqetësime lidhur me besueshmërinë e të dhënave zyrtare për prodhimin minerar (Raporti EITI 2015, f. 81). Vendimet e MSG për materialitetin janë theksuar qartë nën vendimet e MSG në faqen e internetit të AlbEITI.⁸⁵

Kompanitë materiale: Raporti EITI 2015 paraqet një listë të të gjitha nëntë kompanive të naftës dhe gazit (përfshi Albpetrolin), të 106 kompanive minerare dhe 19 kompanive hidroenergjitike, të përzgjedhura për pjesëmarrje në Raportin EITI 2015 (Raporti EITI 2015, f.19, 91, 108-110,127-129). Numri total i kompanive materiale ishte 134 në Raportin EITI 2015, përfshi 115 kompani minerare, naftë dhe gazi.

Raportimi i kompanive materiale: Raporti EITI 2015 pohon se vetëm 122 nga 134 kompanitë material paraqitën formularët e raportimit EITI (Raporti EITI 2015, f.86,96). Ndërkohë që raporti pohon se të gjitha nëntë kompanitë materiale të naftës dhe gazit paraqitën formularët e tyre të raportimit (Raporti EITI 2015, f.89), pohon edhe që një kompani naftë dhe gazi Emanuelle Adriatic Energy Ltd nuk kishte raportuar edhe pse konfirmon se qeveria nuk raportoi ndonjë të ardhura nga kompania në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 89). Raporti po ashtu deklaroi se vetëm 100 nga 106 kompanitë materiale minerare raportuan dhe paraqet emrat e gjashtë kompanive që nuk raportuan⁸⁶ (Raporti EITI 2015, f.91). Raporti vlerëson materialitetin e gjashtë kompanive mos-raportuese në agregat,⁸⁷ por jo të disagreguara sipas kompanisë (Raporti EITI 2015, f. 91). Megjithatë, është e mundur të llogaritet materialiteti i secilës nga katër kompani në gjashtë kompanitë minerare që nuk raportuan bazuar në rezultatet e rakordimit në Shtojcën 2, edhe pse duket se qeveria nuk raportoi të ardhura nga dy kompanitë e tjera mos-raportuese (Raporti EITI 2015, f.113). Arsyet për refuzimin e kompanive mosraportuese për të marrë pjesë nuk paraqiten, përveç

⁸² Renta, tatimi mbi fitimin, TVSH, pagesat për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat personale, tatimi mbi të ardhurat personale, pjesa e shtetit në prodhimin e naftës, bonuse nënshkrimi dhe trajnimi.

⁸³ Renta, tatimi mbi fitimin, TVSH, pagesa për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi për dividendët.

⁸⁴ Pragjet për përzgjedhjen e kompanive materiale ishin: kompanitë e kromit me mbi 3.000 ton p.a. prodhim; kompanitë e bakrit me mbi 100 ton prodhim; kompanitë e nikelit me mbi 10.000 ton prodhim; kompanitë e gurit gëlqeror me mbi 20.000 ton prodhim; kompanitë argjilore me mbi 100.000 ton prodhim; dhe kompanitë e bitumit dhe rërave bituminoze me mbi 10.000 ton prodhim.

⁸⁵ P.sh. përzgjedhja e kompanive material për Raportin EITI 2015 më 29 korrik 2016: <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2016/>

⁸⁶ Durici, Kurti, Silbora, Nickel Mine, Oruçi, dhe Afrimi – K.

⁸⁷ si 0.2% e totalit të të ardhurave minerare publikuar nga qeveria.

referencave të përgjithshme për kufizimet kohore (Raporti EITI 2015, f. 89).

Raporti po ashtu i referohet dispozitave të konfidencialitetit të ligjit për tatimet, ku shpjegon përfshirjen e heqjes dorë nga konfidencialiteti në tatime në formularët e raportimit për të gjitha kompanitë materiale⁸⁸ (Raporti EITI 2015, f.104). Megjithatë, pati vonesa domethënëse në paraqitjen nga kompanitë të heqjes dorë nga konfidencialiteti, dhe këto u morën nga “më pak se 50 në 134” kompanitë materiale (Raporti EITI 2015, f.104).

Entet qeveritare materiale: Entet qeveritare që grumbullojnë të ardhura dhe material nga industrinë nxjerrëse për Raportin EITI 2015 renditen në formë diagrame në Raportin EITI 2015 (Raporti EITI 2015, f. 80). Megjithatë, Raporti EITI 2015 nuk specifikon numrin dhe emrat e NJQV-ve të përzgjedhura për raportim.

Raportimi qeveritar: Raporti EITI 2015 nuk e thotë shprehimisht nëse të gjitha entet materiale qeveritare raportuan të gjitha të ardhurat, edhe pse thekson raportim të paplotë nga qeveritë vendore, pa specifikuar numrin apo emrat e NJQV-ve joraportuese (Raporti EITI 2015, f. 98). Është raportua se jo të gjitha NJQV-të që mbledhin të ardhura nga industrinë minerare, të naftës dhe gazit ishin përfshirë në fushën e raportimit dhe se raportimi nga NJQV-të pjesëmarrjes ishte “i paplotë dhe erdhi me shumë vonesë” (Raporti EITI 2015, f. 89).

Mospërputhje: Raporti i referohet mungesës së pragut të materialitetit të MSG për hetimin e mospërputhjeve, edhe pse kjo nuk është një kërkesë e Standartit EITI, dhe vëren se AP i kishte hetuar mospërputhjet me kompanitë individuale ose me agjencitë qeveritare (Raporti EITI 2015, f.86). Jepet vlera e mospërputhjeve të parakorduara, disagreguar midis sektorëve minerarë dhe të naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f. 88), dhe materialiteti i mospërputhjeve mund të vlerësohet bazuar në të dhënat e ofruara.⁸⁹ Raporti paraqet rezultatet e rakordimit të të ardhurave të naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f. 89) dhe minerare (Raporti EITI 2015, f. 91), ku mospërputhjet identifikohen sipas të ardhurave. Rezultatet e rakordimeve të disagreguara sipas kompanive, paraqitur në shtojcë, si për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2015, f.108-110) ashtu edhe për minierat (Raporti EITI 2015, f. 111-129), japin mospërputhjet të disagreguara sipas kompanive dhe zërit të të ardhurave. Raporti po ashtu ofron një vështrim të përgjithshëm mbi shkaqet kryesore të mospërputhjeve (Raporti EITI 2015, f. 90-91). Një shkak kryesor i mospërputhjeve në rentën nga nafta dhe gazi ishte për shkak të mënyrës në të cilën vendoset renta për eksportet (Raporti EITI 2015, f.90,92).

Publikimi i plotë nga qeveria: Raporti jep publikimin e plotë të njëanshëm të qeverisë të të ardhurave

⁸⁸ Formularët e raportimit përfshinin një letër që jepte pëlqimin shprehimisht të të licensuarit “tek organet publike marrëse për raportim të informacionit mbi të licensuarit që klasifikohet si konfidencial sipas ligjit, rregulloreve dhe marrëveshjeve” dhe “lejonte publikimin e të ardhurave përkatëse sipas flukseve të pagesave sipas të licensuarit në një nivel të disagreguar në Raportin EITI.”

⁸⁹ Mospërputhjet përfundimtare të parakorduara ishin 1.081 milionë Lek në të ardhurat e naftës dhe gazit (ose 0.00976% e të ardhurave të naftës dhe gazit raportuar nga qeveria) dhe 3.898 milionë Lek në të ardhurat minerare (ose 0.124% e të ardhurave minerare të raportuara nga qeveria).

totale të vitit 2015, disagreguar sipas fluksit, në nëntë flukset e të ardhurave materiale në naftë dhe gaz⁹⁰ (Raporti EITI 2015, f.32) dhe shtatë flukse të ardhurash në sektorin minerar⁹¹ (Raporti EITI 2015, f.53). Ndërkohë që raporti përshkruan heqjen dorë nga konfidencialiteti tatimor përfshirë në formularët e raportimit dhe ofrimin e këtyre kërkesave nga “më pak se 50 nga 134” kompani materiale (Raporti EITI 2015, f.104), ai nuk sqaron nëse mungesa e këtyre kërkesave për heqjen dorë nga konfidencialiteti nga mbi 84 kompani materiale ka ndikuar aftësinë e qeverisë për të ofruar publikim të plotë të njëanshëm.

Raporti po ashtu paraqet një vështrim të përgjithshëm dhe rakordim të pagesave nga sektori hidroenergjitik tek qeveria (Raporti EITI 2015, f.72-74).

Raporti EITI 2013-14 EITI përfshin pragje të ngjashme materialiteti (f. 74-78) dhe përshkrime të flukseve materiale të të ardhurave (Raporti EITI 2013-14, f.12, 74-77). Numri i kompanive materiale është më i ulët, në 81 kompani minerare (që përbëjnë 85% të prodhimit) në vitin 2013 dhe 99 kompani minerare (87% e prodhimit) në vitin 2014. Pjesëmarrja ishte po ashtu më e ulët se në vitin 2015, me 94 nga 108 kompani që raportuan në vitin 2013 dhe 103 nga 115 në vitin 2014 (Raporti EITI 2013-14, f.83). Nga analiza e shënimeve të takimeve të MSG duket se MSG kishte vendosur t’i largonte të gjitha kompanitë që nuk kishin raportuar nga lista e kompanive materiale për Raportet EITI 2013-2014,⁹² edhe pse është e paqartë se si ishte justifikuar nga ana metodologjike heqja e kompanive materiale në mënyrë retroaktive bazuar në mbledhjen e të ardhurave.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Materialiteti: Anëtarët e MSG nga të gjitha fushat theksuan sfidat që paraqiste aftësia për të disagreguar komponentët e taksave të përbashkëta në sistemet e tanishme qeveritare, por konfirmuan se MSG i rishikonte vendimet e saj për materialitetin në mënyrë vjetore. Personeli i sekretariatit dhe zyrtarë të qeverisë shpjeguan se paaftësia për të ofruar të ardhurat totale qeveritare nga industrinë nxjerrëse kishte kufizuar aftësinë e MSG për të përcaktuar pragje sasiore për materialitetin. Të gjithë anëtarët e MSG që u konsultuan konfirmuan se MSG kishte vendosur të përfshinte të gjithë flukset e të ardhurave specifike për sektorin dhe të përjashtonte tatimet e përbashkëta nga fusha e rakordimit, edhe pse pranuan se një numër fluksesh të ardhurash specifike për sektorin (tarifat për licensat dhe hyrjen) kishin qenë përjashtuar për shkak të kontributit shumë të ulët në të ardhurat e buxhetit. AP shpjegoi se duke pasur parasysh kufizimet në nivelin e hollësive në të dhënat qeveritare, AP kishte adoptuar një përqasje alternative të përzgjedhjes së kompanive dhe pagesave bazuar në strukturën e pagesave të kërkuara me kontratë dhe sipas ligjit.

Për t’u siguruar që Raporti EITI 2015 përfshinte të gjitha pagesat “domethënëse” specifike për sektorin

⁹⁰ Renta, tatimi mbi fitimin, TVSH, pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi të ardhurat, tatimi për dividendët, gjobat tatimore, pjesa e shtetit në prodhimin e naftës, si dhe bonuset e nënshkrimit dhe trajnimit.

⁹¹ Renta, tatimi mbi fitimin, TVSH, pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat, tatimi mbi të ardhurat, tatimi për dividendët, dhe gjobat tatimore.

⁹² <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2015/>

dhe identifikonte flukse pagesash “të reja apo të pambuluara më parë,” AP shpjegoi se MSG iu kishte kërkuar të gjitha kompanive materiale që të raportonin të gjitha pagesat e tjera (si ato specifike për sektorin ashtu dhe ato të përbashkëta) mbi pragjet prej 5 milionë Lek në pagesa kombëtare dhe 0.5 milionë për pagesat për NJQV-të. Ndërkohë që AP vërejti se mbulimi i rakordimeve nuk mund të përllorritej si pjesë e të ardhurave totale të buxhetit nga industritë nxjerrëse, AP vlerësoi se mbulimi “duhet të ishte relativisht i lartë” duke pasur parasysh që të gjitha flukset kryesore të të ardhurave ishin mbuluar. Për sa i përket më shumë se 2 miliardë Lek në “pagesa të tjera” të agreguara raportuar nga kompani materiale në Raportin EITI 2015, AP shpjegoi se këto pagesa ishin raportuar nga kompanitë e naftës dhe gazit dhe “pak” kompani minerare dhe përbëheshin nga akciza dhe taksa e karbonit për importet e karburanteve që përdoren në prodhimin e naftës, dy taksa të paraqitura pas një ndryshimi në ligjin mbi tatimet në vitin 2014. AP shpjegoi se kompanitë e naftës dhe gazit shpesh përdornin produktet e rafinuara të naftës si diluent në nxjerrjen e naftës dhe se disa kompani minerare përdornin gazoil në impiantet e tyre të shkrirjes. Aty ku këto pagesa ishin raportuar nga kompanitë, AP vërejti se i kishte krahasuar këto të dhëna me informacion nga Doganat (për taksën e karbonit për importet e naftës) dhe nga Drejtoria e Tatimeve (për akcizën mbi naftën e blerë në vend). Ndërkohë që AP nuk i konsideronte këto dy flukse të ardhurash se kishin lidhje me aktivitetet nxjerrëse, ai kishte propozuar përfshirjen e këtyre pagesave në rakordim duke pasur parasysh vlerën e tyre të agreguar me qëllim hartimin e një pamjeje më përfshirëse të të ardhurave totale nga industria nxjerrëse. Një përfaqësues i industrisë në MSG vërejti se diskutimet e zgjeruara të MSG lidhur me pragjet e materialitetit nuk ishin përshkruar si e sa duhet në Raportin EITI 2015, sidomos racionalja për adoptimin e një përfaqëse të caktuar ndaj materialitetit.

Raportimi i kompanive: Disa anëtarë të MSG vërejtën se fokusi kryesor i MSG në diskutimet mbi materialitetin ishte tek minierat më shumë se sa tek nafta dhe gazi, meqenëse të gjithë të licensuarit në naftë dhe gaz ishin të përfshirë, edhe pse një numër anëtarësh vërejtën se kjo mund të kishte qenë përshkruar më mirë në Raportin EITI. Për Raportin EITI 2015, AP i kërkoi Doganave dhe Tatimeve që t’i paraqisnin një listë përfshirëse të të gjithë të licensuarve që operonin në sektorin minerar dhe NIPT e tyre, si dhe publikimin e të gjitha të ardhurave të marra prej këtyre kompanive. Një zyrtar i lartë qeveritar shpjegoi se përzgjedhja e kompanive materiale minerare në bazë të prodhimit dhe jo të pagesave për buxhetin ishte një përfaqëse e pranueshme, meqenëse renta minerare llogaritej bazuar në vëllimet e prodhimit. Një anëtar nga OSHC në MSG shpjegoi se ndërkohë që shoqëria civile në fillim kishte dashur që të gjitha kompanitë minerare të merrnin pjesë në raportimin EITI, në përputhje me dispozitat e ligjit për minierat, e kishin kuptuar se kompanitë minerare me xhiro të ulëta kishin pak gjasa të bënin pagesa të konsiderueshme në buxhet. Megjithatë, një përfaqësues i industrisë ishte shumë kritik lidhur me përjashtimin e kompanive më të vogla minerare nga fusha e raportimit EITI, duke menduar se kompanitë e vogla ishin ato me më shumë gjasa për të devijuar nga detyrimet. Një zyrtar i lartë i qeverisë vërejti se pragu i materialitetit për përzgjedhjen e kompanive materiale ishte ulur që nga Raportet EITI të para, duke ofruar një mbulim mjaftueshëm të lartë rakordimi. Ndërkohë që një numër përfaqësuesish të industrisë vunë në dukje se pjesëmarrja e kompanive ishte përmirësuar në mënyrë konsekuente çdo vit, përfaqësues të industrisë dhe qeverisë mendonin se futja e kërkesave të detyrueshme për raportim EITI në Ligjin për Minierat në 2010 i kishte bërë kompanitë më të kujdesshme lidhur me raportimin, sepse mendonin se raportimi EITI mund të çonte në më shumë taksa nga qeveria.

Për sa i përket arsyeve që 6 nga 115 kompanitë materiale minerare, të naftës dhe gazit (përjashto

hidroenergjitike) refuzuan të merrnin pjesë në Raportin EITI 2015, AP shpjegoi se nuk kishte marrë ndonjë përgjigje zyrtare nga këto kompani, edhe pse disa kompani thjesht jozyrtarisht kishin refuzuar të bashkëpunonin dhe të tjera thjesht nuk ishin përgjigjur pas kërkesave të përsëritura. Në mënyrë anekdotike, AP shpjegoi se disa prej kompanive mund të kenë qenë të frustruara me qeverinë duke pasur parasysh mungesën e rinovimit të licensave të tyre, ndërkohë që të tjera nuk ishin mjaftueshëm të organizuara, nuk kishin sisteme adekuate kontabiliteti ose thjesht ishin “tepër të vogla.” AP vërejti se Sekretariati AlbEITI dhe përfaqësues të MEI-t kishin qenë “shumë mbështetës” në procesin e ndjekjes së kompanive mosraportuese, duke dërguar kujtesa zyrtare tek të gjitha kompanitë mosraportuese. Një numër përfaqësuesish të industrisë vunë në dukje se nuk e quanin pjesë të përgjegjësive të kompanive që të ndiqnin kompanitë mosraportuese dhe t’i nxisnin ato të raportonin. Një anëtar nga OSHC në MSG shprehu kritika të mëdha për faktin që qeveria nuk iu hiqte licensat kompanive që nuk raportonin, duke pasur parasysh se kjo pasqyronte angazhim të pamjaftueshëm të qeverisë ndaj EITI-t. AP shpjegoi se kishte vlerësuar vetëm materialitetin e kombinuar të pagesave nga kompanitë mosraportuese (0.2% e të ardhurave minerare) meqenëse nuk shihte ndonjë vlerë në disagregimin e mëtejshëm të kësaj shifre të vockël.

Raportimi i qeverisë: Shumica e përfaqësuesve të qeverisë dhe personeli i sekretariatit që u konsultuan theksuan sa ngarkesë përbënte procesi i mbledhjes së të dhënave brenda sistemeve të qeverisë. Disa përfaqësues të qeverisë shpjeguan se agjencitë e linjës, dhe jo Thesari, ishin përzgjedhur të raportonin në EITI. Ndërkohë që Thesari ishte në fakt enti që merrte pagesat nga kompanitë, ai nuk disagregonte të ardhurat për çdo taksapagues dhe kështu nuk mund të ofronte disagregim të mjaftueshëm për qëllimet e raportimit EITI. Ndërkohë që agjenci linje të tilla si Tatimet dhe Doganat ishin likuiduesit e pagesave dhe kështu nuk i merrnin vetë të ardhurat, ato kishin sistemet e duhura për të disagreguar të ardhurat sipas numrit identifikues tatimor. Një zyrtar qeveritar shpjegoi se agjencitë e linjës dhe Thesari rakordonin faturat dhe të ardhurat mbi baza mujore.

Ndërkohë që një përfaqësues i industrisë në MSG theksoi pjesëmarrjen e plotë të enteve qeveritare në raportimin EITI, disa anëtarë nga OSHC në MSG shprehën shqetësim lidhur me vonesat e vazhdueshme në raportim nga ente të caktuara qeveritare, të tilla si Doganat dhe Tatimet. Këta përfaqësues të OSHC-ve mendonin se presioni i shoqërisë civile në MSG kishte qenë kyç për të siguruar raportim të plotë nga qeveria në Raportin EITI 2015. Një punonjës i Sekretariatit shpjegoi se kishte një trashëgimi kulturore për ta trajtuar informacionin të kufizuar në Shqipëri, çka mund të shpjegonte një përgjigje të ngadaltë nga disa ente qeveritare. AP konfirmoi se të gjitha entet qeveritare kombëtare kishin raportuar plotësisht të ardhurat nga industritë nxjerrëse në Raportin EITI 2015 dhe se ndërkohë që disa NJQV nuk kishin raportuar, AP mendonte se NJQV-të kryesore që merrnin pjesën e luanit të të ardhurave nga industria nxjerrëse kishin marrë pjesë në raportim.

Mospërputhje: Një përfaqësues i lartë i qeverisë theksoi nivelin e ulët të mospërputhjeve në Raportin EITI 2015 dhe u shpreh se niveli i ulët në varianca në raportimin fillestar pasqyronte besueshmërinë e të dhënave që raportoheshin si nga kompanitë ashtu edhe nga entet qeveritare (*shih Kërkesa 4.9*). Disa anëtarë nga industria në MSG theksuan tendencën në rënie të mospërputhjeve nëpër të gjitha shtatë vitet e raportimit EITI në Shqipëri.

Vlerësimi fillestar

Raporti EITI 2015 përfshin përkufizimin nga MSG të pragjeve të materialitetit për pagesat dhe kompanitë që përfshihen në rakordim bazuar në vëllimet e prodhimit, përfshi një justifikim se pse pragjet u përcaktuan në atë mënyrë dhe në atë nivel. Megjithatë, përcaktimi i një pragu cilësor dhe jo sasior për përzgjedhjen e flukseve të të ardhurave materiale (si pjesë e të ardhurave qeveritare për shembull) përbën shqetësim. Megjithatë, ndërkohë që dy nga flukset e të ardhurave të renditura në Kërkesën 4.1.b janë përjashtuar nga rakordimi vetëm mbi bazën e referencave të përgjithshme për mungesën e materialitetit të tyre, nuk ka të dhëna që të sugjerojnë se vlera e tyre ka qenë domethënëse. Janë përmendur kompanitë që nuk raportuan dhe vlera e pagesave të tyre për qeverinë është ofruar si relative ndaj të ardhurave të raportuara nga qeveria. Pjesa e kompanive mosraportuese duket të jetë e parëndësishme. Raporti EITI 2015 nuk deklaroi shprehimisht nëse të gjitha entet qeveritare materiale raportuan të gjitha të ardhurat, edhe pse konsultimet me grupet e interesit konfirmuan se të gjitha entet qeveritare kombëtare kishin raportuar plotësisht dhe se mungesat nga qeveritë vendore nuk konsideroheshin materiale. Ndërkohë që komentet nga AP lidhur me tërësinë e Raportit EITI kufizohen vetëm në një deklarambi mbi mungesën e sigurisë, është e mundur që të llogaritet materialiteti i atyre që nuk janë përfshirë. Duke qenë se këto duke jomateriale, në dritën e pragut të ulët të materialitetit adoptuar për të përzgjedhur kompanitë materiale dhe në dritën e vendimit të Bordit të EITI në raste të tjera si Mongolia, vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë.

Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të rishqyrtojë pragun që ka caktuar për materialitetin për të përzgjedhur kompanitë minerare për të siguruar një balancë midis tërësisë së publikimeve dhe cilësisë së raportimit. MSG mund të dojë të shqyrtojë një përqasje me kampion, e cila do të lejonte hetimin e këtyre pagesave pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi. MSG po ashtu nxitet që të sigurohet që Administratori i Pavarur të ofrojë opinionin e vet mbi faktin se sa përfshirës është Raporti EITI.

Të ardhurat në natyrë (#4.2)

Dokumentimi i Përparimit

Materialiteti: Raporti EITI 2015 konfirmon se kompanive iu ishte kërkuar të raportonin pagesat në natyrë për qeverinë dhe NPSH-të dhe që ato të ardhura në formën e pjesës së shtetit në prodhimin e naftës kanë qenë të ardhurat e dyta më të mëdha nga industria nxjerrëse në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 90). Në linjë me udhëzimin nr. 1 të 26 majit 2015 nga MEI dhe MF, raporti shpjegon se kompanitë mund të transferojnë pjesën e prodhimit alokuar Albpetrolit ose në para ose në natyrë (Raporti EITI 2015, f. 34). Albpetroli shet si pjesën e naftës mbledhur sipas PSA-ve ashtu edhe prodhimin e vet të naftës me anë të ankandëve publike vjetore (Raporti EITI 2015, f. 34).

Vëllimet e mbledhura: Raporti paraqet dy shifra të ndryshme për vëllimin e naftës së mbledhur si pjesë e prodhimit të naftës të Albpetrolit, ku kompanitë që raportojnë kanë transferuar 50,791 ton tek Albpetroli (Raporti EITI 2015, f. 14, 95) dhe Albpetroli ka raportuar se ka marrë 50,540 ton (Raporti EITI 2015, f. 34). Shifra e dytë konfirmohet si rezultat i prodhimit paraekzistues prej 91,039 ton dhe prodhim të nxjerrë nga investimi i kontraktorit prej 11,985 ton (Raporti EITI 2015, f.34), ndërkohë që shifra e parë citohet dy

herë në raport (përfshi referencën për shifrën më të lartë si pagesë faktike pa burim) pa një shpjegim të qartë se mospërputhja ishte rezultat i rakordimit të flukseve në natyrë, dhe pa hetim të arsyeve për mospërputhjen.

Vëllimet e shitura: Raporti pohon se Albpetroli ka raportuar shitje prej 84,623 ton naftë bruto tek një blerës i vetëm, Trading Petrol & Drilling (TPD) (Raporti EITI 2015, f.34, 137). TPD administron rafinerinë e Fierit në marrëveshje me ARMO-n, pa marrë përsipër borxhin e ARMO-s (Raporti EITI 2015, f. 21, 34) (*shih Kërkesa 2.6*). Shtojca 4 paraqet hollësitë e ankandëve publike për naftën bruto të Albpetrolit (Raporti EITI 2015, f. 137). Megjithatë, arsyet për vëllime mjaft më të larta shitjesh se sa ato të mbledhura nga Albpetroli për shitjen e pjesës shtetërore të prodhimit të naftës nuk shpjegohen. Ndërkohë që nuk deklarohet shprehimisht, kjo do të nënkuptonte se vëllimet e dhëna për naftën bruto shitur nga Albpetroli përfshijnë si prodhimin e vetë Albpetrolit ashtu edhe pjesën e shtetit të prodhimit të naftës përmes PSA-ve.

Të ardhurat nga shitjet: Raporti jep vlerën e të ardhurave nga shitja e 84,623 ton naftë të Albpetrolit në vitin 2015 me vlerë 15.4 milionë USD (Raporti EITI 2015, f. 34, 137). Shtojca 4 jep hollësitë e ankandëve publike për naftën bruto të Albpetrolit, disagreguar sipas muajit dhe blerësit, edhe pse tek një blerës i vetëm (Raporti EITI 2015, f. 137).

Megjithatë, raporti jep edhe vlerën e përlllogaritur të pagesave të naftës nga Albpetroli, 1,615,639,000 Lek, “përlllogaritur duke përdorur çmimin mesatar të eksportit aplikuar në vitin 2013 prej 254 USD/ ton. Shuma në USD... konvertuar në Lek me kursin mesatar të Bankës së Shqipërisë për vitin 2013 prej 1 USD barabartë me 125.96 Lek.” Një total prej 8,024,000 ishte lënë si mospërputhje e parakorduar në rakordimin e pjesës në natyrë të pagesave të naftës, të cilat mund të llogariten si 0.5% e të ardhurave nën pjesën e pagesave të naftës raportuar nga qeveria (Raporti EITI 2015, f. 95). Duke përdorur kursin e këmbimit 1 USD : 125.96 Lek, vlera e naftës krudo nga PSA-të mbledhur nga Albpetroli në vitin 2015 mund të llogaritet si 148.74 milionë USD, afro dhjetë herë më shumë se sa 15.4 milionë USD në të ardhurat nga shitja e naftës bruto raportuar më herët në raport (Raporti EITI 2015, f. 34).

Mospërputhjet: Një total prej 8,024,000 Lek ishte lënë si mospërputhje e parakorduar për pagesat e naftës në natyrë, e cila mund të llogaritet si 0.5% e të ardhurave në pjesën e pagesave të naftës raportuar nga qeveria (Raporti EITI 2015, f. 95).

Disagregimi: Të dhënat në Tabelën 55 të Shtojcës 4 paraqiten të disagreguara sipas blerësit (të vetëm) dhe muajit (Raporti EITI 2015, f. 137).

Informacion shtesë: Informacioni mbi shitjet e naftës bruto nuk është rakorduar me blerësit. Raporti përshkruan procesin e shitjes së naftës bruto të Albpetrolit⁹³ (Raporti EITI 2015, f.136-137) dhe formulën

⁹³ Albpetroli shet përmes ankandëve të hapura publike sipas Urdhrit nr. 83 të 10 tetorit 2012. Sasitë e naftës së shitur bazohen në parashikimet

për llogaritjen e prodhimit të naftës në pjesën e shtetit⁹⁴ (Raporti EITI 2015, f.34).

Raporti EITI 2013-14 jepte vëllimet dhe vlerën e menduar të të ardhurave në natyrë, pjesës së shtetit në prodhimin e naftës (të ndryshme nga nafta pjesë e Albpetrolit)⁹⁵ (Raporti EITI 2013-14, f.12, 100). Raporti bën publike vëllimet e mbledhura nga Albpetroli në emër të qeverisë, vëllimet e shitura dhe të ardhurat nga shitja e naftës bruto. Të dhënat për shitjet e naftës bruto ishin disagreguar sipas blerësit (Raporti EITI 2013-14, f.169).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Raporti i Eurosupport i janarit 2017 vërente se Kërkesa 4.2 nuk ishte e aplikueshme për sektorin minerar shqiptar, duke qenë se Neni 40 i Ligjit 10304 që kërkon që renta minerare të paguhet në para (Eurosupport, 2017).

AP shpjegoi se vendimi nëse kompanitë duhet ta transferonin pjesën e prodhimit të naftës në para apo në natyrë u la në dorë të Albpetrolit dhe kompanive të naftës, në linjë me një urdhër të përbashkët të Ministrit të Energjisë dhe Ministrit të Financave në maj 2015. AP konfirmoi se të gjitha këto transferta ishin në natyrë në vitin 2015. Një zyrtar i qeverisë shprehu shqetësim për faktin se dy shifra të ndryshme ishin dhënë për pjesën e naftës mbledhur përmes PSA-ve, duke u shprehur se kjo theksonte nevojën e enteve qeveritare për të kontrolluar projekt Raportet EITI për t'u siguruar që të tilla mospërputhje nuk do të botoheshin.

Një përfaqësues i qeverisë konfirmoi se shifra për vëllimet e shitura nga Albpetroli në vitin 2015 (84,623 ton) përfaqësonte edhe pjesën e naftës nga PSA-të edhe prodhimin e vetë Albpetrolit. AP shpjegoi se ndërkohë që Albpetroli i kishte disagreguar këto të dyja në raportimin për Raportin EITI 2013-2014, nuk e kishte bërë këtë për Raportin EITI 2015 dhe e kishte kategorizuar Albpetrolin si “jobashkëpunues” në këtë drejtim. Një anëtar i OSHC në MSG tha se vetë prodhimi i Albpetrolit ishte marginal dhe përfaqësonte më pak se 1% të prodhimit të naftës të Shqipërisë, duke menduar për pasojë se edhe vëllimet e agreguara shitur nga Albpetroli ishin pak a shumë ekuivalente të pjesës së prodhimit të naftës përmes PSA-ve. Megjithatë, një zyrtar qeveritar konfirmoi se Albpetroli mbledhte afro 50 mijë ton naftë në vit përmes PSA-ve dhe prodhonte rreth 34 mijë ton të vetat në vit.

AP konfirmoi se nuk kishte ndonjë kërkesë ligjore që Albpetroli të transferonte të ardhurat nga shitja e

vjetore të prodhimit të naftës dhe pjesës së naftës së marrë nga PSA-të. Kalendari i dorëzimit të naftës përcaktohet për vitin. Përkruhet përbërja e komisionit që administrojnë ankandet e naftës. Jepet formula e çmimeve për shitjet e naftës bruto për 2015 (Brent * 72.52% - USD 5.55/fuçi + K (ku K është USD 0.1 për fuçi)) dhe procesi për përcaktimin e çmimeve të shitjes së naftës përkruhet në terma të përgjithshme. Jepet edhe një link për [faqen e internetit](#) të Albpetrolit që përshkruan procedurat për shitjen e naftës bruto të Albpetrolit në vitin 2015r.

⁹⁴ Pjesa e prodhimit të naftës mbledhur nga Albpetroli llogaritet “bazuar në prodhimin e menduar (prodhimi paraekzistues kur u transferua pusi – PEP) dhe prodhimi në pjesë (prodhim i nxjerrë nga investimi i kontraktorit – ASP), e cila varion bazuar në nivelin e prodhimit dhe fazes së rikuperimit të kostos sipas matjeve nga faktori R (Faktori R llogaritet duke pjestuar të ardhurat e naftës të mbledhura nga fillimi i operacioneve të PSA-së me koston e naftës mbledhur për të njëjtën periudhë. Renta e mbledhur gjatë periudhës zbritet nga të ardhurat.” (Raporti EITI 2015, f.34)

⁹⁵ 75,825 ton në vitin 2013 dhe 94,304 ton në vitin 2014.

prodhimit të naftës nga PSA-të tek Thesari duke qenë se formulimi i PSA-ve e identifikonte këtë si “pjesa e prodhimit e Albpetrolit,” jo pjesa e shtetit, meqenëse PSA-të ishin konkluduar përpara korporatizimit të Albpetrolit. Një zyrtar qeveritar tha se Albpetroli kishte nevojë të mbante pjesën më të madhe të të ardhurave nga shitja e naftës nga PSA-të për të financuar operacionet e veta, çka shpjegon nivelin e ulët të dividendëve të Albpetrolit për Thesarin në vitet e fundit. Megjithatë, një tjetër përfaqësues qeveritar dhe disa donator shprehën shqetësime të mëdha për faktin që Albpetroli mbante pjesën më të madhe të të ardhurave dhe theksuan nevojën për ta ndryshuar procesin në mënyrë që operatorët ta transferonin pjesën e naftës në para drejtpërdrejt tek Thesari.

AP konfirmoi se opsioni i përfshirjes së blerësve të shitjeve të naftës bruto të Albpetrolit në fushën e raportimit nuk ishte diskutuar nga MSG në përgatitjet e Raportit EITI 2015. AP vërejti se nuk duhet të ketë pengesa për paraqitjen e të dhënave të shitjeve të naftës bruto të Albpetrolit të disagreguara sipas ngarkesës, ku kjo ndodh (duke qenë se furnizimet për rafinerinë e vendit administruar nga TPD në vitin 2015 bëheshin me tubacione). AP shpjegoi se kishte marrë informacion mbi eksportet e naftës bruto të disagreguara me ngarkesë individuale nga Doganat gjatë përgatitjes së Raporteve EITI vjetore, por se nuk ishte e mundur që këto të dhëna të publikoheshin “në rast se nuk ishte rënë dakord nga palët përkatëse.”

Një numër përfaqësuesish të qeverisë shprehën interes për përpjekjen e shënjestruar të EITI-t për transparencë në shitjen e të ardhurave në natyrë të shtetit. Një zyrtar i qeverisë shprehu pasiguri lidhur me nëse do të ishte e mundur të publikoheshin kontratat e shitjeve të naftës bruto që ishin konkluduar nga Albpetroli, duke vërejtur se do të ishte e nevojshme të konfirmohej nëse këto kontrata përfshinin ndonjë klauzolë konfidencialiteti në të njëjtën mënyrë si PSA-të. Zyrtari theksoi se mund të ishte e mundur të ndërmerrej rakordim i dyfishtë i shitjeve të naftës bruto të Albpetrolit me raportim si nga blerësit e naftës ashtu edhe nga Doganat, të cilat prej vitit 2012 kishin edhe përgjegjësinë për akcizën lidhur me prodhimet kryesore të brendshme të tilla si nafta bruto. Një numër përfaqësuesish të qeverisë theksuan kritika nga Albpetroli kur çmimi i shitjes së naftës bruto të Albpetrolit ishte publikuar fillimisht (së bashku me formulën) në Raportin EITI 2013-14 EITI, meqenëse ishte konsiderueshëm më i ulët se sa çmimi me të cilin operatorë privatë si Bankers Petroleum shisnin prodhimin e vet të naftës tek blerësit ndërkombëtarë (me një shtrirje prej 30% dhe 18% ulje respektivisht sipas Brent). Një zyrtar i qeverisë shpjegoi se ky dallim në çmime mund t'i atribuohet një numri arsyesh, përfshi nivelet më të ulëta shitur nga Albpetroli, aftësinë e operatorëve privatë për të shmangur lëvizjet në çmimin ndërkombëtar të naftës dhe dallimet në cilësitë e përzierjeve të naftës bruto.

Vlerësimi fillestar

Raporti EITI 2015 rakordon vëllimet e naftës bruto mbledhur sipas PSA-ve, publikon vëllimet e naftës bruto të shitur dhe vlerën e të ardhurave nga shitja e naftës bruto, disagreguar sipas blerësit. Raporti ofron vëllimet e mbledhura, vëllimet e shitura dhe të ardhurat nga shitjet si për pjesën e prodhimit të naftës nën PSA-të ashtu edhe naftën e pjesës së Albpetrolit, edhe pse pa disagregim mes të dyjave. Ndërkohë që është rasti për të konsideruar se Shqipëria ka shkuar përtej kërkesës minimale duke publikuar informacion mbi shitjet e pjesës së naftës të Albpetrolit, vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë duke pasur parasysh mungesën e disagregimit midis të ardhurave në natyrë të shtetit dhe pjesës së naftës të

Albpetrolit.

Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen të disagregojnë qartë të ardhurat në natyrë të shtetit nga nafta pjesës së Albpetrolit, siç ka bërë në Raporte EITI të mëparshme. MSG mund të shihte mundësinë për t'iu bashkuar [përpyqjes së shënjestruar](#) të EITI-t për tregtinë e mallrave për të ofruar një kuadër për të siguruar që të bërit publik i shitjeve të shtetit të të ardhurave të veta në natyrë të jenë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Transaksionet ndihmëse dhe infrastrukturore (#4.3)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 nuk trajton ekzistencën e dispozitave infrastrukturore apo marrëveshjeve ndihmëse. Gjatë paraqitjes së raportit fillestar për 2015 nga AP përpara MSG në takimin e 29 korrikut 2016, AP shpjegoi se nuk kishte informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar ekzistencën e ndonjë dispozite infrastrukturore në kontratat minerare apo të naftës dhe gazit dhe vërejti që kompanive materiale do t'u kërkohej të raportonin hollësi të dispozitave të tilla si pjesë e formularëve të raportimit (Alb-EITI, 2016).

Raporti EITI 2013-14 EITI deklaroi se nuk kishte marrëveshje ndihmëse infrastrukturore në fuqi në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit në vitet 2013-14 (Raporti EITI 2013-14, f.275).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Asnjë prej grupeve të interesit të konsultuar nuk ishte në dijeni të ndonjë dispozite ndihmëse apo infrastrukturore të kontratave në sektorin minerar, të naftës dhe gazit. Një anëtar nga OSHC në MSG nuk e kujton që MSG ta ketë diskutuar këtë çështje në përgatitjen e Raportit EITI 2015 dhe tha se MSG duhet të ketë akses në tekstin e plotë të çdo kontrate minerare, naftë dhe gazi për të konfirmuar nëse ndonjë klauzolë e tillë ekzistonte. AP vërejti se dy përfaqësues të MEI-t kishin konfirmuar se nuk kishte marrëveshje të tilla në ndonjë prej kontratave minerare, të naftës dhe gazit të nënshkruara deri më sot. AP vërejti se ndërkohë që nuk kishte akses në tekstin e plotë të kontratave për të konfirmuar se marrëveshje të tilla nuk ekzistonin, shpjegoi se mbështetej në informacionin e paraqitur nga këta përfaqësues të MEI-t dhe mendonte se të tilla marrëveshje duhet të kishin dalë në media. Raporti i Eurosupport i janarit 2017 shprehej se Kërkesa 4.3 nuk ishte e aplikueshme për Shqipërinë, duke qenë se dispozitat ligjore dhe kushtet e marrëveshjeve koncesionare nuk siguronin marrëveshje ndihmëse apo infrastrukturore (Eurosupport, 2017).

Vlerëimi fillestar

Vlerëimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për Shqipërinë në vitin në shqyrtim (2015). Megjithatë, mungesa e komentit në Raportin EITI 2015 mbi konsideratat e MSG për Kërkesën 4.3 përbën shqetësim.

Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen të trajtojnë qartë Kërkesën 4.3 dhe të konfirmojë vlerësimin nga MSG për pavlefshmërinë e saj. MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën do të ishte i nevojshëm një rishikim i kushteve aktuale të kontratave minerare, të

naftës dhe gazit për të siguruar një vlerësim përfshirës për vlerfshëmërinë e Kërkesës 4.3.

Të ardhurat nga transporti (#4.4)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 nënkupton se qeveria dhe NPSH-të nuk marrin të ardhura nga transporti i mineraleve, naftës bruto apo gazit natyror, edhe pse nuk e thotë shprehimisht këtë. Raporti përshkruan infrastrukturën për eksportimin e naftës bruto dhe pohon se NPSH ofrojnë depozita naftë portuale (Raporti EITI 2015, f. 22). Raporti shpjegon se nafta e eksportuar lëvizet me kamionë nga fushat naftëmbajtëse në terminalin e naftës në Portin e Vlorës, i cili është dhënë me koncesion për një kompani private, La Petrolifera Italo-Albanese Sh.a, dhe ofron linqe për dy faqe interneti⁹⁶ me kushtet e koncesionit të portit (Raporti EITI 2015, f. 22). Thuhet gjithashtu që dy tubacionet prej 188 km nga dy rafineritë në Portin e Vlorës nuk janë në gjendje pune (Raporti EITI 2015, f. 22).

Raporti po ashtu ofron një vështrim të përgjithshëm për planet e zhvillimit të infrastrukturës së gazit, përfshi Ligjin për Sektorin e Gazit Natyror nr. 102/2015 të marsit 2015, zhvillimin e Gazsjellësit Trans-Adriatik prej 215 km dhe ngritjen e Operatorit të Transmetimit të Gazit shqiptar (Albgaz Sh.a.) në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 13, 37-38).

Raporti EITI 2013-14 ofron një përshkrim të ngjashëm të rregullimeve të transportit me kamionë për naftën, gazin dhe mineralet dhe mungesën e tubacioneve funksionale (Raporti EITI 2013-2014, f. 275).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Raporti i Eurosupport i janarit 2017 konfirmonte se qeveria dhe NPSH-të nuk marrin të ardhura nga transporti i mineraleve, duke qenë se kostoja e transportit bartet nga kompanitë private minerare. Ndërkohë që këto kompani paguajnë tatime dhe tarifa normale, nuk paguajnë ndonjë tarifë që lidhet me transportin prej tyre të mineraleve (Eurosupport, 2017). Një anëtar nga OSHC në MSG vërejti se MSG nuk e kishte diskutuar çështjen e të ardhurave nga transporti në lidhje me termat e koncesionit të Portit të Vlorës në përgatitjet për Raportin EITI 2015. Ndërkohë që shoqëria civile e kishte ngritur çështjen e TAP-it në MSG, anëtari i MSG tha se gazsjellësi nuk ishte operacional në vitin 2015. Të gjithë grupet e interesit të konsultuara ose nuk shprehën një opinion për çështjen ose u shprehën se qeveria nuk merrte ndonjë të ardhur nga transporti i mineraleve apo naftës bruto.

AP konfirmoi se koncesionari i Portit të Vlorës, La Petrolifera Italo-Albanese Sh.a., nuk kishte bërë ndonjë pagesë për qeverinë në vitin 2015, duke qenë se AP kishte konfirmuar se koncesioni ishte strukturuar si BOT (Ndërto-Opero-Transfero) bazuar në të lexuarit e tij të Ligjit të Koncesioneve. Megjithatë, AP konfirmoi se MSG nuk e kishte konsideruar çështjen në përgatitjen e Raportit EITI 2015 dhe se e kishte

⁹⁶ <http://www.gruppopir.com/en/la-petroliera-italo-albanese> and <http://fiaalbania.al/members-list/la-petrolifera-italo-albanese-sh-a/>

sqaruar çështjen gjatë konsultimeve të grupeve të interesit për Validimin. AP deklaroi se synonte ta ngrinte çështjen me MSG në përgatitjen e Raportit EITI të ardhshëm që mbulon vitin 2016.

AP po ashtu konfirmoi se kompanitë e kamionëve që transportojnë naftë nga fushat naftëmbajtëse në Portin e Vlorës ishin në pronësi private dhe se kompanitë e naftës dhe gazit ishin të lira të zgjidhnin ofruesin e shërbimit që donin, çka nënkuptonte se qeveria nuk merrte të ardhura nga transporti i naftës me kamionë.

Në lidhje me të ardhurat potenciale në të ardhmen nga transporti i gazit natyror nëpërmjet TAP, AP konfirmoi se Shqipëria nuk ka të drejtë të marrë ndonjë tarifë tranzitimi në korridorin e gazit TAP. Ndërkohë që Operatori shqiptar i Transmetimit të Gazit u themelua për të menaxhuar transportin e gazit nga stacionet e TAP në rrjetin e tubacioneve për shpërndarjen e gazit në Shqipëri, AP deklaroi se rregullimet e zbatimit mbeteshin ende për t'u finalizuar në kohën e konsultimeve me grupet e interesit për Validimin.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për Shqipërinë në vitin në shqyrtim (2015). Raporti EITI 2015 përshkruan rregullimet infrastrukturore për transportin e naftës bruto, por jo të gazit natyror apo mineraleve. Megjithatë, Sekretariati Ndërkombëtar kupton se qeveria dhe NPSH-të nuk marrin ndonjë të ardhur nga transporti i mineraleve, naftës bruto apo gazit natyror.

Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të marrë në konsideratë të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen të deklarojnë shprehimisht që qeveria dhe NPSH-të nuk marrin ndonjë të ardhur nga transporti i mineraleve, naftës bruto dhe gazit natyror në vitin (vitet) në shqyrtim.

Transaksionet midis NPSH-ve dhe qeverisë (#4.5)

Dokumentimi i përparimit

Në lidhje me transaksionet midis NPSH-ve dhe kompanive të tjera të naftës, gazit dhe ato minerare, Raporti EITI 2015 konfirmon pjesëmarrjen e shtetit në sektorin e naftës dhe gazit nëpërmjet Albpetrolit (Raporti EITI 2015, f. 10, 27). Është e dukshme nga diagrama e flukseve të të ardhurave nga nafta dhe gazi në Seksionin 8.1 se Albpetrol mbledh pjesë nga prodhimi i naftës dhe bonuse nga kompanitë që operojnë me PSA (Raporti EITI 2015, f. 79).

Raporti pohon se Albpetrol kishte mbledhur 22.6% të të ardhurave nga nafta dhe gazi gjeneruar nga PSA-të në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f.35). Tabela 24 në raport ofron rezultatet e rakordimit të të ardhurave të mbledhura nga Albpetrol (dy flukse të ardhurash: pjesa e pagesave për naftën dhe Bonuset – Albpetrol) (Raporti EITI 2015, f. 95). Rezultatet e rakordimit të pjesës së prodhimit të naftës dhe bonuseve të nënshkrimit paraqiten në Shtojcën 1, disagreguar sipas kompanive (Raporti EITI 2015, f.108-109).

Në lidhje me transaksionet midis qeverisë dhe NPSH-ve, Raporti EITI 2015 përshkruan të ardhurat që shoqërojnë pjesëmarrjen shtetërore në sektorin e naftës dhe gazit, ku Albpetroli transferon dividendë tek thesari, përkrah tatimeve të rregullta që janë të aplikueshme për të gjitha kompanitë komerciale të naftës dhe gazit përfshi tatimin mbi fitimin, rentën, TVSH-në, etj. (Raporti EITI 2015, f. 34). Është e dukshme nga diagrama e flukseve të të ardhurave nga nafta dhe gazi nga NPSH-të tek qeveria në Seksionin 8.1 se Albpetroli i paguan dividendë MZHETTS, rentë për eksportet pranë Doganave, shtatë tatime dhe tarifa⁹⁷ për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe taksa vendore për qeveritë vendore (Raporti EITI 2015, f.80).

Raporti deklaron se Albpetroli kontribuoi 9.7 milionë USD në të ardhura nga nafta dhe gazi për buxhetin shtetëror në vitin 2015 nëpërmjet pagesave të tatimit mbi të ardhurat korporative, renta, TVSH, etj. (Raporti EITI 2015, f. 35). Tabela 23 ofron rezultatet e rakordimit të pagesave në cash nga Albpetrol tek qeveria në vitin 2015 sipas shtatë flukseve të të ardhurave,⁹⁸ disagreguar sipas fluksit të të ardhurave (Raporti EITI 2015, f. 95). Megjithatë, duket se dividendi i Albpetrolin për qeverinë në vitin 2015 ishte publikuar vetëm në mënyrë të njëanshme në pasqyrat financiare të audituara të Albpetrolit për 2012, 2013, 2014, dhe 2015 në Shtojcën 4 (Raporti EITI 2015, f. 138), por jo rakorduar.

Raporti EITI 2015 nuk publikon ndonjë transfertë tjetër ad hoc nga NPSH-të nxjerrëse për apo nga qeveria.

Raporti EITI 2013-14 EITI ofron rakordim të ngjashëm pagesash nga kompanitë e naftës dhe gazit në Albpetrol dhe nga Albpetrol tek qeveria (Raporti EITI 2013-14, f.100-101), por vetëm të njëjtin publikim të njëanshëm të dividendëve të Albpetrolit për qeverinë.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Raporti i Eurosupport nga janari 2017 konfirmonte se nuk kishte NPSH që operonin në sektorin minerar në Shqipëri (Eurosupport, 2017). Ndërkohë që anëtarët e OSHC në MSG dhe përfaqësues të tjerë të medias dhe partnerëve të zhvillimit shprehën shumë shqetësim mbi menaxhimin financiar të Albpetrolit, asnjë prej anëtarëve të grupeve të interesit nuk bëri komente të veçanta lidhur me transaksionet e NPSH në Raportin EITI 2015. AP dhe një përfaqësues i qeverisë vërejtën se Albpetroli kishte të drejtën për pagesa gjobash në rastet kur operatorët e PSA-ve shkelnin detyrimet e programeve të tyre të punës, dhe konfirmuan se nuk kishte të tilla pagesa nga kompanitë e naftës dhe gazit tek Albpetroli gjatë vitit 2015. AP shpjegoi se formularët e raportimit iu kërkonin kompanive material të raportinonin çdo lloj pagese tjetër materiale për NPSH-të por se asnjë pagesë e tillë nuk ishte raportuar gjatë 2015. AP po ashtu konfirmoi se nuk ishte në dijeni të ndonjë transferte tjetër nga Albpetroli për ndonjë ent tjetër qeveritar përveç atyre të mbuluara në Raportin EITI 2015.

⁹⁷ Rentë për shitjet e brendshme; tatim fitimi; TVSH; sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; tatim mbi të ardhurat personale; gjoba tatimore; tatim për dividendin.

⁹⁸ Rentë – shitje të brendshme; TVSH; tatim fitimi; sigurimet shoqërore dhe shëndetësore; tatim për dividendët; gjoba tatimore; pagesa të tjera për qeverinë vendore.

Vlerësimi i FMN për transparencën fiskale të Shqipërisë në janar 2016 gjeti se qeveria nuk kishte publikuar një raport për financat e korporatave publike, edhe pse pasqyrat e tyre financiare janë në dispozicion nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit si të gjitha kompanitë e tjera aksionere dhe transfertat midis qeverisë dhe NPSH-ve janë publikuar në buxhetin kombëtar (FMN, 2016).

Vlerësimi fillestar

Ndërkohë që Raporti EITI 2015 përfshin një rakordim për pagesat e kompanive të naftës dhe gazit për NPSH-të nxjerrëse (Albpetrol) dhe disa nga pagesat e Albpetrol për qeverinë, ai ofron vetëm publikimin e njëanshëm të Albpetrolit të dividendëve të tij për qeverinë, të cilat nuk janë rakorduar me faturat e MZHETTS. Ndërkohë që dividendët e MZHETTS janë materialë, ato përbëjnë vetëm 0.57% të të ardhurave të qeverisë nga nafta dhe gazi dhe 0.39% të të ardhurave nga sektorët minerarë, të naftës dhe gazit.⁹⁹ Megjithatë, Sekretariati Ndërkombëtar kupton se marrja e dividendëve të Albpetrolit nga MZHETTS është bërë publike në raportin vjetor për ekzekutimin e buxhetit, duke qenë se të ardhurat e MZHETTS regjistrohen në buxhetin kombëtar (*shih Kërkesa 5.1*). Gjithashtu, fakti që pasqyrat financiare vjetore të Albpetrolit auditohen (*shih Kërkesa 4.9*) ofron një shkallë të lartë për sigurinë e cilësisë për publikimin e njëanshëm nga Albpetrolit të dividendëve për qeverinë. Kështu mund të argumentohet se objektivat më të gjera të kërkesës janë përmbushur pavarësisht nga mungesa e rakordimit të dividendëve të Albpetrolit për qeverinë. Prandaj, vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë.

Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet fort që të sigurohet që Raportet EITI të ardhshme të përfshijnë dividendët e Albpetrolit për qeverinë në fushën e rakordimit.

Pagesat e drejtpërdrejta lokale (#4.6)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 nuk ofron një përkufizim materialiteti për pagesat e drejtpërdrejta lokale dhe as hollësi për tippet e ndryshme të pagesave të drejtpërdrejta lokale, dhe është e paqartë nëse NJQV-të ishin përfshirë në fushën e raportimit. Është e dukshme nga diagrama e flukseve të të ardhurave nga nafta dhe gazi në Seksionin 8.1 se NJQV-të mbledhin taksat vendore drejtpërdrejt nga kompanitë e naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f. 79), por diagrama e flukseve të të ardhurave minerare në Seksionin 8.2 nuk i referohet ndonjë pagese nga kompani minerare për NJQV-të (Raporti EITI 2015, f. 80). Raporti deklaron se MSG iu kërkoi kompanive minerare, të naftës dhe gazit të raportojnë çfarëdo pagese lokale prej mbi 5 mijë USD për NJQV-të (Raporti EITI 2015, f. 80). Ky prag për raportimin e taksave vendore u dakordësua në takimin e 29 korrikut 2016 të MSG-së.¹⁰⁰ MSG në fillim kishte vendosur në takimin e 16 tetorit 2015 që të përfshinte pes bashi në fushën e raportimit për pagesa të drejtpërdrejta lokale për Raportet EITI 2013-

⁹⁹ Sipas Tabelës 56 të Raportit EITI 2015, Albpetrol kishte paguar 49 milionë Lek për MZHETTS si dividendë në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 138). Sipas Tabelës 1, të ardhurat totale të qeverisë nga nafta dhe gazi ishin 8590 milionë Lek dhe nga minierat, nafta dhe gazi ishin 12,520 milionë Lek (Raporti EITI 2015, f. 14).

¹⁰⁰ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2016/>

2014.¹⁰¹ Megjithatë Raporti EITI 2015 deklaroi po ashtu se “kur taksat lokale të raportuara ishin mbi 50,000 USD, këto përzgjidheshin për rakordim si pagesa materiale” (Raporti EITI 2015, f.80). Kështu, përzgjedhja e pagesave për t’u rakorduar duket se është bazuar në raportimin prej kompanive materiale.

Raporti EITI 2015 paraqet raportim të kompanive të pagesave të drejtpërdrejta lokale për naftën dhe gazin, por jo minierat. Raporti jep raportimin e kompanive të naftës dhe gazit të “pagesave të tjera për qeveritë vendore” prej 158,688,000 Lek si agregat (Raporti EITI 2015, f.89) dhe rezultatet e rakordimit të disagreguara për tri kompanitë raportuese (Raporti EITI 2015, f.110). Gjithashtu, Tabela 23 tregon se Albpetroli kishte paguar 17.88 milionë Lk në “pagesa të tjera” për qeveritë vendore (Raporti EITI 2015, f. 95). Megjithatë, raporti nuk ofron rezultatet e raportimit të kompanive minerare të “pagesave të tjera për qeveritë vendore” dhe nuk shpjegon nëse kjo ka si shkak mungesat në raportimin e kompanive apo mungesën e këtyre pagesave. Seksioni 11.2.2 thekson raportimin e paplotë nga NJQV-të, duke vërejtur se MSG kishte përzgjedhur “vetëm pak” për raportim bazuar në të dhënat për prodhimin e vitit 2015 nga NJQV-të dhënë AKBN dhe se procesi i raportimit nuk përfshinte të gjitha NJQV-të që mbledhnin të ardhura nga industria nxjerrëse. Raporti vëren se pavarësisht bashkëpunimit midis AlbEITI dhe disa NJQV-ve, “raportimi i tyre ishte i paplotë dhe vinte me vonesa të mëdha” (Raporti EITI 2015, f 98).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP theksoi kufizimet e punës së MSG në përgatitjen e raportimit vjetor EITI, duke pasur parasysh pamundësinë për të marrë publikim të plotë të njëangshme nga NJQV-të përpara vendimeve kryesore për materialitetin. AP shpjegoi se tippet e ndryshme të taksave vendore ishin përcaktuar në Ligjin për Taksat Vendore (përfshi taksën për pronën, taksën për ndikimin në infrastrukturë, taksën për zënien e hapësirës publike, etj.), por se asnjë nga këto nuk ishte specifike për kompanitë që operonin në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit. AP shpjegoi se kompanitë “prireshin të përgjigjeshin” për pagesat e tyre të taksave vendore për NJQV-të në mënyrë të agreguar. AP shpjegoi se informacioni për taksat vendore të mbledhura nga NJQV-të nuk ishte i aksesueshëm publikisht dhe nuk i nënshtrohej auditimeve financiare vjetore. AP vërejtë se do ishte e mundur të kërkohej nga kompanitë dhe NJQV-të të raportonin taksa vendore të disagreguara sipas fluksit të pagesave, por se kjo nuk ishte bërë në të kaluarën. AP konfirmoi se rastet e rakordimit, dmth aty ku NJQV-ve iu ishte kërkuar të raportonin të ardhurat nga taksat vendore, ishin përzgjedhur bazuar në pagesat e raportuara fillimisht nga kompanitë, dmth gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave dhe jo që nga fillimi. AP nuk ishte në gjendje të konfirmonte numrin e NJQV-ve të cilave iu ishin dërguar formularë raportimi për Raportin EITI 2015. Një anëtar nga OSHC në MSG vërejtë se çështja e rakordimit të taksave vendore ishte ngritur në MSG por AP ishte përgjigjur se përfshirja e NJQV-ve në fushën e raportimit do të kishte krijuar punë përtej shtrirjes së punës në TeR të AP-së, mbi të cilat ishte nënshkruar kontrata e AP. Ky përfaqësues i OSHC theksoi rëndësinë e taksave vendore për NJQV-të, të cilat ishin të konsiderueshme për komunitetet vendore edhe nëse nuk dukeshin të konsiderueshme krahasuar me të tjera të ardhura që mbledh qeveria kombëtare.

¹⁰¹ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2015/>

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Është e mundur që punë e mëtejshme mbi këtë çështje do të demonstronte se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme në Shqipëri, sepse duket e mundshme që pagesat lokale për NJQV-të të mos jenë materiale. Megjithatë, MSG ra dakord qartësisht për të përfshirë pagesat lokale për NJQV-të brenda fushës së procesit të raportimit, duke theksuar rëndësinë e këtyre pagesave për komunitetet vendore. Në mungesë të të dhënave përfshirëse të qeverisë, përfaqësja e adoptuar ku NJQV-të përzgjidhen për rakordim bazuar mbi të dhënat nga kompanitë duket e arsyeshme. Megjithatë, duket të ketë boshllëqe të konsiderueshme në raportimin nga kompanitë dhe në pjesëmarrjen e NJQV-ve.

Në përputhje me Kërkesën 4.6, MSG duhet të ndërmarrë shqyrtim të përshtatshëm të pagesave të drejtpërdrejta lokale nga kompanitë nxjerrëse për NJQV-të, duke ngritur një bazë përfshirëse për diskutimet e materialitetit në MSG në lidhje me pagesat për NJQV-të. MSG mund të dojë të shqyrtojë përfaqësen e kampionimit, e cila do t'i lejonte këto pagesa të hetoheshin pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi.

Niveli i disagregimit (#4.7)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 paraqet informacion të rakorduar për pagesat dhe të ardhurat të disagreguar sipas kompanive dhe fluksit të të ardhurave (dhe për pasojë sipas entit qeveritar marrës) për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2015, f. 108-110) dhe minierat (Raporti EITI 2015, f. 111-129). Raporti jep hollësi mbi kufizimet për raportimin EITI mbi bazë projekti, duke vërejtur se taksat dhe detyrimet llogariten në nivel kompanie të konsoliduar (për kompanitë që mbajnë disa licensa) dhe se agjencitë që mbledhin të ardhura, përfshi Tatimet, Doganat, Drejtoritë Vendore të Taksave, NJQV-të, Ministrinë dhe të tjera ente publike mbajnë të dhëna vetëm për Numrin Unik të Identifikimit Tatimor (NIPT) (Raporti EITI 2015, f. 82).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Një anëtar i OSHC në MSG deklaroi se MSG nuk e kishte diskutuar çështjen e disagregimit në nivel projekti për të dhëna të rakorduara EITI. Kur u pyet nëse MSG kishte shqyrtuar mundësinë e raportimit në nivel projekti, AP deklaroi se ushtrimi nuk ishte i mundur sepse Ligjet për Taksat dhe Kompanitë nuk kërkonin llogaritjen e detyrimeve tatimore mbi bazë projekti. AP vërejt se ndërkohë që renta “mund të llogaritej në një masë të caktuar” në nivel projekti në sektorin e naftës dhe gazit, nuk mund të thoshte të njëjtën gjë për sektorin minerar. AP deklaroi se nuk do ishte e mundur për qeverinë të raportonte në bazë projekti nga pikëpamja afatshkurtër, duke qenë se kjo do kërkonte amendamente në MIS dhe strukturën e raportimit fiskal të Thesarit meqenëse aktualisht merrte vetëm pagesa të lidhura me numrat ID tatimor të kompanive dhe fluksit të pagesave. AP konfirmoi se Tatimi mbi Fitimin dhe taksa të tjera vendoseshin mbi bazë korporative të konsoliduar, ndërkohë që vetëm AKBN dhe Albpetroli kërkonin që të dhënat për prodhimin dhe bonuset të raportoheshin nga kompanitë e naftës dhe gazit të disagreguara sipas licensës. Megjithatë, AP shprehu pasiguri lidhur me nëse AKBN llogariste detyrimet e kompanive minerare mbi bazë licensë. AP po ashtu vërejt se disa kompani mund mos ishin të përgatitura për të raportuar mbi bazë licensë, duke qenë se kompanitë më të vogla dhe të mesme prireshin të kishin kuadër menaxhimi dhe

kontabiliteti më pak të zhvilluara. AP mendonte se do duheshin të paktën “dy vjet” që Shqipëria të kalonte nga raportimi në nivel projekti, duke pasur parasysh nevojën për studime fizibiliteti dhe ndikimi, shqyrtim e duhur ligjor, ndryshime të mundshme legjislative dhe kontraktuale dhe kohë të mjaftueshme për të reformuar sistemet e informacionit kontabël si dhe praktikën e agjentëve fiskalë dhe kompanive.

Fakti që 527 kompani mbanin 626 licenca dukej se nënkuptonte se të paktën një pjesë e kompanive minerare administronin vetëm një minierë, çka reflektohet në regjistrin e licensave minerare në faqet e internetit të MEI dhe AlbEITI, të cilat përfshijnë numrat e identifikimit tatimor të disa kompanive.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 paraqet informacion të rakorduar disa sipas kompanisë, fluksit të të ardhurave dhe entit qeveritar.

Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën mund të bëjë përparim në zbatimin e raportimit EITI në nivel projekti të detyrimeve dhe taksave përpara afatit për të gjitha Raportet EITI që mbulojnë periudha fiskale që përfundojnë më ose pas 31 dhjetorit 2018, dakordësuar nga Bordi EITI në mbledhjen e tij të 36të në Bogota.

Të dhënat në kohë (#4.8)

Dokumentimi i përparimit

Shqipëria publikoi Raportin EITI 2012 në nëntor 2014, Raportin EITI 2013-2014 në dhjetor 2015 dhe Raportin EITI 2015 në shkurt 2017,¹⁰² ndonëse drafti i publikuar në faqen e AlbEITI thotë dhjetor 2016.¹⁰³ Raporti EITI 2015 konfirmon se periudha e raportimit është viti fiskal që mbaron më 31 dhjetor 2015 (Raporti EITI 2015, f.6).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Të gjithë anëtarët e MSG shprehën kënaqësi për faktin që Shqipëria kishte siguruar raportim më në kohë krahasuar me periudhën e mbuluar nga Validimi i parë i Shqipërisë, sipas Rregullave EITI. Megjithatë, një numër OSHC-sh dhe gazetarësh deklaruan se të dhënat do të ishin më të dobishme nëse Raportet EITI do të botoheshin brenda një viti nga fundi i periudhës fiskale në shqyrtim. Një numër përfaqësuesish të qeverisë u bënë jehonë këtyre shqetësimeve lidhur me kohën e raportimit EITI, duke u shprehur se të dhënat EITI më në kohë do të ishin më të efektshme për të mbështetur politikëbërjen e informuar dhe komunikime të efektshme me komunitetin e investuesve. Një përfaqësues i qeverisë pyeti në lidhje me mundësinë që AlbEITI të prodhonte raporte të përkohshme tremujore përpara Raportit EITI vjetor. Një

¹⁰² <http://www.albeiti.org/year-2017/>

¹⁰³ http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2017/04/EITI-REPORT-2015_FINAL_ENG_FINAL.pdf

numër përfaqësuesish të qeverisë dhe industrisë vërejtën se kërkohej që pasqyrat financiare si të kompanive ashtu edhe të qeverisë do duhej të paraqiteshin përpara qershorit të vitit pasardhës, çka nënkuptonte se mbledhja e të dhënave mund të fillonte brenda gjashtë muajsh nga fundi i periudhës fiskale që mbulohej. Një numër përfaqësuesish të industrisë në dhe jashtë MSG kërkuan integrimin e raportimit EITI në raportimin e detyrueshëm të kompanive tek qeveria. Personeli i sekretariatit theksoi dispozitat e projekt Ligjit për Kontabilitetin dhe Raportimin Financiar, i cili nëse miratohej do ta integronte raportimin EITI të kompanive në kërkesat e tyre statutores të raportimit (përfshi balance të audituara, aty ku është e aplikueshme) (*shih Kërkesa 4.9*).

Gjatë konsultimeve të Sekretariatit Ndërkombëtar me grupet e interesit për këtë vlerësim fillestar, u bë e qartë që versioni i Raportit EITI 2015 në faqen e internetit AlbEITI (në qershor 2017) ishte i ndryshëm nga ai i miratuar nga MSG në shkurt 2017 dhe me versionin e publikuar në faqen e AlbEITI në fillim të Validimit të Shqipërisë, më 1 prill 2017. Pas shqyrtimit të dy versioneve, Sekretariati Ndërkombëtar gjeti se versioni i përditësuar (aktualisht në faqen e internetit AlbEITI¹⁰⁴) kishte ndryshuar rezultatet e rakordimit, sidomos në faktin që mospërputhjet e parakorduara ishin rritur nga rreth 1 milionë Lek në versionin original në 13 milionë Lek në versionin e rishikuar. Personeli i Sekretariatit dhe AP shpjeguan se rishikimet kishin ardhur për shkak të mbërritjes vonë të formularëve të raportimit nga disa kompani, çka kishte ndryshuar rezultatet e rakordimit. AP kishte amenduar Raportin EITI 2015 teksa bënte layout të botimit në shtypshkronjë, por nuk i kishte theksuar ndryshimet pranë Sekretariatit AlbEITI, sipas personelit të sekretariatit. Personeli shpjegoi se e kishin kuptuar mospërputhjen vetëm gjatë konsultimeve të Sekretariatit Ndërkombëtar me grupet e interesit dhe se MSG nuk ishte ende në dijeni të mospërputhjeve. Kështu, numrat e faqeve referuar në këtë vlerësim fillestar nuk janë në linjë me versionin e Raportit EITI 2015 në faqen e internetit të AlbEITI, por janë në përputhje me versionin e Raportit EITI 2015 në faqen e Shqipërisë të faqes globale të EITI-t.¹⁰⁵

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Të gjitha Raportet EITI të Shqipërisë sipas Standardit EITI janë publikuar brenda dy vitesh nga mbyllja e vitit (viteve) fiskal në shqyrtim. Megjithatë, fakti që vula e kohës në Raportin EITI 2015 shënohet sikur është dy muaj përpara botimit faktik të raportit, si dhe fakti që një version i ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme i Raportit EITI 2015 ishte publikuar pa miratimin (ose dijeninë) e MSG është shqetësim. Në të ardhmen, çdo përditësim i Raportit EITI duhet sjellë në vëmendjen e MSG. Kjo shtjellohet më tej në vlerësimin e mbikqyrjes së MSG më sipër (*shih Kërkesa 1.4*).

Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të ndërmjetësojë me agjencitë e grumbullimit të të ardhurave dhe rregullatorët e sektorit për të eksploruar mjetet e përfshirjes së publikimeve të informacionit të të kërkuar nga EITI në sistemet rutinë të qeverisë për të siguruar raportim EITI më në kohë.

¹⁰⁴ http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2017/04/EITI-REPORT-2015_FINAL_ENG_FINAL.pdf

¹⁰⁵ https://eiti.org/sites/default/files/documents/2015_albania_eiti_report.pdf

Cilësia e të dhënave (#4.9)

Dokumentimi i përparimit

Termt e Referencës për Administratorin e Pavarur: MSG miratoi TeR për AP të Raportit EITI 2015 me qarkore më 1 mars 2016, pasi i kishte marrë projekt-TeR për komente dy javë më herët.¹⁰⁶ MSG kishte miratuar TeR të AP për Raportet EITI 2011-2012 më 13 shkurt 2014¹⁰⁷ dhe TeR për Raportet EITI 2013-2014 më 13 qershor 2015.¹⁰⁸ TeR për Raportin EITI 2015 është përgjithësisht konseguent me TeR standarde të miratuara nga Bordi EITI (deri në mars 2016).¹⁰⁹ MSG plotësoi shtojcat e TeR për rakordimet duke përvijuar vendimet fillestare për materialitetin dhe cilësinë e të dhënave dhe TeR konfirmojnë nevojën që MSG dhe AP të dakordësojnë pragjet e materialitetit për përzgjedhjen e kompanive dhe flukset e të ardhurave gjatë fazës fillestare.

Emërimi i Administratorit të Pavarur (AP): Me financim nga grantet e Bankës Botërore nëpërmjet Fondit të Trustit Multi-Donatorësh (MDTF), prokurimi i AP ndoqi udhëzimet e prokurimit të Bankës Botërore nëpërmjet tenderimit konkurrues, ku Sekretariati AlbEITI shërbeu si enti i prokurimit për të gjitha kontratat. TeR të AP, vlerësimi i ofertave dhe përzgjedhja e ofertës fituese të gjitha iu paraqitën Bankës Botërore për të siguruar se “nuk ka kundërshtim” për secilën nga tri proceset e prokurimit për AP-të (për Raportet EITI që mbulojnë 2011-12, 2013-14 dhe 2015-16). Deloitte Audit Albania ishte ofertuesi fitues për të tria proceset e prokurimit për AP-të sipas Standardit EITI, duke mbuluar gjashtë vite fiskale. Raundi i parë dhe i tretë i prokurimit (që mbulonte vitet 2011-12 dhe 2015-16) bazoheshin në kualifikimet e konsulentit, ndërkohë që raundi i dytë (2013-14) u bazua në prokurimin përsëritës me një burim (single-source). Nuk ka të dhëna që MSG të jetë përfshirë në vlerësimin dhe përzgjedhjen e ofertuesve për Raportin EITI 2015 dhe duket se komiteti për vlerësimin e ofertave për Raportin EITI 2015-16 përbëhej ekskluzivisht nga personeli i sekretariatit AlbEITI. Si Banka Botërore ashtu edhe MEI ndërmorën auditime të brendshme pas-akordimi, përfshi prokurimin e AP. Datat e hapave kryesore në procesin e prokurimit paraqiten më poshtë, me burim Sekretariatit AlbEITI:

Përshkrim	Metoda	Miratimi i TeR të AP nga MSG	Banka Botërore S'ka Kundërshtim	Reklama EOI	Raporti i Vlerësimit	Banka S'ka Kundërshtim	Nënshkrimi i Kontratës	Emri i kompanisë	Përmbushja e Kontratës
AP për Raportet EITI 2011-2012	CS - CQ	15-Mar-14	6-Mar-14	10-Mar-14	2-Prill-14	30-Prill-14	2-Maj-14	Deloitte Albania	31-Tetor-14

¹⁰⁶ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2016/>

¹⁰⁷ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2014/>

¹⁰⁸ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2015/>

¹⁰⁹ Shih krahasimin e TeR për Raportin EITI 2015 dhe formularin e miratuar nga Bordi në faqen krahasuese PDF: <https://draftable.com/compare/rrAWnAeZiPxY>

AP për Raportet EITI 2013-2014	CS - SSS	2-Qer-15	-	-	-	3-Korrik-15	14-Korrik-15	Deloitte Audit Albania	30-Nëntor-15
AP për Raportet EITI 2015-2016	CS - CQ	6-Maj-16	14-Maj-16	19-Maj-16	18-Qer-16	13-Korrik-16	18-Korrik-16	Deloitte Audit Albania	31-Dhjetor-17

Burimi: Sekretariati AlbEITI.

Formularët e raportimit: Formularët e raportimit u dakordësuan nga MSG në gusht 2016 (Raporti EITI 2015, f. 84). Raporti ngre shqetësime lidhur me strukturën e formularëve të raportimit EITI, të cilat u dakordësuan në mars 2011 me VKM 233 dhe nuk pasqyrojnë ndryshimet në Standardin EITI, si dhe rekomandon rishikimin e tyre në dritën e Standardit EITI dhe në strukturën e industrisë (Raporti EITI 2015, f.104-105). AP zhvilloi një workshop për entet raportuese, duke ofruar udhëzime mbi plotësimin e formularëve të raportimit EITI, më 6 shtator 2016 (Raporti EITI 2015, f.85).

Shqyrtimi i praktikave të auditimit: Raporti EITI 2015 ofron një përmbledhje të procedurave statutores të auditimit të AP për kompanitë private përfshi pragjet¹¹⁰ për auditime të jashtme statutores, kërkesën statutores të auditimit të jashtëm për kompanitë shpk “që zgjedhin të raportojnë sipas IFRS” (edhe pse nuk është e qartë nëse SHPK-të kanë mundësinë të mos raportojnë sipas IFRS), kërkesat statutores të auditimit për të gjitha kompanitë me aksionerë pavarësisht nga përmasat e tyre, dhe përjashtimin nga auditimet statutores për të degët e kompanive të huaja që nuk raportojnë sipas IFRS (Raporti EITI 2015, f. 77). Raporti po ashtu deklaron se auditimi i pavarur i koncesioneve të naftës dhe gazit dhe performanca e partneriteteve publike-private nuk kërkohet si pjesë e auditimit vjetor statutor (Raporti EITI 2015, f. 77). Raporti konfirmon se auditimet statutores të kompanive private bazohen në ligje, rregullore dhe standarte që janë “përgjithësisht të pranuar në Shqipëri, përfshi Standartet Ndërkombëtare të Auditimit” (Raporti EITI 2015, f.77). Për sa i përket praktikës faktike të auditimit për kompanitë materiale në Raportin EITI 2015, raporti pohon se “shumë të licensuarve” nuk iu kërkohej të kalonin një auditim statutor duke pasur parasysh formën e tyre të inkuorporimit, si degë të kompanive të huaja, ose përmasat e vogla (Raporti EITI 2015, f. 97) por nuk ofron një listë përfshirëse të praktikave të raportimit për secilën prej kompanive materiale. Raporti nuk kategorizon qartë kompanitë materiale që janë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, kompani me aksionerë dhe degë të kompanive të huaja. Raporti rekomandon “ndjekje dhe aplikim strikt” të raportim financiar dhe auditim të pasqyrave financiare të kompanive nxjerrëse (Raporti EITI 2015, f.97).

¹¹⁰ Në linjë me Ligjin për Auditimet nr. 10091 të 5 marsit 2009, se të gjitha kompanitë me përgjegjësi të kufizuar (shpk) i nënshtrohen auditimeve statutores, përpos kompanive të vogla (përkufizuar si të tilla me asetet totale prej më pak se 40 milionë Lek, mesatarisht më pak se 30 punonjës dhe të ardhura vjetore më pak se 30 milionë Lek).

Raporti tregon se pasqyrat financiare i paraqiten Qendrës Kombëtare të Regjistrimit¹¹¹ deri më 31 korrikun e vitit kalendarik pasues (Raporti EITI 2015, f. 77) por nuk pohon shprehimisht nëse të gjitha pasqyrat financiare të kompanive materiale janë në dispozicion nga QKR aty ku është e aplikueshme.

Për sa i përket procedurave të auditimit për entet qeveritare, Raporti EITI 2015 paraqet një përmbledhje të shqyrtimit nga AP përfshi një përshkrim të Kontrollit të Lartë të Shtetit (Raporti EITI 2015, f. 77-78). Raporti ofron një link për në Zyrën e Kontrollit të Lartë të Shtetit,¹¹² ku gjendet informacion mbi standartet dhe udhëzimet e auditimit, dhe konfirmon se standartet shqiptare të auditimit janë në përputhje me standartet INTOSAI (Raporti EITI 2015, f. 78). Raporti nuk deklarohet nëse raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2015 iu paraqit AP në përgatitje të Raportin EITI 2015, edhe pse duket se të gjitha entet qeveritare paraqitën kopje të pasqyrave financiare të tyre të audituara pranë AP përveç AKBN (Raporti EITI 2015, f.86).

Metodologjia e sigurimit: Ndërkohë që Raporti EITI 2015 deklaron se “asnjë kërkesë e posaçme auditimi nuk u imponua në lidhje me shifrat e raportuara sipas EITI” (Raporti EITI 2015, f. 77), bazuar në rezultatet e mbledhjes së të dhënave duket se ente qeveritare të tilla si Albpetrol, KESH dhe AKBN iu kërkua t’i paraqisnin AP kopje të pasqyrave financiare të tyre të audituara të 2015 (Raporti EITI 2015, f. 86). Formularët e raportimit nga të gjitha entet raportuese, përfshi kompanitë dhe qeverinë, kërkohej të nënshkruheshin nga një zyrtar i nivelit të lartë, “për të vërtetuar se formulari i raportimit i plotësuar është i plotë dhe i saktë” (Raporti EITI 2015, f. 86, 92). Bazuar në rezultatet e mbledhjes së të dhënave se AP u përpoq, pa sukses, të krahasonte formularët e raportimit EITI të qeverisë me llogaritë vjetore të botuara, çka nuk ishte e mundur për shkak të mungesës së disagregimit sipas flukseve të të ardhurave të të dhënave të publikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (Raporti EITI 2015, f.86).

Cash vs të përlllogaritura: Raporti EITI 2015 nuk deklaron qartë nëse raportimi EITI u ndërmor mbi bazë cash apo përlllogaritur. Theksohet një prej arsyeve kryesore për mospërputhje në rakordimin e të ardhurave për naftën dhe gazin “raportuan flukset e përlllogaritura kundrejt flukset cash,” duke nënkuptuar se raportimi EITI ishte mbi bazë cash (f. 90). Megjithatë, baza e raportimit mbetet e paqartë në Raportin EITI 2015. Për shembull, raportimi i transfertave lokale të rentave për 2015 në Tabelën 15 përfshin transferta që lidhen me renta të 2015 të ekzekutuara në vitin 2016, pra mbi bazë faktike (Raporti EITI 2015, f. 76).

Konfidencialiteti: Raporti EITI 2015 nuk i referohet ndonjë mekanizmi të vendosur midis MSG dhe AP për të siguruar trajtimin konfidencial të para-rakordimit për raportimin EITI. Megjithatë, raporti përshkruan sfida të shkaktuara nga dispozitat e konfidencialitetit të ligjeve të tatimeve dhe doganave, të cilat parandalojnë publikimin e informacionit të pagesave të kompanisë pa pëlqimin me shkrim të kompanisë

¹¹¹ www.qkr.gov.al

¹¹² <http://www.klsh.org.al/>

(Raporti EITI 2015, f. 104). Ndërkohë që raporti përshkruan heqjen dorë nga konfidencialiteti të zhvilluar për qëllimet e raportimit EITI, ai deklaron se “më pak se 50” nga 134 kompanitë materiale ofruan kërkesa zyrtare me shkrim për këtë qëllim (Raporti EITI 2015, f. 104). Raporti nuk paraqet një listë përfshirëse të kompanive që paraqitën kërkesa me shkrim për heqjen dorë nga konfidencialiteti, as nuk përshkruan implikimet e mungesës së këtyre kërkesave nga më shumë se 84 kompani materiale për aftësinë e qeverisë për të publikuar informacion mbi të ardhurat të disagreguar sipas kompanisë dhe fluksit të të ardhurave.

Gjithashtu, rekomandimi i AP për MSG për t’i kërkuar enteve raportuese të dakordësonin me zyrat tatimore rajonale shumë e taksave të paguara për vitin në shqyrtim përpara se të paraqisnin formularët e tyre të raportimit EITI përbën shqetësim (Raporti EITI 2015, f. 97), sepse kjo duket sikur minon pavarësinë e procesit të rakordimit.

Mbulimi i rakordimit: Ndërkohë që Raporti EITI 2015 nuk ofron mbulimin total të rakordimit, ai deklaron se përzgjedhja e kompanive materiale minerare ofronte një mbulim rakordimi prej 89% të “vlerës së përlloritur të prodhimit mineral në vitin 2015” (Raporti EITI 2015, f. 81), jo si pjesë e të ardhurave totale të qeverisë. Duke qenë se të gjitha kompanitë e naftës dhe gazit që operojnë në Shqipëri përfshiheshin në fushën e raportimit, mund të konkludohet se mbulimi i rakordimit për të ardhurat specifike të sektorit të naftës dhe gazit ishte 100%.

Mungesat e sigurisë: Raporti EITI 2015 deklaron se tetë nga nëntë kompanitë raportuese të naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f. 90) dhe katër nga 104 kompanitë raportuese minerare (Raporti EITI 2015, f. 92) dorëzuan “deklarata dhe autorizime zyrtare të nënshkuara për publikimin e të dhënave, përveç deklarimeve elektronike të paraqitura më herët me email” (Raporti EITI 2015, f. 90, 92). Megjithatë, raporti deklaron se asnjë prej 122 kompanive raportuese (nga 134 kompani materiale) nuk e dorëzoi letrën e kërkuar nga audituesit e tyre të jashtëm dhe se vetëm 15 kompani paraqitën miratimin nga një zyrtar i lartë (Raporti EITI 2015, f. 86). Më tej, raporti shpjegon se AP “kupton” se kërkesa për certifikim nga auditues të jashtëm shoqërohet nga kosto shtesë dhe rekomandon që MSG ta përfshijë certifikimin e raportimit EITI në auditimet e zakonshme të kompanive dhe që të gjitha kompanitë t’i nënshtrohen auditimit pavarësisht formës së tyre ligjore (Raporti EITI 2015, f.86, 97).

Raporti po ashtu deklaron se AKBN nuk i paraqiti pasqyrat financiare të veta të audituara dhe nuk ishte në gjendje të rakordonte raportimin qeveritar EITI me pasqyrat financiare nga Albpetroli, AKBN, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Doganave për shkak të mungesës së disagregimit në llogaritë e tyre vjetore (Raporti EITI 2015, f. 86). Raporti nuk sqaron nëse ndonjë prej formularëve të raportimit nga entet qeveritare shoqërohej nga letra certifikimi nga zyrtarë të nivelit të lartë.

Raporti nuk i identifikon 15 kompanitë që ofruan letra certifikimi nga menaxherët dhe nuk vlerëson materialitetin e atyre që nuk janë përfshirë, përfshi nga AKBN.

Vlerësim i besueshmërisë së të dhënave: Raporti EITI 2015 ofron një vështrim të shpejtë të punës së kryer nga AP përfshi mbledhjen e të dhënave, rakordimin, hartimin e informacionit kontekstual, hartimin e rekomandimeve (Raporti EITI 2015, f. 9, 83-87). Raporti po ashtu përfshin mospranimin e qartë nga ana

e AP të sigurisë për tërësinë apo saktësinë e raportit:

“Ky proces [raportimi EITI] nuk konfirmon se nuk kishte pagesa të tjera të kryera tek qeveria përveç atyre që janë raportuar, sepse të tilla shuma mund të jenë lënë jashtë në raportim nga të licensuarit dhe agjencitë qeveritare në të njëjtën kohë. Rregullimet aktuale nuk na kërkojnë të kryejmë testime të hollësishme me qëllim që të zbulojmë përjashtime të tilla; dhe zbulimi i këtyre përjashtimeve do të ishte i vështirë edhe nëpërmjet testimit të hollësishëm të të gjithë të licensuarve.” (Raporti EITI 2015, f. 87)

Burimi i informacionit: I gjithë informacioni kontekstual duket se citon burime të qarta në Raportin EITI 2015. Raporti nuk duket se përfshin komente nga grupet e interesit përveç AP. Raporti po ashtu ofron një listë të dokumenteve burimore mbi të cilat ishte bazuar mbledhja fillestare e informacionit kontekstual nga ana e AP (Raporti EITI 2015, f. 84).

Të dhënat përmbledhëse: AP duket se ka përgatitur tabela përmbledhëse të të dhënave EITI në linjë me dispozitën 5.3 të TeR për Raportin EITI 2015, të cilat janë në dispozicion në faqen kombëtare të AlbEITI¹¹³ dhe në faqen e Shqipërisë në faqen globale të EITI-t.¹¹⁴

Rekomandime: Raporti nuk shqyrton ndjekjen e rekomandimeve nga Raporte EITI apo Validim të mëparshëm.

Kapitulli 11 paraqet 14 rekomandime nga Raporti EITI 2015, përfshi një shumicë rekomandimesh lidhur me reforma më të gjera në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit si dhe në menaxhimin financiar publik (Raporti EITI 2015, f. 96-105).

Raporti EITI 2013-14 paraqet një vështrim të procedurave statutores të auditimit për qeverinë dhe kompanitë (Raporti EITI 2013-14, f.72), por jo të praktikës aktuale për periudhën në shqyrtim apo të ndonjë reforme të planifikuar apo në proces. Ashtu si në Raportin EITI pasues (2015), vetëm 15 kompani raportuese ofruan miratim me firmën e një zyrtari të lartë dhe asnjë nuk paraqiti letra nga audituesit e tyre të jashtëm (Raporti EITI 2013-14, f.83). Po kështu, AKBN nuk paraqiti kopje të pasqyrave financiare të audituara (Raporti EITI 2013-14, f.18). AP nuk vlerësoi materialitetin e pagesave nga entet moszbatuese dhe as nuk ofroi ndonjë siguri për besueshmërinë e të dhënave të raportuara.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Prokurimi i AP: Të gjithë anëtarët e MSG konfirmuan se ndërkohë që Sekretariati AlbEITI përgatiti një draft të parë të TeR të AP, anëtarët e MSG ofruan input për projekt TeR dhe i miratuan ato çdo vit. Një numër anëtarësh nga OSHC në MSG ishin shumë kritikë për procesin e prokurimit të AP, duke vërejtur se as përfaqësues të shoqërisë civile as të industrisë nuk ishin përfaqësuar në komisionin për vlerësimin e

¹¹³ <http://www.albeiti.org/en/>

¹¹⁴ <https://eiti.org/albania#revenue-collection>

ofertave prej prokurimit të Raportit EITI 2010. Duke vërejtur se kishte pasur interes të madh nga tenderuesit për atë raport, me rreth 10 oferta, një nga OSHC-të shprehu pretendime për bashkëpunim të fshehtë mes ofertuesit të suksesshëm për raportet pasuese (Deloitte) dhe zyrtarë të lartë të qeverisë, ndonëse pa ofruar fakte specifike. Një zyrtar i lartë i qeverisë u shpreh se shqetësimet e OSHC lidhur me prokurimin e AP ishin trajtuar dhe vërejtë se kërkesa të tilla mund të ishin lidhur me dëshirën e OSHC për të marrë kontrata me pagesë për aktivitete EITI. Personeli i sekretariatit konfirmoi se MSG nuk i ishte raportuar lidhur me përparimin në prokurimin e AP midis kohës kur morën TeR të AP dhe nënshkrimit të kontratës së AP. Personeli i sekretariatit theksoi e marrëveshja e grantit e Bankës Botërore me qeverinë deklaronte shprehimisht se Sekretariati AlbEITI ishte enti prokurues dhe prandaj ishte përgjegjësia e tij e vetme që të vlerësonte ofertat, duke vërejtur se përfshirja e anëtarëve të MSG në komisionin për vlerësimin e ofertave për Raportet EITI 2009 dhe 2010 ishte thjesht honorifik. Në përgjigje të pretendimeve të OSHC-ve për keqmenaxhim financiar, personeli i Sekretariatit theksoi se procesi prokurimit të AP ishte kontrolluar nga katër auditime dhe se faqja e internetit AlbEITI paraqiste të gjithë informacionin e nevojshëm për financat e AlbEITI, përfshi raportet e auditimit. AP deklaroi se nuk ishte në dijeni të komenteve të ndonjë aktori lidhur me procesin e prokurimit të AP dhe se ishte i kënaqur me procesin. Pavarësisht shqetësimeve të cituara më sipër, të gjithë anëtarët e MSG që u konsultuan, përfshi nga shoqëria civile, shprehën besim në profesionalizmin e Deloitte Albania si AP.

Formularët e raportimit: Ndërkohë që një anëtar nga OSHC në MSG deklaroi se formularët e raportimit fillimisht ishin dakordësuar në vitin 2011 dhe nuk ishin rishikuar për Raportet EITI pasuese, një numër anëtarësh të MSG nga qeveria dhe industria konfirmuan se projekt-formularët e raportimit ishin miratuar si pjesë e rishikimit nga MSG të raportit fillestar çdo vit. AP shpjegoi se ndërkohë që Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) 233 i marsit 2011 kishte miratuar përmbajtjen e formularëve të raportimit EITI, nuk e kishte ndaluar MSG të përfshinte elementë shtesë në formularët pasues, siç kishte bërë MSG për shembull duke përfshirë informacionin për pronësinë reale. Në fakt, VKM 233 ishte për qëllime zbatimi, pas përfshirjes së kërkesave për raportim të detyruar në Ligjin për Minierat dhe Hidrokarburet, meqenëse kishte miratuar pikat se kompanitë minerare, të naftës dhe gazit ishin të detyruara t'i raportonin EITI-t. Shtesat e MSG në formularët e raportimit miratuar me VKM 233 në këtë mënyrë nuk ishin të zbatueshme me ligj, sipas AP. AP theksoi se projekt ligji për Transparencën në Administratën Publike do ta lejonte AlbEITI-n të shtonte kërkesa raportimi të detyrueshëm në formularët e raportimit me anë të rregulloreve dytësore të zbatimit.

Praktikat e auditimit: Në lidhje me praktikat e auditimit të kompanive, AP konfirmoi se ndërkohë që "shumica" e kompanive minerare, të naftës dhe gazit i nënshtroheshin auditimeve statutorë, ku pasqyrat financiare përgatiteshin mbi bazë kontabiliteti faktik, kompanitë më të vogla në mënyrë tipike nuk kishin pasqyra financiare të audituara. AP po ashtu shpjegoi se ndërkohë që kishte ndërmarrë një rishikim të procedurave statutorë të auditimit për kompanitë nxjerrëse gjatë fazes fillestare të Raportit EITI 2015, nuk kishte rishikuar me hollësi praktikat e auditimit për çdo kompani materiale për vitin 2015 përpara grumbullimit të të dhënave. Në vend të kësaj, kishte kërkuar kopje të pasqyrave financiare të audituara të kompanive materiale si pjesë e mbledhjes së të dhënave dhe këto pasqyra financiare i kishte marrë nga disa por jo nga të gjitha kompanitë raportuese. AP theksoi rekomandimin në Raportin EITI 2015 për të forcuar zbatimin e kërkesave për auditimin statutor. Ekzistonte konfuzion i konsiderueshëm në lidhje me nëse pasqyrat financiare të audituara të kompanive ishin lirisht të aksesueshme nga publiku, kun një numër përfaqësuesish të qeverisë dhe personeli i Sekretariatit konfirmuan se pasqyrat financiare të

audituar ishin të aksesueshme falas nga faqja e QKR-së, ndërkohë që disa përfaqësues të medias dhe shoqërisë civile u shprehën se këto ishin në dispozicion vetëm me kërkesë për Drejtorinë e Tatimeve, e cila normalisht nuk i bënte publike. Pas hulumtimit, Sekretariati Ndërkombëtar konfirmoi se pasqyrat financiare të audituara ishin të aksesueshme në faqen e QKR-së¹¹⁵ (për kompanitë të cilave iu kërkohet të ndërmarrin të tilla auditime statutore), ndonëse procesi për t'i aksesuar ato përbëhej nga disa hapa që nuk ishin sqaruar qartë në faqen e internetit.¹¹⁶ As personeli i Sekretariatit dhe as AP nuk kishin shqyrtuar mundësinë për t'i ofruar publikut udhëzime mbi procesin për të aksesuar pasqyrat financiare të audituara por mendonin se kjo do të ishte një vlerë e shtuar ofruar nga AlbEITI në të ardhmen.

Në lidhje me praktikën e auditimit të *qeverisë*, AP vërejti se entet qeveritare nuk publikonin pasqyrat financiare që dregonin të ardhurat të disagreguara sipas industrisë apo fluksit të të ardhurave dhe nuk i nënshtroheshin auditimeve financiare vjetore. Në vend të auditimeve financiare, AP dhe përfaqësuesit e qeverisë konfirmuan se Zyra e Kontrollit të Lartë të Shtetit ndërmerre vetëm auditime performance dhe përputhshmërie të enteve qeveritare në linjë me ISSAI 400¹¹⁷ të INTOSAI mbi Parimet Themelore të Auditimit për Përputhshmëri dhe ISSAI 300¹¹⁸ mbi Parimet Themelore të Auditimit të Performancës për performancën respektivisht.

AP vërejti se nuk e kishte të mundur që të shqyrtonte praktikën faktike të auditimit të çdo enti qeveritar për vitin në shqyrtim gjatë fazës fillestare për Raportin EITI 2015, duke pasur parasysh mungesën e auditimeve financiare. Përfaqësues nga Kontrolli i Lartë i Shtetit konfirmuan se nuk kishin ndërvepruar ndonjëherë me AlbEITI-n përpara konsultimeve të Sekretariatit Ndërkombëtar për Validimin me grupet e interesit. Përfaqësues të qeverisë shpjeguan se përmbledhje të raporteve të Kontrollit të Lartë të Shtetit ishin në faqen e internetit të institucionit, përfshi raportet vjetore,¹¹⁹ raportet tremujore¹²⁰ dhe manualin e procedurave të Kontrollit të Lartë të Shtetit,¹²¹ edhe pse raportet më të fundit përmbledhëse në gjuhën anglisht datojnë prej vitit 2011.¹²² Me ligj, llogaritë financiare i dorëzohen Kontrollit të Lartë të Shtetit deri më 30 maj të vitit që pason periudhën e raportimit, ku audituesi i raporton Parlamentit në shtator dhe paraqet raportin vjetor të auditimit në parlament në mars të vitit pasardhës (Banka Botërore, 2012). Përfaqësuesit e qeverisë konfirmuan se kreu i Kontrollit të Lartë kishte ndërmarrë edhe auditime performance të AKBN dhe, prej vitit 2015, të Albpetrolit. Disa përfaqësues nga qeveria, media, shoqëria civile dhe partnerë zhvillimi theksojnë gjetje sensacionale të raporteve të kaluara të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të cilat përfshinin pretendime për keqmenaxhim financiar. Megjithatë, një numër partnerësh zhvillimi dhe përfaqësues të qeverisë shprehën shqetësim për natyrën e politizuar të auditimeve të tilla.

¹¹⁵ <http://www.qkr.gov.al/>

¹¹⁶ Për të aksesuar pasqyrat financiare të audituara të një kompanie, në fillim duhet të kërkosh emrin e kompanisë në faqen e QKR, të klikosh “download historical extracts” me qëllim që të shkarkosh një PDF me hyperlink për të gjitha dokumentet historike (në shqip) dhe të lundrosh deri në pasqyrat financiare të audituara që kërkohen (“Balanci Kontabël”) ime qëllim që të shkarkohet një tjetër PDF me pasqyrat e dëshiruara financiare të audituara.

¹¹⁷ <http://www.intosai.org/issai-executive-summaries/view/article/issai-400-fundamental-principles-of-compliance-auditing.html>

¹¹⁸ <http://www.intosai.org/issai-executive-summaries/view/article/issai-300-fundamental-principles-of-performance-auditing.html>

¹¹⁹ http://www.klsh.org.al/web/Raporte_Auditimi_Rregullshmerie_1770_1.php

¹²⁰ http://www.klsh.org.al/web/Buletini_i_Auditimeve_80_1.php

¹²¹ http://www.klsh.org.al/web/Standarde_dhe_Manuale_1328_1.php

¹²² http://www.klsh.org.al/web/raporti_buxh_2011_ang_328.pdf

Një numër përfaqësuesish nga qeveria dhe partnerët e zhvillimit theksuan mbështetjen për reformat e Kontrollit të Lartë të Shtetit nga OECD dhe BE nën programin SIGMA¹²³, në kolonën e gjashtë të reformave PFM të Shqipërisë kërkuar si pjesë e anëtarësimit të saj në BE. Ndërkohë që vlerësimi për Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënia Financiare (PEFA) e Shqipërisë për 2017 ishte duke u përgatitur në kohën e konsultimeve me grupet e interesit për Validimin, vlerësimi më i fundit PEFA i Shqipërisë (nga viti 2011) vërente se ndërkohë që Kontrolli i Lartë i Shtetit auditonte të ardhurat, shpenzimet, asetet dhe detyrimet financiare të qeverisë, ai prapë nuk shprehte një opinion të përgjithshëm mbi një numër pasqyrash financiare të konsoliduara (Banka Boterore, 2012). Vlerësimi PEFA 2011 po ashtu vërente reforma në kontrole të brendshme, me krijimin e një njësie të vogël inspektimi brenda MF për të marrë përsipër hetimin e fushave të dyshuara për aktivitete të korruptuara apo mashtrimi (Banka Boterore, 2012). Vlerësimi theksonte reformat e mbështetura nga donatorët përfshi rishikime të ligjit për auditimet e brendshme të Kontrollit të Lartë të Shtetit për të qenë në përputhje me standartet ndërkombëtare, përgatitjen e një opinion auditimi për pasqyrat financiare përmbledhëse të qeverisë dhe harmonizim i auditeve të brendshme me sistemin e ri të Kontrollit Publik Financiar të Brendshëm (PIFC), me qëllim rritjen e pjesës së auditimeve financiare në 50% të auditimeve totale të kryera në pikëpamje afatmesme (Banka Boterore, 2012).

Disa përfaqësues të qeverisë shpjeguan se sistemet e kontabilitetit të qeverisë ishin në pjesën më të madhe me bazë cash, edhe pse kishte disa raste kontabiliteti bazuar në faturat faktike (accruals). Këta zyrtarë shpjeguan se synimi i Shqipërisë ishte të kalonte drejt një sistemi kontabiliteti me bazë faktike, edhe pse për këtë reformë nuk ishte përcaktuar ende një kohë fikse. AP konfirmoi se raportimi EITI ishte gjithmonë mbi baza cash.

Sigurimi i cilësisë EITI: Në lidhje me sigurimin e cilësisë për raportimin e kompanive, AP vërejti se zbatimi nga kompanitë i procedurave për sigurimin e cilësisë specifike për EITI-n kishin qenë një dobësi e procesit historikisht dhe theksoi se rekomandimi i përsëritur që kompanitë të përfshinin certifikim të formularëve të tyre raportues EITI si pjesë të auditit vjetor rutinë për të ulur kostot shtesë. Përfaqësues nga të gjitha grupet pranuan se kjo ishte provuar tashmë si sfidë kyçe në Validimin e parë të Shqipërisë, sipas Rregullave EITI. Një numër përfaqësuesish nga qeveria dhe industria, si dhe personeli i Sekretariatit dhe AP, theksuan ankesa të përsëritura nga kompanitë raportuese për perceptimin se kompanitë ishin tashmë të mbingarkuara me kërkesa raportimi statutor dhe përputhshmërie. Një zyrtar i lartë i qeverisë iu referua studimeve të pavarura që kishin gjetur se kompanitë shpenzonin mesatarisht 774 në vit për të arritur përputhshmërinë me rregullat e qeverisë. Disa përfaqësues nga qeveria dhe industria po ashtu mendonin se kërkesa për certifikim të formularëve të raportimit të kompanive nga një zyrtar i lartë i qeverisë ishte një lloj mbingarkese, duke qenë se vetë procesi i rakordimit ofronte siguri të mjaftueshme cilësie për raportimin EITI. Disa përfaqësues nga industria bënë thirrje për integrimin e raportimit EITI në kërkesat statutorë të raportimit tek qeveria, një thirrje që përfaqësues të qeverisë dhe personeli i Sekretariatit u shprehën se kishte qenë një kërkesë e përsëritur nga kompanitë në Raporte EITI të mëparshme. Personeli i Sekretariatit dhe disa përfaqësues të qeverisë theksuan dispozitat e projekt-Ligjit për Kontabilitetin dhe

¹²³ <http://www.sigmaweb.org/countries/albania-sigma.htm>

Raportimin Financiar, i cili do të integronte certifikimin auditues të formularëve të raportimit EITI si pjesë e auditimeve të tyre rutinë.

Një auditues i pavarur përlloragari se kostoja e sigurimit të një letre nga një auditues i jashtëm ishte afërsisht një e pesta (20%) e koston së auditimeve të tyre vjetore statutores (edhe kur përgatiteshin si pjesë e auditimit vjetor rutinë të kompanisë), e cila varionte nga 1 mijë Euro deri në 70 mijë Euro në varësi të përmasave të kompanisë. Ekzistonte njëfarë konfuzioni lidhur me faktin nëse ndonjë prej kompanive raportuese në Raportin EITI 2015 kishte paraqitur një letër nga audituesit e jashtëm, ku personeli i Sekretariatit u shpreh se kompanitë më të mëdha e kishin paraqitur këtë certifikim, ndonëse të gjithë përfaqësuesit konfirmuan se Raporti EITI 2015 shprehej qartë se asnjë prej kompanive raportuese nuk kishte paraqitur ndonjë letër të tillë në kohën e publikimit të Raportit EITI 2015. Asnjë prej përfaqësuesve të konsultuar, përfshi anëtarët e MSG, nuk mund të shpjegonte pse MSG kishte dakordësuar të njëjtat procedura për sigurimin e cilësisë për kompanitë raportuese në çdo Raport EITI (pra, një letër certifikimi nga një auditues i jashtëm), kur asnjë prej kompanive raportuese nuk e kishte zbatuar ndonjëherë. AP konfirmoi se nuk ishte e mundur të rakordohej raportimi EITI me bazë cash me pasqyrat financiare të audituara me bazë faktike (accrual).

Për sa i përket sigurimit të cilësisë për raportimin e qeverisë, një numër përfaqësuesish të qeverisë mendonin se publikimet e qeverisë ishin të besueshme duke qenë se entet raportuese kishin paraqitur një deklaratë se të dhënat e raportuara nga EITI ishin të dhëna zyrtare qeveritare. Megjithatë, AP vërejti se nuk kishte sigurim cilësie për raportimin EITI të qeverisë duke pasur parasysh mungesën e auditimeve financiare të të ardhurave të qeverisë nga industria nxjerrëse. Përfaqësues nga zyra e Kontrollit të Lartë të Shtetit konfirmuan se nuk ishin të përfshirë në certifikimin e raportimit EITI të qeverisë.

Pavarësisht mungesës së auditimit financiar të të ardhurave të qeverisë nga industria nxjerrëse, AP shpjegoi se të gjitha të ardhurat nga industria nxjerrëse përveç bonuseve dhe pjesës së naftës nën PSA-të ishin pagesa fiskale të mbledhura nga agjentët kryesorë fiskalë, dmth Tatimet dhe Doganat. AP vërejti se të gjitha pagesat fiskale ishin të regjistruara në sistemet e tatimeve dhe doganave kur paguheshin dhe se taksapaguesit individualë mund të ndërmerrnin një rakordim midis pagesave të tyre dhe faturave të agjentëve fiskalë në kohë reale me anë të portalit kushtuar tatimeve. Gjithashtu, nafta bruto dhe mineralet nuk mund të eksportoheshin derisa të paguhej dhe rakordohej renta e kompanive tek doganat. Kështu, AP mendonte se risku që ndonjë kompani të paguante tatimin por të mos regjistrohej në sistemin e agjentëve fiskalë ishte “shumë i ulët,” siç ishte probabiliteti që një kompani të raportonte pagesa më të mëdha se sa ato të marra nga agjentët fiskalë.

Heqja dorë nga konfidencialiteti: AP dhe personeli i Sekretariatit shpjeguan se me qëllim që të shmangnin dispozitat e konfidencialitetit në Ligjin e Tatimeve të Shqipërisë, AlbEITI (si ent qeveritar) kishte nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me entet qeveritare për të hequr dorë nga dispozitat e konfidencialitetit për raportimin e qeverisë tek AlbEITI. Kështu, mbledhja fillestare e të dhënave nga entet qeveritare ndërmerrej me anë të emaileve nga çdo ent qeveritar në Sekretariatit AlbEITI, duke kopjuar AP i cili e ndiqte më pas. Ndërkohë që formularët e raportimit të kompanive përfshinin një heqje dorë nga konfidencialiteti për të lejuar publikimin e të dhënave të taksapaguesve individualë, AP dhe personeli i Sekretariatit shpjeguan se më shumë se gjysma e kompanive raportuese nuk e kishin paraqitur kërkesën

e nënshkruar për të hequr dorë nga konfidencialiteti. AP vërejti se vazhdonte të merrte kërkesa për heqje dorë nga konfidencialiteti nga kompanitë raportuese pasi Raporti EITI 2015 ishte publikuar, ku “më pak se” 60 kompani e kishin paraqitur këtë kërkesë në kohën e konsultimeve për Validimin, një rritje nga “më pak se 50” të përmendura në vetë Raportin EITI 2015. AP dhe personeli i Sekretariatit theksuan se dispozitat e projekt-Ligjit për Transparencën në Administratën Publike do të shmangnin dispozitat për konfidencialitetin tatimor për qëllime të raportimit EITI dhe do të shmangnin nevojën që kompanitë të nënshkruanin kërkesa për heqje dorë nga konfidencialiteti tatimor.

Besueshmëria e të dhënave: AP dhe një numër përfaqësuesish të qeverisë shpjeguan se natyra e detajuar e rakordimit EITI, i cili kryhej mbi bazë transaksioni, ofronte siguri për saktësinë dhe ekzistencën e pagesave të rakorduara por theksuan se procedura e rakordimit nuk mund të siguronte plotësinë e informacionit të rakorduar nëse të dyja palët në transaksion nuk raportonin pagesa të caktuara. AP gjithashtu konfirmoi se kishte kërkuar kopje të faturave nga entet raportuese në raste mospërputhesh. AP dhe disa përfaqësues të qeverisë mendonin se mjedisi auditues në Shqipëri ishte “i njohur më mirë” dhe ndjekur më rigorozisht se në vende të tjera që zbatojnë EITI-n, duke vërejtur se kjo ulte nevojën për procedura të forta për sigurimin e cilësisë për raportim EITI. Megjithatë, AP mbrojti mosdakordësinë e vet të një vlerësimi për plotësinë dhe besueshmërinë e të dhënave në Raportin EITI 2015 me arsyen se nuk kishte sigurim cilësie për pasqyrat financiare të qeverisë apo procesin e hartimit të llogarive financiare. AP tha se nuk ishte e mundur që të ofronte një përllogaritje për mbulimin e rakordimit duke pasur parasysh mungesën e shifrave tërësore për të ardhurat totale të qeverisë nga industria nxjerrëse (*shih Kërkesa 4.1*), por mendonte se mbulimi ishte “me gjasë mjaft i lartë” meqenëse shumica e kompanive të mëdha kishin raportuar.

Megjithatë, të gjithë grupet e interesit që u konsultuan (nga të gjitha fushat) i shihnin të dhënat në Raportet EITI të Shqipërisë si të besueshme dhe se çështja e sigurimit të cilësisë për të dhënat EITI nuk ishte një çështje e rëndësishme për MSG, apo për Shqipërinë si e tërë. Një numër përfaqësuesish të qeverisë mendonin se cilësia e të dhënave në Raportet EITI ishte përmirësuar me kalimin e kohës meqenëse vlera e mospërputhjeve të agreguara kishte rënë vazhdueshëm.

Rekomandime: Personeli i Sekretariatit mendonte se MSG nuk kishte diskutime me cilësi të lartë për projekt-rekomandimet përpara publikimit të Raporteve EITI. Megjithatë, një zyrtar i lartë i qeverisë u shpreh se rekomandimet EITI gjithmonë diskutoheshin nga MSG pas publikimit të Raportit EITI dhe personeli i Sekretariatit shpjegoi se MSG kishte ngritur grupe pune specifike ad hoc për të ndjekur rekomandimet specifike të EITI-t. Disa përfaqësues të qeverisë dhe AP vërejtën ndjekjen e rekomandimeve EITI të lidhura me cilësinë e shifrave zyrtare të prodhimit dhe faktin se AP i ishin paraqitur numrat unikë tatimorë të kompanive në përgatitjen e Raportit EITI 2015 për herë të parë (*shih Kërkesa 7.3*). AP vërejti se shumica e rekomandimeve EITI ishin të njëjtat çdo vit dhe se vetëm përditësoheshin sipas nevojës. AP mirëpriti pyetjet e Sekretariatit Ndërkombëtar lidhur me ndjekjen e rekomandimeve EITI dhe deklaroi se synonte që në Raportin EITI 2016 të publikonte vitin kur ishte paraqitur fillimisht secili rekomandim EITI në të kaluarën, plani i veprimit i MSG lidhur me çdo rekomandim dhe çfarëdo përditësimi më pas.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. MSG duket të ketë miratuar përzgjedhjen e AP për Raportin EITI 2015, përfshi TeR në përputhje me formularin e miratuar nga Bordi, si dhe formularët e raportimit. Ndërkohë që AP duket se ka shqyrtuar procedurat statutores të auditimit të enteve materiale përpara rënies dakort me procedurat për sigurimin e cilësisë për të siguruar besueshmërinë e të dhënave të rakorduara në Raportin EITI 2015, nuk ka të dhëna që AP të ketë shqyrtuar praktikat faktike të enteve raportuese. Është e paqartë pse përfaqësues të industrisë në MSG miratuan procedurat për sigurimin e cilësisë që asnjë kompani nuk i ndoqi në praktikë. Raporti EITI 2015 nuk bën vlerësim të domethënies së raportimit nga entet që nuk përmbushnin procedurat e dakordësuara për sigurimin e cilësisë. Mungesa e çfarëdo sigurie nga AP për tërësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të rakorduara është shqetësim dhe përbën një devijim nga TeR të AP-së për Raportin EITI 2015. AP ka përgatitur tabela përmbledhëse për të dhënat në Raportet EITI të Shqipërisë.

Në përputhje me Kërkesën 4.9.a, EITI kërkon një vlerësim nëse pagesat dhe të ardhurat i nënshtrohen auditimit të besueshëm, të pavarur, duke aplikuar standarte ndërkombëtare auditimi. Në përputhje me kërkesën 4.9.b.iii dhe Termat e Referencës standarte për Administratorin e Pavarur dakordësuar nga Bordi EITI, MSG dhe Administratori i Pavarur duhet:

- a. të kontrollojë procedurat e auditimit dhe sigurimit (të të dhënave) në kompanitë dhe entet qeveritare që marrin pjesë në procesin e raportimit EITI dhe, bazuar mbi këtë kontroll, të dakordësojë se çfarë informacioni duhet t'i paraqesin Administratorit të Pavarur kompanitë dhe entet qeveritare pjesëmarrëse me qëllim që të sigurohet besueshmëria e të dhënave në përputhje me Kërkesën 4.9. Administratori i Pavarur duhet të përdorë gjykimin dhe të aplikojë standarte profesionale ndërkombëtare në zhvillimin e një procedure që ofron bazë të mjaftueshme për një Raport EITI tërësor dhe të besueshëm. Administratori i Pavarur duhet të përdorë gjykimin e tij/saj profesional për të përcaktuar masën në të cilën mund të kihet besim në kuadret ekzistuese të kontrollit dhe auditimit të kompanive dhe qeverive. Raporti fillestar i Administratorit të Pavarur duhet të dokumentojë opsionet e shqyrtuara dhe racionalen për sigurinë që duhen ofruar.
- b. të sigurojë që Administratori i Pavarur ofron një vlerësim të tërësisë dhe besueshmërisë së të dhënave (financiare) të paraqitura, përfshi një përmbledhje informuese të punës së kryer nga Administratori i Pavarur dhe kufizimet e vlerësimit që është paraqitur.
- c. të sigurohet që Administratori i Pavarur të paraqesë një vlerësim nëse të gjitha kompanitë dhe entet qeveritare brenda fushës së dakordësuar të procesit të raportimit EITI dorëzuan informacionin e kërkuar. Çfarëdo boshllëqesh apo dobësish në raportimin tek Administratori i Pavarur duhen publikuar në Raportin EITI, përfshi përmendjen e çdo enti që ka dështuar në përmbushjen e procedurave të dakordësuara, dhe një vlerësim nëse kjo ka gjasa të ketë ndikim material mbi tërësinë dhe besueshmërinë e raportit.

Tabela 4- Tabelë përmbledhëse e vlerësimit fillestar: Mbledhja e të ardhurave

Dispozitat EITI	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar për përparimin me dispozitat EITI (për t'u plotësuar për dispozitat 'e kërkuara')
Tërësia (#4.1)	<p>Raporti EITI 2015 përfshin përkufizimin nga MSG të pragut të materialitetit për pagesat dhe kompanitë për t'u përfshirë në rakordim bazuar në vëllimet e prodhimit, përfshi një justifikim se pse pragjet ishin vendosur në këtë mënyrë dhe në këtë nivel. Megjithatë, përcaktimi i një pragu cilësor dhe jo sasior për përzgjedhjen e flukseve të të ardhurave materiale (si pjesë e të ardhurave të qeverisë, për shembull) është një shqetësim. Kompanitë që nuk raportuan janë përmendur dhe është dhënë vlera e pagesave të tyre për qeverinë kundrejt të ardhurave të raportuara nga qeveria. Pjesa e kompanive mosraportuese duket se është e papërfillshme. Raporti EITI 2015 nuk deklaroi shprehimisht nëse të gjitha entet qeveritare materiale raportuan të gjitha të ardhurat, ndonëse konsultimet me grupet e interesit konfirmuan se të gjitha entet qeveritare kombëtare kishin raportuar plotësisht dhe se çka ishte lënë jashtë nga qeveritë vendore nuk konsiderohej materiale. Ndërkohë që komentet e AP mbi tërësinë e Raportit EITI kufizohet në një pohim mbi mungesën e sigurisë, është e mundur që të llogaritet materialiteti i atyre që janë lënë jashtë.</p>	Përparim i kënaqshëm
Të ardhurat në natyrë (#4.2)	<p>Raporti EITI 2015 rakordon vëllimet e naftës bruto mbledhur sipas PSA-ve, publikon vëllimet e shitura të naftës bruto dhe vlerën e të ardhurave nga shitjet e naftës bruto, të disagreguara sipas blerësit. Raporti ofron vëllimet e mbledhura, vëllimet e shitura dhe të ardhurat nga shitjet si për pjesën e prodhimit të naftës nën PSA-të ashtu dhe naftën e pjesës së Albpetrolit, edhe pse pa disagregim mes të dyjave. Ndërkohë që ka vend për të konsideruar se Shqipëria ka shkuar përtej kërkesës minimale duke publikuar informacion mbi shitjet e naftës së pjesës së Albpetrolit, vlerësimi fillestar i</p>	Përparim i kënaqshëm

	Sekretariatit Ndërkombëtar është që Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë duke pasur parasysh mungesën e disagregimit midis të ardhurave në natyrë të shtetit dhe naftës së Albpetrolit.	
Transaksionet ndihmëse dhe infrastrukturore (#4.3)	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për Shqipërinë në vitin në shqyrtim (2015). Megjithatë, mungesa e komenteve në Raportin EITI 2015 për shqyrtimin nga MSG të Kërkesës 4.3 është një shqetësim.	
Të ardhurat nga transporti (#4.4)	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për Shqipërinë në vitin në shqyrtim (2015). Raporti EITI 2015 përshkruan marrëveshjet infrastrukturore për transportin e naftës bruto, por jo të gazit natyror dhe mineraleve. Megjithatë, Sekretariati Ndërkombëtar kupton se qeveria dhe NPSH-të nuk marrin ndonjë të ardhur nga transporti i mineraleve, naftës bruto apo gazit natyror.	
Transaksionet midis NPSH-ve dhe qeverisë (#4.5)	Ndërkohë që Raporti EITI 2015 përfshin një rakordim të pagesave nga kompanitë e naftës dhe gazit për NPSH-të nxjerrëse (Albpetrol) dhe disa nga pagesat e Albpetrolit për qeverinë, ai jep vetëm publikimin e njëanshëm nga Albpetroli të dividendëve të vet për qeverinë, të cilat nuk janë rakorduar me faturat e MZHETTS. Ndërkohë që dividendët e Albpetrolit për MZHETTS janë materiale, ato përbëjnë vetëm 0.39% të të ardhurave të qeverisë nga sektorët minerarë, të naftës dhe gazit. Megjithatë, Sekretariati Ndërkombëtar kupton se marrja nga MZHETTS e dividendëve të Albpetrolit publikohet në raportin për ekzekutimin e buxhetit vjetor, duke qenë se të ardhurat e MZHETTS regjistrohen në buxhetin ndërkombëtar (shih Kërkesa 5.1). Gjithashtu, fakti që pasqyrat financiare vjetore të Albpetrolit auditohen (shih Kërkesa 4.9) paraqet një nivel të lartë sigurie cilësie për publikimin e njëanshëm nga Albpetroli të dividendëve të tij për qeverinë.	Përparim i kënaqshëm
Pagesat e drejtpërdrejta lokale (#4.6)	Ka mundësi që punë e mëtejshme mbi këtë çështje mund të demonstronte se kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për Shqipërinë, sepse duket se me gjasë pagesat lokale për NJQV-të nuk janë	Përparim domethënës

	<p>materiale. Megjithatë, MSG qartësisht ra dakort të përfshinte pagesat lokale për NJQV-të në fushën e procesit të raportimit, duke vërejtur rendësinë e këtyre pagesave për komunitetet vendore. Në mungesë të të dhënave përfshirëse të qeverisë, përjasja e adoptuar e përzgjedhjes së NJQV-ve për rakordim bazuar në të dhënat e kompanive duket e arsyeshme. Megjithatë, duket të ketë boshllëqe të konsiderueshme në raportimin nga kompanitë dhe në pjesëmarrjen e NJQV-ve.</p>	
Niveli i disagregimit (#4.7)	<p>Raporti EITI 2015 paraqet informacion të rakorduar disagreguar sipas kompanisë, fluksit të të ardhurave dhe entit qeveritar.</p>	Përparim i kënaqshëm
Të dhënat në kohë (#4.8)	<p>Të gjithë Raportet EITI të Shqipërisë sipas Standartit EITI janë botuar brenda dy vitesh nga mbyllja e vitit (viteve) fiskal në shqyrtim. Megjithatë, fakti që koha e përmendur në botimin e Raportit EITI 2015 është dy muaj përpara publikimit faktik të raportit dhe fakti që një version i rishikuar konsiderueshëm i Raportit EITI 2015 ishte botuar pa miratimin (apo dijeninë) e MSG përbën shqetësim. Kjo shtjellohet më tej në vlerësimin e mbikqyrjes nga MSG (<i>shih Kërkesa 1.4</i>).</p>	Përparim i kënaqshëm
Cilësia e të dhënave (#4.9)	<p>MSG duket të ketë miratuar përzgjedhjen e AP për Raportin EITI 2015, përfshi TeR në përputhje me formën e miratuar nga Bordi, si dhe formularët e raportimit. Ndërkohë që AP duket se ka rishikuar procedurat e auditimit statutor të enteve materiale përpara dakordësimin të procedurave për sigurimin e cilësisë për të siguruar besueshmërinë e të dhënave të rakorduara në Raportin EITI 2015, nuk ka të dhëna që AP të ketë rishikuar praktikën faktike të auditimit të enteve raportuese. Është e paqartë pse anëtarët e industrisë në MSG miratuan procedura për sigurimin e cilësisë që asnjë kompani nuk i ndoqi në praktikë. Raporti EITI 2015 nuk bën vlerësim të materialitetit të pagesave nga entet që nuk përmbushën procedurat e dakordësuara të sigurimit të cilësisë. Mungesa e çfarëdo sigurie nga AP për tërësinë dhe besueshmërinë e të dhënave është një shqetësim dhe përfaqëson një devijim nga TeR të AP për Raportin EITI 2015. AP ka përgatitur tabela përmbledhëse të dhënash në Raportet EITI të Shqipërisë.</p>	Përparim domethënës

Rekomandimet e Sekretariatit:

1. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të shqyrtojë rishikimin e pragut të materialitetit për përzgjedhjen e kompanive minerare për të siguruar një balancë midis tërësisë së publikimeve dhe cilësisë së raportimit. MSG mund të dojë të shohë mundësinë e përjasjes me kampionim, e cila do të lejonte që këto pagesa të hetoheshin pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi. MSG po ashtu nxitet të sigurojë që Administratori i Pavarur të ofrojë mendimin e vet për tërësinë e Raportit EITI.
2. Në përputhje me kërkesën 4.2, MSG duhet të sigurojë që disagregon qartë të ardhurat në natyrë të shtetit nga të ardhurat në natyrë të Albpetrolit në Raporte EITI në të ardhmen. MSG mund të shihte mundësinë për t'iu bashkuar [përpyjekjes së shënjestruar](#) të EITI-t për tregtinë e mallit/mallrave për të ofruar një kuadër për të siguruar që publikimet e shitjeve të të ardhurave në natyrë të shtetit janë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare.
3. Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të sigurojë që Raportet EITI të ardhshme të trajtojnë qartë Kërkesën 4.3 dhe të konfirmojnë vlerësimin e MSG për mosaplikueshmërinë e tij. MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën do të ishte i nevojshëm rishikimi i termave të kontratave minerare, të naftës dhe gazit për të siguruar një vlerësim përfshirës të aplikueshmërisë së Kërkesës 4.3.
4. Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të konsiderojë që të sigurohet që Raportet EITI në të ardhmen të pohojnë se qeveria dhe NPSH-të nuk marrin ndonjë të ardhur nga transporti i mineraleve, naftës bruto apo gazit natyror në vitin (vitet) në shqyrtim.
5. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet fort që të sigurohet që Raportet EITI në të ardhmen të përfshijnë dividendët e Albpetrolit për qeverinë në fushën e rakordimit, në linjë me Kërkesën 4.5.
6. Në përputhje me kërkesën 4.6, MSG duhet të ndërmarrë shqyrtim të përshtatshëm të pagesave jokombëtare të drejtpërdrejta nga kompanitë nxjerrëse për NJQV-të, duke ngritur një bazë përfshirëse për diskutimet e materialitetit të MSG-së lidhur me pagesat e drejtpërdrejta për NJQV. MSG mund të dojë të shqyrtojë një përjasje kampionimi, e cila do të lejonte që këto pagesa të hetoheshin pa krijuar një barrë të paarsyeshme raportimi.
7. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën mund të bëjë përparim në zbatimin e raportimit EITI në nivel projekti të detyrimeve e tatimeve specifike për sektorin përpara afatit për të gjitha Raportet EITI që mbulojnë periudha fiskale që mbarojnë më ose pas 31 dhjetorit 2018, dakordësuar nga Bordi EITI në takimin e tij të 36të në Bogota.
8. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të dojë të ndërmjetësojë me agjencitë kryesore të mbledhjes së të ardhurave dhe rregullatorë të sektorëve për të gjetur mënyra për të përfshirë publikimin e informacionit të kërkuar nga EITI në sistemet rutinore qeveritare për të siguruar

raportim EITI më në kohë.

9. Në përputhje me Kërkesën 4.9.a, EITI kërkon një vlerësim nëse pagesat dhe të ardhurat i nënshtrohen auditimit të besueshëm, të pavarur, duke aplikuar standarte ndërkombëtare auditimi. Në përputhje me kërkesën 4.9.b.iii dhe Termat e Referencës standarte për Administratorin e Pavarur dakordësuar nga Bordi EITI, MSG dhe Administratori i Pavarur duhet:
 - a. Të ekzaminojë procedurat e auditimit dhe sigurisë (së të dhënave) në kompanitë dhe entet qeveritare që marrin pjesë në procesin e raportimit EITI, dhe bazuar mbi këtë ekzaminim, të dakordësojë se çfarë informacioni duhet t'i dorëzojnë kompanitë dhe entet qeveritare Administratorit të Pavarur me qëllim që të sigurohet besueshmëria e të dhënave në përputhje me Kërkesën 4.9. Administratori i Pavarur duhet të përdorë gjykimin dhe të aplikojë standarte të përshtatshme profesionale për të zhvilluar një procedurë që ofron bazë të mjaftueshme për një Raport EITI përfshirës dhe të besueshëm. Administratori i Pavarur duhet të ushtrojë gjykimin profesional për të përcaktuar masën në të cilën mund t'i besohet kuadreve të kontrollit dhe auditimit të kompanive dhe qeverive. Raporti fillestar i Administratorit të Pavarur duhet të dokumentojë opsionet e shqyrtuara dhe racionalen për sigurinë që do ofrohen.
 - b. Të sigurohet që Administratori i Pavarur të ofrojë një vlerësim për tërësinë dhe besueshmërinë e të dhënave (financiare) të paraqitura, përfshi një përmbledhje informuese mbi punën e kryer nga Administratori i Pavarur dhe kufizimeve e vlerësimit të paraqitur.
 - c. Të sigurohet që Administratori i Pavarur të ofrojë një vlerësim nëse të gjitha kompanitë dhe entet qeveritare brenda fushës së dakordësuar të procesit të raportimit EITI e kanë dorëzuar informacionin e kërkuar. Çfarëdo boshllëqesh apo dobësish në raportimin për Administratorin e Pavarur duhen publikuar në Raportin EITI, përfshi përmendjen e ndonjë enti që ka dështuar të përmbushë procedurat e dakordësuara, dhe një vlerësim nëse kjo ka gjasa të ketë ndikim material në tërësinë dhe besueshmërinë e raportit.

5. Menaxhimi dhe shpërndarja e të ardhurave

5.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion paraqet hollësi mbi zbatimin e kërkesave EITI që lidhen me menaxhimin dhe shpërndarjen e të ardhurave.

5.2 Vlerësimi

Shpërndarja e të ardhurave (#5.1)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 deklaron se të ardhurat e mbledhura nga AKBN dhe Albpetroli nuk janë regjistruar në buxhetin kombëtar (Raporti EITI 2015, f. 35). Raporti deklaron se vetëm 76.7% e të ardhurave nga nafta dhe gazi nga kompanitë private ishte regjistruar në buxhetin kombëtar në vitin 2015 (Raporti EITI 2015, f. 35).

Grafiku 16 në Raportin EITI 2015 tregon se AKBN mban të gjitha të ardhurat që merr nga kompanitë e naftës dhe gazit dhe raporti sqaron se AKBN mori vetëm bonuset dhe “garancitë e ekzekutuara” (që përfaqësojnë gjoba nga kompanitë e naftës dhe gazit që nuk pëmbushin detyrimet e programit të punës), por jo pjesë naftës duke qenë se PSA-të ku është palë nuk prodhuan naftë bruto gjatë vitit 2015 (Raporti EITI 2015, f. 35). Ndërkohë që AP kërkoi kopje të pasqyrave financiare të audituara të AKBN, raporti deklaron se AKBN nuk i paraqiti këto (Raporti 2013-14, f.18). Kështu, ndërkohë që raporti thekson se të ardhurat e mbledhura nga AKBN ishin jashtë buxhetit, raporti nuk ofron një shpjegim për alokimin e këtyre burimeve.

Grafiku 16 po ashtu tregon se Albpetroli mblodhi 22.6% të të ardhurave nga nafta dhe gazi në vitin 2015 dhe se këto nuk ishin regjistruar në buxhetin kombëtar (Raporti EITI 2015, f. 35). Ndërkohë që Albpetroli mblodh bonuse (nënshkrimi dhe trajnimi) dhe pjesën e naftës nën PSA-të që ka nënshkruar, ai i mban këto të ardhura dhe paguan vetëm dividendët në Thesar, përveç taksave dhe detyrimeve të rregullta mbi të gjitha kompanitë që operojnë në sektorin e naftës dhe gazit. Shtojca 4 paraqet informacion nga pasqyrat financiare vjetore të audituara të Albpetrolit të viteve 2012, 2013, 2014 dhe 2015 (Raporti EITI 2015, f.138), të cilat ofrojnë informacion për alokimin e këtyre fondeve jashtë buxhetit.

Raporti EITI 2015 nuk i referohet ndonjë sistemi klasifikimi kombëtar të ardhurash.

Raporti EITI 2013-14 ofron një mbulim të ngjashëm të të ardhurave nga industria nxjerrëse të paregjistruara në buxhetin kombëtar, ku AKBN nuk ka publikuar pasqyrat financiare të audituara (Raporti EITI 2013-14, f. 49).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Disa zyrtarë të qeverisë dhe AP konfirmuan se dy entet e vetme që mbledhin të ardhura nga sektori

minerar që nuk ishin regjistruar në buxhetin kombëtar ishin AKBN dhe Albpetroli. Këta përfaqësues konfirmuan se Albpetroli kishte mbajtur të ardhurat që kishte mbledhur dhe kishte paguar vetëm dividendët për qeverinë si dhe taksat e detyrimet e rregullta (*shih Kërkesa 4.5*). AP konfirmoi se AKBN ishte një ent jobuxhetor dhe se nuk bënte transferta tek qeveria qendrore, duke mbajtur të ardhurat për të financuar buxhetin e vet. Megjithë kërkesat e përsëritura për pasqyrat financiare të AKBN, AP shpjegoi se AKBN nuk kishte qenë bashkëpunues në këtë drejtim. Disa përfaqësues të qeverisë konfirmuan se AKBN përgatiste pasqyra financiare vjetore dhe se i nënshtrohej auditimeve për performancën (por jo financiare) nga zyra e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Megjithatë, një përfaqësues i qeverisë shprehu shqetësim se pasqyrat financiare vjetore të AKBN përgatiteshin mbi bazën e standarteve të auditimit të sektorit privat dhe jo standartet e sektorit publik. Disa përfaqësues të qeverisë dhe partnerëve të zhvillimit iu referuan thirrjeve të përsëritura, përfshi edhe nga Këshilli i Lartë i Shtetit, për përqendrimin e flukseve të të ardhurave nga e gjithë industria nxjerrëse tek Thesari, në cash. Megjithatë, një përfaqësues i qeverisë vërejti se ky rekomandim nuk ishte ndjekur më tej. Një anëtar nga OSHC në MSG nuk kujtonte që MSG të kishte shqyrtuar ndonjëherë çështjen e të ardhurave të mbledhura nga AKBN si jashtë buxhetit në kuptimin e Kërkesës 5.1.

Në lidhje me sistemet e klasifikimit të të ardhurave, disa përfaqësues të qeverisë dhe partnerëve të zhvillimit vërejtën se qeveria kishte ndjekur klasifikimet GFS-2001, çka konfirmohej në vlerësimin PEFA të Shqipërisë për 2011 (Banka Boterore, 2012). Ndërkohë që vlerësimi PEFA vërente se qeveria përgatiste pasqyra financiare mbi bazë GFS që nuk përmbushnin plotësisht standartet IPSAS për sistemet e raportimit me bazë cash, ai parashikonte se respektimi i plotë do të arrihej brenda gjashtë vjetësh (pra deri në 2018) (Banka Boterore, 2012). AP konfirmoi se klasifikimet Shqiptare për të ardhurat ishin përgjithësisht në linjë me standartet ndërkombëtare, por theksuan natyrën me bazë cash dhe jo me bazë faktike (accrual) të sistemeve të kontabilitetit.

Disa përfaqësues të qeverisë dhe personeli i Sekretariatit theksuan punën që vazhdonte për të ngritur Sistemin e Informacionit Financiar të Qeverisë Shqiptare (AGFIS) që do lidhte sistemet e MF për të përmirësuar ndërlidhjet midis bazave të ndryshme të të dhënave përfshi Thesarin, Doganat, Tatimet, etj.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Ndërkohë që Raporti EITI 2015 thekson të ardhurat nga industria nxjerrëse mbledhur nga AKBN dhe Albpetroli si jashtë buxhetit (dmth të peregjistruara në buxhetin kombëtar), ai vetëm ofron një shpjegim të alokimit të fondeve të mbledhura nga Albpetroli, por jo nga AKBN. Ndërkohë që raporti nuk i referohet sistemeve kombëtare apo ndërkombëtare për klasifikimin e të ardhurave, Sekretariati Ndërkombëtar kupton se sistemet kombëtare të klasifikimit të të ardhurave bazohen në klasifikimet GFS-2001.

Në përputhje me kërkesën 5.1.a, MSG duhet të sigurohet që të shpjegohet alokimi i të ardhurave nga industria nxjerrëse të peregjistruara, me linqe për në raportet financiare përkatëse ku është e aplikueshme. MSG mund të dojë të eksplorojë masën në të cilën mund të përdorte klasifikimet GFS specifike për industrinë nxjerrëse nga tabelat përmbledhëse të të dhënave EITI si mjet për të disagreguar

përbërësit e taksave të industrisë nxjerrëse në sistemet ekzistuese të MF.

Transfertat lokale (#5.2)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 përshkruan transfertat statutores lokale¹²⁴ dhe zbritjen e tyre nga 25% në 5% të rentës, në fuqi nga viti 2015 (Raporti EITI 2015, f. 75). Raporti përshkruan Udhëzimin nr. 26 të 3 shtatorit 2008, i cili iu kërkon NJQV-ve të dakordësojnë pagesa për rentën nga të licensuarit që operojnë në territorin e NJQV me drejtorinë rajonale të tatimeve dhe doganave në fund të muajit. Drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave më pas i paraqet një listë të të ardhurave nga renta të mbledhura nga çdo NJQV Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave, e cila inicion transfertat mujore të rentës tek NJQV-të (Raporti EITI 2015, f. 75). Për kompanitë e naftës, të cilat operojnë në të njëjtën kohë në disa NJQV, udhëzimi përcakton pjesën e rentës që i caktohet çdo NJQV bazuar në outputin e gjeneruar nga secila fushë naftëmbajtëse (Raporti EITI 2015, f. 75).

Raporti ofron rentat e 2015 mbledhur dhe alokuar për transfertë (5% e rentës së mbledhur), agreguar për të gjitha NJQV-të por disagreguar midis rentës minerare dhe rentës për naftën dhe gazin (Raporti EITI 2015, f. 76). Formula për llogaritjen e transfertave lokale në NJQV-të individuale gjatë 2015 nuk është dhënë, përveç një reference të përgjithshme për alokimet tek NJQV-të pritëse mbi bazën e niveleve të prodhimit. Ndërkohë që raporti ofron vlerën e rentave minerare dhe të naftës që duhet të ishin transferuar në bazë të formulës, si dhe shumat e transferuara faktikisht, ky informacion paraqitet në agregat për të gjitha NJQV-të, jo i disagreguar për NJQV individuale. Gjithashtu, raporti nuk shprehet qartë se sa NJQV duhej të kishin marrë transfertat lokale gjatë vitit 2015, dhe as numrin e NJQV-ve që faktikisht morën transfertat. Së fundi, informacioni mbi transfertat e ekzekutuara ofrohet për transfertat e ekzekutuara si në 2015 edhe në 2016 (siç deklarohet në shënimin në fund të faqes 76), çka do të thotë se raportimi i transfertave të ekzekutuara ishte kryer mbi bazën e të përlogariturve dhe jo mbi bazë kontabiliteti cash.

Raporti vëren se MF kishte shpjeguar që NJQV-të ishin përgjegjëse për të iniciuar transfertat lokale nëpërmjet procesit të rakordimit dhe se disbursimet më të ulëta në vitin e parë të zbatimit të sistemit të ri të transfertave lokale në vitin 2015 po hetohej dhe detyrimet po pastroheshin. Po ashtu vëren se MF planifikonte të prezantonte amendime në procedurat statutores për të parandaluar mbi dhe nënpretentime nga NJQV-të në të ardhmen (Raporti EITI 2015, f. 76).

Raporti po ashtu përfshin komente mbi eficiencën e transfertave lokale gjatë periudhës 2011-2015 me një grafik që tregon tendencën në rritje në transfertat e rentës në periudhën 2011-2015. Ai vëren se vetëm

¹²⁴ Ligji për Taksat Kombëtare nr. 9975, datë 28 korrik 2008, i ndryshuar, kërkon që një pjesë e taksës së rentës t'i alokohet çdo njësie të qeverisjes vendore në përpjestim me kontributin e tyre në prodhimin e brendshëm të naftës, gazit dhe minierave. Pas ndryshimeve në parlament në Ligjin për taksat kombëtare në nëntor 2014, renta e përlogariturve zbriti nga 25% në 5% të rentës, duke filluar nga viti 2015 (Raporti EITI 2015, f. 75)

NJQV-të naftë-prodhuese kishin marrë transferta lokale deri në vitin 2014, pa ndonjë korrelacion të qartë midis rentave të mbledhura dhe transfertave lokale, por se prej vitit 2015 procedurat e reja për transferimin e rentës kishin çuar në nivele më të larta transferimi. Raporti deklaroi se këto transferta do të jenë edhe më të larta kur renta për vitin 2015 të jetë alokuar plotësisht tek NJQV-të prodhuese” (Raporti EITI 2015, f.76).

Raporti thekson devijime të konsiderueshme në nivelin e transfertave lokale të ekzekutuara në vitin 2015, me transfertat e rentës mjaftë më të ulëta se sa pjesa e transferueshme caktuar në ligj, bazuar në raportimin nga Ministria e Financave (Raporti EITI 2015, f. 103). Transfertat e rentës nuk ishin rakorduar në Raportin EITI 2015 dhe AP rekomandon që MSG t’i përfshijë të tilla transferta në fushën e rakordimit në Raportet EITI të ardhshme (Raporti EITI 2015, f. 103).

Raporti EITI 2013-14 paraqet një nivel të ngjashëm hollësish në përshkrimin e transfertave lokale të rentës, përfshi formulën e përgjithshme për ndarjen e të ardhurave, shumën e agreguar të buxhetuar dhe transferuar (Raporti EITI 2013-14, f.49), por jo formulën specifike për ndarjen e të ardhurave për të llogaritur transfertat për NJQV specifike dhe as transfertat lokale të ekzekutuara, disagreguar ispas NJQV-ve.

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP konfirmoi se nuk kishte transferta të tjera lokale të lidhura me të ardhurat nga industria nxjerrëse në vitin 2015 përveç transfertave lokale të rentave përshkruar në Raportin EITI 2015. Mes përfaqësuesve të ndryshëm pati interes të madh lidhur me çështjen e transfertave lokale të rentës. Përfaqësuesit nga të gjitha grupet e interesit që u konsultuan theksuan sfidat e mëdha që kishin paraqitur në të kaluarën transferta të tilla. Disa zyrtarë të lartë të qeverisë shpjeguan se ndërokhë që pjesa e rentave që duhej transferuar ishte pakësuar nga 25% në 5%, transfertat tani në fakt po ekzekutoheshin. Në të kaluarën, trasnferta e 25% rentë për NJQV-të varej nga fakti nëse NJQV-të arrinin 120% të të ardhurave të tyre të buxhetuara dhe të gjeneruara nga brenda (taksa vendore), çka ishte e pamundur të arrihej në mënyrë të vazhdueshme. Gjithashtu, këto fonde mund të përdroreshin vetëm për infrastrukturën e energjisë, për të balancuar ndikimin e aktiviteteve nxjerrëse ose për të mirën e drejtpërdrejtë të komuniteteve ku zhvilloheshin aktivitetet nxjerrëse. Një partner zhvillimi theksoi se qeveria kishte qenë transparente lidhur me arsyet për pengimin e ekzekutimit të transfertave lokale në të kaluarën, sepse kishin vërejtur se nëse 25% rentë iu transferohej NJQV-ve ku zhvillohej aktivitet nxjerrës i konsiderueshëm, një NJQV si Bulqiza do kishte një buxhet më të madh se sa kryeqyteti Tiranë. Përfaqësues të qeverisë shprehën krenari për faktin që kjo çështje ishte identifikuar falë raportimit EITI, ku renta më e ulët prej 5% tani transferohej automatikisht pa kushtëzim përveç atij që fondet të përdroreshin për të financuar shpenzimet kapitale (dhe jo ato të vazhdueshme).

Një numër anëtarësh nga OSHC në MSG bënë thirrje për publikimin e transfertave lokale të disagreguara sipas NJQV-ve me qëllim që grupet e interesit të lejoheshin të gjurmonin zbatimin e sistemit të ri të transfertave, edhe pse këta anëtarë dukej se nuk e kuptonin se një disagregim i tillë ishte pjesë integrale e Kërkesës 5.2. Një numër përfaqësuesish të qeverisë si dhe AP dhe personeli i Sekretariatit shpjeguan se të dhënat për transfertat e ekzekutuara, disagreguar sipas NJQV-ve ishte në dispozicion dhe se nuk kishte asnjë pengesë për t’i bërë publike këto të dhëna. Duke vërejtur mbikqyrjen, AP dhe personeli i

Sekretariatit siguruan të dhënat për transfertat e 2015 disagreguar sipas NJQV-ve dhe e botuan si shtojcë të Raportit EITI 2015 në faqen e internetit AlbEITI¹²⁵ më 13 qershor 2017, pas fillimit të Validimit. Pas konsultimeve, AP dukej se e njihte mungesën e konsequencës në bazën e kontabilitetit midis raportimit me bazë pagesash faktike të transfertave lokale dhe kontabilitetit me bazë cash përdorur për pjesën tjetër të informacionit të përfshirë në Raportin EITI 2015. Kështu, shtojca në Raportin EITI 2015 disagregonte transfertat lokale të vitit 2015 që ishin ekzekutuar në vitin 2015 nga ato ekzekutuar në vitin 2016, disagreguar sipas NJQV-ve. Si AP ashtu edhe personeli i Sekretariatit menduan se kjo kish qenë një gabim në përgatitjen e Raportit EITI 2015 dhe vërejtën se asnjë nga anëtarëte MSG nuk e kishte theksuar këtë çështje më parë.

Disa përfaqësues të qeverisë, AP dhe personeli i Sekretariatit theksuan pengesat për bërjen publike të shumave që çdo NJQV duhet të kishte marrë bazuar në llogaritjen e formulës. Ata shpjeguan se ndërkohë që Doganat ndiqnin vendndodhjen e operacioneve të një kompanie në mbledhjen e rentës, dhe kështu mund të disagregonin rentën për eksportet sipas NJQV-ve, Drejtoria e Tatimeve nuk e ndiqte vendndodhjen e kompanive që paguanin rentë për minerale të përdorura brenda vendit dhe kështu nuk mund të ofronte informacion për transfertat të buxhetuara të rentës disagreguar sipas NJQV. Përfaqësuesit nuk mund të shpjegonin se si MF mund të buxhetonte atë që duhet të merrte çdo NJQV pa pasur të tilla të dhëna nga Tatimet. Disa përfaqësues të qeverisë shpjeguan se ishte përgjegjësi e NJQV-ve që të inicionin rakordimin e faturave të rentës me qëllim që të kërkonin transfertat lokale nga MF. Ata shpjeguan se NJQV-të nuk kishin gjithmonë dijeni për këtë përgjegjësi, çka shpjegonte nivelin e ulët të transfertave të ekzekutuara në 2015-ën dhe mendonin se kishte nevojë për ndërtim të konsiderueshëm kapacitetesh në nivelin e NJQV-ve individuale. Personeli i sekretariatit shpjegoi se AlbEITI kishte ndërmarrë workshop-e trajnimi mbi çështjen e transfertave lokale në vitin 2015 për NJQV-të ku kryheshin aktivitete nxjerrëse. Një përfaqësues nga industria theksoi nevojën për transparencë në transfertat lokale për NJQV-të, duke qenë se komunitetet vendore hera-herës fajësonin kompanitë se nuk ofronin mbështetje të mjaftueshme për zhvillim vendor, kur nuk shikonin asnjë pjesë të rentës që paguanin kompanitë. Një përfaqësues nga NJQV theksoi vlerën e të dhënave të disagreguara sipas NJQV-së marrëse, meqenëse aktualisht, NJQV-të nuk e kishin kapacitetin për të gjurmuar vlerën e transfertave të rentës që duhet të kishin marrë.

Një numër përfaqësuesish nga të tri grupet e interesit theksuan sfidat që paraqiste ristrukturimi i NJQV-ve, në fuqi në vitin 2016, i cili reduktoi numrin e NJQV-ve nga një total prej 305 në 61 bashki dhe 12 rrethe. Një numër zyrtarësh të qeverisë shpjeguan se kjo kishte çuar në pretendime të dyfishta nga disa NJQV lidhur me transfertat e rentës së tyre në 2015, por mendonin se kjo përfaqësonte vetëm “problem rritjeje” për sistemin e ri. AP shpjegoi se nuk kishte mandat për të inspektuar procesin për transferimin e rentës për Raportin EITI 2015 por se kishte në plan të propozonte që transfertat lokale të rakordoheshin në Raportin EITI të ardhshëm që do mbulonte vitin 2016 dhe se tashmë kishte marrë reagime pozitive për këtë rekomandim nga anëtarët e MSG. Konsultimet me grupet e interesit zbuluan që MSG ende nuk

¹²⁵ <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/EITI-Report-2015-Subnational-Royalty.pdf>

kishte kontaktuar me shoqatat e NJQV-ve të tilla si Shoqata Shqiptare e Bashkive.¹²⁶

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Raporti EITI 2015 përshkruan transfertat statutores lokale të rentës, ofron formulën e përgjithshme, transfertat e buxhetuara dhe faktike për 2015 në terma të agreguara, edhe pse të raportuara në bazë përlllogaritjesh dhe jo cash. Megjithatë, raporti nuk ofron formulën specifike për të llogaritur transfertat për NJQV-të individuale, dhe as nivelin e transfertave të buxhetuara dhe të ekzekutuara të disagreguara sipas NJQV-ve, edhe pse thekson mospërputhjet midis shumave të buxhetuara dhe transfertave faktike. Ndërkohë që AlbEITI publikoi transfertat e ekzekutuara të 2015-ës disagreguar sipas NJQV-ve mbi bazë cash pas fillimit të Validimit, niveli i transfertave të buxhetuara për 2015 disagreguar sipas NJQV nuk është ende në dispozicion të publikut.

Në përputhje me kërkesën 5.2.a, MSG duhet të vlerësojë materialitetin e transfertave lokale përpara mbledhjes së të dhënave dhe të sigurojë që formula specifike për llogaritjen e transfertave tek qeveritë vendore të bëhet publike, për të mbështetur një vlerësim të mospërputhjeve midis transfertave lokale të buxhetuara dhe të ekzekutuara. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të interesit publik në këtë çështje, MSG mund të dojë të shqyrtojë përfshirjen e NJQV-ve në procesin e raportimit për transfertat lokale me qëllim që t'i rakordojë këto transaksione.

Informacion shtesë mbi menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimet (#5.3)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 nuk i referohet ndonjë të ardhure të caktuar nga industria nxjerrëse, dhe as nuk përshkruan procesin e bërjes së buxhetit. Raporti ofron një vështrim të shkurtër të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit për entet qeveritare, përfshi një link për më shumë informacion (Raporti EITI 2015, f.77-78), por nuk ofron informacion shtesë mbi projektimet e prodhimit apo parashikimet e të ardhurave.

Raporti EITI 2013-14 deklaroi se Ministria e Financave dhe ente të tjera të qeverisë nuk raportuan të ardhura të caktuara (Raporti EITI 2013-14, f.71), dhe ofron një grafik të alokimeve të të ardhurave të naftës (Raporti EITI 2013-14, f.38).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP konfirmoi se nuk ishte në dijeni të ndonjë të ardhure të mbajtur nga industria nxjerrëse dhe se i ishte thënë nga përfaqësues të MF se asnjë nga të ardhurat nga industria nxjerrëse regjistruar në buxhetin kombëtar nuk ishte rezervuar për një projekt specifik, përveç transfertave lokale të 5% si rentë për NJQV-

¹²⁶ <http://aam.org.al/en/>

të (*shih Kërkesa 5.2*). AP po ashtu deklaroi se nuk ishte në dijeni të ndonjë të ardhure të rezervuar mbledhura nga AKBN apo Albpetrol. Asnjë prej përfaqësuesve të tjerë të konsultuar nuk ishin në dijeni të të ardhurave nga industria nxjerrëse që të ishin rezervuar.

Vlerësimi PEFA i Shqipërisë në 2011 vërejti se në faqen e internetit të MF kishte informacion thelbësor fiskal, përfshi planin afatmesëm të buxhetit, programet ekonomike dhe fiskale, ligjin e buxhetit vjetor dhe raportet për ekzekutimet e buxhetit të vitit në formën e tabelave fiskale në format excel spreadsheet, edhe pse me fokus tek numrat dhe jo teksti shpjegues (Banka Boterore, 2012). Kjo u konfirmua edhe me AP.

Vlerësimi fillestar

Është inkurajuese që MSG ka bërë njëfarë përpjekjeje për të përfshirë informacion mbi procesin e audititit në Raportin EITI 2015, edhe pse pikëpamja e Sekretariatit Ndërkombëtar është se AlbEITI ka bërë vetëm përpjekje modeste për të përfshirë informacion shtesë për procesin e buxhetimit.

MSG mund të dojë të shqyrtojë mundësinë për të përfshirë informacion shtesë për proceset e buxhetimit dhe auditimit për llogaritë qeveritare në Raportet EITI të ardhshme.

Tabela 5 - Tabelë përmbledhëse e vlerësimit fillestar: Menaxhimi dhe shpërndarja e të ardhurave

Dispozitat EITI	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar për përparimit me dispozitat EITI (për t'u plotësuar për dispozitat 'e kërkuara')
Shpërndarja e të ardhurave (#5.1)	Ndërkohë që Raporti EITI 2015 thekson të ardhurat nga industria nxjerrëse mbledhur nga AKBN dhe Albpetroli si jashtë buxhetit (dmth të paregjistruara në buxhetin kombëtar), ai vetëm ofron një shpjegim të alokimit të fondeve të mbledhura nga Albpetroli, por jo nga AKBN. Ndërkohë që raporti nuk i referohet sistemeve kombëtare apo ndërkombëtare për klasifikimin e të ardhurave, Sekretariati Ndërkombëtar kupton se sistemet kombëtare të klasifikimit të të ardhurave bazohen në klasifikimet GFS-2001.	Përparim domethënës
Transfertat lokale (#5.2)	Raporti EITI 2015 përshkruan transfertat statutove lokale të rentës, ofron formulën e përgjithshme, transfertat e buxhetuara dhe faktike për 2015 në terma të agreguara, edhe pse të raportuara në bazë përlllogaritjesh dhe jo cash. Megjithatë, raporti nuk ofron formulën specifike për të llogaritur transfertat për NJQV-të individuale, dhe as nivelin e transfertave të buxhetuara dhe të ekzekutuara të disagreguara sipas NJQV-ve, edhe pse thekson mospërputhjet midis shumave të buxhetuara dhe transfertave faktike. Ndërkohë që AlBEITI publikoi transfertat e ekzekutuara të 2015-ës disagreguar sipas NJQV-ve mbi bazë cash pas fillimit të Validimit, niveli i transfertave të buxhetuara për 2015 disagreguar sipas NJQV nuk është ende në dispozicion të publikut.	Përparim domethënës
Informacion për menaxhimin e të ardhurave dhe shpezimet (#5.3)	Është inkurajuese që MSG ka bërë njëfarë përpjekjeje për të përfshirë informacion mbi procesin e auditit në Raportin EITI 2015, edhe pse pikëpamja e Sekretariatit Ndërkombëtar është se AlBEITI ka bërë vetëm përpjekje modeste për të përfshirë informacion shtesë për procesin e buxhetimit.	

Përfundime fillestare dhe rekomandime:

1. Në përputhje me kërkesën 5.1.a, MSG duhet të sigurohet që të shpjegohet alokimi i të ardhurave nga industria nxjerrëse që nuk janë regjistruar në buxhetin kombëtar, me linqe për raportet financiare përkatëse aty ku është e aplikueshme. MSG mund të dojë të shqyrtojë masën në të cilën mund të përdorte klasifikimet specifike GFS për industrinë nxjerrëse nga tabelat përmbledhëse të të dhënave EITI si mjet për të disagreguar përbërësit e industrive nxjerrëse të taksave të zakonshme në sistemet ekzistuese të MF.
2. Në përputhje me kërkesën 5.2.a, MSG duhet të vlerësojë materialitetin e transfertave tek NJQV përpara grumbullimit të të dhënave dhe të sigurojë që të publikohet formula specifike për llogaritjen e transfertave tek qeveritë vendore specifike, për të mbështetur një vlerësim të mospërputhjeve midis transfertave të buxhetuara dhe atyre të ekzekutuara. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të interesit publik mbi këtë çështje, MSG mund të dojë të shohë mundësinë që t'i përfshijë NJQV-të në procesin e raportimit për transfertat tek to me qëllim që këto transaksione të rakordohen.
3. MSG mund të dojë të shohë mundësinë për të përfshirë informacion shtesë për proceset e buxhetimit dhe auditimit për llogaritë qeveritare në Raportet EITI të ardhshme.

6. Shpenzimet sociale dhe ekonomike

6.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion ofron hollësi për zbatimin e kërkesave EITI lidhur me shpenzimet sociale dhe ekonomike (shpenzimet gjysmëfiskale të NPSH-ve, shpenzimet sociale dhe kontributti i sektorit nxjerrës në ekonomi).

6.2 Vlerësim

Shpenzimet sociale (#6.1)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 nuk deklaroi nëse kompanive minerare, të naftës dhe gazit iu kërkohej të ndërmarrin shpenzime sociale të detyrueshme në përputhje me ndonjë dispozitë në Ligjin për Minierat apo Hidrokarburet, apo të kontratave të aktivitetit të tyre. Raporti nuk deklaroi nëse të gjitha shpenzimet sociale mbuluar në raport janë të detyrueshme, sepse i referohet vetëm shpenzimeve sociale në terma të përgjithshme pa bërë dallim midis shpenzimeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare. Raporti deklaroi se kompanive iu kërkohej të raportojnë në mënyrë të njëanshme shpenzimet sociale prej mbi 5 milionë Lek por se këto nuk ishin rakorduar me raportimin nga përfituesit (Raporti EITI 2015, f. 80). Mbi bazën e listës së flukseve të të ardhurave të përzgjedhura për raportim në Shtojcën 1 të TeR të AP për Raportin EITI 2015, duket se enteve qeveritare iu kërkohej të raportonin dhurimet vullnetare tek qeveria nga kompanitë minerare, të naftës dhe gazit, ndërkohë që kompanive iu kërkohej të raportonin shpenzime sociale të disagreguara në të detyrueshme dhe vullnetare (TeR për AP për Raportin EITI 2015, f. 20-21). MSG dakordësoi një prak materialiteti prej 5,000 USD për raportimin e shpenzimeve sociale të detyrueshme të tilla si “punë publike dhe infrastrukturë nën detyrimet kontraktuale” në takimin e tij të 29 qershorit 2016.¹²⁷

Megjithatë, përveç deklarimit sipërfaqësor të raportit se Bankers Petroleum raportoi shpenzime sociale me vlerë 194 milionë Lek “për të mirën e komunitetit në zonën përreth biznesit” (Raporti EITI 2015, f. 90), nuk ka të dhëna në Raportin EITI 2015 për rezultatet e raportimit të njëanshëm të kompanive për shpenzime sociale. Të vetmet hollësi të shpenzimeve sociale të raportuara, ato të Bankers Petroleum (në agregat), nuk bënë dallim midis kontributeve cash dhe në natyrë dhe nuk theksonte identitetin e ndonjë përfituesi joqeveritar.

Raporti EITI 2013-2014 po kështu nuk sqaron nëse kompanive minerare, të naftës dhe gazit iu kërkohej të ndërmerrnin shpenzime sociale të detyrueshme në 2013-14 dhe i paraqitën Albpetrolit publikimin e njëanshëm të Bankers Petroleum për shpenzimet e tyre sociale, pa sqaruar nëse ato ishin të detyrueshme

¹²⁷ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/msg-meetings/year-2016/>

apo vullnetare (Raporti EITI 2013-14, f.91,101).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Kishte mosmarrëveshje thelbësore midis përfaqësuesve të ndryshëm nëse kishte ndonjë shpenzim social të detyrueshëm për t'u ndërmarrë nga kompanitë që operonin në sektorët minerarë, të naftës dhe gazit. AP dhe disa zyrtarë qeveritarë konfirmuan se as Ligji i Minerave as Ligji për Hidrokarburet nuk i kërkonin kompanive të bënin shpenzime sociale të detyrueshme. Megjithatë, të gjithë anëtarët nga OSHC në MSG deklaruan se kishte klauzola kontraktuale që iu kërkonin disa kompanive të ndërmerrnin shpenzime sociale të detyrueshme. AP dhe përfaqësues të qeverisë vërejtën se disa kontrata mund t'iu kërkojnë kompanive të ndëmarrin shpenzime sociale por nuk përcaktonin një nivel specifik për këto shpenzime. AP vërejtë se disa nga PSA-të që kishte shqyrtuar përfshinin disa dispozita që mbulonin shpenzime sociale, ndonëse këto nuk kërkoreshin të ishin vjetore, me kosto tërësisht të rikuperueshme pasi dakordësoheshin si pjesë e programit të punës me palën e PSA (qoftë AKBN ose Albpetroli). AP përshkroi siguri të dhënë nga dy anëtarë qeveritarë të MSG se asnjë shpenzim social "material" nuk parashikohej në marrëveshjet aktualisht në fuqi, por vërejtë se nuk kishin paraqitur ndonjë dokumentacion mbështetës. Një përfaqësues nga industria shpjegoi se Bankers Petroleum i kërkohej të ndërmerre shpenzime sociale të detyrueshme si pjesë e licensës së vet për eksplorimin e naftës dhe gazit, por jo për licensën për prodhimin e naftës dhe gazit. Disa përfaqësues të industrisë dhe shoqërisë civile mendonin se kishte vetëm shpenzime sociale të detyrueshme në sektorin e naftës dhe gazit, jo në sektorin minerar. Disa përfaqësues qeveritarë po ashtu shpjeguan se kompani të caktuara naftë dhe gazi bënë pagesa cash tek MEI për qëllime trajnimi të personelit, nën kushtet e PSA-ve të tyre. Disa partnerë zhvillimi dhe personel i Sekretariatit theksuan standartet e larta për projektin TAP, i cili përfshinte një shifër të qartë në dollarë për shpenzime të detyrueshme sociale në kontratën midis TAP dhe Qeverisë së Shqipërisë. Të gjithë anëtarët nga OSHC në MSG që u konsultuan, theksuan nevojën për publikimin e të gjitha kontratave minerare, të naftës dhe gazit për të lejuar MSG dhe AP që të ndërmerrnin një shqyrtim përfshirës të klauzolave për shpenzimet sociale të detyrueshme.

AP deklaroi se nuk kishte shqyrtuar të gjitha kontratat e operimit që kompanive material për të vlerësuar ekzistencën e shpenzimeve sociale të detyrueshme por kishte kërkuar nga kompanitë raportuese të publikonin "vullnetarisht" shumat e paguara në shpenzimet sociale, edhe pse jo të disagreguara qarta midis atyre të detyrueshme dhe atyre vullnetare. AP vërejtë se kompanitë kishin raportuar shpenzime sociale në vitet e mëparshme, si p.sh. në Raportin EITI 2013-14, por se kompanitë raportuese asnjëherë nuk kishin bërë një dallim midis shpenzimeve sociale të detyrueshme dhe vullnetare në raportimin e tyre EITI. AP po ashtu vërejtë se "shumica" e shpenzimeve sociale të raportuara në Raportin EITI 2013-14 ishin paraqitur në cash, jo në natyrë. Pas diskutimit, AP vërejtë se referenca për shpenzimet sociale të Bankers Petroleum në Raportin EITI 2015 ishte i gabuar dhe ishte nxjerrë nga versioni i rishikuar i Raportit EITI 2015 botuar në mes të prillit 2017 në faqen e internetit AlbEITI, meqenëse kishte mbetur nga Raporte EITI të mëparshme. AP konfirmoi se asnjë kompani raportuese nuk kishte bërë publike ndonjë shpenzim social në Raportin EITI 2015. Kështu, AP shprehu shqetësime lidhur me mungesën e mundshme të tërësisë në raportimin e shpenzimeve sociale të detyrueshme në Raportin EITI 2015. Personeli i sekretariatit shprehu habi për faktin që kompanitë materiale raportonin programe të zgjeruara shpenzimesh sociale në raportet korporative në faqet e tyre të internetit por nuk kishin raportuar ndonjë shpenzim social në Raportin EITI 2015. Për shembull, citohej shembulli i Bankers Petroleum që raportonte në total 7.5

milione USD në projekte të marrëdhënieve komunitare në Shqipëri në periudhën 2009-2015 në faqen e tyre korporative.¹²⁸ Një anëtar industrie në MSG shprehu habi për mungesën e informacionit për shpenzimet sociale në Raportin EITI 2015, në kontrast me Raportin EITI 2013-14, meqenëse një informacion i tillë në Raportet EITI ishte veçanërisht i dobishëm për marrëdhëniet e kompanive me komunitetet pritëse.

Disa përfaqësues nga industria konfirmuan se shumë kompani minerare, naftë dhe gaz, sidomos të mëdhatë, ndërmerrnin shpenzime të mëdha sociale vullnetare si pjesë e CSR të tyre. Megjithatë, disa përfaqësues nga shoqëria civile dhe partnerët e zhvillimit që u konsultuan shprehën shqetësim lidhur me tendencën që një numër kompanish kategorizonin punën infrastrukturën që ndërtonin për operacionet e veta si formë shpenzimi social vullnetar. AP vërejti se kompanitë kishin interes të raportonin të gjitha format e shpenzimeve sociale pa bërë dallim midis shpenzimeve të detyrueshme dhe vullnetare, si formë marrëdhëniesh publike. Personeli i sekretariatit theksoi nivelin e lartë të interesit publik për shpenzimet sociale nga kompanitë minerare, të naftës dhe gazit, duke qenë se prireshin ta shikonin përdorimin e këtyre fondeve për vete në kontrast me transfertat lokale.

AP konfirmoi se MSG nuk e kishte diskutuar materialitetin e shpenzimeve sociale të detyrueshme përpara mbledhjes së të dhënave për Raportin EITI 2015 dhe se kompanitë thjesht ishin ftuar të raportonin shpenzime të tilla në përpjekje për të gjurmuar të tilla pagesa. AP shpjegoi se enti qeveritar në pozitë për të ofruar informacion të saktë mbi shpenzimet sociale të dakordësuara si pjesë e planeve të punës të kompanive (për pasojë, me kosto të rikuperueshme) ishte AKBN, por se ky ent nuk kishte rezultuar bashëpunues në këtë drejtim. AP konfirmoi se marrësit e shpenzimeve sociale ishin ose NJQV ose komunitete vendore, çka nënkuptonte se disa nga pjesëmarrësit ishin ente joqeveritare. Të gjithë anëtarët e MSG konfirmuan se pagesat për rehabilitimin mjedisor do të përfshiheshin në fushën e Raportit EITI pasardhës, atë që do mbulojë vitin 2016.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është që Shqipëria ka bërë përparim të pamjaftueshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkese. MSG nuk duket të ketë vlerësuar nëse shpenzimet sociale të detyrueshme ekzistojnë sipas termave kontraktuale përpara mbledhjes së të dhënave dhe ka konfuzion të përhapur nëse ekziston ndonjë shpenzim i tillë social i detyrueshëm. Raporti EITI 2015 ofron raportimin e njëanshëm të shpenzimeve sociale nga një kompani naftë dhe gaz (ndonëse kjo mund të ketë qenë përfshirë gabimisht), por nuk sqaron nëse këto ishin të detyrueshme dhe nuk përfshin shqetësimet e AP lidhur me tërësinë e raportimit të shpenzimeve sociale të detyrueshme në Raportin EITI 2015. MSG duket të mos ketë bërë asnjë përpjekje për të bërë dallimin midis shpenzimeve sociale të detyrueshme dhe vullnetare, shpenzimeve cash dhe në natyrë dhe as për të sqaruar identitetin e marrësit joqeveritar të shpenzimeve sociale të detyrueshme.

¹²⁸ <http://www.bankerspetroleum.com/albania/bankers-albania>

Në përputhje me kërkesën 6.1.a, MSG duhet të dakordësojë një dallim të qartë midis shpenzimeve sociale të detyrueshme dhe vullnetare përpara mbledhjes së të dhënave dhe të sigurojë që shpenzimet materiale sociale të detyrueshme të publikohen në mënyrë përfshirëse në Raportet EITI të ardhshme. Aty ku përfituesit e shpenzimeve sociale të detyrueshme janë një palë e tretë, dmth jo një ent qeveritar, MSG duhet të sigurojë që të publikohen emri dhe funksioni i përfituesit. MSG mund të dojë të shohë masën në të cilën do të ishte i nevojshëm publikimi i kontratave faktike minerare, të naftës dhe gazit (ose shqyrtimi i termave kryesore) për të ofruar një vlerësim përfshirës të ekzistencës së shpenzimeve sociale të detyrueshme. MSG mund po ashtu të dojë të shqyrtojë fizibilitetin e rakordimit të shpenzimeve sociale të detyrueshme.

Shpenzimet gjysmë-fiskale të NPSH-ve (#6.2)

Dokumentimi i përparimit

As Raporti EITI 2015 dhe as Raporti EITI 2013-14 nuk i referohet ndonjë shpenzimi gjysmë-fiskal ndërmarrë nga NPSH-të nxjerrëse (p.sh. Albpetroli).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP deklaroi se nuk kishte shpenzime gjysmë-fiskale të kodifikuara në ligjin shqiptar dhe se as Albpetroli dhe as MEI nuk kishin raportuar shpenzime gjysmë-fiskale në mbledhjen e të dhënave për Raportin EITI 2015. Ndërkohë që AP vërejti se Albpetroli ofronte një formë shërbimesh sociale duke ruajtur një forcë pune mjaft më të madhe se sa kishte nevojë, ai vërejti pasiguri lidhur me nëse një politikë e tillë mund të konsiderohej si formë shpenzimesh gjysmë-fiskale. Një numër përfaqësuesish qeveritarë dhe AP theksuan ndryshimin thelbësor të çmimit midis naftë bruto shitur në tregjet private shitur nga operatorë privatë si Bankers Petroleum dhe naftës bruto shitur nga Albpetrol. Ndërkohë që AP vërejti se për këtë mund të kishte arsye të ndryshme, përfshi potencialisht një subvencion nga Albpetroli për blerësit e naftës së tij bruto (TPD në 2015), ai shprehu pasiguri nëse kjo ishte një shpenzim gjysmë-fiskal duke pasur parasysh mungesën e shpjegimit. Megjithatë, një përfaqësues i qeverisë deklaroi kategorikisht se Albpetroli nuk ofronte subvencione në shitjet për kompanitë private dhe AP iu referua përfaqësimeve të menaxhimit të Albpetrolit se nuk ndërmerre shpenzime gjysmë-fiskale.

Pas konsultimesh të gjera, një numër përfaqësuesish qeveritarë vërejtën se Albpetroli ndërmerre tipe të caktuara sponsorizimesh aktivitetesh kulturore, përfshi sponsorizimin e ekipit kombëtar të futbollit, por se kjo ishte në përputhje me Ligjin për Sponsorizimet që lejonte kompanitë të shpenzonin deri një nivel të caktuar të fitimeve të tyre për sponsorizime dhe për pasojë të rikuperonin koston nëpërmjet zbritjesh nga taksat. Një partner zhvillimi vërejti pretendime se Albpetroli ofronte financim për parti të caktuara politike nëpërmjet zgjedhjes së nënkontraktorëve me anësi politike. Një numër përfaqësuesish të qeverisë dhe personeli i Sekretariatit konfirmuan se MSG nuk e kishte diskutuar asnjëherë çështjen e shpenzimeve gjysmë-fiskale në përgatitjen e ndonjë prej Raporteve EITI të Shqipërisë.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria nuk ka bërë përparim drejt

përmbushjes së kësaj kërkesë. Nuk ka të dhëna që MSG të ketë shqyrtuar ndonjëherë çështjen e shpenzimeve gjysmë-fiskale në lidhje me Albpetrolin apo ndonjë NPSH tjetër nxjerrëse.

Në përputhje me kërkesën 6.2, MSG duhet të konsiderojë ekzistencën dhe materialitetin e ndonjë shpenzimi fiskal gjysmë-fiskal ndërmarrë nga NPSH-të nxjerrëse dhe kompanitë vartëse të tyre, duke siguruar që të gjitha shpenzimet gjysmëfiskale materiale të bëhen publike në Raporte EITI në të ardhmen.

Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi (#6.3)

Dokumentimi i përparimit

Raporti EITI 2015 paraqet *kontributin në PBB* të industrive nxjerrëse (minerare, naftë dhe gaz) në(3%) (Raporti EITI 2015, p. 10) por jo në terma absolute. Megjithatë raporti paraqet një link për në faqen e INSTAT,¹²⁹ ku mund të merret informacion mbi PBB 2015 si në çmimet aktuale ashtu dhe ato konstatnte (Raporti EITI 2015, f. 84). Raporti EITI 2015 nuk ofronte një përlllogaritje të përmasave të sektorit informal, të tilla si ai minerar artizanal.

Për sa i përket pjesës së industrisë nxjerrëse në *të ardhurat e qeverisë*, Raporti EITI 2015 ofron pjesën relative të sektorëve minerarë, të naftës, gazit dhe hidroenergjitik (rreth 4.1%) (Raporti EITI 2015, f. 5), si dhe, në terma relative dhe absolute, kontributin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në të ardhurat totale të të ardhurave nga nafta dhe gazi (“mbi 1.1%” dhe “afërsisht 2%”, ose USD 54.6 milionë USD) (Raporti EITI 2015, f. 11, 35) dhe minerare (“minimumi 0.8%” dhe “rreth 1.1%,” ose 31.2 milionë USD) (Raporti EITI 2015, f. 12, 53). Megjithatë, duke pasur parasysh kufizimet në aftësinë e qeverisë për të disagreguar përbërësin e industrisë nxjerrëse në taksat e zakonshme, raporti ofron vetëm të ardhurat e raportuara nga qeveria prej kompanive materiale, dhe jo të ardhurat totale nga industria nxjerrëse. Megjithatë, raporti është transparent lidhur me sfidat në disagregimin e përbërësve të industrive nxjerrëse të taksave tëzakonshme (*shih Kërkesa 4.1*), ofron një shifër për të ardhurat totale nga minierat, nafta dhe gazi, bazuar në raportimin EITI dhe formulon një rekomandim për të trajtuar paaftësinë e qeverisë për të ofruar një shifër përfshirëse për të ardhurat totale nxjerrëse.

Raporti EITI 2015 ofron pjesën e *eksporteve* të sektorit nxjerrës në terma absolute dhe relative¹³⁰ (Raporti EITI 2015, f. 10), si dhe të disagreguar midis naftës bruto¹³¹ dhe eksporteve minerale¹³² (Raporti EITI 2015, f.22,42).

Raporti po ashtu paraqet pjesën e sektorit nxjerrës në *punësim* për të tri sektorët (minerar, naftë dhe gaz, hidroenergji) në terma relative (“më pak se 1%” e punësimit total”) (Raporti EITI 2015, f.5), si dhe në

¹²⁹ <http://www.instat.gov.al/al/home.aspx>

¹³⁰ 24% e eksporteve totale në vitin 2015, ose 57.9 miliardë Lek.

¹³¹ 252 milionë USD ose 13% e eksporteve totale në vitin 2015.

¹³² 26.3 miliardë Lek, ose 208.5 milionë USD, ekuivalente me 11% të eksporteve totale në vitin 2015.

terma absolute dhe relative për naftën dhe gazin¹³³ (Raporti EITI 2015, f.11,23) dhe minerat¹³⁴ (Raporti EITI 2015, f.12,41).

Për sa i përket *vendndodhjes* së industrive nxjerrëse, Raporti EITI 2015 paraqet harta të depozitave kryeosre të naftës dhe gazit (Raporti EITI 2015, f. 23) dhe mineraleve (Raporti EITI 2015, f.43-48).

Raporti 2013-14 EITI paraqiste një nivel të ngjashëm të dhënash makroekonomike por nuk ofronte vlerën absolute të pjesës së industrive nxjerrëse në PBB apo pjesën e industrive nxjerrëse në totalin e punësimit në vitin 2013 (Raporti EITI 2013-14, f.11, 44).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP shpjegoi se informacion mbi përbërjen e PBB në terma absolute dhe relative mund të gjendej në faqen e internetit të INSTAT-it dhe se Raporti EITI 2015 jepte një link për në faqen e INSTAT. Një përfaqësues qeveritar shpjegoi se INSTAT publikonte të dhëna paraprake të PBB në nëntorin e vitit pasardhës dhe të dhënat përfundimtare për PBB në majin pasues. Megjithatë, INSTAT publikonte edhe të dhëna tremujore për PBB me çmimet konstante brenda 90 ditësh nga fundi i tremujorit. AP shpjegoi se i kishte përfshirë të dhënat e PBB në terma relative në Raportin EITI 2015 vetëm për lehtësi të të kuptuarit dhe tha se palët e interesuara mund të aksesonin lirisht informacion shtesë mbi përbërjen e PBB, nëpërmjet portalit të INSTAT.

Konsultime të gjera me një gamë të gjerë përfaqësuesish nga grupet e interesit theksuan paaftësinë e qeverisë për të paraqitur një shifër përfshirëse për të ardhurat totale të qeverisë nga industria nxjerrëse, duke pasur parasysh vështirësitë në disagregimin e përbërësve nga industria nxjerrëse në taksat e zakonshme. Një numër përfaqësuesish theksuan se kjo ishte problem vetëm për kompanitë minerare, dhe jo ato të naftës dhe gazit që prireshin të operonin vetëm në sektorin e naftës dhe gazit (*shih Kërkesa 4.1*).

Një përfaqësues i qeverisë shpjegoi se INSTATI përllogariste përmasat e sektorit informal, për shembull atë minerar artizanal, nëpërmjet (Anketimit Strukturor të Biznesit) Structural Business Survey (SBS), ku iu kërkonin kompanive të përllogarisnin përmasat e forcës së tyre të punës, dhe pastaj e krahasonin këtë informacion me të dhëna zyrtare për punësimin. Megjithatë, asnjë prej përfaqësuesve të grupeve të interesit që u konsultuan nuk kishte dijeni për ndonjë studim që përllogariste vlerën e aktivitetit minerar informal.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm drejt përmbushjes së kësaj kërkesë. Ndërkohë që Raporti EITI 2015 paraqet, në terma absolute dhe relative,

¹³³ 3215 punonjës, ose 0.3% e punësimit total në vitin 2015.

¹³⁴ 5000 punonjës, ose 0.4% e punësimit total në vitin 2015.

përlllogaritje të kontributit të industrive nxjerrëse në të ardhurat, eksportet, punësimin dhe vendndodhjen e aktiviteteve kryesore, ai paraqet vetëm kontributin e sektorit minerar, të naftës dhe gazit në PBB në terma relative, jo absolute. Megjithatë, është e mundur të aksesohet vlera e PBB në 2015 si në çmimet aktuale dhe konstante nëpërmjet faqes së internetit INSTAT, e cila lejon lexuesit të llogarisë kontributin e industrive nxjerrëse në PBB në terma absolute.

Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen do të përfshijnë vlerën e kontributit të industrive nxjerrëse në PBB në terma absolute dhe të ofrojë shifra specifike për informacionin makroekonomik mbuluar sipas Kërkesës 6.3. MSG nxitet të studiojë masën në të cilën mund të ofrojë informacion të përditësuar makroekonomik mbi kontributin e industrive nxjerrëse në kohën e duhur nëpërmjet faqes së internetit AlbEITI (ose ndonjë tjetër).

Tabela 6- Tabelë përmbledhës e vlerësimit fillestar: shpenzimet sociale dhe ekonomike

Dispozitat EITI	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar për përparimin në dispozitat EITI (për t'u plotësuar për dispozitat (e kërkuara')
Shpenzimet sociale (#6.1)	MSG nuk duket të ketë vlerësuar nëse shpenzimet sociale të detyrueshme ekzistojnë sipas termave kontraktuale përpara mbledhjes së të dhënave dhe ka konfuzion të përhapur nëse ekziston ndonjë shpenzim i tillë social i detyrueshëm. Raporti EITI 2015 ofron raportimin e njëanshëm të shpenzimeve sociale nga një kompani naftë dhe gazi (ndonëse kjo mund të ketë qenë përfshirë gabimisht), por nuk sqaron nëse këto ishin të detyrueshme dhe nuk përfshin shqetësimet e AP lidhur me tërësinë e raportimit të shpenzimeve sociale të detyrueshme në Raportin EITI 2015. MSG duket të mos ketë bërë asnjë përpjekje për të bërë dallimin midis shpenzimeve sociale të detyrueshme dhe vullnetare, shpenzimeve cash dhe në natyrë dhe as për të sqaruar identitetin e marrësit joqeveritar të shpenzimeve sociale të detyrueshme.	Përparim i pamjaftueshëm
Shpenzime gjysmë-fiskale të NPSH-ve (#6.2)	Nuk ka të dhëna që MSG të ketë shqyrtuar ndonjëherë çështjen e shpenzimeve gjysmë-fiskale në lidhje me Albpetrolin apo ndonjë tjetër NPSH nxjerrëse	S'ka përparim

Kontributi i sektorit nxjerrës në ekonomi (#6.3)	Ndërkohë që Raporti EITI 2015 paraqet, në terma absolute dhe relative, përlllogaritje të kontributit të industrive nxjerrëse në të ardhurat, eksportet, punësimin dhe vendndodhjen e aktiviteteve kryesore, ai paraqet vetëm kontributin e sektorit mineral, të naftës dhe gazit në PBB në terma relative, jo absolute. Megjithatë, është e mundur të aksesohet vlera e PBB në 2015 si në çmimet aktuale dhe konstante nëpërmjet faqes së internetit INSTAT, e cila lejon lexuesit të llogarisë kontributin e industrive nxjerrëse në PBB në terma absolute.	Satisfactory progress
<p>Rekomandimet e Sekretariatit</p> <ol style="list-style-type: none"> Në përputhje me kërkesën 6.1.a, MSG duhet të dakordësojë një dallim të qartë midis shpenzimeve sociale të detyrueshme dhe vullnetare përpara mbledhjes së të dhënave dhe të sigurojë që shpenzimet materiale sociale të detyrueshme të publikohen në mënyrë përfshirëse në Raportet EITI të ardhshme. Aty ku përfituesit e shpenzimeve sociale të detyrueshme janë një palë e tretë, dmth jo një ent qeveritar, MSG duhet të sigurojë që të publikohen emri dhe funksioni i përfituesit. MSG mund të dojë të shohë masën në të cilën do të ishte i nevojshëm publikimi i kontratave faktike minerare, të naftës dhe gazit (ose shqyrtimi i termave kryesore) për të ofruar një vlerësim përfshirës të ekzistencës së shpenzimeve sociale të detyrueshme. MSG mund po ashtu të dojë të shqyrtojë fizibilitetin e rakordimit të shpenzimeve sociale të detyrueshme. Në përputhje me kërkesën 6.2, MSG duhet të shqyrtojë ekzistencën dhe materialitetin e ndonjë shpenzimi gjysmë-fiskal ndërmarrë nga NPSH-të nxjerrëse dhe ato në varësi të tyre, duke siguruar që të gjitha shpenzimet gjysmë-fiskale të bëhen publike në Raportet EITI të ardhshme. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurojë që Raportet EITI në të ardhmen do të përfshijnë vlerën e kontributit të industrive nxjerrëse në PBB në terma absolute dhe të ofrojë shifra specifike për informacionin makroekonomik mbuluar sipas Kërkesës 6.3. MSG nxitet të studiojë masën në të cilën mund të ofrojë informacion të përditësuar makroekonomik mbi kontributin e industrive nxjerrëse në kohën e duhur nëpërmjet faqes së internetit AlbEITI (ose ndonjë tjetër). 		

Pjesa III – Rezultatet dhe Ndikimi

7. Rezultatet dhe Ndikimi

7.1 Vështrim i përgjithshëm

Ky seksion vlerëson zbatimin e Kërkesave EITI në lidhje me rezultatet dhe ndikimin e procesit EITI.

7.2 Vlerësimi

Debati publik (#7.1)

Dokumentimi i përparimit

Tërësia: Sekretariati AlbEITI ka drejtuar të gjitha përpjekjet e komunikimit lidhur me EITI prej vitit 2011, strukturuar nëpërmjet strategjive të komunikimit për vitet 2011-2012, 2014-2015 dhe 2016-2017. Të gjitha Raportet EITI që mbulojnë vitet 2009-2015, përmbledhjet e tyre dhe Dosjet e të Dhënave Përmbledhëse janë në dispozicion në shqip dhe anglisht në faqen e AlbEITI,¹³⁵ si dhe janë botuar fizikisht. AP ka përgatitur Raportet Përmbledhëse EITI që po ashtu gjenden online dhe si kopje fizike.¹³⁶ Sekretariati përditëson shpesh faqen e AlbEITI, e cila mbulon të gjitha aktivitetet EITI dhe lajmet e fundit në seksionin e lajmeve dhe blogjeve.¹³⁷ Sekretariati po ashtu ka përgatitur dy buletine EITI¹³⁸ dhe një broshurë¹³⁹ në vitin 2012, ndonëse duket se kjo praktikë ka ndaluar më pas. Sekretariati AlbEITI prodhoi dy video promovionale për procesin EITI në Shqipëri, një në janar 2017¹⁴⁰ dhe një në mars 2015¹⁴¹ për të promovuar Raportin EITI 2013-2014. Me nxitjen e Sekretariatit, AlbEITI ka ndjekur çështje të diskutueshme të tilla si transfertat lokale që nuk transferoheshin tek qeveritë vendore¹⁴² dhe ka publikuar një suplement të Raportit EITI 2015 që mbulon transfertat lokale në qershor 2017 (Alb-EITI, 2017).

Promovimi: Sekretariati AlbEITI ka promovuar në mënyrë aktive informacionin për EITI me anë të përmbledhjeve të shtypit,¹⁴³ aktivitete informuese në Tiranë dhe rajonet nxjerrëse,¹⁴⁴ anketime,¹⁴⁵ median

¹³⁵ <http://www.albeiti.org>

¹³⁶ Përmbledhje e Raportit EITI 2015, <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/02/Brochure-EITI2.pdf>

¹³⁷ <http://www.albeiti.org/news-2/>

¹³⁸ http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/newsletter_3.pdf; http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/NewLetter_print-1.pdf

¹³⁹ http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/Broshura_Albeiti_2012.pdf

¹⁴⁰ <https://www.youtube.com/watch?v=rrjfhNsTako&feature=youtu.be>

¹⁴¹ <https://www.youtube.com/watch?v=g1wccmQbbw&feature=youtu.be>

¹⁴² Mbledhja dhe shpërnarja e rentës tek NJQV-të, <http://www.albeiti.org/collection-and-distribution-of-mining-rent-in-igus/>

¹⁴³ <http://www.albeiti.org/press-conference-eiti-report-2013-and-2014/>

¹⁴⁴ <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/EITI-Report-2015-Subnational-Royalty-1.pdf>; <http://www.albeiti.org/presentation-of->

sociale dhe workshop-e për ndërtim kapacitetesh për MSG;¹⁴⁶ shoqërinë civile, median¹⁴⁷ dhe kompanitë.¹⁴⁸ Sekretariati zhvilloi fushata të zgjeruara infomuese që përfshinë takime me qeveritë vendore, popullatat vendore dhe kompanitë në rajonet ku zhvillohen aktivitete nxjerrëse (Tiranë, Korçë, Berat, Kuçovë, Fier, Marinzë, Patos, Bulqizë dhe Kukës). Përveç kësaj, MSG zhvilloi dy takime në rajonet nxjerrëse: një takim në mars 2017 në Borizanë ku zhvillohet prodhim çimentoje¹⁴⁹ dhe një takim në dhjetor 2016 në Bulqizë ku prodhohet krom. Sekretariati së bashku me anëtarë të MSG zhvilluan një tryezë të rrumbullakët me kompani nxjerrëse dhe qeverinë vendore në Kukës¹⁵⁰ në shkurt 2016. Nuk ka të dhëna që anëtarët e MSG të kenë qenë të përfshirë aktivisht në aktivitete të tjera informuese dhe shpërndarjeje në rajonet nxjerrëse, përfshi nga shoqëria civile, përtej atyre aktiviteteve të nxitura e drejtuara nga Sekretariati AlbEITI. Videoja e fundit promovuese bazuar në Raportin EITI 2015 u shfaq në nëntë qytete të mëdha (Tiranë, Korçë, Berat, Kuçovë, Fier, Marinzë, Patos, Bulqizë dhe Kukës) në shkurt 2017 dhe komentet në lidhje me perceptimin dhe të kuptuarit e njerëzve për tema ekonomike komplekse por të thjeshtuara gjendet në një tjetër studim.¹⁵¹ Sipas një anketimi mbi Ndikimin të AlbEITI në vitin 2016, 70% e të intervistuarve konsideronin Facebook-un si mjetin e tyre kryesor për të aksesuar informacion lidhur me industrinë nxjerrëse në Shqipëri (Alb-EITI, 2016).

Aksesibiliteti publik: Sekretariati AlbEITI ka qenë aktiv për të siguruar aksesibilitetin publik të informacionit EITI si në kanalet online, në kopje fizike dhe me anë të aktiviteteve të përhapjes dhe informimit. Një prani aktive në median sociale zhvillohet në Facebook.¹⁵² Personeli i sekretariatit është përpjekur të përmirësojë aksesibilitetin e të dhënave EITI duke zhvilluar infografika të lehta për t'u aksesuar, për shembull hartëzimin e të ardhurave nga industria nxjerrëse në Shqipëri në mënyrë grafike.¹⁵³

Politika e të dhënave të hapura: MSG dakordësoi Politikën e të Dhënave të Hapura të AlbEITI-t në dhjetor 2016, e cila i referohet politikës së qeverisë lidhur me aksesin në informacion në përputhje me Axhendën Dixhitale për periudhën 2015-2020 për E-governance dhe Shoqërinë e Informacionit¹⁵⁴ si pjesë e angazhimeve të qeverisë për OGP (Keshilli i Ministrave, 2015). MSG përditësoi materialin në mars 2017 duke shtuar Parimet dhe Përparësitë për të Dhënat e Hapura me rëndësi për axhendën kombëtare (AlbEITI, 2017). Lidhur me aksesin dhe publikimin, politika deklaron se të dhënat duhet të jenë të plota, autentike, në kohë, të aksesueshme, të lexueshme nga pajisjet, jodiskriminuese, pa pronësi, dhe të publikuara nën një licensë të hapur. Lidhur me ripërdorimin, deklaron se të dhënat duhet të përdoren, modifikohen dhe ndarë lirisht nga kushdo dhe për çdo qëllim. Për sa i përket qeverisjes së burimeve natyrore, qeveria duhet të lëvizë drejt normalizimit EITI dhe të sigurojë të dhëna në kohë me cilësi të lartë

[the-2015-eiti-report-in-bulgize/](http://www.albeiti.org/presentation-of-the-2015-eiti-report-in-fier-and-patos-2/); <http://www.albeiti.org/presentation-of-the-2015-eiti-report-in-fier-and-patos-2/>

¹⁴⁵ <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/2016-Impact-and-Outcomes-of-EITI-Implementation-in-Albania-4-ENG.pdf>

¹⁴⁶ <http://www.albeiti.org/training-from-world-bank-mission-for-msg-members-eiti-albania/>

¹⁴⁷ <http://www.albeiti.org/transparency-and-accountability-in-the-extractive-industry-in-albania/>

¹⁴⁸ <http://www.albeiti.org/roundtable-with-the-extractive-industries-operators/>

¹⁴⁹ <http://www.albeiti.org/msg-meeting-in-premises-of-antea-in-borizane-kruije/>

¹⁵⁰ <http://www.albeiti.org/round-table-with-the-extractive-industries-operators-in-kukes/>

¹⁵¹ <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/02/Eng-Report-Testimi-i-Spotit-te-Vjeter-.pdf>

¹⁵² <https://www.facebook.com/eitialbania/?fref=ts>

¹⁵³ <http://www.albeiti.org/extractive-industries-map-2/>

¹⁵⁴ https://issuu.com/miap4/docs/booklet_m-inovacionit_preview

që mund të përdoren dhe ripërdoren në format të lexueshëm nga pajisje dhe në mënyrë efektive për nga kosto (AlbEITI, 2017, p. 5).

Kontributi për debatin publik: Mbulimi nga media i aktiviteteve të AlbEITI ka qenë i zgjeruar, si në kohën e publikimit të Raporteve EITI si dhe gjatë udhëtimeve informuese dhe workshop-eve, në median online¹⁵⁵ dhe të shkruar, videolajme¹⁵⁶ dhe programe TV.¹⁵⁷ Strategjia e komunikimit EITI 2016-2017 shënjestron grupet kyçe të interesit përfshi ente qeveritare, qeveritë dhe komunitetet vendore, median, OSHC-të, kompanitë nxjerrëse, akademikë dhe studentë, kërkues dhe ekspertë si dhe publikun e gjerë (Alb-EITI, 2016). Ndërkohë që Raportet EITI janë përdorur si mjete diagnostikuese për qeverisjen e industrisë nxjerrëse të Shqipërisë, përfshi zgjerimin tek sektori hidroenergjitik si përparësi e lartë e qeverisë në vitin 2015, përpjekjet e komunikimit janë përqendruar më shumë tek rritja e EITI-t si proces më shumë se sa në gjetjet dhe shifrat e vetë Raporteve EITI. Duke parë se si progres-raporti vjetor për 2016 e thekson EITI-n si mekanizëm për të luftuar korrupsionin, për të siguruar transparencë dhe nxitur reforma sektoriale (Alb-EITI, 2017), është e qartë që AlbEITI ka promovuar në mënyrë aktive debatin public lidhur me faktet dhe reformat e sektorit në komunikimet dhe punën informuese të tyre.

Sipas anketimit për Ndikimin në 2016, 78% e të pyeturve nuk kishin dëgjuar kurrë për EITI, ku të intervistuarit urbanë përbënin pjesën më të madhe të atyre që kishin dëgjuar për EITI-n të paktën një herë. Fakti që 80% nuk ishin në dijeni të të ardhurave të gjeneruara nga kompanitë nxjerrëse u përdor për të demonstruar nivelin e ulët të ndërveprimit midis kompanive dhe komuniteteve pritëse (Alb-EITI, 2016).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Tërësia: Një anëtar i OSHC në MSG shpjegoi se shoqëria civile kishte sugjeruar që MSG të bënte versionin e vet të thjeshtuar të të Raportit EITI, paralelisht me raportin normal përmbledhës prodhuar nga AP, por se kjo nuk ishte mbështetur nga anëtarë të tjerë të MSG. një numër partnerësh zhvillimi vërejtën përdorimin e Raporteve EITI për fakte dhe të dhëna statistikore, por theksuan faktin se Raportet e mëdha AlbEITI nuk ishin shumë miqësore ndaj përdoruesve. Disa zyrtarë të qeverisë mendonin se të dhënat EITI ishin të dobishme për qytetarët. Disa përfaqësues nga grupe të ndryshme interesi u shprehën se pjesa e rakordimit ishte e lehtë për t'u lexuar dhe vetëm disa pjesë të raportit narrativ mund të kishin qenë theksuar. Disa përfaqësues qeveritarë vërejtën se disa përfaqësues të grupeve të interesit nuk kuptonin të dhënat komplekse në Raportet EITI. Një tjetër përfaqësues qeverie tha se Raportet EITI ishin të mjaftueshme dhe konsideroheshin mes raporteve më të mira për industrinë nxjerrëse në vend.

Promovimi: Përfaqësues të ndryshëm qeveritarë thanë se shpërndanin aktivisht Raportet EITI Reports, për shembull kur vizitonin rajonet për të biseduar me komunitetet lokale, në takime të Këshillit të Ministrave dhe të tjera ente qeveritare, si dhe për takime me kompani dhe investues. Disa partnerë zhvillimi vërejtën

¹⁵⁵ Organi mediatik Droni, <http://www.droni.al/2016/01/20/eiti-publikon-transparencen-e-minierave-dhe-naftes-per-dy-vite/>

¹⁵⁶ <https://www.youtube.com/watch?v=53EzMIr5VDk>

¹⁵⁷ Intervistë me Dorina Cinari në SCAN TV, 7 janar 2016, <https://www.youtube.com/watch?v=7JeWBLyJvI>

se nuk i kishin marrë Raportet EITI më parë dhe do ta vlerësonin nëse do të merrnin njoftim kur Raportet EITI publikoheshin, duke kritikuar faktin që nuk ishin ftuar në aktivitete të lidhura me EITI. Një gazetar mendonte se qeveria e përdorte procesin EITI për të përmirësuar imazhin e vet ndërkombëtar.

Një anëtar nga OSHC në MSG vërejti se AlbEITI zhvillonte shumë aktivitete në rajonet njerrëse dhe herëherës ftonte shoqërinë civile të merrte pjesë, edhe pse i intervistuari tha se kishte marrë pjesë vetëm një herë për shkak të kohës. Një tjetër anëtar nga OSHC në MSG tha se shoqëria civile gjithmonë e përmendte EITI-n dhe përfitimet e tij kur fliste me qeverinë dhe komunitetet vendore. Disa përfaqësues nga OSHC si brenda edhe jashtë MSG theksuan kufizimet e financimit për të shpjeguar mungesën e përpjekjeve të shoqërisë civile për EITI-n jashtë Tiranës, në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me përpjekjet e Sekretariatit AlbEITI. Megjithatë, përfaqësuesit e shoqërisë civile u ankuan se nuk kishin financime për të zhvilluar aktivitete informuese dhe ndërgjegjësi. OSHC-të mohuan që AlbEITI t'i kishte kërkuar ndonjëherë t'u bashkoheshin aktiviteteve informuese në rajonet nxjerrëse. Asnjë prej OSHC-ve të konsultuara nuk ofroi prova për përdorimin prej tyre të të dhënave EITI, pavarësisht pretendimeve të përgjithshme se të dhënat EITI ishin të dobishme për nevojat e OSHC-ve për avokati dhe lobim.

Aksesibiliteti publik: Një numër përfaqësuesish qeveritarë komentuan se Raportet EITI ishin publikisht në dispozicion dhe të konsultuara gjerësisht në faqen e AlbEITI. Personeli i sekretariatit shpjegoi se i gjithë dokumentacioni përkatës ngarkohej vazhdimisht në faqen e internetit, përfshi Raportet EITI, përmbledhjet dhe analizat e të dhënave të tyre. Sekretariati publikoi Raportin EITI 2015 si gjithë të tjerët, në shqip dhe raportin përmbledhës EITI në shqip dhe në anglisht. Grupet e interesit nuk shprehën ndonjë pikëpamje të veçantë lidhur me dobinë e të dhënave EITI për kompanitë apo shoqërinë civile dhe as nuk ofruan shembuj specifikë për përdorimin e tyre. Megjithatë, një numër përfaqësuesish të qeverisë dhe kompanive vërejtën përdorimin e Raporteve EITI për investuesit që kërkonin të aplikonin për licensa minerare apo naftë dhe gazi, dhe mendonin se do ishte e dobishme nëse të dhënat kyçe EITI do të nxirreshin dhe përktheheshin në broshura dhe infografikë.

Kontributi për debatin publik: Një anëtar nga OSHC në MSG tha se aktivitetet e ndërgjegjësimit dhe informimit ishin me rëndësi për zbatimin e EITI-t.

Disa përfaqësues industrie thanë se kompanitë përdornin EITI për të lobuar për të drejtat e tyre dhe se iu shërbente si platformë për të komunikuar sfidat e tyre. U vu në dukje se raportimi dhe përdorimi i të dhënave EITI ishte rritur me kalimin e viteve. Raportet dalin më në kohë, cilësia e të dhënave EITI është përmirësuar dhe është bërë më i gjerë. U vërejt se komunitetet mund të shihnin informacionin për pagesat e kompanive dhe të kuptonin më mirë vlerën e pagesave për industrinë nxjerrëse. Një përfaqësues nga industria përgëzoi faktin që Raporti EITI 2013-2014 kishte përfshirë informacion për pagesat sociale por i vinte keq që Raporti EITI 2015 nuk ofronte të tilla të dhëna.

Një kryebashkiak në një rajon nxjerrës tha se dëgjesat publike dhe konsultimet me qytetarët zhvilloheshin në mënyrë të rregullt dhe mes temave të tjera diskutonin edhe për procesin EITI. EITI kishte nxitur diskutime nga qytetarët që kërkonin përfitime nga të jetuarit në toka me pasuri. Zyrtari vendor vërejti se përveç zhvillimit të dëgjesave dhe takimeve të AlbEITI, nuk kishte mekanizëm tjetër të qëndrueshëm nëpërmjet të cilit të shpreheshin shqetësime për çështje vendore në nivel kombëtar. Zyrtari vendor bëri

thirrje që qeveria të konsultohet me qeveritë vendore dhe qytetarët kur merr vendime të rëndësishme të tilla si transfertat e rentës.

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë. Raportet EITI janë publikuar rregullisht dhe në kohë, raportet e plota botohen në shqip dhe anglisht në kopje fizike dhe online. Sekretariati AlbEITI ka qenë shtyja kryesore për komunikimet dhe informimin, hera-herës duke sakrifikuar angazhimin e grupeve të interesit, si dhe ka shpërndarë dhe promovuar gjerësisht Raportet EITI në rrethe dhe online me anë të videove, artikujve dhe anketimeve. Megjithatë, duke qenë se Sekretariati EITI është duke ekzekutuar aktivitete të planit të punës, mund të argumentohet se sekretariati operon me mandat nga MSG. ka disa të dhëna për përdorimin e të dhënave EITI nga disa grupe interesi përfshi qeverinë, gazetarët dhe në një masë më të vogël shoqëria civile. MSG ka dakordësuar një politikë mbi aksesin, nxjerrjen dhe ripërdorimin e të dhënave EITI, e cila është përputhur me axhendën më të gjerë të qeverisë.

Për të forcuar zbatimin, MSG duhet të shqyrtojë forcimin e angazhimit të aktorëve të ndryshëm në përpjekjet për komunikime, shpërndarje dhe informim, për të siguruar shpërndarje më të gjerë dhe debat publik për çështje të lidhura me EITI-n. Qeverisja e burimeve natyrore dhe anti-korrupsioni janë tema të nxeha në Shqipëri dhe MSG mund të dojë t'ia përshtasë diskutimet EITI kërkesave të prekshme të grupeve të interesit.

Aksesueshmëria e të Dhënave (#7.2)

Dokumentimi i përparimit

Politika e AlbEITI për të Dhënat e Hapura përcakton prezumimin e qartë të transparencës për të gjithë informacionin AlbEITI (Alb-EITI, 2016). Tabelat përmbledhëse të të dhënave u prodhuan për të gjithë Raportet AlbEITI që mbulojnë shtatë vite fiskale (2009-2015) në format të lexueshëm nga pajisjet në faqen e internetit AlbEITI¹⁵⁸ de në faqen e Shqipërisë të faqes globale EITI.¹⁵⁹ Megjithatë, AlbEITI ende nuk ka publikuar dosje të lexueshme nga pajisjet të të gjitha të dhënave të rakorduara në Raportet EITI. Ka të dhëna të kufizuara për diskutime të MSG lidhur me rekomandimet që lidhen me Kërkesën 5.1 të EITI mbi sistemet e klasifikimit të të ardhurave ose prodhimin e raporteve përmbledhëse. Megjithatë, MSG ka publikuar përmbledhjet të Raporteve AlbEITI, të aksesueshme në faqen e internetit AlbEITI dhe ka shpërndarë kopje fizike të raporteve. MSG përfshiu lëvizjen drejt publikimit në format të dhëna të hapura si një prej objektivave të saj për planin e punës EITI 2016-2019. Gjithashtu, MSG punësoi DM Consulting Services për të eksploruar mundësi për të integruar EITI-n në sistemet qeveritare në vitin 2015. Studimi i fizibilitetit, përmbledhja ekzekutive e të cilit është e aksesueshme në faqen e internetit AlbEITI,¹⁶⁰

¹⁵⁸ <http://www.albeiti.org/en/>

¹⁵⁹ <https://eiti.org/albania#revenue-collection>

¹⁶⁰ <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2015/04/Feasibility-study-for-the-implementation-of-EITI-data-integrated-system-in-Albania->

përqendrohej në vlerësimin e sistemeve ekzistuese dhe potencialin për të krijuar një sistem raportimi EITI online (DM Consulting Services, 2015).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Disa nga personeli i sekretariatit dhe përfaqësues të qeverisë theksuan se tabelat përmbledhëse të të dhënave ishin përgatitur për të gjitha Raportet EITI prodhuar nga Shqipëria dhe ishin të aksesueshme në faqen e internetit AlbEITI. Anëtarë të personelit të sekretariatit dhe partnerë zhvillimi pohuan se studimi i para-fizibilitetit ishte iniciuar tepër herët dhe ishte fokusuar në ndërlidhjet teknike midis sistemeve IT të qeverisë në vend të çështjeve më të gjera të integritetit të raportimit sipas Kërkesave specifike EITI në sistemet qeveritare rutinë. Personeli i sekretariatit theksoi rëndësinë e politikës dhe punës për të dhëna të hapura të qeverisë, duke vërejtur se përpjekjet për të dhëna të hapura EITI ishin duke u integruar në politikën më të gjerë të të dhënave të hapura të qeverisë me qëllim që të shmangej duplikimi i sistemeve për grumbullimin e të dhënave dhe automatizimi i agregimit. Asnjë prej grupeve të interesit të konsultuara nuk shprehën ndonjë pikëpamje të veçantë mbi përdorimin e të dhënave EITI të lexueshme nga pajisjet.

Disa përfaqësues nga grupi i interesit i qeverisë dhe personel i sekretariatit theksuan studimin e para-fizibilitetit 2015 të AlbEITI-t por vërejtën se ishte fokusuar në integrimin e bazave ekzistuese të të dhënave nga një perspektivë IT në vend të shqyrtimit të informacionit të kërkuar sipas EITI-t që tashmë prodhohej nga sistemet qeveritare. Një konsulent theksoi mungesën e integritetit të bazave të të dhënave të qeverisë, duke vërejtur se agjenci të tilla si Doganat, Tatimet, AKBN dhe të tjera nuk komunikojnë. Ndërkohë që Agjencia Kombëtare për Sistemet IT (NAIS) përpiqej të integronte bazat e të dhënave të qeverisë nëpërmjet GovNet cloud, kjo ishte ende në fazë embrionale. Konsulenti po ashtu vërejtë se kompanive tani u kërkohej të deklaroheshin taksat online, prej vitit 2015. Megjithatë, një numër zyrtarësh qeveritarë theksuan përpjekjet në proces për të ngritur Sistemin Informatik Financiar Shqiptar (AFMIS) në vitin 2018, një projekt prej 40 milionë Euro mbështetur nga Agjencia Austriake e Zhvillimit,¹⁶¹ i cili do të integronte bazat e të dhënave të Thesarit, Doganave, Tatimeve, Departamentet e Buxhetit dhe Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave.

Vlerësimi fillestar

Kërkesa 6.2 nxit MSG-të që t'i bëjnë raportet EITI të aksesueshme për publikun në formate të të dhënave të hapura. Përpjekje të tilla nxiten por nuk janë të kërkuara dhe nuk duhen shqyrtuar gjatë vlerësimit të përputhshmërisë me Standartin EITI. Të dhënat AlbEITI janë të disponueshme në format të lexueshëm nga pajisjet nëpërmjet faqes së internetit të AlbEITI dhe faqes së Shqipërisë në faqen globale të EITI-t, duke u furnizuar nga tabela përmbledhëse të dhënash hartuar nga sekretariati kombëtar dhe AP. Sekretariati AlbEITI po ashtu ka botuar përmbledhje të Raportëve EITI përgatitur nga AP.

[4.pdf](#)

¹⁶¹ http://www.entwicklung.at/fileadmin/user_upload/Dokumente/Publikationen/Landesstrategien/CS_Albania_2015-2020.pdf

Mësime të nxjerra dhe ndjekja e rekomandimeve (#7.3)

Dokumentimi i përparimit

Progres raporti vjetor 2016, miratuar nga MSG më 20 mars 2017,¹⁶² paraqet një vështrim të përgjithshëm të përgjigjes së MSG dhe përparimit të bërë në trajtimin e disa prej rekomandimeve nga Raporti EITI 2015 (f.36-44). Progres raporti vjetor rendit 14 rekomandimet nga Raporti EITI 2015, të gjitha të cilat ishin të përsëritura nga Raporte EITI të mëparshme. Rekomandimet lidhen si me Kërkesat EITI ashtu edhe me përmirësime të mëtejshme në sistemet e qeverisë, përfshi:

- përmirësimi i procesit të raportimit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave,
- kërkimi i sigurimit të cilësisë për raportimin e kompanive përmes auditimit statutor,
- rakordimi i transfertave lokale dhe përfshirja e NJQV-ve në raportim,
- tranzitimi në raportimin e centralizuar të të ardhurave nga industritë nxjerrëse nga sistemi i Thesarit,
- nxitja e MEI-t dhe AKBN për të publikuar të dhëna statistikore në mënyrë rutinë (psh. për prodhimin, eksportet, investimet dhe punësimin, etj.) në faqet e tyre të internetit,
- publikimi i të dhënave për rezervat e provuara të burimeve natyrore,
- mirëmbajtja e një regjistri licensash apo sistemi kadastre të përditësuar që të jetë i aksesueshëm publikisht,
- publikimi online i kriterëve financiarë dhe teknike, listës së tenderuesve dhe rezultateve të tenderave për akordimin e licensave, dhe
- amendimi i bazës ligjore për raportimin EITI përfshirës (Alb-EITI, 2017).

MSG ka diskutuar disa nga rekomandimet në disa raste, përfshi vonesat në raportimin EITI, praktikat e sigurimit të cilësisë, përmirësime në sistemet e raportimit, raportimin nga NJQV-të, publikimi rutinor i të dhënave të prodhimit, mirëmbajtja e një regjistri licensash online dhe publikimi i procedurave për akordimin e licensave. Megjithatë, nuk ka të dhëna se MSG investigoi mospërputhjet e parakorduara pas publikimit të Raporteve EITI. Duke qenë se AP ofroi të njëjtat rekomandime për Raportin EITI 2013-2014 si për Raportin EITI 2015, përparimi në zbatimin e rekomandimeve të kaluara EITI duket se ka qenë i kufizuar vetëm tek diskutimet e MSG. Në shumicën e rasteve, MSG ra dakord me rekomandimet dhe i la detyrë Sekretariatit AlbEITI t'i ndante dhe ndiqte rekomandimet me entet përkatëse individuale.

¹⁶² <http://www.albeiti.org/year-2017/>

Raporti EITI 2015 nuk vlerëson përparimin në zbatimin e 14 rekomandimeve nga Raporti EITI i mëparshëm dhe as komenton nëse ndonjë prej tyre ishte trajtuar. Progres-raporti vjetor vëren se mungesa e zbatimit ligjor nuk i lë entet raportuese të marrin pronësinë dhe të veprojnë për rekomandimet (f. 36). Për këtë arsye, MSG dhe AlbEITI iniciuan një rishikim ligjor që sugjeronte amendime në kuadrin ligjor për të forcuar dhe fuzikuar zbatimin e rekomandimeve EITI të kaluara (Eurosupport, 2017). Bazuar në rishikimin ligjor, një konsulent zhvilloi një projekt-Ligj për Transparencën e Aktivitetit të Industrive Nxjerrëse në Shqipëri, mbështetur nga qeveria dhe gati për t'u miratuar nga parlamenti përpara shtatorit 2017.

Rekomandimet që nuk duket të jenë ndjekur nga qeveria por duken me mjaft rëndësi për përmirësimet në menaxhimin e industrive nxjerrëse përfshijnë:

- rakordimin nga entet raportuese të pagesave të taksave me zyrat rajonale të tatimeve përpara dorëzimit të formularëve të raportimit EITI;
- publikimin nga MF të një formule për llogaritjen e 5% të rentës dhe raportimin se si iu shpërnda NJQV-ve;
- kërkimin nga MEI të pasqyrave financiare të audituara nga kompanitë nxjerrëse;
- diagregimin e pagesave sipas licensave;
- standartizimin e të dhënave statistikore në faqet e internetit të MEI dhe AKBN për raportim më në kohë.

Alb-EITI përgatiti një plan pune për të ndjekur rekomandimet nga Raporti EITI 2015. Plani i punës paraqet të gjitha rekomandimet e kaluara EITI, objektivat, veprimet e kërkuara, grupin e interesit përgjegjës dhe afatet. Plani i punës¹⁶³ po ashtu planifikonte ngritjen e grupeve të punës të anëtarëve të MSG dhe enteve përkatëse të qeverisë për të trajtuar secilin rekomandim, të cilat zhvilluan takimin e parë të përbashkët më 9 maj 2017¹⁶⁴

Pikëpamjet e grupeve të interesit

AP vërejti se trajtimi i rekomandimeve kërkonte bashëpunim midis institucioneve të qeverisë për të ndërtuar procese kombëtare të brendshme EITI dhe për të ngritur kontrollet e nevojshme të cilësisë, për shembull për të dhënat e prodhimit. AP vërejti se kishte memorie të pamjaftueshme institucionale kudo në qeveri për shkak të ndryshimeve të shpeshta të personelit ministror, çka nënkuptonte se kërkohej ndjekje dypalëshe me entet individuale të qeverisë në lidhje me rekomandime të kaluara EITI. AP vërejti se shumë pak rekomandime EITI janë trajtuar në praktikë, me përjashtim të dukshëm ofrimin për herë të parë të një liste të numrave identifikues tatimorë të të gjitha kompanive materiale tek AP për Raportin

¹⁶³ The work plan on recommendations from EITI reports is available in Albanian.

¹⁶⁴ <http://www.albeiti.org/working-group-on-implementing-the-independent-administrators-recommendations-on-the-2015-eiti-report/>

EITI 2015.

Personeli i sekretariatit konfirmoi se nuk kishte strukturë të institucionalizuar për të ndjekur dhe zbatuar rekomandimet EITI dhe vërejtje se ndjekja ishte mbi baza dypalëshe midis sekretariatit dhe agjencive qeveritare përkatëse. Personeli i sekretariatit dhe anëtarë të caktuar të MSG vërejtën se në fund të vitit 2016 kishin filluar të trajtonin rekomandimet që lidheshin me amendamentet ligjore. Megjithatë, AP vërejtje se amendamentet ligjore do të kërkonin përpjekje domethënëse nga qeveria përtej MSG dhe theksuan se të njëjtat rekomandime ishin përsëritur në pesë Raportet EITI të fundit. Sipas AP, kur MSG diskutonte rekomandimet e Raporteve EITI, zakonisht nuk kundërshtonte ndonjë prej tyre dhe as nuk komentonte apo bënte sugjerime.

Një zyrtar i lartë i qeverisë tha se rekomandimet EITI ishin marrë në konsideratë nga qeveria dhe shërbenin për të përmirësuar menaxhimin e industrive nxjerrëse. Zyrtari deklaroi se të dhënat EITI do të bëheshin edhe më të rëndësishme për vendim-marrjen me anë të përpjekjeve të qeverisë për të standartizuar raportimin EITI të kompanive, për ta integruar në raportimin normal të kompanive tek qeveria dhe për të siguruar publikimin më në kohë (psh. në tremujor). Personeli i sekretariatit tha se MEI dhe AlbEITI kishin dërguar letra zyrtare tek entet qeveritare për të ndjekur rekomandimet individuale në 2015-2016, edhe pse ministritë ishin të ngadalta në përgjigje dhe shumë nuk i ndoqën çështjet. U vërejt se disa ente qeveritare nuk ishin të gatshme të merrnin pronësinë në trajtimin e rekomandimeve nga Raportet EITI dhe MSG kishte vetëm diskutime të shpërndara lidhur me rekomandime të caktuara. Sekretariati përgatiti një listë rekomandimesh nga Raporti EITI 2015 dhe sugjeroi krijimin e grupeve të punës që do të trajtonin secilin rekomandim. Një përfaqësues kompanie tha se rekomandimet në Raportet EITI duheshin paraqitur dhe diskutuar nga çdo grup interesi, por se kjo nuk kishte ndodhur në praktikë me Raportet EITI të mëparshme.

Vlerësim fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim domethënës në përmbushjen e kësaj kërkesë. Ka të dhëna të kufizuara se MSG bëri follow-up për mësimet e nxjerra, për të identifikuar, investiguar dhe trajtuar shkaqet e mospërputhjeve dhe për të trajtuar rekomandimet për përmirësime nga AP në Raportet EITI të mëparshme. Shënimet e takimeve të MSG nuk zbulojnë diskutime thelbësore për rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga Raportet EITI. Raporte EITI të njëpasnjëshme që mbulojnë pesë vite kanë përfshirë të njëjtat rekomandime. Progres-raporti vjetor ofron njëfarë vlerësimi të ndjekjes së rekomandimeve të kaluara EITI, edhe pse në një masë të kufizuar. Sekretariati AlbEITI ka qenë drejtuesi i ndjekjes së rekomandimeve, në mënyrë dypalëshe me agjencitë përkatëse me anë të grupeve të punës ad hoc, edhe pse mungesa e angazhimit të grupeve të interesit ka kufizuar masën në të cilën ndjekja nga sekretariati ka pasur ndikim.

Në përputhje me kërkesën 7.3, MSG duhet të ndëmarrë hapa për të vepruar lidhur me mësimet e nxjerra, për të identifikuar, hetuar dhe trajtuar shkaqet për ndonjë mospërputhje, dhe për të shqyrtuar rekomandimet që rezultojnë nga raportimi EITI. MSG, në konsultim sidomos me grupin e interesit nga qeveria, mund të dojë të shohë mundësinë për institucionalizuar mekanizmat e tij për të ndjekur

rekomandimet nga Raportet EITI dhe Validimi si mjet për të siguruar vëmendje më strikte ndaj zbatimit.

Rezultatet dhe ndikimi i zbatimit (#7.4)

Dokumentimi i përparimit

AlbEITI ka prodhuar katër raporte të aktivitetit vjetor që mbulojnë vitet 2013-2016, botuar në shqip dhe anglisht, të cilët gjenden në faqen e internetit të AlbEITI.¹⁶⁵ Ashtu si në vitet e kaluara, MSG miratoi progres-raportin vjetor 2016 dhe e publikoi në faqen e AlbEITI në mars 2017, përpara afatit të 1 korrikut, për të siguruar relevancën dhe afatet për grupet e interesit.

Progres-raporti vjetor nënvizon se një prej rezultateve kryesore të zbatimit EITI në Shqipëri ishte përfshirja e sektorit hidroenergjitik në fushën e raportimit nga viti 2015. Sektori hidroenergjitik është një përparësi e qeverisë në Shqipëri dhe shtrirja e EITI-t tek hidroenergjinë synonte të theksonte sfidat në atë sektor si dhe të siguronte që transparenca do të çonte në reforma dhe përmirësime në qeverisje. Pavarësisht mungesës së kërkesave ligjore për kompanitë hidroenergjitike për të raportuar, këto kompani kanë raportuar vullnetarisht për tre vitet e fundit (Alb-EITI, 2017). Progres-raporti përfshin një përmbledhje të aktiviteteve të ndërmarra në vitin 2016 (Alb-EITI, 2017, f. 3-11). Raporti vëren se puna në vitin 2016 u përqendrua tek përgatitja e Raportit EITI 2015 dhe ndjekja e reformave ligjore për industrinë nxjerrëse si pasojë e rekomandimeve nga Raporti EITI 2013-2014 (Alb-EITI, 2017, f. 3). Raporti po ashtu paraqet një vlerësim të përparimit për përmbushjen e kërkesave EITI, duke deklaruar se Raporti EITI 2015 mbulon 100% të të ardhurave në naftë dhe gaz, 95% në hidroenergjitikë dhe 88% në miniera. Ai ofron një vlerësim të përparimit dhe veprimeve të ndërmarra në lidhje me aspektet e “inkurajuar” të Standartit EITI të tilla si menaxhimi dhe shpenzimi i të ardhurave, pagesat e transportit, shpenzime sociale opsionale, transfertat lokale, kontratat dhe pronësia reale (Alb-EITI, 2017, f. 23-34). Ndërkohë që progres-raporti vjetor nuk përfshin një vlerësim të përparimit për përmbushjen e secilës Kërkesë EITI, secili prej tre Raportëve AlbEITI të kaluara ka dhënë një vështrim përfshirës të përparimit me çdo kërkesë, p.sh. në Shtojcën 10 të Raportit EITI 2015 (EITI Shqiperi, 2016, f. 161). Progres-raporti vjetor po ashtu komenton aspektet e Standartit EITI që u kapërcyen, për shembull në sektorin hidroenergjitik.

Progres-raporti vjetor ofron një vështrim të kufizuar të përgjigjeve të MSG dhe përparimit të bërë në trajtimin e rekomandimeve nga Raporti EITI 2015 (EITI Shqiperi, 2016, f. 36-44). Progres-raporti vjetor rendit 14 rekomandime nga Raporti EITI,¹⁶⁶ ndonëse këto përfshihen edhe në Raportin EITI 2015. Progres-raporti vjetor jep të dhëna të qarta se MSG nuk e ka konsideruar plotësisht ose nuk ka diskutuar në hollësi ndonjë ndjekje për rekomandimet EITI, duke qenë se shumica e rekomandimeve të shqyrtuara në

¹⁶⁵ <http://www.albeiti.org/publications/>

¹⁶⁶ Vonesat dhe mospërputhjet, procesi i Sigurimit të cilësisë, aspekte të tjera të cilësisë së analizës së pagesave, Mungesa e raportimit të centralizuar në nivel qeveritar, Raportimi nga Njësitë e Qeverisjes Vendore, Kufizimet në raportet e prodhuara nga MIS i Tatimeve, Publikimi i statistikave në sektor, të dhënat dhe vlerat e prodhimit, Publikimi i të ardhurave totale të qeverisë, Rezervat, Mirëmbajtja e një regjistri publik të përditësuar të licensave dhe koncesioneve, Transparenca për akordimin e licensave, Rakordimi i transfertave lokale dhe aspektet Rregullatore në contest të raportimit EITI.

progres-raportin vjetor nuk ka treguar ndonjë pozicion që ka mbajtur MSG apo ndonjë veprim për t'i (*shih Kërkesa 7.3*).

Progres-raporti vjetor rendit 12 objektivat nga plani i punës EITI 2016,¹⁶⁷ të cilat lidhen me aspektet teknike EITI dhe jo me prioritetet kombëtare të industrive nxjerrëse, ndonëse objektivat e planit të punës 2017 janë më në linjë me përparësitë kombëtare dhe Parimet EITI. Progres-raporti vjetor vlerëson përparimin krahasuar me objektivat e renditura të planit të punës, duke theksuar rezultatet e zbatimit për çdo objektiv dhe komente për ndikimin ku ka qenë e mundur (Alb-EITI, 2017, f. 11-22). Progres-raporti vjetor përfshin një vështrim përshkrues të pikave të forta dhe atyre të dobëta të zbatimit të EITI në Shqipëri. Raporti komenton se aspektet më të forta përfshijnë shtrirjen e gjerë të kompanive raportuese dhe ndërgjegjësimin EITI mes grupeve të interesit, ndërkohë që një prej dobësive përfshin njohuritë e dobëta për EITI-n mes qytetarëve. Raporti sugjeron mënyra për t'i trajtuar këto dobësi duke ngritur më shumë fonde dhe duke ndërtuar kapacitetet e grupeve të interesit, ndërkohë që rekomandon që Raportimi EITI të integrohet në sistemet raportuese qeveritare për të siguruar qëndrueshmërinë e procesit, përtej varësisë së tij aktuale nga financimet e donatorëve të huaj (Alb-EITI, 2017, f. 46). Raporti nuk komenton në lidhje me të tjera përpjekje për të zgjeruar shtrirjen e zbatimit EITI përtej zgjerimit të raportimit me sektorin hidroenergjitik. Progres-raporti paraqet një vështrim të përgjithshëm të financimit dhe shpenzimeve, përfshi një buxhet të hollësishëm (Alb-EITI, 2017, f. 47-48), dhe shtjellon ndryshimet në MSG mes grupeve të qeverisë dhe shoqërisë civile dhe miratimin e TeR të reja të MSG. Progres-raporti vjetor po ashtu është ilustruar me foto nga takimet e SMG dhe aktivitete të tjera të EITI-t në 2016 (Alb-EITI, 2017, f. 51-62).

AlbEITI ndërmori tre anketime për të matur ndikimin e EITI-t tek komunitetet. Anketimi i parë u krye në tetor 2014 dhe shqyrtonte ndërgjegjësimin e përgjithshëm për zbatimin EITI dhe ndikimin e operacioneve të industrive nxjerrëse tek qytetarët në Bulqizë, Kukës, Librazhd, Patos, Perrenjas dhe Tiranë (AlbEITI, 2014). Anketimi i dytë, ndërmarrë në janar 2016, tregoi se 90% e 1,000 të intervistuarve ishin në dijeni të operacioneve nxjerrëse në rajone por dinin pak për pagesat që bënin kompanitë, përfshi 5% rentë ((AlbEITI, 2016). Anketimi i tretë u zhvillua në shtator 2016 dhe mbuloi trembëdhjetë qytete (Bulqizë, Burrel, Fier, Korçë, Kukës, Librazhd, Patos, Pogradec, Përrenjas, Rrëshen, Tiranë, Vau i Dejës dhe Vlorë) (Alb-EITI, 2016).

Pikëpamjet e grupeve të interesit

Asnjë prej përfaqësuesve të grupeve të interesit që u konsultuan, përfshi anëtarët E MSG, nuk shprehën ndonjë pikëpamje të posaçme mbi përdorimin e progres-raportit vjetor të AlbEITI. Personeli i sekretariatit vërejtë se progres-raporti u shpërnda në disa aktivitete informuese në rrethe dhe ishte i dobishëm për aktivitetet e AlbEITI gjatë vitit. Personeli i sekretariatit po ashtu theksoi ekzistencën e raporteve të ndryshme vjetore auditimi për AlbEITI, të cilat gjenden në seksionin Transparencë të faqes së internetit

¹⁶⁷ Plani i punës EITI 2016; Raporti i Aktivitetit Vjetor 2015; MSG; Shqyrtimi ligjor dhe rregullator; Strategjia e Komunikimit 2016-2017; Aktivitete komunikimi; Raporti EITI 2015; Validimi EITI 2016; Studim mbi përdorimin e transparencës për të ardhurat nga renta dhe dhurimet e kompanive nxjerrëse tek qeveria vendore; Anketime mbi ndikimin e EITI; projekte shtesë; dhe ndërtimi i kapaciteteve EITI.

AlbEITI, të cilat shiheshin si plotësuese të progres-raportit vjetor të AlbEITI. Shumica e përfaqësuesve të grupeve të interesit që shprehën ndonjë pikëpamje lidhur me çështjen dukej se e shikonin progres-raportin vjetor si një dokument përputhshmërie, në linjë me Kërkesat EITI, më shumë se sa një mjet për të komunikuar aktivitetet e AlbEITI tek grupe më të gjera dhe tek publiku i përgjithshëm. Një anëtar i qeverisë në MSG konfirmoi se projekt-raporti i progresit vjetor u përgatit nga sekretariati AlbEITI dhe u qarkullua midis anëtarëve për komente. Progres-raporti vjetor u konsiderua i dobishëm për sa i përket ndjekjes së përparimit, identifikimit të rezultateve dhe vlerësimit të boshllëqeve. Një anëtar nga OSHC në MSG vërejti se shoqëria civile kishte ofruar komente dhe input për progres-raportin vjetor 2016 gjatë takimeve të MSG.

Në lidhje me rezultatet dhe ndikimin e zbatimit të EITI-t kishte pikëpamje të ndryshme si midis ashtu edhe brenda grupeve të interesit. Një përfaqësues i qeverisë komentoj se EITI ofronte të dhëna të besueshme dhe ndihmonte për të vlerësuar boshllëqet në sistemet e raportimit. Një zyrtar vërejti se qeveria e përdorte EITI-n për të tërhequr investime më të përgjegjshme dhe për të miratuar rregulla më transparente për biznesin në Shqipëri. Disa përfaqësues të qeverisë vërejtën se raportimi EITI konsiderohej neutral dhe shërbente si mjet diagnostikues për të ofruar të dhëna të besueshme për qeverinë, ku të dhënat EITI shpesh përdorshin nga deputetët dhe zyrtarët e qeverisë sidomos për të parashikuar të ardhurat. Disa përfaqësues nga të gjitha grupet theksuan rreshtimin EITI përgjatë prioriteteve kombëtare duke vërejtur zgjerimin e zbatimit EITI në sektorin hidroenergjitik, meqenëse kjo në vetvete përbënte një ndikim të zbatimit EITI. Një zyrtar i lartë qeveritar tha se raportimi vjetor nuk ishte i mjaftueshëm dhe se EITI duhet të mbulonte tema më tematike me interes për publikun, duke vërejtur se qeveria shihte vlerë në zgjerimin e EITI-t edhe më tej tek pyjet dhe peshkimi. Disa zyrtarë të qeverisë theksuan rëndësinë e përgjithshme të EITI-t si formë e praktikës së mirë të njohur ndërkombëtarisht. Një anëtar nga industria në MSG tha se EITI përdorej për të komunikuar shqetësime lidhur me qeverisjen e burimeve natyrore dhe si mjet për të siguruar investitorët që duan garanci se investimi i tyre do të jetë i sigurtë duke sqaruar paqartësitë. Kështu, sipas përfaqësuesit, EITI ndihmoi për të sqaruar paqartësitë. Një përfaqësues i shoqërisë civile tha se zbatimi EITI ishte forcuar gradualisht, ku OSHC-të kishin ndjekur çdo hap që nga fillimi në 2009, dhe MSG kishte kërkuar në mënyrë konsekuente përmirësimin e Raporteve EITI. Një tjetër përfaqësues nga OSHC mendonte se EITI ishte një mjet i mirë që Shqipëria të ishte transparente për minierat, naftën, gazin dhe ujin dhe që mund të zgjerohej më tej tek peshkimi dhe pyjet, siç MSG kishte diskutuar kohët e fundit. Një përfaqësues nga OSHC ngriti shqetësime lidhur me nevojën për rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm lidhur me EITI-n, duke pasur parasysh sfidat e qytetarëve për të kuptuar kompleksitetin e të ardhurave që gjenerohen nga industrinë nxjerrëse. Ai vërejti edhe që angazhimi i NJQV-ve dhe enteve përkatëse qeveritare ishte sfidues, duke pasur parasysh kufizimet në kapacitete të vetë OSHC-ve dhe se EITI përbënte një mjet për të ndërtuar kapacitete lidhur me qeverisjen e industrive nxjerrëse.

Sipas një anketimi për ndikimin e EITI-t, zhvilluar në shtator 2016, qytetarët mendonin se ndërkohë që industrinë nxjerrëse duhet t'i shërbenin zhvillimit ekonomik, social dhe kulturor të komuniteteve, zakonisht kjo nuk ndodhte. Kur pyeteshin se kush ndërmjet qeverisë, pronarëve të kompanive, banorëve dhe "njerëzve të fuqishëm" ishin përfituesit realë të pagesave dhe të ardhurave të gjeneruara nga industrinë nxjerrëse, 33% e të intervistuarve zgjodhën qeverisjen vendore dhe askush nuk zgjodhi banorët (Alb-EITI, 2016). Sipas studimit për ndikimin, afro 75% e të intervistuarve nuk kishin dijeni për ndonjë investim publik të kryer me të ardhura që vinin nga aktivitet nxjerrëse në qytetin e tyre. Anketimi tregoi

se qytetarët ishin kryesisht të shqetësuar për rritjen e ngadaltë ekonomike dhe nivelet e larta të papunësisë në zonat e tyre. Megjithatë, një e katërta e të intervistuarve besonin se punët publike të kryera në shumë qytete Shqiptare financoheshin nëpërmjet të ardhurave të gjeneruara nga industritë nxjerrëse (Alb-EITI, 2016).

Vlerësimi fillestar

Vlerësimi fillestar i Sekretariatit Ndërkombëtar është se Shqipëria ka bërë përparim të kënaqshëm në përmbushjen e kësaj kërkesë. MSG ka shqyrtuar përparimin dhe rezultatet e zbatimit në mënyrë të rregullt, përfshi duke publikuar progres-raporte vjetore gjatë katër viteve të kaluara. Megjithatë, progres-raporteve u mungon vlerësimi i ndikimit dhe nuk trajtojnë të gjitha rekomandimet nga Raportet EITI të mëparshme. Gjithsesi, ka prova se AlbEITI k andërmarrë forma të tjera për vlerësimin e ndikimit me anë të anketimeve dhe vlerësimeve të ndikimit.

Për të forcuar zbatimin, MSG mund të shihte mundësinë për të diskutuar rolin që EITI mund të luante për arritur prioritetet kombëtare në reformën e industrive nxjerrëse si pjesë e rishikimit vjetor të planit të punës. MSG mund të dojë edhe të ndërmarrë një vlerësim ndikimi me qëllim identifikimin e mundësive për të rritur ndikimin e zbatimit.

Tabela 7 – Tabelë përmbledhëse e vlerësimit fillestar: Rezultatet dhe ndikimi

Dispozitat EITI	Përmbledhje e gjetjeve kryesore	Rekomandimi i Validuesit për përputhshmërinë me dispozitat EITI (për t'u plotësuar për dispozitat 'e kërkuara')
Debati publik (#7.1)	<p>Raportet EITI janë publikuar rregullisht dhe në kohë, raportet e plota botohen në shqip dhe anglisht në kopje fizike dhe online. Sekretariati AlbEITI ka qenë shtypsa kryesore për komunikimet dhe informimin, hera-herës duke sakrifikuar angazhimin e grupeve të interesit, si dhe ka shpërndarë dhe promovuar gjerësisht Raportet EITI në rrethe dhe online me anë të videove, artikujve dhe anketimeve. Megjithatë, duke qenë se Sekretariati EITI është duke ekzekutuar aktivitete të planit të punës, mund të argumentohet se sekretariati operon me mandat nga MSG. ka disa të dhëna për përdorimin e të dhënave EITI nga disa grupe interesi përfshi qeverinë, gazetarët dhe në një masë më të vogël shoqëria civile. MSG ka dakordësuar një politikë mbi aksesin, nxjerrjen dhe ripërdorimin e të dhënave EITI, e cila është përputhur me axhendën më të gjerë të qeverisë.</p>	Përparim i kënaqshëm
Aksesueshmëria e të dhënave (#7.2)	<p>Kërkesa 6.2 nxit MSG-të që t'i bëjnë raportet EITI të aksesueshme për publikun në formate të të dhënave të hapura. MSG dakordësoi Politikën e të Dhënave të hapura dhe përfshiu të dhënat më të aksesueshme si një nga objektivat e planit të punës EITI. Përpjekje të tilla nxiten por nuk janë të kërkuara dhe nuk duhen shqyrtuar gjatë vlerësimit të përputhshmërisë me Standartin EITI.</p>	

<p>Mësime të nxjerra dhe ndjekja e rekomandimeve (7.3)</p>	<p>Ka të dhëna të kufizuara se MSG ka ndërmarrë veprime serioze për të vepruar mbi mësimet e nxjerra, për të identifikuar, investiguar dhe trajtuar shkaqet e mospërputhjeve dhe për të trajtuar rekomandimet për përmirësime nga AP në Raportet EITI të mëparshme. Shënimet e takimeve të MSG nuk zbulojnë diskutime thelbësore për rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga Raportet EITI. AP ofroi të njëjtat rekomandime për dy Raportet EITI të fundit dhe pak veprime u ndërmorën për t'i trajtuar ato. Deri në njëfarë mase, një vlerësimi kufizuar i pikëpamjeve të MSG për rekomandimet u paraqit në Progres-Raportin Vjetor 2016. AlbEITI zhvilloi një plan pune për të ndjekur rekomandimet nga Raporti EITI 2015.</p>	<p>Përparim domethënës</p>
<p>Rezultate dhe ndikimi i zbatimit (#7.4)</p>	<p>MSG ka prodhuar një përmbledhje të aktiviteteve të ndërmarra në vitin 2016 nëpërmjet Progres-Raportit Vjetor. PRV vëren pikat e forta dhe të dobëta të procesit EITI në Shqipëri. Pavarësisht mungesës së ndikimit në PVR, ka të dhëna për përpjekjet e MSG për të vlerësuar ndikimin me anë të mjeteve të tjera, si anketimet.</p>	<p>Përparim i kënaqshëm</p>

Rekomandimet e sekretariatit:

1. Për të forcuar zbatimin, MSG nxitet të sigurohet që Raportet EITI të ardhshme të përfshijnë vlerën e kontributit të industrive nxjerrëse në PBB në terma absolute dhe të ofrojnë shifra specifike për informacionin makroekonomik që mbulohet sipas Kërkesës 6.3. MSG nxitet të studio masën në të cilën mund të ofrojë informacion të përditësuar makroekonomik për kontributin e industrive nxjerrëse më në kohë nëpërmjet faqes së internetit të AlbEITI (ose ndonjë tjetër faqeje qeveritare).
2. MSG nxitet që të ofrojë më shumë të dhëna EITI në formate të dhënash të hapura.
3. Në përputhje me kërkesën 7.3, MSG duhet të ndërmarrë hapa për të vepruar për mësimet e nxjerra, për të identifikuar, investiguar dhe trajtuar shkaqet e ndonjë mospërputhjeje dhe të shqyrtojë rekomandimet që rrjedhin nga raportimi EITI. Në konsultim sidomos me grupet e interesit nga qeveria, MSG mund të dojë të shqyrtojë institucionalizimin e mekanizmave për të ndjekur rekomandimet e Raporteve EITI dhe Validimit si mjete për të siguruar vëmendje më strikte ndaj zbatimit.
4. Për të forcuar zbatimin, MSG mund të konsideronte të diskutonte rolin që mund të lunate EITI për të arritur prioritetet kombëtare në reformimin e industrive nxjerrëse si pjesë e shqyrtimit vjetor të planit të punës. MSG mund të dojë edhe të ndërmarrë një vlerësim ndikimi me qëllim identifikimin e mundësive për të rritur ndikimin e zbatimit.

8. Analiza e ndikimit

(nuk duhet konsideruar në vlerësimin e përputhshmërisë me dispozitat EITI)

Dokumentimi i përparimit

Ndikimi

Objektivat e zbatimit të EITI në Shqipëri, siç është dakordësuar nga MSG, përfshijnë qeverisjen e konsoliduar të burimeve natyrore, duke u zhvendosur drejt formatit të të dhënave të hapura, mbështesin pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe merren me korrupsionin. Objektivat u miratuan në fillim të vitit 2017 dhe është herët për të vlerësuar përparimin e zbatimit të tyre. Megjithatë, ka një drejtim pozitiv lëvizjeje në përmbushjen e shumicës së këtyre objektivave dhe rezultatet e zbatimit kanë treguar ndikim pozitiv.

EITI ka qenë një platformë e rëndësishme për të forcuar transparencën dhe llogaridhënien në qeveri dhe industrinë nxjerrëse në Shqipëri. EITI po ndihmon për të përmirësuar sistemet dhe procedurat, sidomos lidhur me licensimin. Për shembull, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ka ndërtuar një regjistër minierash pas rekomandimeve nga Raportet EITI. Me anë të raportimit EITI, qeveria ka zbuluar një numër pengesash domethënëse për të marrë transfertat lokale të rentës që iu takonin NJQV-ve. Në vitin 2014, formula e alokimit dhe pjesa e rentës u ndryshuan, duke mundësuar ekzekutim në praktikë.

Procesi i raportimit EITI në Shqipëri ndodh në kohë dhe përgjithësisht menaxhohet mirë. Ministri i Energjisë dhe Industrisë Damian Gjoknuri dhe Zëvendës Ministri Ilir Bejtja kanë demonstruar një angazhim energjik ndaj zbatimit EITI. Sekretariati Alb-EITI drejtuar nga Dorina Cinari është konsoliduar mirë.

Ka interes në rritje, nga jashtë dhe brenda, në sektorin hidroenergjitik, i cili mbulohet në Raportet EITI Shqiptare. Raportet EITI paraqesin një bazë solide për të dhëna të hapura, sjellin qartësi në kuadrin ligjor dhe fiskal që qeveris sektorin dhe japin rekomandime për reforma strukturore. Përmirësimi i rregullimit të koncesioneve hidroenergjitike mund të stimulojë zhvillimin e sektorit.

Projekti i Gazsjellësit Trans-Adriatik është bërë një nga motorët kryesorë të zhvillimit ekonomik dhe social të vendit. EITI mund të përcaktonte një kuadër për transparencë dhe llogaridhënie të projektit TAP në Shqipëri.

Në dritën e ndryshimit politik pas zgjedhjeve parlamentare në qershor, çështja e diskutimit të pronësisë reale është posaçërisht me rëndësi. Në vitin 2017, Alb-EITI do të ndëmarrë një projekt pilot mbi publikimin e pronarëve realë të kompanive nxjerrëse. Udhërrëfyesi trevjeçar i Shqipërisë për pronësinë reale (deri në 2020) ofron hapat e tjerë për harmonizimin e rregullimeve të brendshme me Direktivat e BE-së lidhur me bërjen publike të pronarëve realë. Udhërrëfyesi parashikon ngritjen e një regjistri publik për pronësinë reale në vitin 2018, i cili potencialisht mund të përfshihej në bazat e të dhënave ekzistuese për regjistrat korporativë.

Angazhimi konstruktiv: EITI ka ndihmuar me krijimin e mundësive për dialog mes enteve të ndryshme qeveritare që më parë nuk koordinoheshin lidhur me çështjet nxjerrëse. Shumë përfaqësues të qeverisë ranë dakort se pjesëmarrja në raportimin EITI dhe ndjekja e takimeve të MSG kishin mundësuar komunikim më të shpeshtë mes enteve përkatëse. Shoqata e Investitorëve të Huaj të Shqipërisë (FIAA) po

ashtu nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me AlbEITI në tetor 2016 për të forcuar bashkëpunimin dhe koordinimin e industrisë. FIAA ka në plan të ndërmarrë informim më të gjerë tek kompanitë me pronësi vendase me qëllim që të marrin pjesë si në FIAA, në EITI dhe potencialisht në MSG. megjithatë, ka pak të dhëna për ndikimin e EITI-t në forcimin e bashkëpunimit midis OSHC-ve dhe ndërtimin e besimit midis OSHC-ve dhe grupeve të tjera të interesit. Ndërkohë që EITI ka mbështetur lindjen graduale të lidhjeve me grupet e qeverisë dhe industrisë, ka të dhëna të pakta për lidhje apo koordinim domethënës brenda grupit të shoqërisë civile. Gjithashtu, marrëdhëniet në MSG mbeten të tensionuara dhe besimi midis anëtarëve të MSG nga grupe të ndryshme është zhvilluar vetëm në mënyrë sporadike.

Kontributet ekonomike: Nëpërmjet raportimit EITI, qeveria theksoi kufizimet në aftësinë e saj për të llogaritur të ardhurat totale nga industria nxjerrëse për shkak të paaftësisë për të ndarë përbërësit e taksave të zakonshme paguar nga konglomerate të diversifikuara. Megjithëkëtë, nëpërmjet Raportit EITI, qeveria ka ndihmuar zhvillimin e përlllogaritjeve në të ardhurat totale minerare, të naftës dhe gazit duke përdorur të dhënat EITI. Duke u mbështetur në gjetjet e Raporteve EITI, AP ka rekomanduar në mënyrë të përsëritur reformimin e sistemeve të Thesarit për të trajtuar paaftësinë e qeverisë për të ofruar një shifër përfshirëse për të ardhurat totale nga industria nxjerrëse. Gjithashtu, Raportet EITI të Shqipërisë kanë treguar, për herë të parë, mekanizmin për të mbledhur rentën dhe për të alokuar një pjesë për transfertë tek NJQV-të (5% të rentës), duke theksuar sfidat në disbursimin e transfertave lokale.

Të kuptuarit publik: AlbEITI zhvilloi tri anketime të opinionit lidhur me ndikimin e EITI mes komuniteteve që jetojnë në rajonet nxjerrëse (Pogradec, Korçë, Bulqizë, Burrel, Librazhd, Kukës, Vlora, Patos, Fier, Perrenjas, Rrëshen, Vau i Dejes dhe Tirana) (AlbEITI, 2014), (AlbEITI, 2016), (Alb-EITI, 2016). Anketimet tregojnëse pavarësisht se janë në dijeni të aktiviteteve nxjerrëse në rajonet e tyre, qytetarët nuk e dinin se si ata përfitonin nga këto aktivitete, as se sa paguanin kompanitë. Disa kompani vërejtën se e gjenin EITI-n të dobishëm për marrëdhëniet e tyre publike dhe se shikonin vlerë dhe ndikim në drejtim të përmirësimit të të kuptuarit të publikut. Një numër zyrtarësh të qeverisë shpjeguan se e përdornin EITI-n për të përmirësuar imazhin e Shqipërisë në nivel ndërkombëtar.

Forcimi i sistemeve qeveritare: Nëpërmjet raportimit EITI, grupet e interesit Shqiptare kanë identifikuar çështje të NJQV-ve që nuk marrin transfertat e rentës që u takon. Në të kaluarën, transfertat e 25% rentës për NJQV-të varej nëse këto NJQV arrinin 120% të taksave të buxhetuara vendore, e cila ishte e pamundur të arrihej në mënyrë konsekuente. Pjesa e rentës u zbrit nga 25% në 5% në vitin 2014 dhe transfertat tani ekzekutoheshin pa kushte.

Qeveria ofroi një mjedis mundësues ligjor për raportimin EITI të kompanive, përfshi dispozita për ta bërë raportimin EITI të detyrueshëm në bazë të Ligjit 10304 për sektorin minerar dhe Ligjin 7746 (i ndryshuar) për hidrokarburet (Parlament, 2010), (Parlament, 2015). Neni 51 i Ligjit 10304 për sektorin minerar specifikisht heq çdo dispozitë konfidencialiteti lidhur me pagesën e taksave vendore dhe kombëtare në sektorin minerar dhe konfirmon detyrimin e kompanive minerare për të publikuar pagesa të tilla tek EITI (Parlaament, 2010).

Njohja: EITI ka qenë i rëndësishëm për imazhin ndërkombëtar të Shqipërisë. Mes negociatave lidhur me projektin TAP, EITI ka qenë i rëndësishëm në përcaktimin e një kuadri për transparencë dhe

Ilogaridhënie në pagesat e kompanive tek qeveria si dhe shpenzimet sociale. Zbatimi i ETIT-t po ashtu ka qenë me rëndësi për qeverinë shqiptare për të mbështetur axhendën e saj reformuese si pjesë e përpjekjeve të saj për anëtarësim në BE.

Qëndrueshmëria

Financimi: MEI ka ofruar në mënyrë konseguente financim të pjesshëm për zbatimin EITI, duke mbuluar afërsisht një të tretën e nevojave të AlbEITI për fonde. Ky financim mbulonte pagat e personelit të sekretariatit, prokurimet administrative, transportin, hapësirën e zyrave dhe mjedise të tjera. Pjesa tjetër prej dy të tretash është mbuluar nga Fondi i Trustit Shumë-Donatorësh (MDTF) i Bankës Botërore deri në vitin 2016 dhe MDTF e Mbështetjes Programore Globale për Industrinë Nxjerrëse (EGPS) prej vitit 2016. Varësia e madhe tek financimi i jashtëm imponon risqe në qëndrueshmërinë e procesit. Megjithatë, nga pikëpamja afatmesme, përfshirja e raportimit EITI në sistemet qeveritare dhe të kompanive duhet të sigurojë qëndrueshmërinë e zbatimit EITI nga pikëpamja afatgjatë.

Institucionalizimi: Alb-EITI ka zhvilluar një projektligj për EITI-n me qëllim futjen e tij në kuadrin legjislativ kombëtar. Ligji ka gjetur mbështetje politike brenda qeverisë dhe me gjasë do të miratohet përpara shtatorit 2017. Qeveria ka shprehur mbështetje për Ligjin e MSG për Transparencën në Industrinë Nxjerrëse, i cili është përafuar me Direktivën për Transparencë të BE-së dhe sanksionon kërkesat kyçe EITI në legjislacionin kombëtar. MF ka mbështetur një projekt-Ligj për Raportimin Kontabël dhe Financiar, i cili do të integronte raportimin e certifikuar EITI të kompanive në kërkesat e tyre statutores për raportimin tek qeveria.

Shtojca

Shtojca A – Listë e anëtarëve të MSG dhe hollësitë e kontaktit¹⁶⁸

Kreu i Grupit Ndër-Institucional (MSG)

Z. Ilir Bejtja Zëvendës Ministër, Ministria e Energjisë dhe Industrisë ilir.bejtja@energjia.gov.al
+355692071156

Përfaqësues të Qeverisë Shqiptare

Z. Dritan Spahiu, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dritan.spahiu@energjia.gov.al +355666059000

Z. Sajmir Laçej, Ministria e Financave sajmir.lacej@financa.gov.al +355676051100

Z. Aurel Lamçe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse aurel.lamce@drejtesia.gov.al
+355694037144

Znj. Borjana Shaka Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve borjana.shaka@tatime.gov.al +355689073400

Z. Nikoll Kaza Shërbimi Gjeologjik Shqiptar nikollkaza@hotmail.com +355684045759

Z. Azbi Arapi Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore azbiarapi@yahoo.com +355682055616

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Z. Sami Neza Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë saminezaus@yahoo.com +355682088602

Z. Ilir Aliaj Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve natolin02@yahoo.co.uk
+355692095284

Znj. Anila Hajnaj Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim anilahajnaj@gmail.com +355674109682

Z. Baki Bajraktari Sindikata e Minatorëve të Bulqizës bajraktaribaki@gmail.com +355686335686

Përfaqësues të Operatorëve të Industrive Nxjerrëse

Z. Adriatik Golemi Bankers Petroleum Ltd agolemi@bankerspetroleum.com +355696078243

Z. Saimir Boka Albchrome s.boka@albchrome.al +355664020432

Z. Perparim Alikaj FIAA alikalp@albmail.com +355682020101

Z. Dritan Dervishaj ANTEA Cement dervishajd@anteacement.com +355694060150

Z. Turker Sengonul Shell Upstream Albania – Menaxher Kombëtar t.sengonul@shell.com +35542440888

Kontribues të Përherëshëm të Procesit EITI

Z. Mehmet Hasalami Ministria e Energjisë dhe Industrisë mehmet.hasanlami@energjia.gov.al
355692091555

Zn. Arjana Dyrmishi Drejtoria e Përgjithshme e Doganave arjana.dyrmishi@dogana.gov.al +355684086152

Z. Oltion Kuke Drejtoria e Përgjithshme e Doganave +355682031218

Znj. Jonida Kaza Ministria e Financave jonida.kaza@financa.gov.al +355692941950

Znj. Entela Muha Ministria e Drejtësisë entela.muha@drejtesia.gov.al +355699982929

Znj. Laura Cela Bankers Petroleum Ltd lcela@bankerspetroleum.com +355662030715

Z. Bilal Koçi Shërbimi Gjeologjik Shqiptar koci.bilal@yahoo.com +355684083181

Z. Sokol Mati sokol.mati@neskometal.com.tr +355674092730

¹⁶⁸ <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/>

Shtojca B – Prania në takimet e MSG

Albania-EITI MSG meeting attendance chart																	
MSG meeting	13.feb.15	13 March 2015	02.apr.15	2 June 2015	21 July 2015	16 Oct 2015	06.nov.15	23 Dec 2015	6 May 2016	9 June 2016	29 July 2016	31 Oct 2016	31.jan.17	Not attended	Attended	MSG member at that time	
Government																	
MSG Chair														9	4		
Ministry of Energy and Industry														2	11		
Ministry of Finance														13	-		
AKBN														5	8		
Geological Albanian Service														3	10		
Ministry of Justice														7	6		
General Directorate of Taxes														7	6		
Civil society																	
Sami Neza, Center for Transparency and Free Information														3	10		
Ilir Aliaj, Center for Development and Democratizations of the Institutions														4	9		
Anila Hajnaj, Albanian Center for Institutional Development														3	10		
Baki Bajraktari, Miners Union Bulqiza														9	1	3	
Madlina Puka (Vlore)														2	5	6	
Companies																	
Adriatik Golemi, Bankers Petroleum Ltd														5	8		
Saimir Boka, Albchrome														12	1		
Perparim Alikaj, FIAA														2	11		
Dritan Dervishaj, ANTEA Cement														3	10		
Shell																13	
Note																	
<i>a. Shell was appointed as member of MSG by FIAA on 02. 05. 2017</i>																	
<i>b. Other companies were member of MSG on 2015 & 2016</i>																	
<i>c. Already requested different times to the CSOs to replace the missing member of MSG and we have highlighted to them that Mr. Bajraktari since his appointment has been attending meetings only once and asked to them to solve the question.</i>																	
<i>Until now we don't have any response from the CSOs in this regard.</i>																	

Shtojca C – Kostoja e Raporteve EITI

Raporti EITI	Kosto (USD)	Procesi përzgjedhës	MSG S'ka Kundërshtime për TeR	Banka S'ka Kundërshtime	Nënshkrim Kontrate	Emri i konsulentit	Përfundimi i Kontratës
Raporti EITI 2011-2012	109,000	CS - CQ	15-Mar-14	30-Pri-14	2-Maj-14	Deloitte Albania	31-Tet-14
Raporti EITI 2013-2014	100,000	CS - SSS	2-Qer-15	3-Kor-15	14-Kor-15	Deloitte Audit Albania	30-Nën-15
Raporti EITI 2015-2016	128,000	CS - CQ	6-Maj-16	13-Kor-16	18-Kor-16	Deloitte Audit Albania	31-Dhje-17

Burimi: Sekretariati AlbEITI.

Shtojca D – Lista e përfaqësuesve të grupeve të interesit që u konsultuan

Qeveria

ALBANA AGOLLI, Drejtore Departamenti, KLSH, Kontrolli i Lartë i Shtetit

ARLINDA RUMBALLAKU, personel, AlbEITI

ARJANA DYRMISHI, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

AUREL LAMÇE, Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse, Ministria e Drejtësisë

AZBI ARAPI, Drejtor i Drejtorisë së Minierave, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

BORJANA SHAKA, Drejtor për Ekzekutimin e Mbledhjes së Taksave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

BILAL KOÇI, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

BLERIM BRAJA, Departamenti i Hidroenergjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

DORINA CINARI, Koordinatore Kombëtare, Kreu i AlbEITI

ELSA DHULI, Drejtor e Drejtorisë së Statistikave Ekonomike, Instituti i Statistikave (INSTAT)

ENTELE MUHA, Ministria e Drejtësisë

FRAN BRAHIMAJ, Drejtoria e Buxhetit, Ministria e Financave

ILIR BEJTJA, Zëvendës Ministër, Ministria e Energjisë dhe Industrisë

IRSIDA NUELARI, Instituti i Statistikave (INSTAT)

LAVDERIM SAHITI, Kreu i Drejtorisë së Thesarit, Ministria e Financave

MANJOLA NACO, Drejtor i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë i Shtetit (KLSH)

MAJLINDA ARUCI, Departamenti i Hidroenergjisë, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

MEHMET HASANLAMI, Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Minierave, Ministria e Energjisë dhe Industrisë

MYNYR SINAMAJ, Departamenti i Hidrokarbureve, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN)

NERTILA XHIVESHI, Kreu i Drejtorisë së Tatimeve, Ministria e Financave

NIKOLL KAZA, Drejtor i Burimeve Natyrore, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)

OLTION KUKE, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

RAIMONDA BALILAJ, Kryebashkiake e Patosit

SAJMIR LACEJ, Drejtor i Drejtorisë së Politikës dhe Analizës Fiskale, Ministria e Financave

VALMIRA BEBRI, Instituti i Statistikave (INSTAT)

Industria

ANISA CANAJ, ALBPETROL

BLERIMA AZEMI, Mining Ferro Nickel

DRITAN DERVISHAJ, Drejtor Teknik për Shfrytëzimin Technical, ANTEA Cement

DRITAN SPAHIU, ALBPETROL

HAMZA CUM, Yebei Shpk moi

LAURA CELA, Bankers Petroleum Ltd

LUCA DI BENEDETTO, Ph.D, North Group Mining SHPK

MARINELA JAZOJ, Drejtore Ekzekutive, FIAA

PATRICK PASCAL, Menaxher i Përgjithshëm, Selenice Bitumi Sha

PANOI BOMBAJ, Selenice Bitumi Sha

PERPARIM ALIKAJ, Kreu i Komitetit për Industrinë dhe Minierat, FIAA

SIBA AZEMI, Mining Ferro Nickel

SILVANA HYSENI, Analiste Kontabël dhe Përputhshmërie, Shell Upstream Albania B.V.

SOKOL MATI, Nesko Metal A.Ş.

Shoqëria Civile

ANILA HAJNAJ, Qendra Shqiptare për Zhvillim dhe Integrim

ANI PLAKU, Gender Impact

BAKI BAJRAKTARI, Sindikata e Minatorëve të Bulqizës

ERALD KAPRI, Youth Media Albania

ERION BANUSHI, Kreu i Sektorit për Zhvillim Programesh, Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Komunikim, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

FROSTINA GJINO, Drejtore Ekzekutive, Qendra Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

HENK SCHRAMA, Qendra Shqiptare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

ILIR ALIAJ, Drejtor Ekzekutiv, Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve

LORENC GORDANI, Kryetar, Qendra Shqiptare për Rregullimin dhe Ruajtjen e Energjisë

LVIS TANUSHI, Rrjeti Politik Shqiptar

NERITA SEJAMINI, New Policy Group

SAMI NEZA, Qendra për Transparencë dhe Informacion të Lirë

Administratorë të pavarur

ELVIS ZIU, Engagement Partner, DELOITTE Albania Sh.p.k

JONIDA VESIU, Consulting Manager, DELOITTE Albania Sh.p.k

Partnerë zhvillimi

ELTON QENDRO, Asistent Projekti, Departamenti për Mirë-Qeverisjen në Çështjet Ekonomike Mjedisore, OSBE Shqipëri

FRANK NIKOLLA, Asistent Ekonomik, Ambasada e SHBA

ILIR BASHA, Bankier i Asociuar, BERZH Shqipëri

JEFFREY D BOWAN, Zyrtar Ekonomik & Tregtar, Ambasada e SHBA

JENS REINKE, Përfaqësues i Përhershëm i FMN në Shqipëri

ORLENA SHAPO, Pikë Kontakti Anti-Korrupsion për DGC, GIZ Shqipëri

MATTEO COLANGELI, kreu i Misionit, BERZH Shqipëri

PHILIPP KELLER, Zëvendës-Kreu i Misionit, Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

SIGITA STAFA, Zyrtare e Programit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Media

ENIO CIVICI, Drejtor Informacioni, SCAN TV

FEJZI BRAUSHI, Rrjeti i Gazetarëve Politikë Shqiptarë

LUTFI DERVISHI, gazetar

VJOLLCA KOLGJONI, gazetare

Të tjerë

ASMARA KLEIN, Koordinator EITI Coordinator, PWYP

EMIL OMAROV, Koordinator Rajonal për Euroazinë, PWYP

DRITAN MEZINI, Drejtor Menaxhimi, DM Consulting

Shtojca E – Listë e dokumenteve të referencës

Bibliografi

- Këshilli i Përfaqësuesve. (2010, 7 prill). *Ligj Nr. (12) 2010 Ligji për Organizatat Joqeveritare*. Nga nëntori 2016, from <http://www.icnl.org/research/library/files/Iraq/12-2010-En.pdf>
- Departamenti i Tregtisë i SHBA. (2016, 15 gusht). *Shqipëria - Minierat dhe mineralet*. Nga maj 2017, from <https://www.export.gov/article?id=Albania-Mining-and-Minerals>
- Departamenti i Shtetit i SHBA. (2016, 5 korrik). *2016 Deklaratë për Klimën e Investimeve në Shqipëri*. Nga maj 2017, tek <https://www.state.gov/e/eb/rls/othr/ics/2016/eur/254331.htm>
- Departamenti i Shtetit i SHBA. (2015). *2015 Raport për Transparencën Fiskale*. Nga nëntor 2016, prej <http://www.state.gov/e/eb/ifa/oma/fiscaltransparency/243692.htm>
- US Geological Survey. (2016, qershor). *2014 Minerals Yearbook Albania*. Nga maj 2017, tek <https://minerals.usgs.gov/minerals/pubs/country/2014/myb3-2014-al.pdf>
- USAID. (2015). *Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve*. Nga https://www.usaid.gov/sites/default/files/documents/1861/Europe_Eurasia_CSOSIRreport_2015_Update8-29-16.pdf
- World Oil. (2015, July 8). *Shell, Petromanas i jepet blloku onshore në Shqipëri*. Nga qershor 2017, në adresën <http://www.worldoil.com/news/2015/8/07/shell-petromanas-awarded-onshore-block-in-albania>
- World Petroleum Council. (2003, April). *Industria e Naftës në Bashkimin Europian të Zgjeruar - Sektori i naftës në Shqipëri*. Nga maj 2017, from http://www.world-petroleum.org/docs/docs/pdf/albania_oil_sector.pdf
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. (2017, January 18). *Albania: a country of opportunities*. Retrieved May 2017, from <https://www.developingmarkets.com/sites/default/files/3%20Genti%20Beqiri%20Albania%2C%20AIDA%20A%20Country%20of%20Opportunities.pdf>
- Agjencia Shqiptare për Zhvillimin e Investimeve. (2012). *Albania Mining Industry*. Retrieved May 2017, from <http://www.unindustria.bo.it/flex/cm/pages/ServeAttachment.php/L/IT/D/7%252F5%252Fc%252FD.4cc8c6fefdf7852ccda3/P/BLOB%3AID%3D82744/E/pdf>

AKBN. (2012). "PETROLEUM EXPLORATION AND PRODUCTION IN ALBANIA". Retrieved May 2017, from http://akbn.gov.al/images/pdf/aktivitete/oil_gas_albania.pdf

Alb-EITI. (2017, mars). *Annual Progress Report 2016*. Retrieved from <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/02/2016-Annual-Progress-Report-ENG-.pdf>

AlbEITI. (2016, 6 maj). *Albania's MSG meeting minutes, 06.05.2016*. Nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/05/Minutat-e-Takimit-MSG-6-MAJ-2016.pdf>

AlbEITI. (2016, 29 korrik). *Albania's MSG meeting minutes, 29.07.2016*. Nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/05/Minutat-e-Takimit-t%C3%AB-MSG-29.-07.-2016.pdf>

Alb-EITI. (2017). *Alb-EITI MSG ToR*. Nga <http://www.albeiti.org/multi-stakeholder-group/regulation-of-msg/>

Alb-EITI. (2013). *Raport për Aktivitetin Vjetor*. Nga Alb-EITI: https://eiti.org/sites/default/files/documents/2013_eiti_albania_annual_activity_report.pdf

Alb-EITI. (2016, nëntor). *Strategjia e komunikimit për 2016-2017*. Nga http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/07/Final-communication-strategy_EITI_2016_2017.pdf

Alb-EITI. (2016, dhjetor). *EITI Albania Open Data Policy*. Nga qershor 2017, në <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/Open-Data-Policy.pdf>

AlbEITI. (2014). *Anketimi për Ndikimin*. Marrë nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2015/03/Survey-Results.pdf>

Alb-EITI. (2016, shtator). *Anketimi për Ndikimin*. Marrë nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/2016-Impact-and-Outcomes-of-EITI-Implementation-in-Albania-4-ENG.pdf>

Alb-EITI. (2016, 29 korrik). *Shënime takimi të MSG më 29 korrik 2016*. Marrë nga maj 2017, në adresën <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/05/Minutat-e-Takimit-t%C3%AB-MSG-29.-07.-2016.pdf>

AlbEITI. (2017, Mars). *Open Data Policy Paper*. Nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/Open-Data-Policy.pdf>

Alb-EITI. (2017, qershor). *Supplementary 2015 EITI Report*. Marrë nga Subnational transfers of royalties: <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/EITI-Report-2015-Subnational-Royalty-1.pdf>

AlbEITI. (2014, tetor). *Anketim mbi Ndikimin e EITI në Komunitet*. Marrë nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2015/03/Survey-Results.pdf>

- AlbEITI. (2016, janar). *Anketim mbi Ndikimin e EITI në Komunitet*. Retrieved from <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/Anketa-2-Anglisht-.pdf>
- AlbNet-EITI. (2016, janar). Statuti i Rrjetit Shqiptar - EITI. Tiranë, Shqipëri.
- Balkan Insight. (2014, November 3). *Albania's New Public Consultation Law Wins Praise*. Nga qershor 2017, në adresën <http://www.balkaninsight.com/en/article/civil-society-hails-approval-of-albania-s-public-consultation-law>
- Balkan Insight. (2016, Mars 22). *Self-Censorship in Albania's Media Worries MEPs*. Marrë nga 2017, në adresën <http://www.balkaninsight.com/en/article/european-parliament-concerned-with-widespread-self-censorship-in-albanian-media-03-22-2016>
- Banka Botërore. (2012). *ALBANIA - Public Expenditure and Financial Accountability Assessment (PEFA) 2011*. Retrieved June 2017, from <https://pefa.org/sites/default/files/assessments/comments/AL-Jan12-PFMPR-Public.pdf>
- Banka Botërore. (2015). *Grant Agreement with the Government of Albania*. Banka Botërore.
- Bankers Petroleum. (2016, July). *July 2016 Corporate presentation*. Marrë nga 2017, në adresën <http://www.bankerspetroleum.com/sites/default/files/presentations/pdfs/BNK-2016-07-05-%20Corporate%20Presentation%20July.pdf>
- Bankers Petroleum. (2017, May). *Patos Marinza Oilfield, Albania: "Not Dead Yet"*. Marrë në maj 2017, nga http://www.geoconvention.com/uploads/2017abstracts/109_GC2017_Patos_Marinza_Oilfield_Albania.pdf
- BE. (2013, dhjetor). *Raport për Vlerësimin e Nevojave të Shqipërisë Rishikuar (Përfundimtar)*. Marr nga qershor 2017, në adresën http://www.tacso.org/doc/nar_al2014april.pdf
- BERZH. (2012). *Transition Report Albania 2012*. Retrieved May 2017, from <http://www.ebrd.com/downloads/research/transition/assessments/albania.pdf>
- Bertelsmann Stiftung. (2016). *Transformation Index BTI*. Marrë nga <https://www.bti-project.org/en/reports/country-reports/detail/itc/alb/ity/2016/itr/ecse/>
- Bordi, E. (2016, tetor 26). *35th EITI Board meeting Minutes*. Marrë nga EITI.org: https://eiti.org/sites/default/files/documents/35th_eiti_board_meeting_-_minutes.pdf
- CIVICUS . (2010). *Civil Society Index Country Report for Albania*. Marrë nga 2017, adresa <http://www.icnl.org/research/library/files/Albania/albaniacsoi.pdf>
- CIVICUS. (2015). *Outline of CIVICUS*. Marrë në janar 2017, nga

<http://civicus.org/index.php/ar/component/content/article/35-media-centre/open-letters/1581-open-letter-requesting-the-indonesian-parliament-to-reject-to-the-proposed-ormas-law-and-create-an-enabling-environment-for-civil-society>

Eurosupport. (2017, January 25). *Background research, analysis of Albanian national legislative and regulatory framework in implementing EITI standards*. Retrieved May 2017, from <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/Legal-review-Final-Report-ENG.pdf>

EBRD. (2016, November). *Transition Report 2016-17 Albania*. Marrë në maj 2017, nga http://2016.tr-ebrd.com/wp-content/uploads/2016/11/TR2016_CA_Albania.pdf

EBRD. (2008). *Transition Report 2008*. Marrë në maj 2017, adresa <http://www.ebrd.com/downloads/research/transition/TR08.pdf>

EITI. (2016, 10 06). *EITI - About us - Secretariat*. Marrë nga EITI.org: <https://eiti.org/about/Secretariat>

EITI. (2007, nëntor 23). *EITI Newsletter December 2007*. Marrë në janar 2017, adresa <https://eiti.org/es/node/3923>

EITI. (2009, maj). *MINUTES OF THE 9TH EITI BOARD MEETING, WASHINGTON, 14-15 MAY 2009*. Marrë qershor 2017, adresa https://eiti.org/sites/default/files/documents/boardmeeting_009_minutes.pdf

EITI Shqiperi. (2016, dhjetor). *Raporti EITI 2015 Shqipëri*. Marrë në maj 2017, adresa https://eiti.org/sites/default/files/documents/2015_albania_eiti_report.pdf

EITI. (2009, February). *The 4th EITI Global Conference Configure*. Marrë korrik 2017, adresa <https://eiti.org/conference/2009-doha>

EITI. (2015, March). *The EITI, NOCs and the sale of the government's oil*. Marrë nëntor 2016, adresa <https://eiti.org/node/4867>

Deliberately considered. (2011, October 7). *A Hunger Strike in Albanian Mines: A Quest for Justice and Sound Public Policy*. Marrë në qershor 2017, adresa <http://www.deliberatelyconsidered.com/2011/10/a-hunger-strike-in-albanian-mines-a-quest-for-justice-and-sound-public-policy/>

Departamenti i Shtetit i SHBA. (2016). *Raporti i të Drejtave të Njeriut Shqipëria*. Marrë nga Departamenti i Shtetit i SHBA: <https://al.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/140/2017/03/Albania-2016.pdf>

DM Consulting Services. (2015, March). *Feasibility study for the implementation of EITI data integrated system in Albania*. Retrieved May 2017, from <http://dm-consulting.biz/projects/feasibility-study-for-the-implementation-of-eiti-data-integrated-system-in-albania/>

- FIAA. (2012, 19 prill). *Foreign Investors Association in Albania*. Marrë nga www.fiaalbania.al:
<http://fiaalbania.al/press-release-on-the-expoconference-on-albanian-natural-resources-3rd-edition/>
- Financial Times. (2013, 13 shkurt). *Albania cancels murky Albpetrol sale*. Marrë maj 2017, adresa
<http://blogs.ft.com/beyond-brics/2013/02/13/albania-cancels-murky-albpetrol-sale/>
- FMN. (2016, janar). *ALBANIA FISCAL TRANSPARENCY EVALUATION*. Marrë në maj 2017, adresa
<https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr1605.pdf>
- FMN. (2016). *Article IV Consultation: Albania 2016*. Marrë në maj 2017, adresa
<https://www.imf.org/external/pubs/ft/scr/2016/cr16143.pdf>
- Freedom House. (2017). *Freedom in World 2017, Albania*. Marrë në qershor 2017, adresa
<https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2017/albania>
- Freedom House. (2016). *Freedom in the World*. Marrë në nëntor 2016, adresa
<https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2016/iraq>
- ICNL. (n.d.). *Summary of Albanian Laws on NGOs*. Marrë nga ICNL:
http://www.icnl.org/research/library/files/Albania/ALB010901_law_npo.pdf
- Hart Nurse Ltd. (2011, gusht). *Validim për EITI-n në Shqipëri*. Marrë nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/04/Albania-Validation-report.pdf>
- Keshilli i Europes. (2016, maj). *CIVIL PARTICIPATION IN DECISION-MAKING PROCESSES*. Marrë nga
<https://rm.coe.int/1680701801>
- Keshilli i Ministrave. (2010, korrik 7). *Vendim për ngritjen e sekretariatit kombëtar*. Marrë nga Alb-EITI:
http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/03/VKM_Nr_540_date_07_07_2010-Ngritja-dhe-funksionimi-i-sekretariatit.pdf
- Keshilli i Ministrave. (2008, 27 dhjetor). *Dekret 156 për Ngritjen e Grupit Ndër-Institucional të Punës*.
Marrë nga http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/04/VKM_Nr_156_date_27_12_2008_per_Sekretriatin_EITI.pdf
- Keshilli i Ministrave. (2015). *DIGITAL AGENDA OF ALBANIA FOR 2015-2020*. Marrë nga
http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf
- Keshilli i Ministrave. (2001, maj 7). *Ligj për Regjistrimin e Organizatave Jo-Fitimprurëse (#8789)*. Marrë nga
<http://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/02/NGO-Registration.8789.pdf>
- Keshilli i Mnistrave. (2011, korrik). *Dekret #71 për Ngritjen e MSG*. Marrë nga <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/04/MSG-Validation-report.pdf>

content/uploads/2014/04/Urdheri-i-Kryeministrit-Nr.-71-dat%C3%AB-21.07.2011.pdf

Kodi i Sjelljes i OSHC-ve. (2015, April). Code of Conduct of CSOs involved in the EITI process. Tirana, Albania.

Kryeministri. (2011, 21 korrik). *Dekret #71 për ngritjen e MSG*. Marrë nga Alb-EITI:
<http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/04/Urdheri-i-Kryeministrit-Nr.-71-dat%C3%AB-21.07.2011.pdf>

Nenkomiteti i FIAA per Minierat, Naften & Gazin ne EITI. (2011, 12 shtator). Marrë nga www.fiaalbania.al:
<http://fiaalbania.al/fiaa-s-subcommittee-of-mining-oil-gas-will-be-part-of-the-working-group-to-follow-up-procedures-of-the-membership-of-albania-in-the-extractive-industry-transparency-initiative-eiti/>

NRGI. (2015, prill). *Natural Resource Governance Institute organized first training on data analyses of EITI reports based on New Standard*. Marrë korrik 2017, adresa <http://eiti.org.ua/en/2015/04/first-eiti-standard-based-data-analyses-workshop-organized-by-nrgi-in-istanbul/>

Ministria e Energjisë dhe Industrisë. (2016, shkurt). *Fjalim i Ministrit të Energjisë dhe Industrisë Damian Gjikhuri*. Marrë nga BalkanWeb: <http://balkanweb.com/site/gjikhuri-ne-konferencen-e-eiti-t-ne-peru-transparence-per-shfrytezimin-e-burimeve-natyrore/>

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjise. (2009, 20 mars). *APPLICATION FOR EITI CANDIDATE STATUS*. Marrë në qershor 2017, adresa
http://archive.resourcegovernance.org/sites/default/files/Albania_EITI%20Application.pdf

Ministria e Energjise dhe Industrise. (2016, tetor). *Energy and Building Fair*. Marrë në
<http://www.albeiti.org/the-third-edition-of-the-energy-and-building-fair/>

Ministria e Mjedisit. (2015, 24 shkurt). *Albania - Ensuring Public Participation in Decision Making: Best practices and Challenges*. marrë në qershor 2017, adresa
https://www.unece.org/fileadmin/DAM/env/pp/ppdm/5th_PPDM/Presentations/Enkelejda_Malaj.pdf

OGP Shqiperi. (2012, prill). *OGP Action Plan*. marrë nga Open Government Partnership:
https://www.opengovpartnership.org/sites/default/files/legacy_files/country_action_plans/Albanian%20OGP%20Action%20Plan_2.pdf

Qendra Burimore Anti-Korrupsion. (2011). *Overview of corruption situation in Albania*. Retrieved from
<https://assets.publishing.service.gov.uk/media/57a08ab0ed915d3cfd0008b2/expertanswer-289.pdf>

Qendra për Zhvillimin dhe Demokratizimin e Institucioneve. (2015, prill 19-21). Workshop with local civil society: outreach for potential PWYP coalition and capacity building on EITI. Tiranë, Shqipëri.

- PWYP. (2016, shkurt). *Global Assembly, Shkurt 2016*. Marrë në korrik 2017, adresa <http://www.publishwhatyoupay.org/wp-content/uploads/2016/03/PWYP-Global-Assembly-2016-report.pdf>
- PWYP. (2015, prill). *News: Communiqué of PWYP Eurasia meeting*. Marrë në korrik 2017, adresa <http://www.publishwhatyoupay.org/pwyp-news/communique-of-pwyp-eurasia-meeting/>
- Parlament. (2015, mars 12). *Amendments to the Law on Hydrocarbons #7746*. Marrë nga <http://www.albeiti.org/eiti-disclosure-mandatory-in-hydro-carbons-law-nr-7746-date-28-7-1993/>
- Parlament. (2010, korrik 15). *Ligji për Minierat #10304*. Marrë nga Alb-EITI: <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2014/04/Ligji-per-minierat-Nr.-10304-dat%C3%AB-15.7.2010.pdf>
- Parlamenti i Shqipërisë. (1998, tetor 21). *Kushtetuta e Shqipërisë miratuar nga Parlamenti i Shqipërisë më 21 tetor 1998*. Marrë në qershor 2017, adresa <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/untc/unpan013810.pdf>
- Parlamenti i Shqipërisë. (2014, 18 shtator). *LAW No. 119/2014 ON THE RIGHT TO INFORMATION*. Marrë në qershor 2017, adresa <http://www.rti-rating.org/wp-content/themes/twentytwelve/files/pdf/Albania.pdf>
- Parlamenti i Shqipërisë. (2001, 7 maj). *LIGJ Nr. 8788, 7 maj, 2001 ON NON-PROFIT ORGANIZATIONS*. Marrë në qershor 2017, adresa https://www.imolin.org/doc/amlid/Albania_Law%20No.%208788%20On%20Non-Profit%20Organizations.pdf
- Partnership for Economic Policy. (2015, prill). *Développement minier et pétrolier et politiques de dépenses publiques au Niger*. Marrë në janar 2017, adresa https://www.pep-net.org/sites/pep-net.org/files/typo3doc/pdf/files_events/2015_kenya_conf/MPIA_12805.pdf
- Plani i Punes Alb-EITI. (2016). *Alb-EITI Workplan*. Marrë nga Alb-EITI: <http://www.albeiti.org/wp-content/uploads/2016/02/Albanian-EITI-Work-Plan-2016-2019.pdf>
- Sali Berisha, P. M. (2009, 16 janar).
- Sindikata e Industrisë. (2007, July 2). *Albanian Chrome Miners Strike over Safety, Pay, and Work Conditions*. Retrieved June 2017, from <http://www.industrialunion.org/archive/icem/albanian-chrome-miners-strike-over-safety-pay-and-work-conditions>
- Shoqata Shqiptare e Energjisë. (2012, April). *Mineral Resources in Albania*. Marrë në maj 2017, adresa <http://aea-al.org/wp-content/uploads/2012/04/MINERAL-RESOURCES-ALBANIA.pdf>
- Shqipëria EITI. (2016, dhjetor). *Raporti EITI 2015 i Shqipërisë*. Marrë në maj 2017, adresa

https://eiti.org/sites/default/files/documents/2015_albania_eiti_report.pdf

Reuters. (2013, 8 shkurt). *Albania calls off Vetro offer for Albpetrol oil firm*. Marrë në maj 2017, adresa <http://www.reuters.com/article/albania-albpetrol-sale-idUSL5N0B8DJ320130208>

Reuters. (2011, 30 shtator). *Albanian miners, DCM Decometal agree to end strike*. Marrë në qershor 2017, adresa <http://uk.reuters.com/article/albania-chrome-strike-idUKL5E7KU1PW20110930>

Re:Common. (2016, shtator). *The Trans Adriatic Pipeline An opportunity or a scam in the making for Albania?* Marrë në maj 2017, adresa <http://www.counter-balance.org/wp-content/uploads/2016/09/Albania-TAP.pdf>

Republika e Kosoves. (2013, tetor 23). *Albania helps Kosovo in EITI Membership*. Marrë në qershor 2017, adresa <http://www.mzhe-ks.net/en/news/albania-helps-kosovo-in-eiti-membership-#.WUnz6hOGOjI>

Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin e Shoqërisë Civile. (n.d.). *Foreign funding in Albania*. Marrë nga <http://www.balkanicsd.net/civil-dialogue/albania/foreign-and-eu-funding/>

TACSO Shqiperi. (2016, shkurt). *INFORMATION SESSIONS' REPORT ON THE TAX TREATMENT OF NON-FOR-PROFIT ORGANIZATION IN ALBANIA*. Marrë në qershor 2017, adresa http://www.tacso.org/doc/al20160330_tax_treatment.pdf

Tirana Times. (2015, 4 dhjetor). *Albania delays privatization plans on Albpetrol*. Marrë në maj 2017, adresa <http://www.tiranatimes.com/?p=125038>